BOTIM I UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

EUROMEDITERRANEAN

Revistë periodike shkencore
8
2016

PËRMBAJTJA

EVROPA JUGLINDORE GJATË PERIUDHËS SË PAS KRIZËS EKONOMIKE DHE FINANCIARE NË EUROZONË. SFIDAT AKTUALE DHE TË SË ARDHMES.

HARMONIZIMI FISKAL I EVROPËS JUGLINDORE
Anastas Angjeli, Ervin Koci.....

TRANSFORMIMI I AUDITIMIT. DIKUR NJË PUNË E THJESHTË TANI NJË PROFESION BASHKËKOHOR.
Greta Angjeli…….....…

KTHIMI I EMIGRANTËVE NË SHQIPËRI. BURIM KNOW-HOW DHE INVESTIMESH. RASTI I RAJONIT GJIROKASTËR, SHQIPËRI
Ilia Kristo, Theodhor Kuro.....

KONKURRENCA DHE KONSUMATORI NE KOSOVE
Teuta Beka……

ÇMIMI I NAFTËS, SI DHE PSE NDRYSHON AI? CILI ËSHTË FAKTORI QË NDIKON MË SHUMË, PRODHIMI, POLITIKA, LUFTA APO REZERVAT E ZBULUARA?
Vladimir Mici, Bukuri Dumani, Rudina Qurku……

TRANSFERET RRJEDHËSE SI BURIM KRYESOR I MBULIMIT TË DEFICITIT TREGTAR- RASTI I KOSOVËS
Rahmije Mustafa, Albulena Zatriqi, Agon Topxhiu……..

CIKLI I BIZNESIT, VEÇORITË E TIJ DHE ECURIA E EKONOMISË SHQIPTARE
Alqi Naqellari, Nexhmedin Dumani.....

INFLACIONI NË SHQIPËRI - PASOJË E TRASMISIONIT NDËRKOMBËTAR TË INFLACIONIT
Alqi Naqellari, Arjan Gjini, Elona Shahini……

TREGËTIA RAJONALE DHE NDIKIMI SAJ NE EKONOMINË SHQIPTARE, RASTI I ITALISË
Elona Shahini, Altin Hoti…….

RISTRUKTURIMI I MFI NË BANKA, SFIDË DHE DOMOSDOSHMËRI (RASTI I NOA)

Etleva Dashi, Natasha Hodaj, Elton Muça, Flora Merko, Nertila Arapaj……

RËNDËSIA E AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE NË NXITJEN E INVESTITORËVE TË HUAJ NË SEKTORIN PRIVAT NË KOSOVË
Leonora Rudhani-Haliti, Hysen Ismajli, Albulena Mustafa Zatriqi.....

ROLI I ARSIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK, NË RRITJEN E BASHKËPUNIMIT RAJONAL DHE TË INTEGRIMIT EVROPIAN.

EDUKIMI UNIVERSITAR, SIPERMARRJA DHE VLERA E STOKUT TE KAPITALIT NJEREZOR NE SHQIPERI
Niko Pano, Ira Zoga (Gjika).....

REFORMIMI I ARSIMIT TË LARTË DHE ZHVILLIMI EKONOMIK.
Skender Demaliaj.....

INVESTIMI NË KAPITALIN NJERËZOR DHE ROLI I EDUKIMIT
Sonila

SHQIPËRIA DHE REFORMIMI NË EDUKIMIN E DJEMVE KUNDRA DHUNËS NË FAMILJE.
Ela Tollkuçi.....

Hyrje

Ky numër i ri i revistës shkencore EUROMEDITERRANEAN përmbledh punimet shkencore të prezantuara në sesionet tematike të Konferencës Ndërkombëtare Shkencore "South East Europe as a Common Market" e organizuar nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë dhe Unioni i Universiteteve Euroaziatike EURAS në datat 14-15 mars 2015.

Dita e parë e konferencës konsistonte në seanca plenare ku merrnin pjesë akademikë, politikanë, profesorë vendas dhe të huaj, studiues, student dhe të ftuar të tjerë. Në sesionin e parë të seancës plenare mbajtën referate mbi cështjet thelbësore të konferencës Kryeministri i Shqipërisë z. Edi Rama, themeluesi i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë Prof. Dr. Anastas Angjeli, Presidenti i Akademisë Evropiane të Shkencave dhe Arteve Prof. Dr. Felix Unger, Presidenti i EURAS Prof. Dr. Mustafa Aydin si dhe Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Prof. Dr. Muzafer Korkuti. Në dy sesionet e tjera të Seancës Plenare referuan Profesore nga Universitete të ndryshme të rajonit, të Evropës dhe të Azisë.

Konferenca në seancën plenare dhe në sesionet tematike analizoi realitetin ekonomik, politik, social të rajonit të Evropës Juglindore, e parë nga një këndvështrim rajonal dhe jo kombëtar. Konferenca trajtoi situatën ekonomike e financiare të rajonit kushtet e periudhës së post krizës globale në përgjithësi dhe asaj të Eurozonës në veçanti, sfidat aktuale dhe të së ardhmes, perspektivën e zhvillimit të rajonit në këndvështrimet e reja ekonomike si dhe perspektivën evropiane të vendeve që nuk janë ende anëtare të Bashkimit Evropian.

Në Konferencë u trajtuann raste nga të gjitha vendet e rajonit, u krahasuan përvojat kombëtare dhe u dhanë rekomandime për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ekonomik rajonal, për rritjen e shkëmbimeve tregëtare ndërmjet vendeve të rajonit si dhe për intensifikimin e dialogut politik dhe social ndërmjet vendeve të rajonit.

Në ditën e dytë të Konferencës, në ambjentet e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë u zhvilluan sesionet tematike ku u referuan temat e përzgjedhura nga komisioni shkencor i Konferencës.

DREJT HARMONIZIMIT FISKAL RAJONAL

Anastas Angjeli
Albanian Parliament
anastasangjeli@hotmail.com

Ervin Koci
Albanian Parliament
erv.koci@gmail.com

ABSTRACT

South East Europe is not a region fiscally harmonized. Generally there has been competition over tax reduction which has tended to weaken revenue collection in relation to GDP. Competition between countries in the region has caused many countries to facilitate or exclude from taxation a number of sectors, which often have consequences in creating the right environment for a sustainable development of the economy. This fiscal diversity can be a factor for tax evasion and smuggling. This makes the coordination of fiscal policies between countries of the region and between the region and the EU, a necessity. Fiscal harmonization has positive effects such as the reduction of tax evasion and smuggling, better competitiveness and efficiency of resources, optimization of revenues to the budget, new features to the functioning of markets, products and services. Regarding South East Europe it will bring less nationalism and more strategic foreign investment. Fiscal harmonization of the countries of SEE is a continuous process in order to harmonize with EU policies and a further step towards EU integration.

Keywords: *fiscal policy, fiscal harmonization legislation, tax evasion, strategic foreign investment.*

Hyrje

Kriza globale dhe perspektiva e afërt e vendeve të rajonit për integrimin e plotë ne BE, na përballin me sfida të përditshme, sfida që na përballin me rreziqe dhe na krijojnë mundësi. Vendet tona duhet të jenë shumë të kujdesshëm për rreziqet, por njëkohësisht ato duhet të gjejnë mundësitë për të shfrytëzuar pozitivisht sfidat për të gjeneruar rritje ekonomike dhe punësim.

Një nga mundësitë që ofron sot globalizimi dhe që duhet të shfrytëzojnë vendet tona është rritja e bashkëpunimit ekonomik, ku politikat duhet të jenë të orientuara për të patur tregje të lidhur fort me njëri tjetrin me qëllimin krijimin e një tregu të përbashkët rajonal.

Që krijimi i një tregu të përbashkët është një histori suksesi mjaftojmë të kujtojmë Shtetet e Bashkuara të Amerikës e cila pas mbarimit të luftës së brëndshme civile duke funksionuar si një treg i vetëm pati një rritje të jashtëzakonshme ekonomike, punësimi dhe teknologjike[1] duke i hapur rrugën krijimit të superfuqisë që ne njohim sot.

Po ashtu Europa u ringrit nga gërmadhat e Luftës II Botërore duke u bashkuar. Fillimi i Bashkimit Europian nisi me traktatin e karbonit dhe çelikut ku vëndet si Italia, Belgjika, Hollanda, Luksemburgu por veçanërisht Gjermania dhe Franca dy rivalet historike vendosën për tu ndërtuar dhe bashkëpunuar së bashku, duke përdorur të dy produktet për mirëqënien e përgjithshme, të cilat më parë ishin burim për luftra.

Një nga hapat që kanë marrë SHBA dhe institucionet e BE për të shkuar drejt një tregu funksional dhe efektiv ka qenë harmonizimi fiskal.

Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Bashkimi Evropian kanë ndërrmarrë hapa konkretë për të ndaluar praktikat e dëmshme tatimore të vendeve anëtare për të qene atraktiv ndaj investitorëve. Arsyeja është se konkurenca e taksave dhe masave proteksioniste nëpërmjet procedurave mund të çojnë në erozionin e të ardhurave tatimore për qeveritë, dhe fut vendet në një garë për ulje taksash që mund të ketë efekte shkatërruese për financat publike të një vendi.

Duke i parë politikat fiskale si faktorin më të rëndësishëm në gjetjen e kapitalit të huaj dhe të punës, vendet tona po bëjnë vite që kanë filluar të konkurrojnë me njëri-tjetrin në bazë të barrës fiskale.

Ekonomitë e vogla si janë ekonomitë e vendeve tona janë më të prirur për t'u angazhuar në konkurrencë fiskale, avantazhi i taksave të ulëta tërheq kapital për tu investuar që mund të prodhojë përfitime të mëdha për thesarin e tyre.

[1] *Paul Kennedy, The Rise and Fall of the Great Powers (New York: Vintage Press, 1987), 242*

Kjo është situata që kemi sot në rajon, ku vendet tona vazhdojnë të luftojnë me njëra tjetrën kush i ka taksat më të ulëta që të shërbej si avantazh konkurrues ndaj një vendi tjetër të rajonit.

Konkurenca midis vendeve të rajonit ka sjellë që shumë vende të lehtësojnë apo përjashtojne nga taksat një sërë sektorësh, që shpeshherë kanë dhënë efektet e tyre negative për të patur një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë.

Rajoni ynë nuk është i harmonizuar nga ana fiskale, është në fillesat e veta, konkurrenca fiskale ka qenë një shqetësim për qeveritë pasi ka patur tendencë të dobësoje mbledhjen e te ardhurave në raport me GDP, që do të thotë më pak investime dhe shërbime për qytetarët.

Ky diversitet fiskal midis vendeve të rajonit midis të tjerave është një faktor për zhvillimin e evazionit fiskal dhe kontrabandës, përmend këtu tendencën për kontrabandën e kafes për bë vendin tim, pasi në Ballkan vetëm Shqipëria aplikon akcizë për këtë produkt apo karburantet ku vendet e rajonit kanë barrë fiskale me diferenca të mëdha ose politika subvencionuese për sektorë të vecantë. Këto ndryshime të niveleve të taksave shërbejnë si elementë motivimi për bizneset abuzivë për të kryer evasion fiskal dhe kontrabandë.

Kjo e bën të domosdoshme që midis vendeve të rajonit të filloj koordinimi mbi aplikimin e tarifave fiskale sidomos ato tatimore, por në të njëjtën kohë kjo duhet të jetë shoqëruar me politika fiskale për të njehsuar dhe thjeshtuar procedurat nëpërmjet harmonizimit të legjislacionit fiskal midis vendeve të rajonit si dhe me atë të Bashkimit Europian.

Vendosim theksin te njehsimi dhe thjeshtimi i procedurave pasi sipas Trading Across Borders i cili është matësi i Doing Bussines i prodhuar nga Banka Botërore që mat lehtësinë për të importuar dhe eksportuar lë vëndet e rajonit tonë jashtë 50 vëndeve të para[2]. Po ashtu niveli i hapjes së ekonomive tona i matur si raporti i importet dhe eksporteve mbi Prodhimin e Brëndshëm Bruto është shumë më i ulët se në vëndet e Europës Qëndrore dhe për më tepër vetëm rreth 20% e importeve dhe ekporteve kryhen brënda rajonit. Kjo shifër është më e ulët se ajo e vëndeve të Bashkimit Europian, por dhe e vëndeve të Europës Qëndrore të cilat duke ndjekur rrugën e një tregu të përbashkët janë bërë tashmë pjesë e Evropës së Bashkuar.

Vlerësojmë se këto të dhëna janë një rezultat i qartë i barrierave të fshehura të vendosura nga vëndet tona dhe pasojat që ato sjellin janë shumë negative për ekonominë kombëtare por dhe për atë rajonale.

[2] *http://www.doingbusiness.org/rankings*

Së pari mallrat dhe kapitali nuk lëvizin lirisht duke bërë që resurset të mos përdoren në mënyrën më efiçente të mundshme. Kjo sjellë deformim të tregut dhe si pasojë kostot të shtuara mbi qytetarët[3].

Së dyti duke qënë se ekonomitë e këtij rajoni janë relativisht të vogla për interesat e korporatave dhe investitorëve, barrierat e fshehta dhe mungesa e harmonizimit në këtë drejtim pengon vërshimin e mëtejshmëm të investimeve të cilat kanë ulur ritmet që pas fillimit të krizës.

Së treti barrierat e fshehura ndikojnë në mungesën e standarteve duke nxjerrë nga tregu produktet më cilësore të cilat do të mund të na bënin më konkurues në tregun global.

Së katërti këto barriera stimulojnë sipërmarrësit e ndryshëm që ti anashkalojnë ato duke përdorur mënyra korruptive. Efekte këto të cilat rrisin kontrabandën dhe evazionin fiskal

Së pesti këto barriera pengojnë konkurencën e cila sic thotë dhe Joseph Schumpeter por siç ka treguar dhe historia e vëndeve më të zhvilluara stimulon inovacionin i cili është motori lëvizës i ekonomisë së tregut dhe i mirqënies

Sot ekonomia globale nuk është në ditët e saj më të mira, madje është në një pikë kritike, e cila ka dhënë efektet dhe rajonin tonë duke penguar rritjen ekonomike dhe duke rritur numrin e individëve të cilët jetojnë nën nivelin e varfërisë.

Në situatën që jemi lindin pyetjet:

A mund të përballim këtë sfidë si ishuj të ndarë nga Europa e Bashkuar apo si një rajon i bashkuar i cili kërkon të integrohet duke u bazuar mbi avantazhet konkururese të secilit.

A mund të kërkojmë ti bashkohemi Europës dhe të përthithim investime nëpërmjet bllokadave fiskale mes nesh apo duke lejuar individët dhe sipërmarrjet të konkurrojnë lirisht në një treg realisht të bashkuar?

Konceptit i harmonizimit fiskal identifikon një proces sipas cilin sistemet e ndryshme tatimore priren drejt nje strukture shume ose me pak homogjene fiskal dhe për secilin burim të hyrash tatimore kanë të njëjtin presion tatimor.

Fillimisht si ide dhe më pas një teori, harmonizimi fiskal është një temë e ditës në tryezat ekonomike të vendeve.

Për këtë qëllim është i nevojshëm sensibilizimi në drejtim të integrimit rajonal por dhe objektiva të qarta dhe të gjithpranuara nga politikibërësit e vëndeve të rajonit si dhe nga përfaqësuesit e dhomave të ndryshme të tregëtisë pasi harmonizmi i plotë rrit konkurencën e ndershme duke vënë në qëndër qytetarin.

Së pari për sa i perket vëndeve të rajonit është fakt se ato të cilat pengojnë lirinë e tregut nuk janë tarifat doganore, pasi gati të gjithë vëndet e rajonit

[3] *LSE, South East Europe after the Economic Crisis: a New Dawn or back to Business as Usual (36-37)*

kanë marrëveshje midis tyre si marrëveshja CEFTA, apo mos-aplikimi i tarifave doganore me vëndet e Bashkimit Europian si dhe janë nënshkruese të marrëveshjeve te mosdiskriminimit me vëndet e OECD-së. Ato të cilat sjellin pengesë së tregëtisë së lirë nga pikëpamja fiskale janë taksat si dhe barrierat e fshehta nëpërmjet procedurave me shumë hallka dhe me kosto financiare dhe në kohë që nevojiten për të importuar dhe eksportuar, efekte të cilat sjellin në kosto të shtuara në krahasim me mesataren e vëndeve të Europës Qëndrore[4].

Pra ajo që frenon integrimin rajonal dhe hapjen e mëtejshme të ekonomive tona nga pikpamja janë burokracitë si dhe mungesa e standarteve të gjithpranuara midis vëndeve tona.

Në deklaratën e Samitit të Berlinit mes vëndeve të Ballkanit Perëndimor u ra dakort se rritja ekonomike dhe integrimi rajonal mund të arrihet vetëm përmës hapjeve së tregjeve të cilat do të ndihmojnë në rritjen e investimeve të huaja direkte. Në të njëjtën Konferencë u dakortësua se zinxhiret tregëtare mes vendeve të rajonit duhen shtuar e për këtë motiv kërkohet bashkëpunimi midis agjensive të investimeve të vëndeve të rajonit. Për të arritur këto objektive rajoni do ketë mbështetjen e plotë të Bashkimit Europian[5].

Takimi i Shtatorit në Mal të Zi i iniciuar nga komuniteti Gjerman i biznesit por dhe takimet e ndryshme bilatrale kanë hapur dritën jeshile drejt konkurencës së ndershme.

Në fund të fundit sic thotë dhe babai i kapitalizmit, Adam Smith, sido që të jetë gjëndja ekonomike e një vendi, sido që të jenë kapacitetet intelektuale e rëndësishme për zhvillimin e afatgjatë është raporti midis individëve të cilët kryejnë punë për të cilat kanë aftësi specifike dhe sa prej tyre jo[6]. Kjo mund të arrihet vetëm përmës lëvizjes së lirë të mallrave, individëve, shërbimeve dhe kapitalit.

Harmonizimi fiskal ka efekte pozitive në ekonomitë e vendeve tona, do të sjell reduktim të evazionit fiskal dhe kontrabandës, do të rrise konkurrueshmërine dhe efektivitetit e burimeve, do të sillte optimizim të të ardhurave në buxhet, do të sjellë karakteristika të reja në funksionimin e tregjeve të produkteve dhe shërbimeve si dhe për rajonin e Ballkanit do të sillte më pak nacionalizem (sëmundje me shume kosto) dhe më shumë investime.

Harmonizimi fiskal i vendeve të rajonit duhet të jetë në vëmendjen e parlamenteve në procesin e vazhdueshëm për të harmonizuar politikat me

---

[4] Peter Sanfey and Simone Zeh, Trade potential and long-run growth in SEE

[5] http://www.bundesregierung.de/Content/EN/Pressemitteilungen/BPA/2014/2014-08-28-balkan.html

[6] http://schools.birdvilleschools.net/cms/lib2/TX01000797/Centricity/Domain/1013/AP%20Economics/wealthOfNations.pdf (fq 8-9)

vendet e BE dhe është një hap shumë i mirë në integrimin e rajonit në BE si dhe për të përballuar me sukses rreziqet që vijnë nga krizat globale.

Si përfundim mund të thuhet qartë se rruga drejt zhvillimit të mëtejshëm rajonal dhe konvergimit të këtij rajoni me vendet e Bashkimit Europian duhet të nisë nga forcimi i bashkëpunimit tregëtar, rezultat i cili mund të arrihet vetëm nësë vëndet e rajonit tonë do të jenë më të harmonizuara nga pikpamja fiskale.

Harmonizmi i plotë fiskal është një nga levat më të rëndësishme që kemi në dorë. Në mënyrë që ta përdorim atë efektivisht duhet vullnet dhe gjithpërfshirje për të vendosur në qëndër të zhvillimit konkurencën e lire duke shtuar tortën dhe jo duke ruajtur me fanatizëm copëzat e saj.

BIBLIOGRAFIA

Paul Kennedy, The Rise and Fall of the Great Poëers (New York: Vintage Press, 1987),

LSE, South East Europe after the Economic Crisis: a New Dawn or back to Business as Usual (36-37)

Peter Sanfey and Simone Zeh, Trade potential and long-run growth in SEE

http://www.doingbusiness.org/rankings

http://schools.birdvilleschools.net/cms/lib2/TX01000797/Centricity/Domain/1013/AP%20Economics/wealthOfNations.pdf

http://www.bundesregierung.de/Content/EN/Pressemitteilungen/BPA/2014/2014-08-28-balkan.html

TRANSFORMIMI I AUDITIMIT. DIKUR NJË PUNË E THJESHTË TANI NJË PROFESION BASHKËKOHOR

Greta Angjeli
Mediterranean University of Albania
gretaangjeli@umsh.edu.al

ABSTRACT

The world today demands effective public institutions and auditing agencies that promote honest and competitive governance which serves the present and the future of each nation.
Based on this objective, this study is focused on changing the concept of understanding auditing as a simple job to understanding it as a contemporary profession which faces many obstacles in order to fulfill its duties within a governing structure. The study tries to give an answer to the dilemma faced by governments today: reporting or performance improvement while looking at restructuring the functions of public administration through a conceptual plan of uniting its pieces together; analyzing auditing as a government instrument in order to create public goods; its role in the political processes; with the goal to increase faith of citizens in their government and the method of presenting and communicating the auditing results.
Auditing adds value to governance not only economically but also from the point of view of public service aiding in changing the concept of its real value and the perception of the result of its job, which is really important.

Keywords: *auditing, auditor, public administration, givernance, obstacles of auditing, auditing and governance, political processes, value added from auditing, reporting, governing performance, public institutions, auditing agency, etc.*

KTHIMI I EMIGRANTËVE NË SHQIPËRI BURIM KNOW-HOW DHE INVESTIMESH RASTI I RAJONIT GJIROKASTËR, SHQIPËRI

Ilia Kristo
University of Tirana
ilia.kristo@yahoo.com
Theodhor Kuro
University of Tirana
theodoros.kouros@yahoo.com

ABSTRACT

The globalization trends of international economic integration of product-oriented markets, the rapidly-shifting economic demographic patterns of the globe, the integrated continental and intercontinental economic blocks, the technological developments in communications, manufacturing sector, the cost vs. benefits of the globalization phenomenon in the medium and long-term are safely leading to a reconfiguration of the globe or better to the need for changes in the economic, political, managerial and environmental philosophies in this day and age, the classical and cyclical developments, the characteristic of the market economy and businesses all the way down to the heart of economic and political systems that find themselves located on the brink of the re-modification process.
All the more relevant become the development dynamics of countries in transition, which are an ultimate outcome of the global, including the national and regional ones, particularly at a time of an all-out crisis.
As well as painting a fleeting snapshot of the economic, social, migration and emigration-related developments in the 90's, the paper will endeavor to examine briefly and draw conclusions on the likely outcomes of the

return of the Albanian emigrants, the multi-faceted motives with the stress being laid thickly on the know-how flows and the likelihood for targeting for investment purposes the region of Gjirokastra Albania, in various sectors: agriculture and agro-processing industry. All of the above happening at a time when Albania is a step away from integration into the European Union, hence prompting the legitimate question: What kind of macro-economic policies should the government design and draft in order to achieve sustainability and economic growth?

The paper also intends to evaluate whether the return of emigrants translates merely as a new dynamics in the labor market or it could be interpreted as changes in the factors of economic growth. Put in a different context, the increase in manufacturing productivity is attributable to the growth of workforce or to the exogenous changes in the total factor productivity (TFP).

Keywords: *emigrants, return, Albania, problems*

HYRJE

Kriza ekonomike filloi duke prekur fillimisht sektorin financiar por në një kohë të shkurtër asimiloi tiparet e një krize të përgjithshme ekonomike. Efektet e saj, të transmetuara nga SHBA në Evropë sollën jo vetëm dinamika në tregjet e të mirave, financiare, lëvizjen e kapitalit por edhe në karakteristikat demografike kryesisht të vendeve në tranzicion ekonomiko-politik, sfida më ë madhe e të cilave ishte konvergjenca drejt Perëndimit.

Analizat teorike dhe empirike për krizën ekonomike nxjerrin përfundimin se nuk janë vetëm rregullimet e mundshme në tregjet financiare kombëtare dhe ndërkombëtare ato që mund të përmirësojnë situatën, por edhe një sërë faktorësh që shkaktuan uljen në kërkesë për mallra dhe shërbime, borxh financiar si dhe ulja e ndjeshme në investime (Banka Botërore, 2008). Në botën në proces dinamik integrimi, lëvizin gjithnjë e më lirshëm mallrat, shërbimet dhe faktorët e prodhimit por, fatkeqësisht po kaq lirshëm me gjasa edhe më shpejtë, përhapen edhe efektet e krizës, që në një kohë relativisht të shkurtër shtrihen nga rajone të veçanta në të gjithë globin. Kështu që nga vendet/rajonet e origjines, kriza ekonomike përhapet duke prekur si sipërmarrjen private, ashtu edhe ekonomitë familjare. Pra, në një kohë shumë të shpejtë kriza ekonomike do të infektonte shumë vende evropiane (pavarësisht nivelit të zhvillimit) ndër to edhe Greqinë.

Leximi që i bëhet krizës tregon se sa më shpejt të ndihet dhe paraprihet kriza prej politikës, aq më të mëdha janë gjasat e përballimit të shpejt të saj dhe me kosto më të ulët. Dihet që ka një dallim mes vendeve në tranzicion për përpjekjet subjektive të mos pranimit të krizës dhe leximit jo teknik të saj. Normalisht këto vende për inerci dhe për shkak të mos integrimit të plotë ndërkombëtar mund të preken nga kriza në një stad më të lartë varësie por, leximi dhe paraprirja e saj është një nga instrumentat për ta përballuar dhe për të dalë më shpejt.

Vendet objekt të këtij punimi janë Shqipëria dhe Greqia, e njohur si destinacioni i 60% emigrantëve shqiptarë që pas rënies së komunizmit (Banka Botërore 2010). Nuk vonoi shumë derisa në vitin 2008 Greqia u përball me një situatë të vështirë ekonomiko-financiare. Kjo e fundit do të thellonte borxhet, do të sillte falimentimin e shumë bizneseve (në të cilët ishin të punësuar një numër i madh shqiptarësh), do të sillte mëdyshje për kthimin tek "drachma" por mbi të gjitha do të pozicionontе në një pikë kritike daljen e këtij vendi nga Eurozona. Pyetja që shtrohet është se ku dhe si do të ndikojë kjo gjëndje e "jashtëzakonshme" në jetët e emigrantëve shqiptarë e më gjerë?

Është e paevitueshme që kthimi i emigrantëve do të presionojë ofertën për punë. Kjo jo domosdoshmërisht do të shoqërohet me një rritje në numrin e të punësuarëve. Kështu që është e domosdoshme të analizohet tregu i punës në sektorin kyc të punimit, bujqësinë. Nëse emigrantët e kthyer orientohen drejt punësimit në bujqësi dhe agropërpunim a do të jetë kjo zgjedhje eficente dhe afatgjatë për ta dhe ekonominë shqipare?

Rreth 60% e kthimeve u vendosën në vendet e origjinës si Gjirokastra, Korca, Saranda dhe Fieri ata filluan të investonin kursimet e tyre në formën e bizneseve të orientuara nga bujqësia dhe agropërpunimi. Theksi vendoset mbi rajonin e Gjirokastrës për arsye se në këtë rajon janë eksploruar prirjet e migrimit, investimeve dhe ecuria e prodhimit bujqësor. Për më tepër, aty përqëndrohet përqindja më e madhe e kthimeve si dhe ekzistojnë një sërë përparësish që i vijnë në ndihmë analizës së këtij sektori ku eksperiencat knoë-hoë priten të risin masën e investimeve. Por më parë le të arsyetojmë se pse ky sektor kyç në ekonominë shqiptare është baza e investimeve të emigrantëve të kthyer si dhe sa kanë ndikuar investimevet kryesisht në rajonin e Gjirokastrës, fokusuar në prirjet rritëse/rënëse dhe faktorët që influencojnë këto dinamika.


2. EMIGRACIONI NË GREQI

Prirjet e shqiptarëve për të emigruar drejt shtetit grek por edhe flukset e mëdha të pas viteve 90' mbështeten në disa shkaqe. Së pari, mund të hyje lehtësisht në Greqi legalisht apo ilegalisht. Së dyti të qënit shtet fqinj ishte positive për të larguarit. Së treti mund të punësoheshe lehtësisht në të zezë si dhe flitej për paga relativisht të kënaqshme. Së fundmi, një pjesë e mirë e tyre ishin me prejardhje greke.

2.1. Emigrimi pas viteve 90'

Pas rënies së komunizmit, Shqipëria renditej së bashku me Rumaninë në dy shtetet me flukse më të larta emigrimi në kontinent. Nga fundi i vitit 2011, 1.4 milion shqiptarë ose 1/3 e popullsisë vendosi të emigronte kryesisht në Greqi dhe Itali (Banka Botërore 2011).

Figura 1. Numri i emigrantëve legal (ligjor) shqiptarë në periudhën 1990-2010



Burimi: USAID & ACIT (2011)

Duket që emigrimi në aspekt kohor, lidhet me ngjarje të rëndësishme kryesisht politiko-ekonomike, shkak-pasojat e të cilave detyruan rreth një million shqiptarë të emigronin në destinacione të ndryshme. Në fillimet e krizës (2008-2009), prirja e emigrimit është rënëse pasi kjo periudhë ndesh më tepër kthime sesa largime. Por, cilat ishin shkaqet kryesore që i detyruan shqiptarët të braktisin vendin e tyre?

2.2. Shkaqet e emigrimit dhe sektorët e punësimit

Arsyet e emigrimit të shqiptarëve pas viteve 90' lidhen me faktorë ekonomik, financiar por mbi të gjitha me aspekte sociale. Shumë prej tyre ishin të papunë, të paarsimuar, pa prespektivë për të ardhmen dhe mbi të gjitha nuk do të dëshironin të njëjtën situate për pasardhësit e tyre. Nga ana tjetër fakorë si gjëndja shëndetësore apo ajo psikologjike e ndikuar nga ndryshimet që sollën trazirat e viteve 90' në ekonomitë familjare, pakënaqësitë në punë apo sigurinë e përgjithshme bën që shqiptarët jo vetëm të dëshironin emigrimin por një nevojë të përgjithshme për të përmirësuar kushtet e jetesës. Faktorë të tjerë do të interpretoheshin nga vendet pritëse si shkaqe të përgjithshme, të kudondodhura në botë.

Sakaq, Greqisë do t'i hynte shumë shpejt në punë forca e lirë punëtore e grumbulluar nga të ardhurit shqiptarë që kërkonin domosdoshmërisht një punë. Paraqitja krahasuese e mëposhtme e sektorëve të punësimit të emigantëve në Greqi lidhet me përcaktimin e nevojave të ekonomisë greke për krah të lirë por edhe nevojën e shpejtë të tyre për të ardhura. Punësimi sipas sektoreve i emigrantëve shqiptarë në kohën ku shteti grek po përballej me krizën ekonomiko-financiare dhe periudhën para saj tregon gjithashtu imunitetin e sektorëve të caktuar ndaj krizës.

Figura 2. Sektorët e punësimit të shqiptarëve në Greqi

Sektorët e punësimit	2006	2009
Ndërtim	39%	37%
Industia përpunuese	11%	14.40%
Argokulturë	11%	12%
Shërbime/Turizëm	17%	20.90%
Shërbim shtëpiak[7]		14.4 %
Të tjera	22%	1.20%

Burimi: ACIT & USAID 2012. Tabela: autorët

Kjo pamje sektoriale krahasuese e angazhimit të emigrantëve shqiptarë në 2009 me tre vjet më parë, tregon prirjet ristrukturuese të ekonomisë greke dhe prirjen e orientimit të emigrantëve.

7 Sektori i shërbimeve në vitin 2006 përfshin shërbimin shtëpiak. Për këtë arsye nuk ka vlere në tabelën e të dhënave. Në vitin 2009 numri i të punësuarëve rritet ndjeshëm, krahasuar me shërbimet e tjera, kërkesa për punë e të cilave u reduktua për shkak të krizës.

3. KRIZA DHE KTHIMI I SHQIPTARËVE

Në vitin 2008 kriza greke ishte zyrtarisht e shpallur. Kjo pati një ndikim të menjëhershëm ekonomik e psikologjik tek emigrantët shqiptarë. Shumë prej tyre tërhoqën kursimet nga Bankat Greke dhe i transferuan në Shqipëri. Kjo tendencë vazhdoi edhe në katër vitet e fundit. Përveç impaktit financiar, rritja e nivelit të papunësisë dhe falimentimi i bizneseve greke bëri që këta emigrantë të konsideronin zgjedhje optimale, në kushte presioni ekonomik dhe psikologjik, kthimin në Shqipëri. Midis 2008-2009 pati një fluks të madh kthimesh i përkthyer sipas institucioneve shqiptare në 120,000 shqiptarë të kthyer (MPJ, 2009). Sipas Zyrave Doganore, pas shpalljes zyrtare të krizës greke, ne vitin 2012 ka një rritje të kthimit të emigrantëve 26%. Sipas Zyrave Lokale të Punës kthimet të konsideruara përfundimtare zënë 18-20% të të kthyerve gjithsej. Megjithatë është e vështirë të përcaktohet nëse ata u shpërngulën përkohësisht apo përfundimisht.

Sipas një anketimi të kryer për qëndrueshmërinë e kthimit të tyre, në një pikë doganore, në ditë me hyrje-dalje të konsiderueshme individësh, (Labrianidis & Lyberaki, 2004) rezulton që: 28% e tyre kanë emigruar në Greqi më shumë se një herë dhe se 11.4% e tyre provuan të riemigronin. Kthimi dhe riemigrimi vlerësohet si proçes i vazhdueshëm edhe në të ardhmen pasi 70% e të anketuarëve pohojnë se kthimi është zgjedhje optimale ndërsa 56.5% e tyre do e konsideronin riemigrimin në vartësi të zhvillimeve lokale.

Sektorët e punësimit të shqiptarëve në Greqi ishin kryesisht industria e ndërtimit, agrokultura, shërbimet (figura 2). Një gjykim i parë të bën të mendosh se orientimi i tyre nga punësimi në sektorë publik apo privat, nga investimet krysesisht në nivelin e SME-ve, jo gjithmonë përputhet me aftësitë formimin dhe eksperiencën e tyre. Ky boshllëk riintegrimi natyrisht do të kërkojë dhe kërkon nga pritësit në nivel lokal dhe kombëtar vënien në dispozicion të informacionit, këshillimit e deri tek asistenca financiare.

3.1. Impakti në ekonominë shqiptare

Sikur 50 përqind e të kthyerve do të prireshin të riintegroheshin në vendin e origjinës, çfarë ndikimesh do të kishte kjo lëvizje në ekonominë shqiptare?

Pikërisht, intensiteti i kthimit është një faktor që krijon dinamike por edhe sfidë për ekonominë dhe shoqerinë shqiptare dhe si i tillë duhet të lexohet, konsiderohet dhe paraprihet nga qeverisja lokale dhe qëndrore. Teksa ekonomia greke vazhdon të qëndrojë në reçension dhe niveli i papunësisë është mbi 22%,

shqiptarët e kthyer do të presionojnë sistemin arsimor shqiptar dhe jo vetëm për të përballuar kërkesat e tyre (ACIT & USAID, 2012).

Konsideruar studimin mbi pasojat e krizës ekonomike greke në ekonominë shqiptare konkludohej se në periudhën afatshkurtër, Shqipëria është e limituar në rritjen e sigurisë sociale apo të investimeve në përmirësimin e sistemit shëndetësor konsideruar prirjet për uljen e shpenzimeve publike në mënyrë që të mbajë borxhin publik në kufijtë e pranueshëm.

Por, kthimi i tyre ka edhe impakte pozitive duke filluar nga stimulimi i kërkesës për konsum dhe banesë me qenë se shumë emigrantë nuk kishin një banesë kur u larguan dhe shumë të tjerë synuan zonat urbane pas kthimit. Por, në rradhë të parë impakt pozitiv janë prurjet e ekpertizave dhe njohurive të mbartura nga emigracioni që shumë shpejt do të përkthehen në investime.

3.2. Investime, punësim dhe rritje ekonomike

Është e paevitueshme që kthimi i emigrantëve do të presionojë ofertën për punë. Kjo jo domosdoshmërisht do të shoqërohet me një rritje në numrin e të punësuarëve. Më sipër u përmendën dinamikat e riintegrimit të të kthyerëve, por nuk është ky synimi i kësaj analize. Nëse supozojmë se kthimi i emigrantëve nuk do të ndikojë forcën punëtore (kryesisht në sektorin e bujqësisë dhe agropërpunimit), si do do të interpretohet ky efekt në rritjen ekonomike?


Le të shohim se çfarë na indukton analiza teorike lidhur me pyetjen e mësipërme. Teoria ekzogjene e rritjes (Solow 1956) thotë se progresi teknologjik është burimi i rritjes ekonomike. Produktiviteti total i faktorëve të prodhimit (PTF) që përfshin teknologjinë dhe njohurinë, së bashku me kapitalin human mund të shpjegojnë një pjesë të konsiderueshme të diferencës në të ardhura midis vendeve (Greco & Mastromarco, 2008).

Pas tranzicionit drejt ekonomisë së tregut në 1991, shumë vende të Evropës Lindore mundën të siguronin rritje ekonomike në nivel të lartë dhe të qëndrueshëm. Megjithatë duke marrë në konsideratë se të ardhurat mesatare për frymë në Evropën Lindore ishin sa 30% të të ardhurave për frymë në Evropën Perëndimore, ia vlen të themi se performanca e ekonomive në tranzicion ka qenë zhgënjyese (Greco & Mastromarco, 2008). Kjo do të thotë se ka ende horizont për të adaptuar dhe përvetësuar "kufirin teknologjik" të perëndimit. Ky i fundit do ti bëjë ekonomitë e tyre konkurruese si pasojë e rritjes së produktivitetit, mungesa e të cilit i privon ekonomitë të orientohen drejt tregjeve botërore të eksportit dhe frenon tërheqjen e investitorëve të huaj.

Gjithë diskutimi ekonomik na çon në përfundimin se ekonomitë në tranzicion, ku bën pjesë edhe ekonomia shqiptare duhet të luftojnë drejt rritjes së PTF në mënyrë që të sigurojnë rritje të qëndrueshme por edhe që në terma afatgjatë të konvergjojnë me vendet e Evropës perëndimore.

Në periudhën 1993-1996 rritja mesatare vjetore ishte 9.3%. Ndërkohë që, kriza e skemave piramidale të 97' shkaktuan një rënie prej 11%. Kriza botërore financiare paralizoi rritjen ekonomike nga 7.5% në 2008 në vetëm 3.4% në 2009. Efektet e krizës reflektohen në luhatjet e rritjes ekonomike në periudhën më pas. Ndër të tjera kriza e goditi ekonominë shqiptare në bilancin tregtar duke rënuar eksportet në masë më të madhe sesa rënia e GDP, si dhe në sistemin e kreditimit duke rritur nivelin e kredive të këqija me 12% krahasur me mesataren evropiane. Duket se viti 2013 është fillimi i një reçensioni të gjatë që po e ndjejmë edhe sot.

Figura 3. Rritja ekonomike e Shqipërisë në periudhën 2004-2013 (në %)



Burimi: Të dhënat marrë nga Banka Botërore, përpunimi: autorët

Ulje - ngritjet në rritjen ekonomike shoqërohen me ndryshime në kontributin e sektorëve primarë në GDP si bujqësia. Ndërsa në 97' pesha e bujqësisë në GDP rritet në 32%, në vitin 2009 bujqësia kontribon me vetëm 19.4%. Në vijim (sic tregohet në grafik) trendi është rritës. Kjo mund të lidhet me faktin se prurjet dhe ekpertizat e emigrantëve si dhe "Plani dhe Strategjia për Zhvillim Rural", projekt i asistuar nga Bashkimi Evropian patën ndikim pozitiv

Figura 4. Pesha e sektorit të bujqësisë në GDP në periudhën 2004-2013 (në %)



Burimi: Të dhënat marrë nga Banka Botërore. Perpunimi: autorët

Edhe pse shohim që rritet pasha e sektorit të bujqësisë në GDP, pjesa e dytë e grafikut tregon se ky ndryshimi është thuajse i pakonsiderueshëm. Kjo mund të lidhet me produktivitetin e ulët të sektorit apo mbipunësim.

Le ti kthehemi sërisht modelit neoklasik të rritjes ekonomike (Solow, 1956), që të mund të analizojmë faktorët që përcaktojnë rritjen. Modeli merr në kosideratë produktivitetin e punës, të kapitalit dhe nivelin e PTF si faktorët e rritjes. Supozimi i rradhës është marrja në nivel konstant e punës dhe kapitalit. Gjithashtu, modeli Solow nuk merr parasysh variabla si kualifikimet, niveli arsimor apo eksperiencat profesionale të forcës punëtore. Si metodologji do të përdorim Modelin Soloë të trajtuar nga Kota (2009) i integruar me Robert M. Solow (1956). Modeli është dhënë si një output i agreguar sipas funksionit të prodhimit Cobb Douglass:

Y(t)= F(K(t), A(t)L(t))

$$Y = A \cdot L^{\alpha} \cdot K^{1-\alpha} \quad (1)$$

Ku A- Produktiviteti Total i Faktorëve (PTF), L- faktori punë, K- stoku i kapitalit dhe α-elesticiteti i punës.

Linearizimi i ekuacionit (1) përftohet si më poshtë:

$$\frac{dY}{Y}(\mathbf{1}) = \alpha \frac{dL}{L}(\mathbf{2}) + (1-\alpha)\frac{dK}{K}(\mathbf{3}) + \frac{dA}{A}(\mathbf{4}) \quad (2)$$


ku (**1**) përfaqëson rritjen e GDP dhe (**2**), (**3**), (**4**) përfaqësojnë kontributin nga

punësimi, kapitali fizik dhe PTF respektivisht. Kjo e fundit përftohet si mbetje e ekuacionit të mëposhtëm:

$$A = \log Y - [\alpha \log L + (1-\alpha) \log K] \quad (3)$$

Sipas Greko & Mastromarco (2008), një rënie e vogël në PTF shoqërohet me një rritje të vogël të faktorit punë. Modeli tregon se rritja e qëndrueshme në të ardhurat për punëtor duhet të vijnë nga progresi teknologjik i cili përmirëson aftësitë kualifikuese të forcës punëtore. Pra, një rritje në PTF shoqërohet me një rritje në produktivitetin e punës, rritje në standartin e jetesës si dhe nxitje të konvergjencës mes vendeve me nivel të ndryshëm të treguesve makroekonomik. Si pasojë e mungesës në të dhëna mbi peshën e faktorit punë në të ardhura përdorim supozimin e njohur se 70% e të ardhurave në total vijnë nga punësimi dhe 30% nga stoku i kapitalit fizik.

Figura 5. Rritja ekonomomike dhe faktorët e prodhimit




Burimi: Banka e Shqipërisë, 2012

Duket se kontributi më i madh në rritjen ekonomike deri në vitin 2000 vjen nga PTF. Pas vitit 2000, rritja ekonomike stabilizohet por shihet qartë që renia në PTF sjell edhe rënien në progresin ekonomik. Ndërkohë që kontributi nga punësimi është thuajse i pakonsiderueshëm, madje deri në vitin 2002 është negativ. Kjo mund të shpjegohet me anë të nivelit të pakualifikuar të fuqisë punëtore ose me prirjet e ekonomive në tranzicion për të adaptuar teknologjinë e perëndimit. Në fillimet e krizës ekonomike përveç PTF faktorët e tjerë të prodhimit pësojnë rënie të shpejtë.

Le të kthehemi tek emigrantët për të treguar efiçençën e punësimit të tyre në sekrorin e bujqësise. Për këtë, bazohemi tek prirjet e punësimit sipas sektorëve dhe produktivitetet respektive.

Figura 6. Produktiviteti i punës dhe punësimi sipas sektorëve



Burimi: Kota, 2009

Dukshëm vërehet se bujqësia mban numrin më të madh të të punësuarëve. Madje edhe në fillimet e krizës bujqësia është sektori që pëson më pak tkurrje krahasuar me sektorët e tjerë primarë. Mirëpo, produktiviteti i punës në këtë sektor është i ulët, sado që në periudhën 2001-2008 të jetë më i lartë se në vitet paraardhëse. Sipas Kota (2009), në nivel agregat produktiviteti i punës është rritur mesatarisht me 6.4% përgjatë periudhës 1996-2008. Për këtë arsye është me interes identifikimi i faktorëve pas këtij zhvillimi.

3.3. Procesi i Riintegrimit

Më sipër u analizua se drejtimi i emigrantëve të kthyer drejt punësimit në bujqësi është jo efiçent. Pavarësisht kësaj, fllukset e mëdhja hyrëse në shtetin shqiptar do të presionojnë qeverinë përkatëse për asistencë, burim informacioni, punësim, siguri sociale etj. Për këtë arsye proçesi i riintegrimit dhe problemet e tij duhen analizuar duke marrë në konsideratë kriteret e punësimit në sektorë të ndryshëm, situatën ekonomike të vendit si dhe konkurrencën në tregun e punës. Sidoqoftë, papunësia dhe ngecja ekonomike, që u percollën në Shqipëri nga bota dhe Eurozona, duhen konsideruar si një pengesë e rëndësishme për kthimet apo riemigrimet.


Duket se emigrantët po shfaqin interes në investimin e kursimeve të tyre në Shqipëri, në projekt-biznese. Njohja e kufizuar e veçorive të sistemit të sipërmarrjes në Shqipëri, krahasuar me atë grek, efekti psikologjik i skemave piramidale si dhe ngjarjet e vitit 1997 i bënë të druhen para lëvizjeve të tilla me peshë të konsiderueshme për të ardhmen e tyre. Sipas King & Vullnetari (2003), destabiliteti politik, siguria e ulët sociale, infrastruktura ende e pazhvilluar, pamundësitë për financim afatgjatë, rënia e fuqisë blerëse i listohen faktorëve

pengues për investime, krahas problemeve të pronësisë mbi tokën dhe të rregjistrimit problemi të pronave. Megjithatë, listimi dhe thellimi i vështirësive dhe pengesave për investim nuk e zgjidh problemin e shtruar. Rrjedhimisht, dy janë zgjedhjet parësore që një emigrant i kthyer duhet të marrë parasysh: orientimi 7 i duhur sektorial dhe burimi i financimit 8.

Remitancat janë një burim i konsiderueshëm të ardhurash sidomos në kohë krize, aq sa përqindja dërrmuese e defiçitit buxhetor dhe në periudhën e krizës u financua prej tyre Është e thjeshtë të konsiderojmë se emigrantët investojnë kursimet e tyre por, në mënyrë që të ndodhë kështu do të duhej që të supozonim shifra relativisht të larta. Në 2011, depozitat bankare të emigrantëve në Shqipëri ishin 17% më të larta krahasuar me një vit më parë (ACIT & USAID 2012). Mirëpo, remitancat më tepër shkojnë për konsum dhe shumë pak për investime private (King & Vullnetari, 2003). Nga ana tjetër, financimi përmes kredive për biznes gjatë periudhës së krizës konsistonte në norma të larta interesi, 10% në 2009 dhe 2% më pak në 2010. (Banka Botërore). Le të shohim se si financoheshin investimet private përgjatë viteve dhe të analizojmë periudhën e krizës.

Ajo çka bie menjëherë në sy është defiçit i lartë tregtar në periudhën e krizës. Remitancat janë thuajse impotente për të financuar deficitin.Destabiliteti ekonomik dhe norma e lartë e brendshme e interest frenojnë Investimet Direkte të Huaja (IDH). Sakaq, niveli i kreditimit është i lartë. Për shumë raste kredia e butë, mund të ketë rezultuar efiçente ndërkohë që për emigratë të tjerë mund të ketë qenë shkaku i falimentimit.

Figura 7. Burimet kryesore të financimit për investime private (1996-2011) në % GDP




Burimi: Banka e Shqipërisë, 2012

[7] *Orientimi i duhur sektorial do të analizohet në varësi të kërkimit në terren në zonat më potenciale konsideruar sipas Drejtorisë Rajonale Bujqësore Gjirokastër.*

[8] *Për shkak të mungesës së të dhënave pas vitit 2011, burimet e financimit do të analizohen në varësi të prirjeve të tyre në vazhdim.*

Për sa i përket orientimit sektorial në investimet private, studimi në terren tregon se ai varion në bazë të eksperiencave "know-how" të të kthyerëve. Mosnjohja e tregut dhe sektorëve potencialë për të investuar ka qënë kritike. Emigrantët shprehen se përvoja në një sektor është tregues i mirë por jo gjithmon mjafton.

Figura 8. Pesha e sektorëve kryesor në GDP (në %) në periudhën 1996-2011



Burimi: Banka e Shqipërisë, 2012

Në vitin 2009, pesha e bujqësisë është 19% pra 4.5 pikë % më e lartë së industria ndërtimore. Shërbimet janë një sektor me peshë por edhe risk të lartë. Nëse marrim në konsideratë që fuqia blerëse është ende e ulët për të mira dytësore ngelet të konkludojmë se bujqësia dhe agropërpunimi janë sektorët që zotërojnë më tepër potencial dhe ku Shqipëria ka avantazhin konkurrues. Rastet e studiuara tregojnë se në mungesë të analizës së mësipërme, emigrantët investojnë në ndërtim dhe pas dështimit orientohen drejt bizneseve agro dhe agro përpunuese. Kostoja e riorientimit sektorial është kredia dhe përqindja e interesit. Nëse rastet e mësipërme flasin për emigrantë të kthyer për shkak të krizës akoma më interesant është rasti i kthimit të emigrantit jo për shkak të krizës. Motivi i emigrimit të tij ka qenë më shumë "know how", për ti aplikuar ato në vendin e origjinës se sa nevoja për mbijetesë apo nevoja financiare. Shumë emigrant kanë përfuar nga grantet IPARD-Like[9] dhe jo vetëm njëherë.

[9] *Instrumenti per Asistencë Para-aredimit, IPA ka një komponent të Zhvillimit Rural (IPARD), i cili u siguron vendeve kantidate të BE-së asistencë për implementimin e progameve shumëvjecare duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe zonave rurale si dhe në përgatitjen e tyre për zbatimin e politikave dhe ligjeve të BE-së.*

4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Kriza ekonomike e vitit 2008, për post ndryshimeve në tregjet e të mirave dhe tregun monetar solli kthimin e emigrantëve në Shqipëri. Ky kthim nuk duhet lexuar si dyndje e popullsise drejt tregut të punës apo rritje të pakontrolluar të shpenzimeve publike por si një stimul në investime dhe progres teknologjik.

Dinamikat e procesit riintegrues të emigrantëve të kthyer janë të shumta si, mungesa e asistencës financiare dhe mungesa e qëndrave të informacionit dhe konsulencës. Megjithatë po merren masa në nivel lokal dhe kombëtar me anë të instrumenteve si"Plani dhe Strategjia e Riintegrimit 2010-2015".

Ndonëse dyshohet për mundësi të rikthimit të emigrantëve në Greqi, analiza e investimeve na bën të gjykojmë se epiqendra e një stabiliteti te ri ekonomik është zhvendosur nga Greqia në Shqipëri gjatë viteve të fundit. Kjo nuk përjashton faktin se zhvillimet e fundit politico-ekonomike po e pakësojnë popullësinë shqiptare.

Analiza e rritjes ekonomike na sygjeron se ristrukturimi i fuqise funëtore pas kthimit të emigrantëve duhet të jetë i mirëpërcaktuar me qëllim që në sektorë të caktuar të mos rritet punësimi kur faktori punë nuk e rrit produktivitetin e sektorit. Rrjedhimisht, sektorë si bujqësia dhe agropërpunimi iu nevojiten më tepër përqasja me teknologjinë perëndimore në mënyrë që vendet me nivel të ndryshëm të varfërisë të konvergjojnë. Progresi tekonologjik, një pjëse e mirë e të cilit adaptohet me anë të eksperiencave "know-how" të emigrantëve, jo vetëm rrit eficencën në prodhim dhe cilësinë e produktit, por në periudhë afatgjatë rrit standartin e jetesës, zhvillon aftësinë e shoqërisë për të prodhuar si dhe orienton lehtësisht një ekonomi (sidomos ekonomitë e tranzicionit) drejt tregjeve globale të eksportit.

Këto prirje dhe rastet e studiuara në terren përkthehen në një dinamikë optimiste së pari sepse, në qoftë se dikur në këte rajon ishte e vështirë të gjeje toka të punuara, sot është e vështirë të gjesh tokë të papunuar. Së dyti një pjesë e mirë e fuqisë punëtore buron nga zonat Gramsh, Librazhd etj. që u rezulton më mirë të punojnë në biznese të tilla se sa të emigrojnë. Së treti, gjithnjë e më shumë shikon stalla moderne, industri agropërpunimi që janë duke shkuar drejt eksportit të produkteve dhe modelit se ku duhet të zhvendosen sforcimet e deri tanishme në "industrinë" e marihuanës.

Po kështu, institucionet e qeverisjes lokale dhe qëndrore si dhe ato ndërkombëtare duhet të optimizojnë mbështetjen ndaj emigrantëve të kthyer që ata të gjenerojnë zhvillim ekonomik dhe jo subjekte të asistencës kronike sociale.

BIBLIOGRAFIA

USAID & ACIT (2012), "Study on the Economic Impact of the Greek Crisis in Albania". http://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1863/USAID%20Study%20on%20Greek%20Crisis.pdf

Bank of Albania (2009) Economic Buletin 2009, 12(4).

European Commission (2011), EU Enlargment Strategy 2011-2012, Brussels: COM (2011) 666 final, fq. 55-56.

AZHBR, MBUMK & GIZ (2012), Udhëzuesi për Aplikantët- SKEMA E GRANTEVE "IPARD-LIKE" për Zhvillimin e Sektorit Agro-Ushqimor në Shqipëri 2012-2014, Tiranë: AZHBR (version 1.0), fq. 5-28.

Bank of Albania (2013) Annual report 2012, Tirana

King, R. and Vullnetari, J. (2003) Migration and Development in Albania, Brighton: University of Sussex, Development Research Centre on Migration, Globalisation and Poverty, Working Paper C5.

Fullani, A. (2012) Growth in Albania and South East Europe: The Way Ahead, Oxford: South East European Studies at Oxford (seesox), European Studies Centre.

Labrianidis, L., Lyberaki, A. (2004), "Back and forth and in-between: Albanian return-migrants from Greece and Italy", Journal of International Migration and Integration, 5(1), fq. 77-106.

Greco, N., Mastromarco, C. (2008), "Sources and Determinants of Output Growth in Albania and other Transition Economies". Working Paper, University of Salento, Italy.

World Bank. (2007) 'Albania – Urban growth, migration and poverty reduction: a poverty assessment ' Raport No. 40071- AL, The World Bank, Washington DC.

World Bank, 2012. world development indicators: Albania. Url:
http://data.worldbank.org/country/albania?display=default#cp_wdi

Gedeshi I. (2012),"Effects of the Global Crisis on Migration and Remittances in Albania". Url:
www.iki.bas.bg/files/1_Gedeshi.ppt

Intervista me zyrtarë ne institucionet:

Prefektura dhe Këshilli i Qarkut Gjirokastër
Zyrat e Punës, Gjirokastër
Drejtoria Bujqësore Rajonale Gjirokastër (DBR)
Ministria e Bujqësise, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorëve (MBUMK)

KONKURRENCA DHE KONSUMATORI NE KOSOVE

Teuta Beka
European College "JURIDICA"
lawyer_teuta@yahoo.com

ABSTRACT

Competition is a crucial factor of the progress for economic subjects and of the economy in general. A strong competition increases the efficiency among companies, of the free market and of economy in general. This efficiency includes lower prices, better quality and an advantage over the competition in the market. Market competition incites production efficiency and better results, where as main concern is the consumer's wellbeing. Each market subject presumes to be part of competition market, the inexistence of the entrance and exit obstacles, and transparent prices. With a purpose of creating of such environment, the state creates defense mechanisms. The competition law offers the Kosovar market a legal protection in a sense of securing a free and efficient market competition. Therefore, regulating mutual relations within the market is realized through applying the competition law, which has to be a legal framework for applying certain policy of regulation competition with a purpose of obstructing misuse, and of realization of the basic principles of the commercial law in support of the function of the free market and its protection from unfair competition.

Keywords: *Competition, market, economy, price, law, consumer, misuse, dominant position, law, treaty.*

HYRJE

Konkurrenca e tregut është baza e funksionimit të ekonomisë së tregut ku konkurrenca në treg paraqet një formë të rivalitetit mes ndërmarrjeve. Konkurrenca është dukuri ekonomike në të cilën veprojnë njëkohësisht dy ose më shumë operatorë në treg të cilët prodhojnë produkte të njëjta apo të ngjashme dhe të cilët konkurrojnë kundër njëri-tjetrit përmes cilësisë, çmimeve dhe karakteristikave tjera të mallrave ose shërbimeve. Pra konkurrenca është mekanizëm thelbësor i

ekonomisë së tregut. Qëllimi i konkurrencës është që ndërmarrjeve t'iu sigurohet një treg i lirë dhe i barabartë për të gjithë pjesëmarrësit. Konkurrenca paraqet bazë për funksionimin e ekonomisë së tregut të një shteti.

Me anë të konkurrencës në treg arrihet një nivel më i lartë i mirëqenies shoqërore ku si përfitues është konsumatori. Konkurrenca e tregut u ofron shërbim konsumatorëve në përzgjedhjen e produkteve apo shërbimeve në mesin e prodhuesve të ndryshëm me çmime më lira dhe cilësi më të mirë.

1. E drejta e evropiane e konkurrencës

Në shumë sisteme shoqëroro-ekonomike të vendeve të ndryshme, kudo që është e pranishme ekonomia e tregut, aty është e pranishme edhe konkurrenca e prodhuesve të mallrave. Konkurrenca është në radhë të parë, kategori ekonomike dhe ajo është në masë të duhur sinonim i tregut të lirë. Prandaj çdo aktivitet në treg përmban në vete edhe një synim ose qëllim të caktuar të konkurrencës, sepse vetë konkurrenca është në të vërtet një përpjekje me anën e masave që i ndërmarrin subjektet ekonomike në treg për ti siguruar vetës vend dhe pozitë sa më favorizuese[10]. Kjo nënkupton se subjektet ekonomike janë të detyruara t'u përmbahen rregullave të caktuara, qëllimi i të cilave është të pengohet sjellja e cila është në kundërshtim me parimet e konkurrencës së lirë.

Në periudhën e tanishme të zhvillimit të tregut ndërkombëtar , domosdoshmëria e rregullimit dhe mbrojtjes së tregu të lirë brenda kornizave ligjore ishte sfida e shteteve anëtare të Bashkësisë Evropiane në vendosjen e politikave të konkurrencës. Krijimi i një tregu të vetëm evropian ofronte siguri ekonomike dhe politike në rajon.

Shtetet anëtare të BE fillimisht u pajisen me të drejtën e brendshme të konkurrencës të frymëzuar fort nga modeli evropian gjë që mund të vërë në dyshim bashkëjetesën e njërit me tjetrin. BE-ja nuk kërkon konkurrencën në vetvete, por nivelin e konkurrencës që mundëson funksionin e mirë të tregut të brendshëm respektivisht krijimin e një tregu unik që realizon kushte të ngjashme me ato të një tregu të brendshëm(GJDKE 25 tetor 1977, Metro, 26/76. Rec.1.875).[11]

Në të drejtën evropiane ekzistojnë dy përkufizime shumë të ndryshme lidhur me ligjin e konkurrencës. Përkufizimi i parë nënkupton tërësi e rregullave ligjore që rregullojnë rivaliteti mes agjentëve ekonomikë që janë në kërkim të klientelës ose që duan ta mbajnë atë, i dyti e koncepton ligjin e konkurrencës si grup

[10] *Prof.Dr.Mehdi Hetemi, Mbrojtja e tregut të lirë nga konkurrenca jo lojale, fq. 24, Prishtinë, 2004.*

[11] *Prof.Cyril Nourissat, E drejta e biznesit e bashkimit evropian, fq. 237,Tiranë, 2012.*

rregullash të hartuara për të ndaluar dhe për të luftuar, kur është e nevojshme, praktikat që çrregullojnë konkurrencën.[12]

E drejta evropiane e konkurrencës ka filluar të zhvillohet paralelisht me krijimin e Komunitetit Evropian.

1.2. Rregullimi normative i konkurrencës

Zhvillimi i ekonomisë në shumë vende mori përmasa të gjëra, prandaj nevoja e funksionimit të tregut lirë dhe shfaqjes së interesave konfliktuoze të cilat dominuan në të, u imponua nevoja që relacionet e tregut të rregullohen me norma juridike.

Zanafillat e para të rregullimit normative të drejtës së konkurrencës do ti hasim në gjysmën e dytë të shekullit XIX-në SHBA, ku koncentrimi i madh i kapitalit në duar të disa subjekteve ekonomik , kërcënonte shkatërrimin e plotë të sistemit të tregut. Në SHBA përmirësimet e mëdha në transport dhe komunikim ishin njëra nga shtysat më të mëdha në iniciativat antitrust. Krejt kjo bëhej për shkak të lëvizjes së pa kontrolluar të çmimeve, sepse firmat po bëheshin gjithnjë e më të mëdha përmes bashkimeve, shkrirjeve, dhe blerjeve. Efektivisht, firmat e mëdha po imponoheshim me çmime diskriminuese për ndërmarrjet e vogla dhe për pasojë, po e dëmtonin konkurrencën e lirë. Një situatë e tillë e krijuar detyroj shtetin të ndërhyjë dhe të kufizoj "liberalizimin tradicional të ekonomisë" me nxjerrjen e ligjeve kundër trusteve, e quajtur "Scherman act" e vitit 1890,[13] i cili ka pasur për qëllim krijimin e rendit dhe rregullit në asgjësimin e monopoleve dhe tendencave monopoliste. Ky akt parashikonte sanksione të dyfishta: 1. Sanksione penale nga shteti federal, e cila përfundonte me dhënien e një dënimi që kufizonte lirin personale dhe dëmin pasuror; dhe 2. Të ngrejë padi civile për përmbushje detyrimi, që konsiston në lëshimin e ndalimeve ose urdhrave që kufizojnë palët një numër të caktuar vitesh ose në mënyrë të përhershme, përmbajtja e të cilave mund të jetë nga më të ndryshmet.

Praktikën e kufizimit të monopoleve në tregun e brendshëm ekonomik , do të ndjekin edhe shumë shtete të Evropës duke rregulluar këtë sferë me norma juridike .Në vitin 1923 Gjermania për herë të parë rregullon kufizime lidhur me kartelat, mirëpo pa ndonjë rezultat të veçantë. Britania e madhe për herë të parë sjell ligjin mbi konkurrencën në vitin 1948, por zbatimi i saj në praktik fillon 1957. Franca në vitin 1953 fillon zbatimin e dispozitave ligjore mbi konkurrencën. Me krijimin e Bashkësisë Ekonomike Evropiane fillon një epokë e re e rregullimit të drejtës së konkurrencës.

[12] *Prof. Cyril Nourissat, vep.e cit.,fq.240*

[13] *M.Ilesiq, Problemi pravnog regulisanje trziste i konkurencije, fq. 413,Beograd.*

E drejta e konkurrencës në Bashkësinë Ekonomike Evropiane do të zhvillohet në lidhje me praktikat anti-konkurrencë përmes neneve 81 dhe 82 të Traktatit të Komunitetit Ekonomik Evropian ku ndaloheshin marrëveshjet anti-konkurruese dhe abuzim me pozitën dominuese.

Rasti" Grundig" i vitit 1966 mund edhe të kuptohet si momenti ku pushteti i Gjykatës Evropiane të Drejtësisë së KE-ve(ECJ) u dëshmua qartë. Grundig kishte imponuar praktika të papërshtatshme për tregun e brendshëm, duke i imponuar distributorit francez çmime jo-koherente, përderisa shitësit me shumicë në Francë dilnin në treg me çmime më të lira nga i njëjti prodhues pasi furnizoheshin nga distributorë në shtete tjera (Consten S.à.R.L. and Grundig-Verkaufs-GmbH v Commission of the European Economic Community, 1966)[14]

Unifikimi i rregullimit të së drejtës së konkurrencës do të vazhdoj me Direktivën evropiane nr.2005/29/KE mbi praktikat e pandershme të ndërmarrjeve kundrejt konsumatorit. Ndërsa në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian me nenin 101 dhe 102 rregullohet e drejta e konkurrencës lidhur me marrëveshjet anit-konkurruese në mes firmave, abuzim me pozitën dominuese dhe shkrirjet.

Neni 101 i TFBE-ës kërkon që marrëveshja të ketë për objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembimin e konkurrencës në treg. Ky nene parasheh:

1. Sa me poshtë do të ndalohet e papajtueshme me tregun e brendshëm të gjitha marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet të shoqatave të sipërmarrjeve dhe praktikat e koordinuara të cilat mundë të dikojnë mbi tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare dhe të cilat kanë si objektiv ose efekt të parandalojnë,të kufizojnë ose të shtrembërojnë konkurrencën brenda tregut të brendshëm,dhe në veçanti ato të cilat:

a. Direkt ose indirekt fiksojë çmimet e blerjes dhe të shitjes ose çdo kusht tjetër te tregimit;

b. Kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin,tregjet,zhvillimet teknike,ose investimet;

c. Ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit;

d. Zbatojnë kushte të ngjashme me transaksionet të njëvlershme me palë të tjera tregtare,duke i vendosur ato në këtë mënyrë në një disavantazh konkurrues;

e. E kushtëzojnë përfundimin e kontratave me pranimin nga palë të tjera të detyrimeve shtesë të cilat ,nga natyra e tyre apo sipas zakoneve tregtare,ato nuk kanë lidhje me subjektin e këtyre kontratave;

2. Çdo marrëveshje ose vendim i ndaluar sipas këtij neni do të jetë automatikisht i pavlerë.

[14] *Prof.Ass.Iva Zajmi, E drejta evropiane e konkurrencës, fq.38, Tiranë,2012.*

3. Megjithatë, dispozitat e paragrafit të parë mund të deklarohen të pazbatueshme në raste:

- Çdo marrëveshje apo kategori marrëveshjesh ndërmjet ndërmarrjeve;
- Çdo vendimi apo kategori vendimesh të shoqatave te ndërmarrjeve;
- Çdo praktikë ose kategori praktikash të koordinuara;

Të cilat për të përmirësuar prodhimin ose shpërndarjen e të mirave ose për të promovuar progresin teknik apo progresin ekonomik, ndërsa u japin konsumatorëve një pjesë të mirë të përfitimit final, dhe i cili nuk:

a. Vendos mbi ndërmarrjet në fjalë kufizimet të cilat nuk janë të domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave;
b. U lejojnë këtyre ndërmarrjeve mundësinë e eliminimit të konkurrencës në drejtim të një pjese të mirë të prodhimit në fjalë. [15]

Esenca e Nenit 102 është kontrolli i fuqisë së tregut si nga një ndërmarrje apo varësisht nga kushtet, nga disa ndërmarrje. Sipas këtij neni kërkohet që ndërmarrja të jetë në pozitë dominuese. Dominimi duhet të vlerësohet lidhur me tre faktorë: tregun e mallit, tregun gjeografik dhe faktorin kohë. Ky nen parasheh:

Çdo abuzim nga një apo më shumë ndërmarrje e një pozite dominuese brenda tregut të përbashkët apo në një pjesë të madhe të tij do të ndalohet si e papajtueshme me tregun e brendshëm për sa ajo ndikon në tregtinë ndërmjet shteteve anëtare. Ky abuzim mund të konsistojë në veçanti:

a) imponimin direkt apo indirekt të çmimeve të padrejta të shitjes apo të blerjes apo në kushte të padrejta tregtimi;
b) kufizimin e prodhimit, të tregjeve apo të zhvillimit teknik në dëm të konsumatorëve;
c) zbatimin e kushteve të pabarabarta për transaksione të njëvlershme me palë të tjera, duke i vënë kështu ato në disavantazh konkurruese;
d) bërja peng e nënshkrimit të kontratës në varësi të pranimit nga palët tjera të detyrimeve shtesë të cilat, nga natyra apo sipas zakoneve tregtare, nuk kanë lidhje me përmbajtjen e këtyre kontratave. [16]

2. E drejta e konkurrencës në Kosovë

Konkurrenca manifestohet në një ekonomi të lirë të tregut. Liberalizimi i tregut, krijimi i kushteve të barabarta për hyrje në treg, mbrojtja e konkurrencës,

[15] *Vep.e cit. fq.14.*

[16] *Vep.e cit. fq.94.*

janë disa nga objektivat kryesore të zhvillimit ekonomik te Kosovës.

Tregu kosovarë është relativisht i vogël prandaj si i tillë është e nevojshme një konkurrencë e lirë dhe e ndershme në mes subjekteve ekonomik, efektet e së cilës manifestohen direkt në konsumatorin. Ndërmarrjet janë të detyruara të zhvillojnë strategji konkurruese, në momente të caktuar dhe agresive si kundërpërgjigje ndaj rivalëve aktual apo potencial duke ndihmuar kështu realizimin e mallrave për të cilat ka nevojë tregu dhe konsumatori. Pra konkurrenca kontribuon në rritjen e cilësisë dhe shërbimeve, në të mirë të konsumatorit dhe zhvillimit ekonomik të një vendi.

Me qëllim të zhvillimi të një tregu të lirë konkurrues, si dhe bazuar në nevojën për harmonizimin dhe rregullimin e praktikave të ndryshme konkurruese në Kosovë, duke ndjekur standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare Kuvendi i Kosovës ka aprovuar ligjin nr.2004/36 Ligjin për Konkurrencën.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, Nr.03/L-299 objektivi i fushëveprimi është të siguroj zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së tregut në Kosovë duke ndaluar veprimet që kufizojnë shtypin ose çrregullojnë konkurrencën. Ky ligj përcakton rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës si dhe procedurat për zbatim të sajë. Ligji për mbrojtjen e konkurrencës zbatohet për të gjitha format e parandalimit të konkurrencës nga ndërmarrjet në territorin e Kosovës apo dhe jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekt në Kosovë.

Me hyrjen ne fuqi të këtij ligji tregu ekonomik kosovarë fiton mbrojte juridike në kuptim të sigurimit të një konkurrence të lirë dhe efektive në treg duke u mbështetur në tri shtyllat kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës:

- Marrëveshjet e ndaluara në formën e kartelave;
- Abuzimin me pozitën dominuese dhe
- Bashkimet ose përqendrimet e ndërmarrjeve. 17

Zhvillimi i ekonomisë së tregut të në Kosovë mundtë realizohet vetëm më zbatimin e ligjit mbi konkurrencën si dhe krijimin e politikave të konkurrencës. Politika e konkurrencës përfshin ndërmarrjen e të gjitha masave të dalin nga ligji drejtuara sektorit privat apo publik, bazuar në konkurrencën e lirë, efektive dhe të ndershme.

Duke u bazuar në Ligji mbi konkurrencën u themelua Komisioni Kosovar i Konkurrencës (KKK), misioni i së cilës është kompletimi i bazës ligjore dhe kujdesi për zbatimin e tij, si dhe monitorimi i tregjeve. Komisioni Kosovar i Konkurrencës duhet të japë kontributin e vetë në këto procese duke e mbështetur gjithmonë zgjidhjen më të pranueshme që vijnë nga tregu, nga pjesëmarrësit

[17] *Shih Ligjin nr.03/L-229, për mbrojtjen e konkurrencës, Kosovë.*

aktiv në zhvillimin e politikave ekonomike nëpërmes rekomandimeve si dhe me masën e ndërhyrjes ligjore në procedurat e rregullimit të konkurrencës.

Fusha më të ndjeshme ku bëhet cenimi i konkurrencës, janë të pranishme në: sektorin e teknologjisë së komunikimit, transportit, sektorit të sigurimeve, importit të naftës, energjetikës, farmaceutikës, sektorit të bankave dhe shërbimeve financiare dhe si e tillë është e nevojshme bashkëpunimi ndërinstitucional.

Deri më tani ky Komision ka marrë gjithsejtë 8 vendime që lidhen me 5 çështje të ndryshme. Zbatimi i normave ligjore mbi mbrojtjen e konkurrencës në tregun kosovar has në barriera të shuma. Megjithatë, deri më tani nuk ka pasur ndonjë iniciativë nga ana e qeverisë apo gjykatave në drejtim të ndëshkimit të operatorëve ekonomik në këto tregje.

Komisioni Kosovar i Konkurrencës, në procedurën administrative të datës 07.08.2010 mori në shqyrtim fillimin e hetimeve për praktikën e bashkërenduar të caktimit të çmimit të derivateve të naftës. KKK shfuqizoj marrëveshjen gojore apo praktikat e bashkërenduara nga pronarët e pompave të derivateve të naftës në rajonin e Gjilanit, për caktimin dhe nivelizimin e çmimit të derivateve të naftës.[18]

KKK ka bërë një hetim dhe për pasojë ndëshkimin e kompanisë GEKOS dhe Dukagjini në lidhje me furnizimin e tregut kosovar me arka fiskale (Vendim mbi Praktikën e bashkërenduar për shitjen e Arkave Fiskale në mes të ndërmarrjes SH.P.K.GEKOS & SH.P.K. DUKAGJINI, 2010). Në këtë rast, janë dënuar të dyja kompanitë me nga EUR 100 mijë, shumë kjo margjinale në raport me realizimin në treg dhe dëmin e shkaktuar.[19]

Sfidë për Autoritetin e konkurrencës në Kosovë paraqesin bankat dhe shërbimet financiare në vend. Bankat aplikojnë norma të larta interesit dhe këto norma janë të qëndrueshme tash e disa vite. Tri bankat kryesore në Kosovë janë: Riaffaisen Bank Kosovo, Pro Credit Bank dhe Novo Ljubljansko Banka. Këto banka mbulojnë mbi 80% të tregut financiar. Kjo ju mundëson atyre të kenë një pozitë dominuse në treg. Këto tri banka kanë operuar me norma përafërsisht të njëjta interesi dhe pa ndonjë konkurrencë të qartë me njëra tjetrën.(për më tepër shih Bankometrin e prodhuar nga Instituti për Studime të Avancuara GAP 2010)

Lidhur me praktikat e tilla KKK ka deklaruar se ka marr iniciuar një hetim mirëpo deri më tani asnjë vendim konkret nuk është sjell.[20]

Bazuar si më lart mund të konkludojmë se krijimi i konkurrencës së lirë, luftimi i dukurive jo të mira në treg, është një sfidë që shtrohet para Komisionit Kosovar të Konkurrencës dhe zbatuesve të ligjit.

---

[18] *http://ak.rks-gov.net/?cid=1,14,33*

[19] *htt;/ak.rks.net/?cid=1,16,39*

[20] *www.kdi-kosovo.org*

3. E drejta e konkurrencës në Shqipëri

Baza ekonomike e lindjes dhe e funksionimit të së drejtës e konkurrencës në Shqipëri ka filluar të zbatohet vetëm pas ndryshimit të sistemit politik dhe vendosjes së ekonomisë së tregut. Ligji i parë për mbrojtjen e konkurrencës është miratuar më 7 dhjetor 1995, Ligji Nr. 8044 "Për Konkurrencën". Me miratimin e këtij ligji fillon periudha e institucionalizimit të së drejtës së konkurrencës.. Ligji trajtonte çështjet që lidhen me monopolet, pozicionin dominues, si dhe ato të konkurrencës së pandershme.

Me gjithë zhvillimet e së drejtës së konkurrencës, u konstatua se legjislacioni përkatës kishte mangësi dhe ishte larg legjislacionit, institucioneve dhe Politikave të Konkurrencës të BE-së. Për të plotësuar këtë boshllëk u miratua ligji 9121, datë, 28.07.2003."Për mbrojtjen e konkurrencës"[21] Ky ligj u hartua në frymën e parimeve të përgjithshme të BE-es mbi tregu e lirë dhe lirin e qarkullimit të mallrave. Qëllimi i këtij ligji ishte mbrojtja e konkurrencës se lire dhe efektive ne treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes se ndërmarrjeve, si dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës dhe përgjegjësitë e tyre. ti ofroj tregut shqiptarë mbrojtje juridike në sferën e konkurrencës.[22] Ky ligj në mënyrë të detale rregullon çështjet lidhur me kufizimet e konkurrencës siç janë : marrëveshjet e ndaluara, abuzimet me pozitën dominuese dhe përqendrimet e ndërmarrjeve.

Ligji në fjalë përcakton Autoritetin Kontraktues. Autoriteti si institucioni publik për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në Shqipëri.Ky institucion ka për qëllim të mbrojë konkurrencën në vetvete, si dhe mbrojtjen e tregut të brendshëm nga pasojat e çdo veprimi të jashtëm. Ky ligj është i zbatueshëm në të gjithë sektorët e ekonomisë, si dhe për të gjitha ndërmarrjet, private dhe shtetërore, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për ndërmarrjet që veprimtarinë e ushtrojnë jashtë këtij territori, por pasojat e saj ndihen në tregun e brendshëm.

Një aspekt i rëndësishëm i ligjit aktual për mbrojtjen e konkurrencës është e drejta e çdo personi që t'i drejtohen drejtpërdrejt gjykatës në rast se pengohen në veprimtarinë e tyre nga një marrëveshje e ndaluar apo nga një praktikë abuzive. Sipas ligjit këta persona të mund t'i drejtohet Gjykatës me anë të një kërkesë padie pavarësisht faktit të inicimit të një procedure pranë Autoritetit. Në këtë mënyrë palët e interesuara kanë dy mundësi: të ankohen para Autoritetit të Konkurrencës ose të ngrenë padi pranë Gjykatës së Tiranës.[23]

Kushtetuta e Shqipërisë në parimet themelore të saj proklamon se sistemi

21 Broshurë e AK, Konkurrenca dhe konsumatori, fq.2, Tiranë

22 Neni 1, Ligji për mbrojtjen e konkurrencës, Shqipëri.

23 Broshura e AK :Konkurrenca dhe konsumatori,fq.4,Tiranë.

ekonomik i Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike si kufizime të lirisë së veprimtarisë ekonomike mund të vendosen vetëm me ligj dhe vetëm për arsye të rëndësishme publike.[24] Ndërsa në Ligjin për të drejtën ndërkombëtare private në nenin 64, rregullon konkurrencën e padrejtë dhe veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë.

II. POLITIKA E KONKURRENCËS EVROPIANE.

1. Konkurrenca e tregut, mbrojtja e tij dhe tiparet e konkurrencës

Konkurrenca e tregut është baza e funksionimit të ekonomisë së tregut ku konkurrenca në treg paraqet një formë të rivalitetit mes ndërmarrjeve. Prandaj, konkurrenca në treg ndodh nëse në treg veprojnë njëkohësisht dy ose më shumë ndërmarrje të cilët konkurrojnë kundër njëri-tjetrit përmes cilësisë, çmimeve dhe karakteristikave tjera të mallrave ose shërbimeve. Qëllimi kryesor i konkurrencës pasqyrohet në mirëqenien e konsumatorit .

Konkurrenca e tregut u ofron shërbim konsumatorëve në përzgjedhjen e produkteve apo shërbimeve në mesin e prodhuesve të ndryshëm. Thelbin e konkurrencës së tregut në radhë të parë e bëjnë interesat e konsumatorëve, e pastaj të ndërmarrjes. Konkurrenca efektive e tregut është një proces dinamik i reflektuar në përpjekjet të vazhdueshme drejt zhvillimin të ndërmarrjeve dhe inovacioneve në fushën e teknologjisë. Prandaj krahas zhvillimit të ekonomisë së tregut, lindi domosdoshmëria për të rregulluar e drejta e konkurrencës. Qëllimi i konkurrencës është që ndërmarrjeve t'iu sigurohet një treg i lirë dhe i barabartë për të gjithë pjesëmarrësit.

Konkurrenca efektive e tregut është në shërbim të interesit të konsumatorëve. Ndërmarrjet gjatë konkurrimit me njëri-tjetrin përmes çmimin dhe cilësinë së produkteve dhe shërbimeve, krijojnë mundësinë që konsumatorët të zgjedhin mes një shumëllojshmëri të gjerë të produkteve dhe shërbimeve.

2. Roli i drejtës së konkurrencës në Bashkimin Evropian

E drejta modern evropiane e konkurrencës është zhvilluar paralelisht me krijimin e Komunitetit Evropian (KE). Në fakt, baza e së drejtës së konkurrencës ishin të përfshira ende në Traktatin e Romës, ku janë përcaktuar objektivat e politikës së konkurrencës, në fillim në Komuniteti Evropian dhe më vonë në BE.

[24] *Neni 11 i Kushtetutës së Shqipërisë*

Objektivat më të rëndësishme të politikës së konkurrencës në BE janë:

1. mbrojtja e konsumatorit,
2. ulja e çmimit dhe rritja e cilësinë së produkteve dhe shërbimeve,
3. ofrimi i një ekonomie tregu të hapur me konkurrencë të lirë,
4. shpërbërje (hallakatje, shpërndarja) e fuqisë ekonomike në një gamë të gjerë të kompanive,
5. rishpërndarja e burimeve ekonomike dhe pasurore,
6. arritjen e efikasitetit optimale në nivelin mikroekonomik dhe makro-ekonomik dhe zhvillimi i ekonomisë evropiane,
7. rritja e mirëqenies sociale,
8. mbrojtja e ndërmarrjeve nga aktivitetet e ndaluara të konkurrentëve,
9. sigurimi i normave më të lartë të mundshme të punësimit në shoqëritë,
10. forcimi i konkurrencës së brendshëm dhe të jashtëm të ekonomisë evropiane dhe të tjerëve.[25]

Konkurrencën e tregut të lirë luan një rol vendimtar në funksionimin e Bashkimit Evropian si një bashkësi mbi kombëtare dhe multinacionale. Katër liritë themelore të tregut të proklamuar nga BE si: a) liria e lëvizjes së mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve – në korrelacion me parimin e mos diskriminimi dhe të drejtës aktuale të konkurrencë, janë elemente thelbësore të sistemit ekonomik të BE-së. Objektivi i Bashkimit Evropian është eliminimi i monopoleve dhe oligopolies, si dhe ndërhyrjet e pajustifikueshme të shtetit rreth çmimit ose ndarjes së tregut . Ajo zhvillon një politikë aktive në mbrojtjen e konkurrencës në Tregun e Përbashkët. Prandaj, e drejta e konkurrencës së BE-ës kontribuon në zhvillimin dhe ruajtjen e tregut të brendshëm, si dhe inkurajon tregtinë në mesë Shteteve Anëtare. E drejta BE-ës rreptësisht ndalon detyrimet doganore, kufizimet sasiore mbi importet, si dhe masa të tjera që do të pengojnë rrjedhën e lirë të mallrave dhe shërbimeve brenda BE-së.

Politika e konkurrencës përbën normat ligjore brenda së cilës ndërmarrjet kryejnë veprimtarit e tyre ekonomike mbi bazat e një konkurrence të lirë, efektive e të ndershme. Prandaj Politikat e konkurrencës janë të drejtuara në drejtim të korrigjimit të shtrembërimit të tregut të lirë në mes shteteve anëtare. Politika e konkurrencës harrohet nga Komisioni evropian.

Politika e konkurrencës së BE-ës, merret me analizën e katër formave themelore të shtrembërimit të konkurrencës:

1. *Marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjeve të cilat kanë për qëllim shtrembërim e konkurrencës së lirë;*
2. *Abuzimi me pozitën dominuese të ndërmarrjes në treg;*
3. *Përqendrimi i ndërmarrjeve (zakonisht kompanitë apo ofruesit e shërbimeve).*

[25] www.ups.ns.ac.rs , *Prof. Lidija Mazdar,Poslovanje sa Evropskom Unijom.*

E drejta evropiane mbi konkurrencën qe ka për qëllim të parandaloj dhe të ndëshkoj politikat që shtrembërojnë konkurrencën, ua ka besuar këtyre institucioneve:

- Komisionit- Drejtoria e përgjithshme për konkurrencën dhe
- Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian.

III. KONKURRENCA DHE KONSUMATORI NË TË DREJTËN EVROPIANE

Mbrojtja e konsumatorit, për çdo shtet, rrjedhimisht shoqëri të organizuar, jo vetëm që është një sferë dhe problematikë më rëndësi dhe peshë të veçantë, por edhe komponentë po aq relevante dhe me ndikim të përhershëm në ecuritë dhe kahet e zhvillimit ekonomik e shoqëror.

Shkalla e zhvillimit të të drejtave të konsumatorit, parimisht është rrjedhojë dhe rezultat i një shkalle të caktuar dhe në rrethana e ambient të caktuar të zhvillimit të gjithëmbarshëm ekonomik dhe social të një vendi, që do të thotë është karakteristikë e vendeve të zhvilluara dhe demokratike. Pikërisht duke u bazuar në këtë frymë dhe në Rezolutën nr. 39/248, të datës 09.04.1985 Asambleja e përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara ka miratuar Udhëzimin mbi mbrojtjen e konsumatorit i cili u jep qeverive korniza dhe mundësi për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacioneve gjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit.[26]

Po kështu, vendet nënshkruese të Traktatit për themelimin e Bashkimit Evropian në Romë (Traktati është lidhur në vitin 1957), në fund të vitit 1973, do të miratojnë Kartën evropiane për informimin dhe mbrojtjen e konsumatorëve, duke përfshirë të drejtat e tyre, që kishin të bënin me interesat ekonomike, me të drejtat për mbrojtje nga rreziqet e jetës dhe të shëndetit, të prodhimeve dhe shërbimeve në treg, të drejtat për mbrojtje juridike dhe përkrahje të shtetit.

Sipas dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit të Kosovës[27] konsumatorë është çdo person fizik, që blen dhe përdor mallra ose shërbime për plotësimin e nevojave të veta dhe jo për qëllime që janë të lidhura me veprimtari tregtare, respektivisht për rishitjen e atyre mallrave.

Politika e mbrojtës së konsumatorit mbulon një fushë të veprimit, e cila, sa është unike, dinamike e specifike, po aq është edhe e gjerë dhe vitale. Komponentët më qenësore të politikës konsumuese në rend të parë janë mbrojtja e plotë e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse e pozitës, rrjedhimisht e të drejtave, nevojave dhe kërkesave të konsumatorit.

---

[26] Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Programi për mbrojtjen e Konsumatorit 2010-2013, fq.3.

[27] Shih më tepër Ligji nr.2004/17, Kosovë.

1. Parimet themelore dhe parimet e mbrojtjes së konsumatorit ne Bashkimin Evropian

a) Parimet themelore te mbrojtjes së konsumatorit në Bashkimin Evropian

Parimet themelore për mbrojtjen e konsumatorit janë bazë kryesore orientuese në të cilën ndërtohen dhe zbatohen politikat për mbrojtjen e konsumatorëve të një vendi. Mirëqenia e konsumatorit(consumer welfare) është koncept më i gjerë se mbrojtja e konsumatorit (consumer protection). Mund të thuhet se mirëqenia e konsumatorit është forcë shtytëse e politikës së konkurrencës të çdo shteti. Pra synim i çdo shteti demokrati është mbrojtja e konsumatorit.[28]

Parimet themelore të politikes për mbrojtjen e konsumatorit janë:
- Parimi i prioritetit;
- Parimi i bashkëpunimit, koordinimit, përgjegjësisë dhe llogaridhënies;
- Parimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes efikase dhe efektive;
- Parimi i gjithëpërfshirës; dhe
- Parimi i parandalimit[29]

b) Parimet e Bashkimit Evropian për Mbrojtjen e Konsumatorit

Bashkimi Evropian, si një organizatë rajonale e organizuar dhe e avancuar, veçanërisht si një treg i lirë dhe ndër tregjet më të mëdha në botë, duke pasur në konsideratë seriozisht dinamikën zhvillimore ekonomike, brenda strukturës së saj, por edhe jashtë saj, mbrojtjes së konsumatorëve, i ka kushtuar vëmendje parësore. Në këtë drejtim kjo organizatë ka krijuar dhe proklamuar edhe parimet e veçanta në mbështetje të të cilave, nëpërmjet akteve të ndryshme juridike, siç janë ndër të tjera edhe me dhjeta direktiva, realizohet dhe gjithnjë e më tepër avancohet niveli dhe cilësia e mbrojtjes së konsumatorëve evropianë.

Çështja e mbrojtjes së konsumatorit, gjykuar sipas parimeve të mësipërme, por Mbrojtja e konsumatorëve edhe si çështje e të drejtave të njeriut është e përcaktuar po ashtu edhe në ligjet dhe praktikat më të mira të BE-së, të pasqyruara në dhjetë parimet e mbrojtjes së konsumatorit, por edhe Direktivën 1999-44-EC.

Politika e konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorit janë politikat komplementare të cilat reciprokisht plotësojnë njëra tjetrën edhe pse ata kanë perspektiva të ndryshme dhe shfrytëzojnë mjete të ndryshme për të arritur qëllimin e përbashkëta. Këto kanë qasje të ndryshme por qëllimi është i njëjtë: një treg konkurrues në të cilën është i sigurt sovraniteti i konsumatori dhe mirëqenia e tij.

---

[28] *Desa Mlikotic, Hana Horak, Verdan Soljan Jasmina Pecotic-Kaufman, Evropsko trzisno pravo,fq.175, Zagreb,2006.*

[29] *Vep.e cit.,fq.16.*

Për shkak të këtyre raporteve mjaft komplekse dhe tensioneve të vazhdueshme që ekzistojnë mes tyre kërkon analiza dhe monitorim të vazhdueshëm. Ekziston **parimi se** "Mbrojtja më e mirë për konsumatorin është konkurrencën e zhvilluar", mirëpo në shumicën e rasteve nivel i lartë i konkurrencës nuk është i mjaftueshme. Me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit është e nevojshme që rregullave në fushën e mbrojtjes së konkurrencës tu bashkëngjiten edhe rregullat nga fusha e mbrojtjes së konsumatorit. Kështu që do të arrihej një balancim i raporteve në mes të konsumatorit dhe pjesëmarrësve tjerë të tregut.

Në kushtet e konkurrencës së tregut, tregtarët janë të vetëdijshëm se konsumatori kanë mundësi të bëjë zgjedhje të ndryshme prandaj përpiqen që të sigurojnë ofertat me qëllim të parandalimit të përzgjedhjes së konkurrentit tjetër. Ata u ofrojnë konsumatorëve një përzgjedhje të gjerë me çmime konkurruese.

Në kushtet e një sistemi të zhvilluar të mbrojtjes së konsumatorit, konsumatorët janë më të informuar, të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe mundësitë e zbatimit të tyre dhe me presioni e vazhduar mbi shitësit i shtyn ata drejtë një konkurrence të drejtë.

Duke pasur parasysh ndërlidhjen e politikës së konkurrencës dhe politikës së mbrojtjes së konsumatorit që nënkupton se niveli i mirëqenies së konsumatorëve është në përputhje me nivelin e zhvillimit të konkurrencës në treg, është jashtëzakonisht e rëndësishme për të forcuar vetëdijes dhe të kuptuarit se:

- Çdo gjë që shtrembëron konkurrencën dhe dëmton pozitën e konsumatorit, dhe
- Ajo që forcon mirëqenien e konsumatorit forcon edhe konkurrencën.

Rregullat nga fusha e mbrojtjes së konsumatorit radhë të parë janë të destinuara për parandalimin e dëmtimit të konsumatorëve, si individualisht ashtu dhe kolektivisht, si dhe mënyrat e mbrojtjes së drejtat, nëse vjen deri tek shkelja e tyre. Këto rregulla parandalojnë sjelljen e padrejtë të shitësit kundrejt konsumatorit.

Krijimi i një mjedisi të mirëfilltë të biznesit në tregun e brendshëm, zhvillimi i konkurrencës në mesin e ndërmarrjeve, sjell nivele të larta të mbrojtjes së konsumatorit me qëllimi të rritjes së vetëdijesimit mbi mbrojtën e konsumatorëve.

PËRFUNDIMI

Që një shtet të ketë perspektivë evropiane, shtetit i kërkohet të garantojë një ekonomi konkurruese e cila do të ishte e gatshme t'iu përballoj presioneve të konkurrencës së tregjeve të unionit. Prandaj shikuar historikisht, shtetet e ndryshme, ne stadin e tyre te hershëm të zhvillimit ekonomik janë detyrua të vendosin rregulla përmes të cilave janë siguruar që operatorët ekonomik të mos

e shfrytëzojnë pozitën e tyre të favorshme në treg në dëm të konsumatorëve si dhe në çrregullimin e tregut të lirë të qarkullimit të mallrave dhe shërbimeve.

Tregu i lirë duhet të jetë verifikuesi më i mirë i punës së suksesshme të subjekteve ekonomike, të cilën gjë e mundëson konkurrenca e lirë. Mbrojtja e tregut të lirë dhe konkurrencës nuk arrihet vetëm duke përdorur mjete represive, por ajo arrihet edhe me vetëdijesimin e shoqërisë e në radhë të parë të vetë konsumatorin. Sepse konsumatori i informuar i cili i dinë të drejtat e tija dhe mënyrën e mbrojtës së tyre, është partner në tregun e lirë të shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve. Prandaj në bazë të studimeve të bëra si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë vijmë në konkluzion se e drejta e konkurrencës dhe zbatimi i saj në praktikë hasin në pengesa të shumta të cilat me kohë do të eliminohen. Në tregun kosovarë barrierat të cilat ndikojnë në mbrojtjen e konkurrencës janë:

- Baza ligjore mbi konkurrencës është ende në fazën fillestare të konsolidimit. Ekziston Ligji mbi mbrojtjen e konkurrencës por nuk ka norma ligjore shtesë të cilat e definojnë qartë çdo sjellje abuzive në tregjet relevante në Kosovë. Prandaj orientimi i institucioneve qeveritare hartimi i politikave të mirëfillta mbi fushën e konkurrencës.
- Komisioni Kosovar i Konkurrencës ende nuk ka nxjerrë të gjitha aktet nënligjore që do t'ia mundësonte një veprim më efikas. Hetimet në tregje te ndryshme kanë hasur në pengesa kryesisht për shkak të mungesës së qartësisë ligjore, mungesës së vullnetit të institucioneve, por edhe me ndërhyrje politike.

BIBLIOGRAFIA

Pof. dr. Mehdi J. Hetemi, Mbrojtja e tregut të lirë nga konkurrenca jo lojale, Prishtinë, 2004.
Cyril Nourissat, E drejta e Biznesit e Bashkimit Evropian.
Prof. Ass. Iva Zajmi, E drejta evropiane e konkurrencës, Tiranë, 2012.
M. Ilesiq, Problemi pravnog regulisanje trziste i konkurencije, Beograd.
Lidija Madzar, Politika e konkurrencës në Bashkimin Evropian, 2011.
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
Desa Mlikotic, Hana Horak, Verdan Soljan Jasmina Pecotic-Kaufman, Evropsko trzisno pravo, Zagreb,2006.
Ligji nr. 10 428, Për të drejtën ndërkombëtare private.
Ligji nr. 03/L-229, Për mbrojtjen e Konkurrencës, Kosovë.
Ligji për mbrojtjen e konkurrencës , Shqipëri.
Udhëzues i kombeve të bashkuara për mbrojtjen e konsumatorëve, Nju York, 2003.
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Kosovë, Programi për mbrojtjen e Konsumatorit 2010-2014, Prishtinë, 2009.
www.kdi-kosova.org, Komisioni Kosovar i Konkurrencës, 2012.
Broshurë e AK, Konkurrenca dhe Konsumatori, Tiranë

ÇMIMI I NAFTËS, SI DHE PSE NDRYSHON AI ? CILI ËSHTË FAKTORI QË NDIKON MË SHUMË, PRODHIMI, POLITIKA, LUFTA APO REZERVAT E ZBULUARA?

Vladimir Mici
Mediterranean University of Albania
vladimirmici@umsh.edu.al

Bukuri Dumani
Universiteti i Tiranës
bukuri.dumani@unitir.edu.al

Rudina Qurku
Mediterranean University of Albania
rudina.qurku@umsh.edu.al

ABSTRACT

In this paper we intend to bring another approach on the causes and reasons for the change in the price of crude oil. The main reason is not related to actors and factors that determine the world markets, but also that Albania, Crude Oil companies operating in Albania are fully dependent on oil price changes. Equally good is dependent on the government, as revenue in the budget on the basis of taxes lowered and raised precisely this fact. The article has a very interesting findings on the relationship between price and production, supply and demand. This is also another reason that makes this product not only the world of this century fugitive but even more particularly in economic and financial analysis. Although this area has better engage the world financial experts better back management of oil companies remains challenging. No one can explain the ups and downs of the price of its giant. The current case price decline can not be explained simply by reducing production quotas.

Keywords: *crude oil, oil proven reserves, production, Oil Search, correlation*

HYRJE

Risku i ndryshimeve të çmimit të naftës n në mjaft vende i ka bërë buxhetet e shteteve të varur prej tij. Kjo shoqërohet me pasoja të forta në në investimet publike dhe drejtimin e planit të biznesit. Çmimet e naftës impaktojnë krizat dhe krizat nga ana tjetër merren me çmimet e naftës, me ndërhyrje rregullative apo politika të caktuara vendesh, rajonesh e më gjerë.[30]

Çmimi i naftës brut, përdoret si mekanizëm për rishpërndarjen e pasurisë së botës. Një çmim i lartë e shton pasurinë e vëndeve prodhuese, dhe anasjelltas një çmim i ulët shton pasurinë e vëndeve konsumatore. Manovra të fuqishme sjellin në skene edhe domosdoshmërinë e krijimit te rezervave tepër të mëdha për të përballuar nevojat në kohë krizash. Sa më të mëdha këto rezerva aq më lehtë përballohen mungesat dhe anasjelltas. Sidoqoftë rezervat lëvizin, ndryshojnë dhe për pasojë edhe çmimi. Në vendet e OECD, 24 prej tyre kanë 72% e kërkesës[31]. OPEC, siguron 50% të naftës brut në botë. Lufta për tregjet e naftës është e ashpër. Këtu nuk ka disiplinë.

Në historinë e pas luftës së dytë botërore vërejme se çmimi i naftës brut ka pasur një variacion të gjerë të çmimeve në kohën e mungesës ose mbiofertës. Cikli i çmimit të naftës brut mund të zgjasë gjatë disa viteve duke reaguar ndaj ndryshimeve të kërkesës si dhe ofertave si të OPEC-ut dhe jo-OPEC-ut. Gjatë shekullit XX, çmimi i naftës është rregulluar shumë nëpërmjet prodhimit ose çmimeve të kontrolluara deri në vitin 1970. Por kjo mori fund në vitin 1971 dhe pas kësaj periudhe çdo gjë i kaloi tregut botëror. (J.L Williams 2014). Vënde të veçanta që ishin eksportues të këtij produkti filluan të të ishin më të vëmendshëm për vlerën e pasurisë së tyre duke sjellë një pamje krejt tjetër të vlerësimit të këtij produkti. Në punim synohet të ofrohet një qasje e ndërlidhjes së faktorëve, pse dhe si ndryshon çmimi i naftës brut.

METODOLOGJIA E KËRKIMIT

Të dhënat

Për të zhvilluar analizën empirike janë marrë të dhënat e periudhës 1980-2013 me frekuencë vjetore. Burimi i të dhënave është Agjensia Nderkombetare

[30] *Historia e çmimeve të naftës Williams J.L.2014*

[31] *OECD-data*

e Energjise (IEA) . Në këtë shtrirje kohore bota ka përcjellë kriza të naftës si ajo në vitet 1991, 2008.Kriza e vitit 1991 lidhej me luftën e Irakut për pushtimin e Kuvajtit dhe për këtë shkak çmimet shkuan në një pik të ri. Kriza e viteve 2008 erdhi si pasojë e erozionit të shpejtë të kapaciteteve rezerve të prodhimit, gjë që rriti çmimin e pasigurisë. Nivelet e kapacitetit rezervë kishin rënë nën një million barrelë prodhim, ndërkohë që inventarët e rezervave prekën minimumin historik(J.L Williams 2014). Pavarësisht luhatjeve të forta në çmimin e naftës apo periudhave të krizës, a është lidhja e variablave çmim, prodhim, rezerva, e kointegruar? Edhe pse do të ishte dashur të kishim një numër më të madh të dhënash, gjykojmë se trajtimi i kësaj analizë nuk cënon cilësinë e përfundimeve.

Të dhënat e përfshira në model janë reale. Për variablat fillestarë janë llogaritur indekset bazë dhe më pas janë logaritmuar për të shmangur heteroskedasticitetin dhe për të rritur shkallën e stacionaritetit të variablave. Janë kontrolluar supozimet rreth termit të gabimit: mbi normalitetin, autokorrelacionin dhe heteroskedasticitein. Supozimet mbi termin e gabimit nënkuptojnë shpërndarje normale të vlerave të termit të gabimit (vektorit të gabimeve), variance konstante dhe të pakorreluara. Përpunimi i të dhënave është bërë në Eviews 7.

Metodat

Shpesh seritë kohore janë jostacionare, pra variablat në përbërje të tyre ndryshojnë në varësi të kohës. Një variabël konsiderohet jostacionar ose i integruar në një rend 1 kur variablat kanë rrënjë njësi. Ky test kontrollon hipotezën zero për praninë e rrënjës unitare (unit root test). Zakonisht stacionariteti arrrihet duke bërë diferencat e para, nën funksionin Dickey-Fuller (ADF).

Para viteve 1980 shumë ekonomistë kanë përdorur regresionet lineare për seritë kohore jo-stacionare, por këto regresione mund të prodhojnë lidhje jo të sakta (Granger.C, Newbold.P). Edhe pse trendi mund të largohet, seria e të dhënave mund të rezultojë ende jostacionare. Së bashku me Robert Engle në 1987 ata formalizuan qasjen e kointegrimit duke shpikur dhe termin e vektorit kointegrues.

Prania e mundshme e kointegrimit kontrollon hipotezat nëse variablat në një seri kohore kanë rrënjë njësi (p.sh. të integruara të paktën në rendin 1). Në analizën e kointegrimit forma më e zakonshme e jostacionaritetit është ajo e variablave të integruar. Kur të dhënat kanë rrënjë njësi të rendit të parë, të dhënat fillestare (pa kontrollin e stacionaritetit) nuk mund të përdoren për të studiuar lidhjet mbasi rezultati nga regresioni linear me metodën e katrorëve më të vegjël

është i dyshimtë (Hendry & Juselius, 2000). Gjithësesi të dhënat tregojnë se ato mund të bëhen stacionare nga diferencimi i rendit të parë. Kur një seri kthehet në stacionare nga diferencimi i parë, atëhere seria ka ekzaktësisht një rrënjë njesi. (Granger and Swanson, 1996).

Kur një kombinim linear i variablave jostacionarë kthehet në stacionar, thuhet se variablat janë të kointegruar, dhe vektori që përcakton kombinimin linear stacionar quhet vektor i kointegrimit.

Për analizën e të dhënave u përdor Modeli i Vektorit të Korrektimit të Gabimit (VECM). Sipas kësaj metode VECM, fillimisht testohet prania e lidhjes kointegruese. Mbasi provohet ekzistenca e saj, vlerësohet sistemi i ekuacioneve për secilin variabël endogjen si në lidhjen afatgjatë edhe në lidhjen afatshkurtër. Në këtë sistem ekuacionesh përcaktohet edhe koeficienti i korrektimit të gabimit dhe shpejtësia e kthimit në ekuilibër të vektorit të lidhjes afatgjatë.

Forma e ekuacionit të regresionit për VECM (modeli i korrektimit të gabimit) është:

$$\Delta X_t = \pi X_{t-1} + \sum_{j=1}^{q-1} \gamma_j \Delta X_{t-j} + \theta D_t + u_t$$

ku:

ΔX_t është vektori me diferencat e para të variablave endogjenë të përfshirë në model.

Më konkretisht ky vektor përfshin çmimin e naftës, prodhimin dhe rezervat e naftës.

πX_{t-p} është vektori i lidhjes kointegruese që përmban variablat endogjenë (jostacionarë) me një lag kohor. Më konkretisht ky vektor përfshin çmimin e naftës, prodhimin dhe rezervat e naftës. π është një matricë e koeficienteve të lidhjes afatgjatë. Koeficienti përpara kësaj matrice duhet të jetë negativ dhe statistikisht i rëndësishëm. Ky koeficient tregon shpejtësinë e kthimit drejt nivelit ekuilibër sa herë që ka devijime nga ekuilibri.

- janë variablat endogjenë në diferencë të parë me kohëvonesë të paracaktuar që shërbejnë për të identifikuar lidhjen afatshkurtër; γ është një matricë e parametrave afatshkurtër.
- janë variablat ekzogjenë të përfshirë në model. Në rastin konkret u provua të përfshihej variabli dummy për vitin 1998, por modeli nuk ishte i përshtatshëm.

u_t është një vektor i gabimeve të modelit, të cilat duhet të kenë shpërndarje normale, të jenë të pakorreluara dhe me variance konstante. Në përgjithësi ky vektor pritet të ketë karakteristikat e "gabimit të rastit"

Ky model VECM është i përshtatshëm për seritë kohore të disa variablave. Avantazhi kryesor i këtij modeli është reduktimi i ndjeshëm i efektit të multikolinearitetit, i cili është i pranishëm në seritë kohore dhe përmbledh informacionin mbi ndërlidhjen afatgjatë midis variablave endogjenë në formë matrice. Për më tepër ky model vlerëson brenda të njejtit system edhe ekuacionet afatshkurtër, të cilat paraqesin informacion për mardhënien afatshkurtër midis variablave.

Pyetje dhe hipoteza

Për vlerësimin e lidhjeve midis çmimit, prodhimit dhe rezervave u përdorën metodat kointegruese për t'i dhënë përgjigje pyetjes:

A janë çmimi, prodhimi dhe rezervat të tillë që lëvizin sëbashku, a ka një lidhje kointegruese?


Analiza empirike ka në fokus të saj hipotezat e mëposhtme:
H_0: Midis çmimit, prodhimit dhe rezervave të naftës ka një lidhje kointegruese

H_1: Nuk ka një lidhje kointegruese midis çmimit, prodhimit dhe rezervave të naftës

Rezultatet

Gjatë periudhës 1980-2013 çmimi i naftës është rritur rreth 9 herë me lëkundje të forta, veçanërisht në vitet 1998 dhe 2009, prodhimi i naftës është rritur rreth 1.6 herë dhe zbulimi i rezervave rreth 2.6 herë. Në vitin 1998 ishte kriza aziatike faktor kryesor në uljen e kërkesës për naftë, e shoqëruar ndërkohë që vëndet e OPEK-ut vendosën shtimin e kuotave të prodhimit e cila çoi në një mbiofertë tregu dhe për pasoi çmimi doli nga trajektoria normale e tij duke arritur nivelin më të ulët historik, gjë që detyroi vëndet e OPEKU-t të ndërhynin me disa ulje kuotash prodhimi derisa çmimi të ndalonte r[nien dhe të rifilllonte të merrte ngritjen. Në vitin 2009 çmimi ra për shkak se ekonomia e SHBA dhe vëndet e OECD kaluan në recession ekonomik duke sjellë një ulje drastike të kërkesës së tyre dhe çmimet rane në 40$/barel

Figura 1. Indekset bazë të çmimit, prodhimit dhe naftës, Bota 1980-2013



Pas transformimit logaritmik të variablave në studim, statistikat përshkruese evidentojnë një normalizim të shpërndarjes (Shtojca, Tabela 1). Përpara identifikimit të modelit të vektorit të korrektimit të gabimit, u ndërmorën të gjitha hapat për përcaktimin e komponentëve kryesorë të të modelit. Kontrolli për rrënjët njësi tregoi se seria e të dhënave për secilën vlerë të logaritmuar të variablave ka rrënjë njësi unitare të rendit të parë (Shtojca, Tabela 2)..

Rezultatet e testit Granger Causality/Block Exogenity Wald tregojnë se variablat e përfshirë për spjegimin e çmimit të naftës janë endogjenë (Shtojca, Tabela 3). Këto rezultate tregojnë praninë e një problemi të ekzogjenitetit të dobët midis variablave. Testet e kointegrimit (Trace test dhe Maximun Eigenvalue) tregojnë se ekziston të paktën një lidhje kointegruese ndërmjet variablave të përzgjedhur ($p<0.05$) për kohëvonesën me dy vjet të përzgjedhur nga testet (Shtojca, Tabela 5). Të katër testet e përzgjedhjes së lag-ut tregojnë ($p<0.05$) se kohëvonesa e përfshirjes së variablave në ekuacion është dy vjet (Shtojca, Tabela 4)

Gjithashtu u kontrollua prania e endogjenitetit për variablat kryesorë, plotësimi i të cilit është parakusht për përfshirjen e variablave në VECM. Në një model statistikor, një variabël është endogjen kur ka një korrelacion midis variablit dhe termit të gabimit. Endogjeniteti mund të jetë pasojë e gabimit të matjes, autoregresionit me gabime të autokorreluara, njëkohshmërisë, konfuzionit midis variablave të varur e të pavarur si dhe nga mospërfshirja e variablave.

Analiza empirike u mbështet në disa prova për të përftuar modelin më të përshtatshëm të lidhjes kointegruese. Rezultatet tregojnë lidhje të rëndësishme të prodhimit me çmimin e naftës dhe ekuacion kointegrimi të rëndësishëm (Tabela 1). Koeficienti pranë prodhimit prej 16.56 tregon ndikimin e rritjes së prodhimit në rritjen e çmimit për një periudhë afatgjatë (rreth 6 vjet) në kushtet e një tregu i

ndikuar nga variablat e përfshirë në studim. Edhe pse çmimet e naftës kanë pësuar luhatje të vazhdueshme dhe ulje të ndjeshme në 1998 nga një rritje e lartë e ofertës së naftës dhe në 2009 nga pasojat e reçesionit në SHBA dhe Europë, rritja me një pikë përqindje e prodhimit është shoqëruar me rritjen e çmimit të naftës me 16.6 pikë përqindje. Duhet thënë se kjo prirje rritëse është e pritshme sepse kërkimi dhe gjetja e naftës bëhet me kosto gjithnjë e më të lartë dhe si burim i kufizuar, pavarësisht momenteve të veçanta, vëndet prodhuese janë përpjekur të ruajnë dhe rivlerësojnë pasurinë e tyre. Kjo prirje pritet të jetë afatgjatë më shumë se afatshkurtër, për shkak të gjendjeve të brendshme politike në disa vende dhe konflikteve të ashpra në disa vende të tjera.Kjo dëshmohet në vendet arabe(Libi, Irak, Iran, Nigeri, Algjeri,Venezuelë) të cilat janë edhe antare të OPEK-ut .

Modelimi ekonometrik i lidhjeve tregon se ndikimi i rezervave në çmim për periudhën afatgjatë nuk evidentohet i rëndësishëm, madje në drejtim të kundërt. Në afat të gjatë ndikimi i rezervave nuk ndikohet, sepse cikliciteti që vërehet me sjelljen e çmimit, në thelb ka ndikuar që ritmi i gjetjes së rezervave të jetë jo problematik.Një çmim i lartë i naftës stimulon dhe nxit kërkimin për naftë, sepse pa kërkim nuk ka rezerva të reja.Një çmim i ulët dekurajon kërkimin dhe fik motorët e sondave të kërkimit dhe për pasojë punohet me rezervat egzsituese, Sipas Daniel Jhonston (2004[32]) në vitet e ardhshme duke iu referuar grafikut të zbulimit të rezervave të reja sjellja duhet të ndryshojë.Po sipas Jhonston "Më shumë se 80% e prodhimit vjen nga fushat egzistuese të zbuluara para vitit 1973.Zbulimet e vb gjigande nuk janë një gje e kaluar tashmë, por ato janë ekstremisht të rralla…"[33]

Tabela 1. Modeli empirik i lidhjes afatgjatë

	Koeficienti	Statistika *T*
LProdhimi	16.5625	- 3.1853
LRezerva	3.5945	1.2119
C	55.8274	
ECT(CointEq1)	**- 0.1758**	- 4.0524
R^2 i koregjuar	0.3315	
F	3.1248	
Testet e mbetjeve	**Vlera e testit**	**Statistika *p***
Testi Jaque Bera	9.9835	0.1253
Testi Langrage Multiplier	8.2046	0.5137
Testi i Heteroskedasticitetit	81.9754	0.5422

Me gjithë periudhat shok në naftë, termi i korrektimit të gabimit tregon një shpejtësi të kthimit në ekuilibër prej rreth 6 vjet (1/0.1758). Për serinë e të dhënave u provua ndjeshmëria e luhatjeve të çmimit dhe impakti në shpejtësinë


[32] *International Exploration economics, risk and Contract analysis 2004*
[33] *International Exploration economics, risk and Contract analysis 2004*

e kthimit në ekuilibër në rastet e zëvendësimit të çmimit real me çmimin mesatar për vitin 1998 dhe/ose 2009 (seria është fiktive, çmimi është ndryshuar, variablat e tjerë të pandryshuar). Në këto modele konstatohen ekuacione kointegrimi me vlera të afërta, pra me një shpejtësi të kthimit në ekuilibër që shkon nga 4-6 vjet. Një vb i ri që hyn në prodhim i duhen 4-6 vite të jetë në pikun e rendimentit, ku as metodat intensive as ato ekstensive nuk shtojnë rezultatin, gjë që kërkon hyrjen në veprim të vb të rinj. (Jhonston.D,1994)

Gjetjet empirike të lidhjeve si në vektorin afatgjatë dhe afatshkurtër konfirmojnë lidhje të rëndësishme të variablave në ekuacionin e mëposhtëm:

D(LÇMIMI) = - 0.1758*{(LÇMIMI (-1) - 16.5625*LPRODHIMI(-1) + 3.5945*LREZERVA(-1) + 55.8274) – 0.2843*D(LÇMIMI (-1) + 1.5450*D(LREZERVA(-2)}

Sipas vektorit afatshkurtër të koeficientëve ndryshimi i çmimit është i ndikuar negativisht nga çmimi i naftës në periudhën paraardhëse dhe është i ndikuar pozitivisht nga rritja e rezervave në dy periudha kohore të mëparshme (2 vjet). Çmimi i periudhave parardhëse ka ndikuar negativisht sepse kontratat në tregun e kontratave NYMEX, kanë njohur një zhvillim të madh, aq sa numri i tyre kalon rreth 10 herë nevojat e tyre. Ndërsa lidhja pozitive me rezervat spjegohet me faktin që kostoja e zbulimit dhe vënies në përdorim të rezervave është më e lartë se sa presioni që ushtron një ofertë më e madhe. Sipas grafikut të mëposhtëm (burimi -Giant fields retain dominance in reserves growth. **Guoping Bai,Yan Xu** China University of Petroleum Beijing)



Periudha e zbulimeve më të mëdha të naftës i përket deri para viteve 1973. Pas kësaj periudhe parashikohen rezerva gjithnjë e më pak. Kjo sepse vb e rinj gjenden larg qëndrave të banuara dhe painfrastrukturë, në kushte atmosferike të vështira dhe në det të thellë. Një Vendburim në det mund të ketë debitë më të mira se sa një në tokë,por ai smund të jetë kompetitiv, pra smund të zhvillohet nëse çmimi i naftës nuk kalon pragjet e kostos së tij. Fushat m[t[m[dha janë të vendosura në 7 vënde. Lindja e Mesme 28, Deti në Brazil 19 Deti i Afrikës Lindore 13, Azia qëndrore 9, Shelfi veriperendim i Austalisë 8, Afrika Perëndimore 6, Gjiri Meksikës 5[34] Nga monitorimi i 400 puseve të kërkimit të shpuar në vitin 2013 vlerësohen që industria ka zbuluar rreth 20 bilion barrelë kundrejt një konsumi prej 50 milion barrelësh.[35]

Duket qartë, që bumi i rezervave ka kaluar dhe gjetja e tyre është më e vështirë për tu gjetur me kosto më të lire, së pari për shkak madhësisë së vendburimeve të rinj,e kushteve: gjeologjike, atmosferike dhe largësisë nga burimet përpunuese (janë më larg, në det të thellë apo pol të veriut, ku kërkohen teknologji dhe kosto të larta për kërkimin dhe për përpunimin e vendburimeve.)

Për lidhjen kointegruese, me anën e testit Granger Causality u kontrollua dhe "shkakësia" (kazualiteti) midis variablave (Shtojca, Tabela 6). Në një analizë regressive lidhja midis variablave nuk provon shkakësi. Testet e "shkakësisë" synojnë të provojnë drejtimin e lidhjes së variablave dhe rëndësinë e këtij kazualiteti. Testi sipas Granger Causality tregon se çmimi në këtë seri kohore është ndikuar në mënyrë të rëndësishme nga prodhimi, ndërkaq prodhimi nuk është ndikuar nga çmimi.

Duke ju referuar çmimit të naftës në 2014, rënia e tij nuk lidhej me prodhimin, por parashikimet e një viti më parë tregonin se OPEC-u do të riste kuotat e prodhimit[36]. Kjo sepse antarë të Opekut siç janë Libia, Algjeria, Iraku janë në procesin e rimëkëmbjes së tyre nga Pranvera Arabe dhe daljes nga lufta dhe kanë më shumë se kurrrë kanë nevojë për para dhe këto mund ti gjejnë duke shitur burimin e tyre të vetëm naftën pavarësisht çmimit. Kjo histori është e përsëritur. Nga 1982-1985, OPEC-u përpoq për të vendosur kuota të ulëta prodhimi, të mjaftueshme për të stabilizuar çmimet. Këto përpjekje kanë rezultuar në dështim të përsëritur, sepse anëtarë të ndryshëm të OPEC-ut prodhuan përtej kuotave të tyre. Gjatë kësaj periudhe Arabia Saudite veproi si prodhuesi standard i uljes së

[34] *-Giant fields retain dominance in reserves growth. Guoping Bai,Yan Xu China University of Petroleum Beijing*

[35] *Revista forbes. 10 zbulimet më të mëdha të vitit 2013 date 01/08/2014*

[36] *Plumer B. Why oil prices keep falling- and throwing the world into turmoil*

prodhimit të saj në një përpjekje për të frenuar rënien e lirë e çmimeve. Në gusht 1985, sauditët të lodhur nga ky rol. lidhën çmimin e tyre të naftës në treg vend me çmimin spot dhe deri në fillim të 1986 e rritën prodhimin nga dy milionë fuçi në ditë, në pesë milionë. Çmimet e naftës brut ranë nën 10 $ për fuci (barrel deri nga mesi i 1986. Pavarësisht nga rënia e çmimeve, të ardhurat nga Arabia Saudite mbeten pothuajse të njëjta për shkak të vëllimeve të larta, që u kompensuan nga çmime më të ulëta.[37]

Gjithashtu çmimi është ndikuar nga rezervat, dhe anasjelltas, rezervat janë ndikuar nga çmimi. Ndërkaq rritja e prodhimit nuk është ndikuar nga shtimi i rezervave, dhe shtimi i rezervave nuk është ndikuar nga rritja e prodhimit. Kjo është evidente, sepse çmimi i lartë i naftës rrit nevojën për burime të reja, të cilat mund të përballohen vetëm në kushtet e një çmimi të lartë.

Në lidhjen e rezervave me prodhimin, rëndësia do të dukej kur rezervat nuk përballonin kërkesën e tregut. Aktualisht janë dy burime të rëndësishme, që manipulojnë me kërkesën. E para që pas Embargos së naftës në vitin 1973, vëndet e OECD, filluan krijim e inventarëve(Inventari përfaqson rezervën qarkulluese në të gjitha kompanitë e naftës në një vend, të cilat mbajnë në formën e naftës brut dhe nënprodukteve të tyre.) apo sasive reserve të naftës brut, që të përballonin situata kur në treg të kishte mungesë nafte brut apo çmimi i saj të dilte jashtë kornizave, në të cilat ekonomia borërore të hynte në recession. Aktualisht SHBA ka rezerva inventari sa për kërkesën tremujore botërore për naftë brut dhe së dyti prodhimi aktual botëror është nën nivelin e tij maksimal të prodhimit. Viti 2008 i reçesionit kondicinoi që këta dy faktorë të ishin minimalë në inventor dhe nga ana tjetër të kishim minimumin e kapacitetit rezervë të prodhimit.(me kapacitet rezervë prodhimi duhet të kuptuar diferenca midis prodhimit të mundshëm në një kohë të caktuar me prodhimin aktual). Aktualisht Inventarët në vëndet e OECD janë 208 million barrels më të larta se mesatarja e krahasuar me atë të vitit të kaluar dhe më e madhe si rritje që nga viti 1989.[38]

Si përfundim duke aplikuar procedurën kointegruese, gjejmë që pavarësisht lëkundjeve të forta të çmimeve në periudha të ndryshme, midis çmimit, prodhimit dhe rezervave ska asnjë lidhje kointegruese. Ata lëvizin së bashku.

---

[37] *Historia e çmimeve të naftës dhe analiza .James L. Williams 2014*

[38] *The Availability and Price of Petroleum and Petroleum Products Produced in Countries Other Than Iran. EIA 26 shkurt 2015*

KONKLUZIONE

Çmimi i naftës është një mekanizëm se si pasuria botërore shpërndahet; ai është kompleks nga mënyra se si ndikon mbi ekonominë dhe si ndikohet prej saj. Çmimi i naftës, përveçse një marrdhënie kërkese dhe oferte është i ndërthurur ndjeshëm me faktorin politik, natyror, mjedisor, e rajonal.

Analiza empirike provon një lidhje të rëndësishme kointegruese midis çmimit, prodhimit dhe rezervave të naftës në afatgjatë dhe afat shkurtër me një kohë mesatare të kthimit në ekuilibër rreth 6 vjet. Modeli i vektorit të korrigjimit të gabimit (VECM) konfirmon ndikim të rëndësishëm të rritjes së prodhimit në rritjen e çmimit të naftës. Ndërkohë edhe në periudhën afatshkurtër (1-2 vjet) vihet re një ndikim i rëndësishëm i rritjes së rezervave të të dy viteve të mëparshme në çmimin e vitit korent

Politika shtetërore shqiptare duhet të synojë në një bandë çmimi nafte brut të manaxhueshme, dhe jo një politikë e cila çon në erozion të pasurisë kombëtare.

Për Shqipërinë do të duhet të sigurohen seri kohore me të dhënat mbi naftën për çdo vit dhe në periudha më të shkurtra. Analiza e dinamikave në naftë në tërësinë e faktorëve ndikues do të mbështesë më drejt politikat lokale të zhvillimeve në naftë për rritjen e efektshmërisë. Gjithashtu, analizat kointegruese do të ishin me interes për t'u përdorur në të ardhmen dhe për lidhjet e çmimit të naftës me çmimet e konsumatorit, kursin e këmbimit të monedhës etj.

SHTOJCA

Tabela 1. Statistikat e të dhënave

Të dhënat	Emërtimi	Nr. i vroj-timeve	Mesatarja	Devijimi Standard	Intervali i besimit 95%	Mini-mum	Maxi-mum	Skew-ness
Çmimi	PRICE	34	37.68	29.88	27.3 – 48.1	12	109	1.436
Prodhimi	PRODH	34	73241.19	10394.83	69614.3 - 76868.1	57928	90130	0.121
Rezervat	SHTIMREZ	34	1039.85	274.102	944.2 - 1135.5	642	1646	0.258
Ln i indeksit të çmimit	LDPRICE	34	4.4128	0.67890	4.176- 4.650	3.53	5.72	.704
Ln i indeksit të prodhimit	LDPRODH	34	4.7304	0.14252	4.681-4.780	4.51	4.95	-.021
Ln i indeksit të rezervave	LSHTIMREZ	34	5.0527	0.27101	4.958-5.147	4.61	5.55	-.216

Tabela 2. Testet e rrënjës njësi (ADF, Augmented Dickey-Fuller test statistic)

Variabli	Diferenca e parë	
	Vlera *t*	Vlera *p*
D(PRICE)	-6.357729	0.0000
D(PRODH)	-5.459223	0.0001
D(SHTIMREZ)	-4.986055	0.0003

Shënim: Hipoteza zero për testin ADF është që seria ka një rrënjë njësi. Vlerat kritike të kësaj serie janë nga MacKinnon (1996). Testet e ADF tregojnë se seritë e përfshira kanë një rrënjë njesi, pra janë seri të integruara të rendi të parë, I(1), me 99% besueshmëri.

Tabela 3. Testi për endogjenintetin e variablave (VAR Granger Causality/Block Exogeneity test)

Dependent variable: D(LDPRICE)			
Excluded	Chi-sq	df	Prob.
D(LDPRODH)	2.507107	2	0.2855
D(LSHTIMIREZ)	7.125568	2	0.0284
All	**7.907288**	**4**	**0.0950**

Shënim: VAR Granger Causality/Block Exogeneity Wald bazohet në hipotezën zero se variablat janë ekzogjenë. Janë marrë kombinimet e variablave dy nga dy, si dhe të gjithë variablat e ekuacionit së bashku, df tregon lag-un e përfshirë në ekuacion. Rezultatet tregojnë se variablat e përfshirë në model janë endogjenë, p < 0.1

Tabela 4. Testi i përcaktimit të rakut të kointegrimit të pakufizuar

Hypothesized No of CE(s)	**Trace test**				**Maximum Eigenvalue**		
	Eigenvalue	Trace Statistic	0.05 Critical Value	Prob.**	Max-Eigen Statistic	0.05 Critical Value	Prob.**
None *	0.521499	43.11890	35.19275	0.0057	22.84999	22.29962	0.0419
At most 1 *	0.373491	20.26891	20.26184	0.0499	14.49536	15.89210	0.0818
At most 2	0.169929	5.773550	9.164546	0.2089	5.773550	9.164546	0.2089

Shënim: Testi Trace tegon se ka 2 ekuacione kointegrues, p< 0.05 dhe sipas statistikës për Maximum Eigenvalue ka një lidhje kointegruese, p<0.05

** Tregon se hipoteza zero hidhet poshtë*

*** Vlerat p sipas MacKinnon –Haug_Michelis (1999).*

Tabela 5. Testet për zgjedhjen e kohëvonesës


	D(LDPRICE)	D(LDPRODH)	D(LSHTIMIREZ)	Joint
DLag 1	7.233139	6.043102	1.500552	15.21516
	ë0.064827]	0.109532]	0.682143]	0.085193]
DLag 2	ë10.61136	5.954074	8.221047	28.13164
	ë0.014024]	ë0.113866]	ë0.041658]	0.000907]
DLag 3	2.575173	6.185917	0.990977	9.327178
	ë 0.461859]	ë0.102907]	ë0.803435]	ë0.407637]
df	3	3	3	9

Shënim: Lag-u i përzgjedhur është lag-u 2, i cili është përfshirë në modelim, p < 0.001

Tabela 6. Testet e "shkakësisë" (Pairëise Granger Causality Tests)

Hipoteza zero	Statistika F	Probabiliteti
LDPRODH does not Granger Cause LDPRICE	4.44040	0.0128
LDPRICE does not Granger Cause LDPRODH	1.10603	0.3660
LSHTIMIREZ does not Granger Cause LDPRICE	4.34192	0.0140
LDPRICE does not Granger Cause LSHTIMIREZ	4.76415	0.0096
LSHTIMIREZ does not Granger Cause LDPRODH	0.47440	0.7030
LDPRODH does not Granger Cause LSHTIMIREZ	1.23978	0.3172

Figura 1. Testi i mbetjeve



BIBLIOGRAFIA

AKBN, 2013. Petroleum exploration and production opportunities in Albania

AKBN, 2014. Situata aktuale e liçensimit

Analiza dhe diskutime te manaxhimit te Stream Oil (vitet 2010,2011,2012,2013)

Bai. G and Y XU 2014. Giant fields retain dominance in reserves growth.

Bankers Petroleum. Consolidadet financials statements (vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 ,2013)

June 2013. BP Statistical Review of World Energy

Granger,C., 1981. Some Properties of Time Series Data and Their Use in Econometric Model

Specification, Journal of Econometrics, 16, pp. 121-130,. 3.

Johansen, S. 1991., Cointegration and Hypothesis Testing of Cointegration Vectors in Gaussian Vector Autoregressive Models, Econometrica, Vol.59, No.6, pp. 1551–1580,.

Engle, R.F. and C.W.J. Granger. 1987. "Co-integration and error-correction: Representation,

EIA. 26 shkurt 2015, The Availability and Price of Petroleum and Petroleum Products Produced in Countries Other Than Iran.

Estimation and testing," Econometrica, 55, 251-276.

Johnston, Daniel 2004, Sistem Bazat ekonomike te kerkimit ndekombetar, risku dhe analiza e kontratave autor et fiskale nderkombetare te naftes dhe kontratat me ndarje prodhimi

Financial Stetement of Petromanas GMBH 2012,2013

Forbes. 01/08/2014 Revista forbes. 10 zbulimet më të mëdha të vitit 2013

Heinberg R. 2011.Fundi i rritjes

M Van Der Hoeven IEA 2014 GE Oil&Gas Annual Meeting.Strategic challenges in global energy -The contribution from the oil and gas business .

Mici V , AngjeliG. 2014 Risku I kompanive që operojnë në industrinë e naftës (UP STREAM). Kërkimi dhe prodhimi, Rasti shqiptar. Konferenca Prishtine, Globus.

Mici V, Angjeli G 2014 Zhvillimi i sistemit hidrokarbur në Shqipëri pas vitit 1990. Sfidat dhe problemet.Artikull Konferenca Struge Maqedoni

Mici V. Politika e privatizimit te sektorit Hidrokarbure ka qene një politike jo efikase. Konferenca Budva. Universiteti La Sapiensa Roma.

Plumer B 2015. Why oil prices keep falling-and throwing the world into turmoil

STREAM Oi. Financial Statements of l Vitet (2010,2011,2012,2013)

Williams,J L 2014. Historia e çmimeve të naftësdhe analiza.

TRANSFERET RRJEDHËSE SI BURIM KRYESOR I MBULIMIT TË DEFICITIT TREGTAR- RASTI I KOSOVËS

Rahmije Mustafa
University of Pristina –Faculty of Economics

Albulena Zatriqi
Head of Treasury, ProCredit Bank, Prishtinë

Agon Topxhiu
University of Pristina –Faculty of Economics

ABSTRACT

One of the main characteristics of Kosovo's external sector is its high trade deficits, which is a similar characteristic of the developing countries and also transition economies.
The main objective of this paper is to do empirical research of Kosovo's trade balance for a seven year period, and also to analyze the current transfers which have been a major source on covering the trade deficit. In the current account of the Balance of Payment there are two major items: trade balance and current transfers. One of them has deficit (trade balance) the other has surplus (current transfers). After reviewing the literature about the trade deficit, in the first section of the paper we analyze the trends of the trade balance of Kosovo, while in the second part we analyze the one-sided current transfers, notably private transfers and remittances. In the third part we discuss the interaction between these two items, the rate of compensation and consequences.

Keywords: *Balance of Payment, Trade Balance, Current Transfers, Current Account, Remittances.*

HYRJE

Ekonomia e Kosovës përbën një ekonomi të re dhe dinamike. Baza e saj është transformuar nga një ekonomi centraliste, e dirigjuar, në një ekonomi të hapur të tregut. Qëllim në vete tashmë është rritja e konkurrencës së kësaj ekonomie, duke rritur kapacitetin e saj eksportues për të zvogëluar deficitin tregtar që Kosova aktualisht ka.

Ekonomia e Kosovës si një strukturë e vogël ekonomike, pak ka forca të brendshme të cilat mund t'i japin gjallërim ekonomik vendit, duke qenë gjithmonë e varur nga hyrjet e kapitaleve nga jashtë të cilat regjistrohen si flukse në llogarinë rrjedhëse dhe në llogarinë kapitale-financiare të bilancit të pagesave.

Një prej karakteristikave kyçe të ekonomisë së Kosovës për periudhën e pasluftës (1999-2014) në sektorin e jashtëm është deficiti shumë i lartë tregtar që arrin në miliarda euro, dhe me rritje të vazhdueshme prej viti në vit, gjegjësisht në vitin 2013 ky deficit kap shumën prej 2,156,444 euro, mirëpo krahasuar me vitin paraprak ka një rënie prej 3.4%. (Është hera e parë që deficiti tregtar ka shënuar një rënie të vogël), (ASK, 2014). Deficiti tregtar vazhdon të jetë shkaktari kryesor për nivelin e lartë të deficitit të llogarisë rrjedhëse. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në Kosovë gjatë vitit 2013 shënoi rënie të konsiderueshme duke arritur nivelin prej EUR 244.1 milion që në krahasim me vitin 2012 paraqet rënie prej afër 36 përqind. Si përqindje e PBB-së, deficiti i llogarisë rrjedhëse gjatë vitit 2013 kishte nivelin më të ulët në vitet e fundit duke arritur në 6.6% e PBB. Rënia e importeve konsiderohet si faktori që nuk lejoi thellimin e mëtutjeshëm të deficitit të llogarisë rrjedhëse ndërsa pozicioni pozitiv në kuadër të eksporteve të shërbimeve gjatë vitit 2013 ndikoi në zvogëlimin e këtij deficiti. Pastaj, ndikim në zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse kishte edhe kategoria e të ardhurave si dhe kategoria e transfereve rrjedhëse. (CBK, 2014). Tranferat e njëanshme, sidomos ato private historikisht kanë ndikuar në zbutjen e deficitit të lartë tregtar. Tranferet private përfshijnë të hollat të cilat dërgohen nga jashtë siç janë remitancat, pensionet, invaliditet për të cilat nuk është kryer ndonjë shërbim. Në llogarinë private zëri dominues janë remitancat dhe ato paraqiten si tregues stabilizues dhe zhvillues i vendit.

Studimet makroekonomike dhe punimet e shumta që mbështesin rolin pozitiv të remitancave në rritje ekonomike tregojnë se edhe pse paratë e emigrantëve janë të ndikuara nga ciklet ekonomike të vendit ku punojnë dhe vendit amë, ato zakonisht sigurojnë një burim të rëndësishëm të valutës së huaj, rrisin të ardhurat kombëtare, importin e financave dhe kontribuojnë në bilancin e pagesave. (Topxhiu R. 2010).

Madhësia e vërtetë e dërgesave të emigrantëve (remitencave) në Kosovë nuk

dihet për faktin se një pjesë e konsiderueshme e tyre vijnë përmes kanaleve joformale dhe gjithmonë është sfidë për Kosovën që të përshtatë llogarinë e rrjedhjeve të remitancave në përbërje të tranfereve rrjedhëse. Për këto arsye në analizë do të marrim llogarinë e transfereve rrjedhëse dhe kontributin e saj në zvogëlimin e deficitit tregtar në Kosovë.

Një vështrim i shkurtër teorik për deficitin tregtar

Ka numër të konsiderueshëm të literaturës në lidhje me deficitin tregtar. Për disa, deficiti tregtar është problem, për të tjerët nuk është problem. Një vështrim për bilancin tregtar të vendeve të ndryshme sugjeron që shumë vende kanë përjetuar deficit tregtar dhe kjo çështje është diskutuar në arenën kombëtare, ndërkombëtare, ekonomike dhe politike. Debati rreth deficitit tregtar kryesisht zhvillohet rreth efekteve të tij në ekonomi, mënyrës së financimit të tij dhe natyrës së tij (shkaqet, madhësia dhe kohëzgjatja e tij). Ka studime dhe institucione që fokusohen në analizimin e çështjes nga këndvështrimi i vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim. Në rastin e parë shumë studime argumentojnë se deficiti tregtar nuk është problem, kurse studime të tjera theksojnë se deficiti tregtar e zvogëlon rritjen dhe zhvillimin duke nxitur kriza financiare, de industrializimin, papunësinë e kështu me radhë.

Sipas pikëpamjes konvencionale, bilanci tregtar reflekton fuqinë konkurruese të vendit - sa më i vogël deficiti tregtar, më e madhe fuqia konkurruese e vendit dhe rritja ekonomike më e lartë.

Pjesa më e madhe e pikëpamjeve popullore rreth bilancit tregtar i kanë rrënjët te një grup i autorëve intelektual të shekullit shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë të quajtur Merkantilistët. Merkantilistët kanë avancuar teorinë se përfitimet e vendeve nga tregtia ndërkombëtare varen nga ajo se a kanë bilanc tregtar të "favorshëm" (në kuptimin që eksporti është më i madh se importi). Merkantilistët ishin biznesmenë, dhe ata e shihnin bilancin tregtar të vendit njësoj me pasqyrën e fitimit dhe humbjes së firmave. Sa më të mëdha që janë të hyrat ndaj shpenzimeve (eksportet ndaj importeve) më profitabil (më konkurruese) është biznesi (vendi). Kështu, ata argumentuan se një vend mund të përfitojë nga politikat proteksioniste që inkurajojnë eksportet dhe dekurajojnë importet. Meqenëse shumica e transaksioneve ndërkombëtare gjatë shekujve shtatëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë janë paguar me ar dhe me argjend, Merkantilistët mbështetën një tepricë tregtare në mënyrë që vendi të grumbulloj metale të çmuara dhe sipas argumenteve të tyre vendi bëhet më i pasur. (Krugman, Paul R. 2010).

Më vonë, më 1752, David Hume ka prezantuar një mospërputhje logjike në doktrinën e merkantilistëve. Ai ka argumentuar se akumulimi i kapitalit në

formë ari nga teprica tregtare rrit ofertën e përgjithshme të qarkullimit të parasë brenda vendit dhe me këtë shkakton inflacionin. Një rritje e inflacionit sipas tij, do të ndikoj në rritjen e çmimeve të faktorëve të prodhimit. Prej këtu, vendi me tepricë tregtare së shpejti do të humb përparësitë konkurruese në çmime dhe paga për faktin se ato do të jenë më të mëdha në krahasim me vendet e tjera në kushtet kur kursi i këmbimit mbetet konstant. (Michaely, M., D. Papageorgiou, and A. Choksi, 1991).

Disa dekada më vonë pas punimit të Hume-it, ekonomistët si Adam Smith dhe David Ricardo kanë dhënë argumente shtesë kundër teorisë së merkatilistëve për dobinë e tepricës tregtare. Ata kanë argumentuar se ajo çka është me rëndësi për vendin janë kushtet e tregtisë- që është çmimi relativ që paguan për importet e tij ndaj çmimeve që merr për eksportet e tij. Adam Smith më 1776 ka argumentuar se paratë për një ekonomi janë të ndryshme nga paratë për një individ ose firmë. Objektivi i firmës është që të maksimizojë dallimin në mes të importi të parasë dhe eksportit të parasë. "Importi" i parasë është shitja e mallrave e "eksporti i parasë është furnizimi me fuqi punëtore dhe faktorë të tjerë të prodhimit. Megjithatë për një ekonomi si tërësi, mirëqenia përbëhet nga mallrat dhe shërbimet e jo nga ari. Paraja, ose ari është i dobishëm si mjet këmbimi dhe nuk mund të vishet e as të ngrënët. Më shumë para, në afat të shkurt dhe të mesëm, vetëm do të rezultojë në nivel më të lartë të çmimeve. (David M. Gould, Roy J. Ruffin &M. D. Anderson, 1996).

Pikëpamjet e merkantilistëve edhe sot janë shumë dominuese në mesin e shumë individëve dhe studiuesve të cilët vazhdimisht bazohen në ekuacionin e Bruto Produktit të Brendshëm (GDP) i cili paraqet shumën e konsumit (C), investimeve (I), shpenzimeve qeveritare (G) dhe net-eksporteve (EX-IMP), gjegjësisht: GDP = C + I + G + X – M. Nga këtu duket qartë se eksportet e rrisin vëllimin e GDP, kurse importet e zvogëlojnë GDP. Kjo është gabim për faktin se definimi i GDP është vetëm një tautologji, dhe jo konkluzion rreth shkaqeve të mundshme. P.sh. është gjithashtu e vërtetë se volumi i mallrave dhe shërbimeve të disponueshme në një ekonomi (C+I+G) përbëhet nga GDP plus importi - eksporti që është : C + I + G = GDP + M –X. Nëse shikohet në këtë mënyrë, deficiti tregtar duket të jetë "i përshtatshëm" sepse ne jemi të interesuar në konsumin e vendit. Edhe kjo gjithashtu është çështje e definimit të GDP. Por çështja se deficit tregtar e përmirëson apo e lëndon ekonominë, nuk mund të tregohet përmes manipulimeve tautologjike. Nevojitet teoria dhe evidenca empirike për të vlerësuar se deficitet a janë të favorshme apo të pafavorshme për ekonominë e vendit. (Michaely, M., D. Papageorgiou, and A. Choksi, 1991).

Duke analizuar kontestin e SHBA-ve, Mueller (2006), argumenton se problem nuk është deficiti tregtar vetvetiu, por problem është mënyra se si të eliminohet ai kur financat e jashtme të mungojnë. Në mbështetje të këndvështrimit se deficiti

tregtar nuk është problem, autori argumenton se rrjedha e kapitalit është shenjë për një ekonomi se është atraktive dhe në rritje.

Byrne and Derbin (2003), studiues nga SHBA, arsyetojnë se deficiti tregtar mund të krijojë papunësinë ose borxh të jashtëm të madh si dhe probleme ekonomike dhe financiare. Sipas tyre, në njërën anë, deficiti tregtar ndihmon që të plotësohen kursimet e vendit si dhe të rritet mirëqenia e njerëzve falë konsumit të madh dhe nuk është i parëndësishëm në kuptimin se është i lidhur me variablat e tjerë makroekonomik.

Në një hulumtim të Fondit Monetar Ndërkombëtar, Ghosh and Ramakrishnan (2006) e perceptojnë deficitin e llogarisë rrjedhëse nga tri perspektiva: si diferencë në mes të eksportit dhe importit të mallrave dhe shërbimeve; hendek në mes të investimeve kombëtare dhe kursimeve dhe tregti ndërkombëtare. Nëse deficiti është për shkak të investimeve (të jashtme) të mëdha, sipas autorëve, kjo reflekton vetëm nivel të ulët të kursimeve dhe nuk ka nevojë për shqetësim, sigurimi i investimeve ndihmon në rritjen e autputit. Nëse deficiti tregtar financohet nga kapitali i jashtëm siç bënë Australia dhe Zelanda e Re nuk është e keqe, por mund të jetë e keqe nëse ka problem me financimin e tij dhe nëse ai bëhet përmes tërheqjes private si në Meksikë dhe në Tajlandë.

Elwell (2008) ofron një studim kritik rreth deficitit tregtar dhe bënë bashkë idetë nga perspektiva optimiste dhe pesimiste. Varësisht nga natyra e importit dhe e përdorimit të tij, deficiti tregtar mund të vlerësohet se a e ndihmon apo nuk e ndihmon ekonominë e vendit. Është mirë nëse importet bëhen për të nxitur prodhimin e produkteve të tregtueshme ose produkteve investive. Nuk është keq nëse deficiti tregtar nuk krijon probleme me Bilancin e Pagesave, ose nuk i zvogëlon rezervat në valuta të huaja, ose nëse është i shkaktuar nga ciklet ekonomike afatshkurtra. Nëse deficiti ndodh për shkak të ndërtimit të infrastrukturës së vendit ose bazës industriale, ose importi i lëndëve të para ndodh për shkak të rrjedhës ndihmave të jashtme dhe investimeve të huaja direkte në sektorët produktiv, nuk ka arsye për shqetësim meqë ato do të mbulojnë importin në një të ardhme të afërt.

Moon (2001), në punimin e tij, prezanton se si deficiti tregtar e pengon rritjen ekonomike të vendeve dhe shpie deri te akumulimi i borxheve të jashtme të larta, krijon varësinë ndaj vendeve të tjera, ndikon në shtrembërimin e prioriteteve nacionale, ndikon në rritje dhe zhvillim të ngadalshëm dhe paraqet potencial për kriza financiare si në Amerikën Latine dhe në vendet e Azisë Perëndimore.

Një hulumtim rreth shkaqeve dhe pasojave të deficitit tregtar për 91 vende të ndryshme nga autorët David M. Gould, Roy J. Ruffin & M. D. Anderson, (1996), ka rezultuar në një konkluzion interesant se mosbalancimi tregtar ka efekt të vogël në normën e rritjes ekonomike nëse merren parasysh determinantet fundamentale të rritjes ekonomike. Për shumicën e rasteve, deficiti tregtar

është më shumë reflektim i huamarrjes dhe huadhënies ndërkombëtare përgjatë kohës. Sipas tyre deficiti dhe suficiti tregtar janë pjesë e shpërndarjes efikase të burimeve ekonomike dhe shpërndarje e riskut në nivel ndërkombëtar që është kritike për shëndetin në afat të gjatë të ekonomisë botërore.

BILANCI TREGTAR I KOSOVËS DHE ZHVILLIMET

Bilanci i Pagesave në Kosovë vazhdon të karakterizohet me deficit të llogarisë rrjedhëse dhe me bilanc pozitiv në llogarinë kapitale dhe financiare. Deficiti i llogarisë rrjedhëse (i prirë kryesisht nga deficiti në bilancin tregtar), përkundër përmirësimeve gjatë vitit 2012 dhe gjysmës së parë të vitit 2013, vazhdon të mbetet në nivel relativisht të lartë. Tregtia e mallrave, si komponenti kryesor i llogarisë rrjedhëse, në vazhdimësi është duke u karakterizuar me shkallë të lartë të deficitit tregtar. (CBK, 2014)

Bilanci tregtar paraqet një prej zërave më dominues në llogarinë rrjedhëse dhe rëndësia e tij qëndron në atë se na jep informacione në lidhje me shkëmbimin tregtar me botën e jashtme dhe si e tillë na mundëson që të identifikojmë fuqinë prodhuese të një vendi, fuqinë konsumuese të atij vendi, kërkesën vendore, kërkesën e huaj, prirjet për konsum apo për kursim si dhe na jep informacione detale se me cilat vende jemi të lidhur ngushtë ekonomikisht, cilët janë sektorët më frytdhënës dhe më të brishtë të ekonomisë kombëtare. Kosova është një ekonomi e hapur; pjesëmarrja e eksportit dhe importit në BPV (ose faktori i hapjes së tregut, d.m.th. eksport + import /BPV) ishte mbi 0,7 në vitin 2010 (për vitet e mëparshme situata nuk ndryshon ndjeshëm), kurse në vitin 2013 kjo pjesëmarrje ishte 53.4 përqind, krahasuar me 51.0 përqind sa ishte në vitin 2012.

Tregtia (të dyja importi dhe eksporti) është vitale për një ekonomi moderne të suksesshme.Tregtia është vendimtare për rritjen e konkurrueshmërisë së ekonomisë në afat të gjatë. Ka evidencë të shumtë që e mbështet këtë qëndrim. Duke u ekspozuar firmat dhe produktet në një konkurrencë ndërkombëtare, ekonomitë inkurajohen që të fokusohen në fushën e përparësive konkurruese të tyre. Kjo ndihmon që të sigurohet se aftësitë dhe burimet e rralla janë zhvilluar aty ku janë më së shumti produktive. Tregtia rrit, në mesin e të tjerave konkurrencën (nxisin produktivitetin dhe inovacionin), aftëson firmat që të kapitalizojnë ekonomitë e shkallës duke pasur qasje në një treg më të gjerë dhe inkurajon shpërndarjen e aftësive, njohurive dhe inovacioneve.

Edhe pse pjesëmarrja e tregtisë së jashtme në GDP e Kosovës është relativisht e madhe, ajo kryesisht është e dominuar nga importet; niveli i eksportit është i vogël duke rezultuar në deficit të lartë tregtar që paraqet njërën prej karakteristikave kryesore të tregtisë së jashtme të Kosovës dhe njërën nga sfidat më të mëdha për institucionet e Kosovës.

Tab. 1 Rrjedha e mallrave në tregun e jashtëm (000 €)

Vitet	Eksporti		Importi		Bilanci tregtar	Mbulimi në përqindje
1	**2**	Indekset zinxhir	**3**	Indekset zinxhir	**4**=2-3	**5**=2/3
2001	10 559	-	684 500	-	-673 941	1.54
2002	27 599	261.38	854 758	124.87	-827 159	3.23
2003	35 621	129.07	973 265	113.86	-937 644	3.66
2004	56 567	158.80	1 063 347	109.26	-1 006 780	5.32
2005	56 283	99.50	1 157 492	108.85	-1 101 209	4.86
2006	110 774	196.82	1 305 879	112.82	-1 195 105	8.48
2007	165 112	149.05	1 576 186	120.70	-1 411 074	10.48
2008	198 463	120.20	1 928 236	122.34	-1 729 773	10.29
2009	165 328	83.30	1 935 541	100.38	-1 770 213	8.54
2010	295 957	179.01	2 157 725	111.48	-1 861768	13.72
2011	319 165	107.84	2 492 348	115.51	-2 173 184	12.8
2012	276 100	86.51	2 507 609	100.61	-2 231 509	11.0
2013	293 919	106.45	2 450 363	97.72	-2 156 444	12.0

Burimi: Statistical Agency of Kosova, External trade 2014, April 2014, fq,10, dh llogaritjet e autorëve.

Tregtia e jashtme në Kosovë prej periudhës së pasluftës ka pasur trende rritëse të eksportit dhe të importit. Përkundër rritjes më të shpejtë të eksportit, baza e ulët e eksporteve bënë që rritja e tyre të ketë ndikim relativisht të ulët në zvogëlimin e deficitit tregtar të Kosovës.

Edhe pse ndër vite, aftësia eksportuese e Kosovës ka shkuar duke u rritur, në të njëjtën kohë edhe importi ka shkuar duke u rritur, duke i mbajtur deficitin tregtar gjithnjë të lartë.


Tregtia me Kosovën konsiderohet të jetë në rritje e sipër, duke pasur parasysh se importet kanë arritur një vlerë prej mbi EUR 2.4 miliardë kurse eksportet janë afër EUR 300 milion në vitin 2013. Ekonomia e Kosovës është ende shumë e varur nga importet (raporti në mes të importit dhe eksportit është 8:1, gjegjësisht mbulueshmëria e importit me eksport për periudhën e vrojtuar në mesatare është mbi 8%). Integrimi i kufizuar me tregjet regjionale dhe globale e kanë 'ruajtur' Kosovën ndaj një ekspozimi më të theksuar kundrejt krizës globale financiare, por në anën tjetër kjo bën që edhe të kufizohet interesimi për investime të huaja. Remitancat ende mbeten shtyllë kryesore për financimin e ekonomisë në Kosovë.

Eksportet për periudhën 2001-2013 janë rritur mesatarisht 32% për çdo vjet, kurse në vitin 2009, për shkak të ndikimit të krizës globale financiare dhe rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, eksporti ka shënuar rënie për afër 18%, gjithashtu edhe në vitin 2012 krahasuar me vitin paraprak kemi një rënie të dukshme të eksporteve për 13.5%.

Eksportet e Kosovës arritën vlerën prej 293.9 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.5 përqind (13.5 përqind rënie vjetore në vitin 2012). Në terma real, eksportet shënuan rritje vjetore prej 3.8 përqind, rritje kjo më e ulët krahasuar me rritjen nominale, që pasqyron efektin e rritjes së çmimeve të disa produkteve minerale që Kosova eksportoi gjatë vitit 2013.

Kategoria me peshën më të lartë në kuadër të gjithsej eksporteve të Kosovës mbetet kategoria e metaleve bazë, e cila shënoi rënie të lehtë në vitin 2013 kryesisht për shkak të rënies së çmimeve të metaleve gjatë kësaj periudhe (figura 1).

Fig. 1. Gjithsej eksportet (jo kumulative) dhe çmimet ndërkombëtare të metaleve



Burimi: (CBK, 2013)

Ndërsa, eksportet e produkteve minerale, pijeve dhe duhanit, produkteve të gomës, plastikës dhe të tjera, si dhe produktet bujqësore ndikuan pozitivisht në rritjen e eksporteve të Kosovës gjatë kësaj periudhe. Kontributin më të madh në rritjen e gjithsej eksporteve të Kosovës gjatë kësaj periudhe e kishte eksporti i produkteve minerale, që kryesisht përbëhet nga koncentrati i zinkut dhe plumbit dhe energjia elektrike.(CBK, 2013).

Një pasqyrë më premtuese do të paraqitet në qoftë se merret në konsideratë edhe i ashtuquajturi eksporti"virtual"- i cili përfshin konsumin e pranisë ndërkombëtare në Kosovë-sipas të cilit eksporti mbulon 20 për qind të importeve (në llogaritë kombëtare, kjo pjesë e eksportit konsiderohet si "eksport i shërbimeve") (MTI 2009). Për periudhën e vrojtuar bilanci tregtar i shërbimeve

ka qenë kryesisht pozitive dhe në vitin 2013 arrin vlerën prej EUR 308.4 milion.

Sa i përket partnerëve tregtar, Kosova kryesisht eksporton në vendet e Bashkimit Evropian rreth 30,4% të eksporteve totale në prill të vitit 2014 dhe në vendet e CEFTA-as rreth 47.3% në prill të vitit 2014, kurse në vendet e tjera rreth 22.3% të eksporteve. Italia, Shqipëria dhe Serbia janë tri vendet në të cilat Kosova eksporton më së shumti, respektivisht 16.7%; 16.5%; dhe 12.7% e gjithsej eksporteve. (ASK, 2014).


Importet për periudhën 2001-2013 kanë shënuar rritje mesatare vjetore për 11,2%, me një trend rritës të vazhdueshëm deri në vitin 2013 kur kemi një rënie prej më pak se 3% në krahasim me vitin paraprak.

Rritja e importeve ishte më e ngadalshme krahasuar me rritjen e eksporteve, megjithatë, pesha e lartë që kanë importet në strukturën e përgjithshme të tregtisë së Kosovës vazhdon të neutralizojë efektin e rritjes së eksporteve, kështu që shkalla e mbulimit në mesatare vjetore është rreth 7%, kurse në vitin 2013 shkalla e mbulimit është 12%. Vlera e gjithsej mallrave të importuara në Kosovë në vitin 2013 ishte 2.45 miliardë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 2.3 përqind (0.6 përqind rritje vjetore në vitin 2012). Në terma real, importet kanë shënuar rënie vjetore prej 2.5 përqind në vitin 2013. Kategoritë me rënien më të madhe të importeve në vitin 2013 ishin importi i makinerive, pajisjeve mekanike dhe elektrike, si dhe mjetet e transportit. Për shumë vite, produktet dhe artikujt ushqimorë kanë mbizotëruar strukturën e importit (tani për tani, kjo kategori e mallrave është në vendin e dytë, me 12% të totalit), ndërsa në vitet e fundit produktet minerale janë malli më i importuar, me 21.6% të totalit. Kategoria e tretë e importuar janë makineria, pajisjet dhe veglat elektrike, me rreth 11% të totalit.

Rritja në importimin e mineraleve, në njërën anë, dhe e makinerisë, pajisjeve e veglave elektrike, në anën tjetër, tregon që Kosova në mënyrë të qëndrueshme po e ndërton bazën e saj prodhuese.

Përveç tregtisë me mallra industriale, një tjetër kategori e rëndësishme e tregtisë në mallra është ajo e prodhimeve bujqësore. Edhe pse konsiderohet potencialisht si sektor me përparësi të konsiderueshme krahasuese, prodhuesit bujqësorë kosovarë kanë arritur të eksportojnë prodhime me vlerë vetëm rreth €25 milionë në 2011, krahasuar me €266 milionë të importuar. Gjendja ka qenë pak a shumë e njëjtë gjatë gjithë dhjetëvjeçarit të fundit, por hendeku më i gjerë ndërmjet eksportit dhe importit të produkteve bujqësore është shënuar në vitin 2011. Kategoria e produkteve ushqimore të përpunuar, pijeve dhe produkteve të duhanit, dhe ajo e perimeve, përbëjnë sasinë më të madhe të eksporteve bujqësore. Ato eksportohen kryesisht në Shqipëri, Maqedoni, Serbi dhe Gjermani. Sa i përket importit të produkteve bujqësore, Kosova më së shumti importon ushqime të përpunuara, pije dhe duhan, pasuar nga produktet perimore, kafshët e gjalla dhe produktet shtazore. (ASK, 2014).


Fig. 2 Dinamika e eksportit, importit dhe bilancit tregtar të Kosovës 2001-2013



Burimi: Statistical Agency of Kosova, External trade 2014, April 2014

Edhe përkundër rrjedhave pozitive të rritjes së eksporteve nëpër vite, deficiti tregtar i Kosovës vazhdimisht ka ardhur duke u thelluar për shkak të importit shumë të madh që ka Kosova. Deficiti tregtar prej viti 2011 e tutje arrin mbi 2 miliard euro që përfaqëson mbi 40% të GDP së Kosovës, kurse pjesëmarrja e deficitit tregtar në volumin e gjithëmbarshëm të tregtisë (importi/ importi+eksporti) është jashtëzakonisht e madhe rreth 78%. Nëse pjesëmarrja e deficitit tregtar në vëllimin e tërësishëm të tregtisë është e vogël (p.sh. në SHBA rreth 12 %) atëherë deficiti tregtar nuk paraqet shumë problem për ekonominë e vendit. (David M. Gould, et al. 1996). Në rrethanat e Kosovës duket se është mjaft problem një nivel kaq i lartë i deficitit tregtar.

Fig. 3. Bilanci tregtar si % e GDP dhe si vlerë nominale (2004-2012)



Burimi: CBK, 2012

Nga figurat e prezantuara (fig. 2 dhe 3) dhe analiza e mësipërme, shohim qe Kosova historikisht ka një shkëmbim tregtar deficitar që sillet mesatarisht prej afër 1.5 miliard për periudhën 2001-2013, apo mesatarisht 41.2% e GDP (periudha 2004-2013). Ky net eksport negativ nënkupton që paratë e Kosovarëve shkojnë për të blerë mallra dhe shërbime të huaja, duke reduktuar prodhimtarinë vendore e cila pastaj shkakton tkurrje si në tregun e punës ashtu edhe në tregun e të mirave. Deficit i lartë tregtar i Kosovës është pasqyrim i një ekonomie me bazë të dobët të prodhimit dhe mungesë të konkurrencës ndërkombëtare. Megjithatë, gjendja e përgjithshme sa i përket tregtisë fsheh një dallim të rëndësishëm ndërmjet tregtisë në mallra dhe tregtisë në shërbime. Në sektorin e mallrave, bilanci i tregtisë është vazhdimisht deficitar. Në kontrast me këtë, sektori i shërbimeve ka performuar mjaft mirë. Kosova që nga viti 2006 ka pasur një bilanc tregtar pozitiv në sektorin e shërbimeve. Megjithëkëtë bilanci pozitiv në shërbime pati një rënie thelbësore si pasojë e importimit të shërbimeve të ndërtimit (autostrada që lidh Kosovën me Shqipërinë) në vitin 2010.

A është e mundur që Kosova në këto rrethana të mbaj stabile rezervat devizore? Në vijim për ilustrim më të mirë fillimisht paraqesim zërin e transfereve rrjedhëse duke e analizuar ndër vite dhe pastaj përmes tabelave dhe grafikëve do të shohim rëndësinë që ka për një mbulim të deficitit tregtar si dhe çfarë forme i jep ajo llogarisë rrjedhëse dhe bilancit të pagesave në tërësi.

TRANSFERET RRJEDHËSE DHE ZHVILLIMET

Transferet rrjedhëse janë regjistrime balancuese që zbatohen në rastet e ndryshimeve të pronësisë së vlerave reale (mallra apo shërbime) nga rezidentët tek jorezidentët (debi) ose nga jorezidentët tek rezidentët (kredi), të cilat nuk shoqërohen me shpërblim nga pala tjetër. Transferet rrjedhëse ndikojnë drejtpërsëdrejti në nivelin e të ardhurave të disponueshme dhe do të ndikojnë kështu edhe në konsumin e mallrave dhe shërbimeve. Pra, transferet rrjedhëse pakësojnë të ardhurat dhe mundësitë e konsumit të donatorit, duke rritur të ardhurat dhe mundësitë e konsumit të marrësit. Transferet rrjedhëse klasifikohen në: transferta shtetërore nga jashtë që zakonisht quhen transfere zyrtare; dhe në transfere të sektorit privat që përfshijnë dërgesat nga emigrantët dhe transferta të tjera. (BSH, 2006).

Transferet zyrtare paraqesin ndihmën në të holla dhe të mira nga shtetet dhe organizatat e huaja drejtuar ka vendi ynë. Transferet shtetërore rrjedhëse përfshijnë subvencione apo ndihma për buxhetin vijues (përveç kur subvencionet lidhen me shtesa të stokut të kapitalit të vendit marrës), asistencën teknike, dëmshpërblimet e ngarkuara nga traktatet e paqes, primin e sigurimit minus pagesën për shërbimin dhe pretendimet e sigurimit mbi humbjet, kontributet

qeveritare për buxhetet administrative të organizatave ndërkombëtare. Gjithashtu, në transferuat shtetërore rrjedhëse përfshihen (në kredi) taksa, gjoba dhe biletat e shitura nga qeveria në llotari të sponsorizuara prej saj; dhe (në debi) bursa dhe ndihma të tjera për trajnim dhënë jorezidentëve për të financuar edukimin e tyre në vendin e donatorit ose jashtë, rikthimi i shumave të paguara si taksa, pagesa për anëtarësi në organizatat joqeveritare, ndihma për njësitë joqeveritare, pensione jokontraktore e përfitime të tjera si dhe çmime të fituara nga llotaritë e sponsorizuara nga qeveria. (BSH, 2006).


Në tranfere private përfshihen dërgesat në dhe nga jashtë; transferet kesh nga efektiva e huaj e blerë në tregun e këmbimeve; si dhe transferet tjera si rentat, pensionet, invaliditetet etj.

Një nga kategoritë më të rëndësishme të bilancit të pagesave të Kosovës, që vazhdon të kontribuojë në ngushtimin e deficitit të llogarisë rrjedhëse, janë transferet rrjedhëse. Bilanci i llogarisë së transfereve rrjedhëse arriti vlerën prej 1.2 miliard euro, (viti 2013) që paraqet një rritje vjetore prej 2.5 përqind.

Transferet rrjedhëse përbëhen nga transferet qeveritare (28.0 përqind) dhe transferet e sektorit privat (72.0 përqind). Transferet qeveritare arritën vlerën prej 341.9 milionë euro në vitin 2013, që paraqet rënie vjetore prej 14.8 përqind. Në kuadër të transfereve rrjedhëse qeveritare kryesisht hyjnë transferet e donatorëve, EULEX-it dhe UNMIK-ut.

Transferet rrjedhëse të sektorit privat dominohen kryesisht nga remitencat, bilanci neto i të cilave përfaqëson rreth 62.7 përqind të gjithsej transfereve të sektorit privat. Në vitin 2013, remitencat arritën vlerën e 620.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.5 përqind (CBK, 2013)

Fig. 4 Transferet rrjedhëse në milion euro.



Burimi: BQK (2014)

Sa i përket shpërndarjes gjeografike të remitencave, Gjermania dhe Zvicra kanë pjesëmarrjen më

të lartë prej 33 përkatësisht 24 përqind të gjithsej remitencave të pranuara në Kosovë, pasuar

nga vendet me pjesëmarrje më të ulët si Italia dhe Austria me 7 përkatësisht 6 përqind të gjithsej remitencave. Rreth 21.2 përqind e remitencave transferohen përmes sistemit bankar, ndërsa 35.2 përqind transferohen përmes agjensioneve për transferimin e parave. Pjesa e mbetur e remitencave transforehen përmes kanaleve të tjera që përfshijnë edhe kanalet joformale. (CBK, 2013).

Që nga përfundimi i luftës në Kosovë, viti 2009 paraqet periudhën e vetme kur dërgesat e emigrantëve kosovarë shënuan rënie. Rënia e dërgesave të emigrantëve ishte rezultat i krizës ekonomike globale, e cila në masë të konsiderueshme goditi vendet e zhvilluara ku janë të koncentruar një numër i madh i emigrantëve nga Kosova. Efektet e krizës u manifestuan me shkurtime të theksuara të vendeve të punës, ku nuk mbetën pa u ndikuar edhe emigrantët kosovarë. (BQK, 2013). Dërgesat e emigrantëve kanë pasur një tendencë pozitive të rritjes përgjatë periudhës 2004-2012, me një normë mesatare vjetore të rritjes prej 7.0%. Mirëpo, përkundër kësaj, në vitin 2009 në krahasim me periudhën paraprake dërgesat nga diaspora kanë shënuar një rënie prej 5,56%, duke shënuar rënie në 505.6 milion euro nga 535.4 milion euro, sa ishte në vitin 2008, një rënie që është e ngjashme me vendet e rajonit dhe përgjithësisht me vendet në zhvillim dhe me nivelin botëror. Rënia e dërgesave nga emigrantët është më e vogël se rënia e investimeve direkte të huaja në Kosovë që ka qenë rreth 25%., një trend që ka përcjellë edhe vendet e rajonit dhe vendet në nivelin global.

Tab. 2. Lëvizja e dërgesave të diasporës

Vitet	Dërgesat nga diaspora (në milionë Euro)	Indeksi bazë: 2004=100	Indeksi vargor
2004	357	100	-
2005	418	117.086	117.086
2006	467.1	130.84	111.75
2007	515.6	144.26	110.38
2008	535.4	149.97	103.84
2009	505.6	141.45	94.43
2010	584.3	163.7	115.6
2011	584.8	163.8	100.08
2012	605.6	169.6	103.6
2013	620.8	173.9	102.5

Burimi: CBK, 2013

Dërgesat e emigrantëve në Kosovë përbëjnë një përqindje domethënëse të PBB-së (12.32%, në vitin 2012) dhe tejkalojnë në mënyrë të konsiderueshme nivelin e Investimeve të Huaja Direkte, përkrahjen nga donatorët, eksportin e mallrave. Në kuadër të burimeve të jashtme të financimit pjesëmarrja më e madhe në BPV të Kosovës është e remitancave duke siguruar edhe më tutje një burim të financimit mjaft të rëndësishëm për shumë familje kosovare.

Tab. 3 Burimet e jashtme të financimit për Kosovën (si përqindje e BPV, 2004-2013)

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Paratë e dërguara nga diaspora	12.2	13.9	15.0	15.1	13.6	12.61	13.61	12.24	12.32	11.65
Investimet direkte të huaja	1.5	3.6	9.3	12.6	8.9	7.8	8.7	8.5	4.7	5.3
Eksporti (i mallrave)	2.2	2.3	3.9	5.2	5.7	4.2	7.10	6.8	5.98	5.52
Përkrahja e donatorëve	11.5	12.2	10.2	8.7	7.5	8.6	7.4	6.7	8.2	
Gabimet dhe shmangiet	6.2	7.8	8.8	6.8	3.2	6.9	5.07	5.01	4.7	3.24
BPV (milion euro)	2 928	3005	3 118	3 411	3 940	4 007.8	4 291.1	4 776.1	4.916,4	5 326.6

Burimi: WB, 2010, CBK, 2013 dhe llogaritjet e autorëve

Paratë e dërguara nga diaspora në Kosovë, burimi më i madh i financimit të jashtëm, ishin ekuivalente me 12.2 për qind të BPV-së në vitin 2004, për të shënuar një rritje të konsiderueshme në vitin 2006 dhe 2007 ku pjesëmarrja e tyre në BPV ishte mbi 15% e me një tendencë të zvogëlimit të pjesëmarrjes së tyre në PBV në vitet vijuese, kështu që në vitin 2013 pjesëmarrja e tyre ra në 11.65 për qind. Sipas standardeve rajonale dhe globale kjo pjesëmarrje është ende e lartë. Për fqinjët e afërt si Bosnja-Hercegovina dhe Shqipëria paratë nga diaspora janë gjithashtu një pjesë e konsiderueshme e BPV-së.

Sipas të dhënave të fundit të Bankës Botërore, Kosova hynë në mesin e 10 vendeve të para në botë sipas pjesëmarrjes së remitancave në BPV (18%), ku pjesëmarrja e tyre duket të jetë më e madhe se sa raportojnë institucionet vendore. World Bank, (2013).

Shifra e bilancit zyrtar të pagesave për paratë e dërguara nga diaspora është nënvlerësim, pasi ajo ndoshta nuk i kap plotësisht rrjedhat informale. Një pjesë e konsiderueshme e gabimeve dhe shmangieve statistikore të bilancit të pagesave të Kosovës i atribuohet dërgesave të emigrantëve dhe sipas të gjitha gjasave ato

duhet të jenë më të mëdha se shifrat zyrtare. (BB, 2011).

Pothuajse gjysma e parave të dërguara nga diaspora vijnë nëpërmjet bizneseve private, të tilla si Western Union, edhe pse shpesh kjo është metoda më e shtrenjtë e transferimit të fondeve. Nëse më shumë pagesa vijnë përmes transfereve bankare, ato do të ndihmojnë zgjerimin e bazës së depozitave të bankave, e cila nga ana tjetër mund të zgjerojë kreditë dhe mund të motivojë njerëzit të përdorin më shumë shërbimet bankare. (BB, 2011).

DEFICITI TREGTAR DHE KOMPENSIMI ME TRANSFERE RRJEDHËSE

Deficiti dhe suficiti mund të shihen vetëm në nën bilancet si bilanci i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga investimet, transferet rrjedhëse dhe llogaria kapitale dhe financiare.

Deficiti në llogarinë rrjedhëse në esencë nënkupton se vendi shpenzon më shumë se që prodhon në një periudhë të dhënë kohore. Dallimi në mes të harxhimit në vend dhe prodhimit vendor përbën akumulimin e borxhit ose shitjen e aseteve jorezidentëve.

Në ekonominë e Kosovës, deficiti i llogarisë rrjedhëse vazhdimisht ka shënuar rritje, duke u ndikuar kryesisht nga rritja e deficitit tregtar. Faktorët që ndikojnë në thellimin e deficiti tregtar janë të shumtë duke përfshirë rritjen e vazhdueshme të kërkesës së brendshme, revalvimi i valutës vendore ndaj disa valutave rajonale, nivelin e ulët të produktivitetit në ekonominë vendore si dhe mosshfrytëzimin e mjaftueshëm të kapaciteteve ekzistuese prodhuese në ekonomi. Mbizotërimi i niveleve të larta të deficitit tregtar në vendet e rajonit gjithashtu është edhe reflektim i tranzicionit, i cili në shumë raste është karakterizuar me kolaps të prodhimit.(CBK, 2012).

Edhe pse është shumë e dukshme se bilanci i pagesave duhet të jetë në ekuilibër, tejkalimi i shpenzimeve kërkon akumulim të borxhit ose humbje të pronësisë. Këto, në një mënyrë nuk janë të regjistruara direkt në bilancin e pagesave. Ato shfaqen në mënyrë indirekte dhe në mënyrë signifikante vetëm më vonë në llogarinë të ardhurat nga investimet ku pagesat për interes, dividendë dhe renta të huajve do të regjistrohen si debi (borxh).

Një prej pasojave në afat të gjatë të deficitit në llogarinë rrjedhëse do të jetë që më shumë asete të brendshme do të kalojnë në pronësi të huaj. Çdo shitje e e aseteve nënkupton humbje të pronësisë vendore dhe në afat të gjatë vendi e humb pavarësinë. Marrë në konsiderim atë që u tha shihet se sa me rëndësi janë transferet rrjedhëse në rrethanat e Kosovës për zvogëlimin e deficiti tregtar.

Se si do të financohet deficiti tregtar varet nga ajo se si financohet deficiti i llogarisë rrjedhëse. Nëse deficiti financohet përmes investimeve kapitale në afat të gjatë kjo do të ishte e dobishme për një ekonomi. Nëse deficiti tregtar

financohet përmes huazimeve afatshkurta kjo do të ishte më problematike. Në rrethanat e Kosovës deficit tregtar në pjesën më të madhe mbulohet nga transferet rrjedhëse, në mesatare rreth 59.5 e deficitit tregtar mbulohet nga transferet rrjedhëse.

Se sa janë me rëndësi transferet rrjedhëse për sektorin e jashtëm të ekonomisë së Kosovës tregojnë edhe llogaritjet që kemi bërë rreth deficitit të llogarisë rrjedhëse sikur transeret rrjedhëse të ishin të barabarta me zero. Në këto rrethana deficiti i llogarisë rrjedhëse do të ishte shumë i madh, prej 863.2 milion euro (2014) deri te 1561.8 milion euro (2014). Llogaria financiare dhe kapitale në këtë rast do të mund të mbulonte deficitin tregtar mesatarisht me vetëm 12%. Në rrethanat reale të deficitit të llogarisë rrjedhëse shkalla e mbulimit të deficitit tregtar nga llogaria financiare dhe kapitale është në mesatare 39.5%.


Tab. 4 Llogaritë e Bilancit të Pagesave të Kosovës 2004-2013 (Në milionë euro)

	Llogaria rrjedhëse	Llogaria rrjedhëse pa transferet rrjedhëse	Llogaria kapitale financiare	Investimet e huaja direkte neto	Rezervat zyrtare
2004	-208.3	-863.2	79.4	42.9	112.7
2005	-247.6	-947.9	72.7	107.6	32.4
2006	-226.1	-985.3	-14.9	289.2	-77.9
2007	-214.0	-1056	10.7	431.0	-294.3
2008	-460.9	-1333.2	298.9	341.5	-18.25
2009	-374.2	-1357.6	209.3	276.9	94.8
2010	-515.7	-1498.2	297.2	331.1	-53.4
2011	-658.4	-1679.5	418.9	378.2	612
2012	-380.2	-1572.7	143.3	213.3	-267.2
2013	-339.4	-1561.8	168.1	241.0	210

Burimi BQK, Raporti vjetor 2013, Prishtinë, 2014


Masën e kompensimit të deficitit tregtar përmes transfereve rrjedhëse e shohim përmes figurës vijuese.

Fig. 5. Masa e kompensimit të deficitit tregtar me transfere rrjedhëse



Duke analizuar të dhënat nga figura shohim se niveli më i lartë i kompensimit të deficitit tregtar përmes trasfereve rrjedhëse ka qenë në vitin 2004 me 66.2%, kurse niveli më i ulët i mbulimit ka qenë në vitin 2008 dhe 2011 me vetëm 52.92% gjegjësisht 49.59%. Kjo si duket është e lidhur me nivelin e dërgesave nga diaspora ku po ashtu vërehet se në këtë vite niveli i tyre ka qenë më i vogël.

Fig 6. Masa e kompensimit të deficitit tregtar me transfere rrjedhëse (të dyja si % e GDP)



Burimi i njëjte.

Gjithashtu edhe nëse shikojmë të dy zërat, deficiti tregtar dhe transferet rrjedhëse si përqindje e GDP, do të shohim se në mesatare më shumë se gjysma e deficitit tregtar të Kosovës mbulohet nga transferet rrjedhëse.

Nga më lartë mund të shohim se trasferet rrjedhëse janë një zë stabilizues në bilancin e pagesave duke i konsoliduar në këtë mënyrë rezervat devizore. Në anën tjetër transferet rrjedhëse kanë efekte edhe në sektorin real të ekonomisë ku në mesatare marrin pjesë me rreth 23%, kurse prej tyre remitancat në mesatare marrin pjesë në GDP e Kosovës në mesatare me rreth 13%.

Përkundër faktit se deficiti i llogarisë rrjedhëse kontribuon negativisht në rritjen ekonomike, në Kosovë, qëndrueshmëria e këtij deficiti nuk konsiderohet si rrezik për goditje ndaj ekonomisë nga ndryshimet në normën e këmbimit. Kosova në përgjithësi nuk rrezikohet nga goditjet e normës së këmbimit si dhe besimit të publikut ndaj valutës për shkak të përdorimit të euros. Një shkallë e lehtë e rrezikut në kontekst të normës së këmbimit vjen nga disa produkte të caktuara (si p.sh. derivatet e naftës), të cilat tregtohen në dollarë amerikan, prandaj ndryshime të theksuara ndërmjet euros dhe dollarit mund të ndikojnë në çmimet këtyre produkteve dhe rrjedhimisht në thellimin e deficitit tregtar. Rrethanë tjetër lehtësuese për qëndrueshmërinë e llogarisë rrjedhëse në Kosovë është fakti se partnerët kryesor tregtarë të Kosovës janë ose plotësisht ose në masë të madhe të euroizuar. Për shembull, përderisa vendet me valutë kombëtare përdorin borxhin e jashtëm për të intervenuar në rezervat valutore me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të normës së këmbimit Kosova nuk ka nevojë të hyjë në borxh për këto qëllime pasi që partnerët kryesor tregtarë të Kosovës janë vende të Eurozonës. Po ashtu, euro është valutë e cila mbahet rezervë nga shumica e vendeve të CEFTA-s, prandaj çdo transaksion në këtë valutë është lehtë i realizueshëm. (CBK, 2012).

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në bazë të analizës së deritashme rekomandojmë si në vijim:

Së pari, mund të jenë dy mënyra për të minimizuar nivelin e lartë të deficitit tregtar: a) promovimi i eksportit; b) zëvendësimi i importit ose të dyja. Në rastin e parë duhet bërë përpjekje që të nxitet eksporti i produkteve sekondare e jo atyre primare siç ndodh tani me eksportin në Kosovë. Varësia e madhe e Kosovës nga mallrat e jashtme (duke përfshirë edhe lëndën e parë) kufizon shtrirjen e zëvendësimit të importit. Në rastin e politikave për zëvendësimin e importit (mbrojtja dhe stimulimi i industrisë së vendit për të zëvendësuar mallrat e konsumit të importuara), vendosja e tarifave selektive ose kuotave ose ndalesave të ndryshme në importimin e mallrave specifike mund të provohet. Në një botë të globalizuar, promovimi i eksportit mund të jetë zgjedhja e parë për Kosovën.

Së dyti, duhet bërë përpjekje për të përmirësuar bilancin në Llogarinë

kapitale dhe financiare duke inkurajuar më shumë investime të huaja direkte ose investime portfolio, marrje hua nga bankat komerciale ndërkombëtare ose kërkimin e ndihmave publike të jashtme. Në të dy rastet, marrja e kredit dhe ndihmave publike janë me obligim kthimi, mirëpo investimi i tyre në aktivitete produktive do të ndihmonte që kthimi i borxhit dhe i interesit të mos jetë problem. Inkurajimi investimeve të huaja private ka implikime më të mëdha zhvillimore se sa masa e transferimit të burimeve kapitale fizike ose financiare.

Së treti, përmirësimi i strukturës së tregtisë së jashtme të vendit që nënkupton difersifikimin e eksportit në kuptimin e mallrave dhe destinacioneve që mund të ndihmojnë në zbutjen e ndikimeve nga jashtë.

Së katërti, mungesa e konkurrueshmërisë së industrisë së prodhimit është një problem i madh dhe kërkon përveç të tjerave infrastrukturë të përshtatshme, burime njerëzore të afta, kualitet të lëndës së parë, politikë fiskale të favorshme, administratë efikase dhe investime në zhvillim dhe hulumtim.

Së pesti, Edhe pse tregtia e shërbimeve për dallim nga tregtia e mallrave ka qenë me bilanc pozitiv, megjithatë nuk është e mjaftueshme për të zvogëluar deficitin tregtar, por paraqet një potencial që duhet dhënë përparësi dhe përkrahë.

Së fundi, Politikat tregtare e Kosovës duket e shëndetshme por ka mungesë në kualitetin e implementimit, evaluimit dhe monitorimit efektiv.

BIBLIOGRAFIA

Antony Mueller, The Hidden Danger of Trade Deficits, (2006), http://www.continentaleconomics.com/

Banka Botërore, (2011), (BB, 2011), Migrimi dhe Zhvillimi Ekonomik në Kosovë, Washington DC.USA

Banka e Shqipërisë, (B.SH. 2006), Metodika e Bilancit të Pagesave, Nr.1, Tiranë, p.40-Banka e Shqipërisë,

Byrne, D. and E.T. Derbin (2003) 'U.S. Trade Deficit: Good, Bad, or Irrelevant?' Economic Newsletter for the New Millenium, pp. 1-37.

Central Bank of Kosovo. (CBK, 2012), Balance of Payments Report, nr. 11, Central Bank of The Republic of Kosovo.

Central Bank of the Republic of Kosovo (CBK) (2010a), Annual Report, Pristina, p. 48-54

Central Bank of the Republic of Kosovo (CBK) (2011), Annual Report, Pristina, p. 72-76

Central Bank of the Republic of Kosovo (CBK) (2012), Annual Report, Pristina, p. 72-76

Central Bank of the Republic Of Kosovo, (CBK) (2013), Annual Report, Pristina p. 55-61

Central Bank of the Republic of Kosovo, (CBK) (2014), Financial Stability Report, Number 4, p. 26-27

David M. Gould, Roy J. Ruffin & M. D. Anderson, (1996), Trade Deficits: Causes and Consequences, Federal Reserve Bank of Dallas, Economic Review Fourth Quarter

Elwell (2008) 'The U.S. Trade Deficit: Causes, Consequences, and Cures' electronic version. http://italy.usembassy.gov/pdf/other/RL31032.pdf

Ghosh, A. and U. Ramakrishnan. (2006, 9 October 2008) 'Do Current Account Deficits Matter?' Finannce and Development: A Quarterly Magazine of the IMF 43(4).

Kosovo Agency of Statistics (ASK) (2014) External Trade Statistics, p. 4-9

Krugman, Paul R. (2010), Ekonomia Ndërkombëtare II, Teoria dhe Politika Ekonomike, përkthim nga kroatishtja, Kolegji Victory, Prishtinë.

Michaely, M., D. Papageorgiou, and A. Choksi, eds. (1991), Liberalizing Foreign Trade: Lessons of Experience in the Developing World, vol. 7 (Cambridge, Mass.: Basil Blackwell).

Ministry of Trade and Industry Kosovo (MTI), (2009), Trade Policy of Kosovo, p. 7-16

Statistical Office of Kosovo (SOKa), (2010a), Series 3: Economic Statistics, External Trade 2010, Pristina

Topxhiu, R. (2010), Ndikimi i krizës globale në dërgesat e emigrantëve / remitanca, IFK, Prishtinë, p. 1-9

World Bank, (2013), Migration and Development Brief, 20, Washington DC.USA

World Bank. (2010). (WB, 2010), Unlocking Growth Potential: Strategies, Policies, Actions-Kosovo. A Country Economic Memorandum, Report no. 53185-XK, p. 10.

CIKLI I BIZNESIT, VEÇORITË E TIJ DHE ECURIA E EKONOMISË SHQIPTARE

Alqi Naqellari
Mediterranean University of Albania
alqinaqellari@umsh.edu.al

Nexhmedin Dumani
Mediterranean University of Albania
nexhod@yahoo.com


ABSTRACT

The business cycle is one of the most important macroeconomic models. Through this model will be analyzed performance of GDP and will determine the causes of changes in the torso. In this analysis will build a real model of the cycle for 11 years (2003-2013) and will be determined theoretical model of the cycle. Will be determined multiplier and accelerator for each year. Through them, by selecting some options, will create the shape of the bust cycle to 2025. The theoretical model shows that our economy will have ups and growth, will be unstable. The analysis determined that the main factor influencing the growth and shape of the bust is not domestic demand and foreign demand. In this group takes the brunt of the population consumption. The main item that has affected the growth has been agriculture and services that have been on the increase. In MA model analysis was used written by Samuelson-Hicks. At the same time using the model set by Yyje. Comparison methods are used, analysis and synthesis, statistical methods etc.

Keywords: Macroeconomic model business cycle, accelerator, multiplier, inflation, GDP, etc.

Rritja ciklike e ekonomisë i referohet luhatjevetë të ardhurave kombëtare ose të PBB-së reale.Në këto raste situatate luhatjeve ciklike shoqërohen me një tendencë rritëse. Kjo do të thotë se çdopikë e ardhëshme është më e lartë se ajo e mëparshmja dhe, gjithashtu, se çdo rënie është më pak e madhe se sa ajo e mëparëshmja. Kjo do të thotë se lëvizja lart, në rritje zgjat më shumë se lëvizja në rënie që përkon me recesionin. Figura 1 tregon tendencën dhe bustin e ciklit të biznesit.Në figurën e modelit të bustit të ciklit të biznesit ose të fuktacionit ekonomik janë dhënë 4 fazat e ciklit.

Figura Nr.1 Modeli i ciklit të biznesit



Faza e parë është shënuar me numrin 1.Në këtë fazë PBB kalon Produktin Potencial.Në këtë fazë rriten investimet, prodhimi dhe niveli i çmimeve, ulet c dhe rritet v, niveli papunësisë shkon drejt zeros.Në fazën e dytë kemi pikun, në të tretën fazën e recesionit e cila karakterizohet nga rritja e c dhe rënja e v, rënja e investimeve, rritja e normës së papunësisë dhe e nivelit të çmimeve. Kjo fazëështë tipike për ekonominë e Shqipërisë e cila ka këto karakteristika. Në fazën e katërt kemi fazën e depresionit.Shqipëria me treguesit që ka më shumë i afrohet recesionit sesa periudhës së rritjes ekonomike.Nje ekonomist tjetër krahas Samuelsonit, Hiksit, Bernier, Simonit është dhe Schumpeter. Sipas mendimit të Schumpeter, inovacionet luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike.Ky është fenomen i rritjes ciklike sipas Schumpeter. Në shpjegimin për rregullsinë e ulje-ngritjeve të inovacionit është se atojanë të lidhura me ciklin e jetës së mallrave kapitale.Në periudhë ebumit, inovacionet në prodhimin e mallrave kapitale aplikohen plotësisht.Në periudhën e rënies ekonomike ky kapital teknikisht ose ekonomikisht del jashtë loje. Megjithatë, nëpërmjet procesit të inovacionit, të karakterizuar nga Schumpter si njëproces i shkatërrimit "krijues", risitë duhen zbatuar në vijimësi, duke eliminuar metodat e vjetëruara të prodhimit. Një metodë e re rilind ndërsa një e vjetër shkatërohet. Shansi që sapo mjetet e e prodhimit do të bëhen shpejt ekonomikisht të vjetëruara investimi

i bizneseve bëhet me risk mëtë lartë.Ky risk mund të zvogëlohetduke zgjeruar sa më shumë tregun.Kështu, konkurrenca kthehet në njëmekanizëm në procesin e inovacionit, duke siguruar risi të reja për bizneset.

Schumpeter thekson se luhatjet ciklike janë të pandara në procesin ekonomik të prodhimit industrial. Kur ka ndryshime të brendshme që ndodhin për shkak të inovacionit, procesi i zhvillimit fillon.

Schumpeteri i klasifikon inovacionet në pesë kategori si vijon:

(I) Hyrje e tipit të ri të mallrave.

(II) Futja e metodave të reja të prodhimit.

(III) Hapja e tregjeve të reja.

(IV) Zbulimi i burimeve të reja të lëndëve të para.

(V) Ndryshimi në organizimin e një industrie, si krijimin e një monopoli, besimit, apo karteli, etj.

Në material analizohet busti i ciklit të biznesit për 11 vjet për të parë sesi ka ardhur ky bust, a kemi pasur rënje apo rritje ekonomike. Në çfarë pozicioni ndodhet kurba, nën apo mbi produktin potencial. Të dhënat e INSTAT tregojnë se kemi pasur rritje mesatare mbi 3% por në fakt të dhënat e akseleratorit, të prirjes marxhinale për konsum, të papunësisë dhe të nivelit të inflacionit tregojnë se ekonomia ka qënë nënjë gjenje pararecesioni.

1. Cikli i biznesit afatmesëm dhe afatgjatë; shumëzues-përshpejtues(M-A) Modeli Samuelson-Hiksit dhe Bernier- Simon

a)Bashkëveprimi i akseleratorit me multiplikatorin

Një model i rëndësishëm për të shpjeguar ciklet ekonomike afatmesme është modeli dinamik i zhvilluar në 1939 nga Samuelson dhe më vonë të përpunuar nga Hicks. Modeli u bë i njohur si modeli akselerato-multiplikator i Samuelsonit dhe i Hiksit. Ai përshkruan ndërveprimin midis punës së multiplikatorit dhe të ashtuquajturit mekanizëm të nxitimit, akseleratorit.Investimet në modelin shumëzues- përshpejtues (modeli M- A, multiplikator-akselerator), luajnë një rol të rëndësishëm në shpjegimin e ciklit ekonomik.Investimet në Model janë pjesë endogjene e përcaktuar nga rritja e të ardhurave kombëtare.

Në bazë të këtij studimi qëndron ideja se fluktacioni ekonomik ose cikli i biznesit shkaktohet nga kërkesa agregate. Kjo sepse AD = C + Î + G + Nx. Në këtë barazim, AD shpreh shpenzimet agregate, C shpenzimet e konsumit, Î shpenzimet për investimet bruto të biznesit, G shpenzimet qeveritare dhe Nx eksportet neto (eksport minus import). Secili prej grupeve përkatëse mund të shkaktojë inflacion. Duke qenë se investimet janë grupi më i lëvizshëm i tyre atëherë është mundësia më e madhe e prezences në inflacion. Provokimi i inflacionit shoqërohet me një sërë pasojash që kanë ndikim të dukshëm në bustin e ciklit të biznesit. Rritja e tij frenon rritjen e prodhimit si rezultat i rritjes së çmimit të faktorve ekonomikë e para dhe e dyta si rezultat i ndikimit në

rishpërndarjen e të ardhurave dhe të pasurisë. Prandaj një rritje e tij ul vlerën e aseteve financiare dhe rrit vlerën e aseteve reale.

Inflacioni provokohet në fazën e rritjes ekonomike.Kjo fazë kur prodhimi aktual kalon prodhimin potencial shoqërohet me rritje të akseleratorit v dhe me rritje të koeficientit të prirjes marxhinale për kursim MPS ose s. E para shpjegohet me rritjen e çmimit të faktorëve ndërsa e dyta me rritjen e të ardhurave.

Në fazën e rënies ekonomike drejt recensionit kemi rënie të prodhimit aktual e shoqëruar me rritje të normës së papunësisë. Për pasojë do të kemi rënie të çmimit të fuqisë punëtore, e në përgjithësi, rënie të çmimit të faktorëve ekonomikë. Në këtë fazë kemi rritje të MPC dhe rënie të akseleratorit v. Në analizën konkrete që i kemi bërë këtyre dy treguesve konstatohet lehtë se ekonomia shqiptare nuk ka qënë ndonjëherë në fazën e kalimit të produktit potencial por ka qënë vazhdimisht nën produktin potencial. Kjo sepse prirja marxhinale për konsum ka shkuar deri në 0.93 ndërsa akseleratori ka qënë disa herë me minus.

Konkretisht le të supozojmë se gjatë një periudhe kohe t do të kemi një rritje të investimeve. Ta supozojmë se rritja e investimeve është shkaktuar nga një politikë ekspansioniste monetare. Çvendosja e kurbës së ofertës për para djathtas do të sjellë rënie të normës së interesit. Pasojë e saj është rritja e kërkesës për para. Rritja e investimeve me një $\Delta \hat{I}$ do të sjellë rritje të të ardhurave me një ΔY ($\Delta \hat{I} * M = \Delta Y$). Në krahun tjetër rritja e të ardhurave do të sjellë rritje të shpenzimeve të konsumit në masën e MPC ($\Delta C = c \Delta Y$). Rritja e shpenzimeve të konsumit do të kërkojë rritje të sasisë së mallit për konsum. Rritja e sasisë së kërkuar e shumzuar me akseleratorin do të sjellë rritje të investimeve ΔIn. $\Delta In = v (\Delta Y)$. Kështu, nga një veprim mbi investimet ne provokojmë një fluktacion ekonomik. Parimi i akseleratorit bazohetmbi konsideratën se sipërmarrësit i bazojnë vendimet e tyre te investimet (në lidhje me zgjerimin e të mirave në stokun e kapitalit) në rritjen e prodhimit. Në tabelën1 tregohet ky parim. Nga kjo tabelë mund të shihet se të ardhurat kombëtare neto në vite janë rritur.

Tabela Nr. 1 Parimi i akseleratorit. Në milionë lekë


Viti	Prodhimi Brendshëm Bruto	Rritja neto e PBB-së	Ndryshimi vjetor i formacionit bruto të kapitalit fiks
2004	**751,022**	70,734	-1,542
2005	**814,797**	55,984	21,976
2006	**882,209**	46,934	42,528
2007	**967,670**	103,832	30,176
2008	**1,080,676**	131,696	-7,176
2009	**1,143,936**	41,016	7,287
2010	**1,239,645**	54,649	-21,756
2011	**1,300,624**	54,396	29,532
2012	**1,335,488**	25,246	-36,914

Rezultati përfundimtar është se kemi një marrëdhënie midis rritjes së PBB-së dhe të investimeve.Në shembullin tonë, të dhënat janë reale të ekonomisë së Shqipërisë.Investimet kanë ndikuar në rritjen e PBB-së. Kjo nuk ka qënë gjithnjë e vërtetë sepse kemi vite si në vitin 2004, 2008, 2010 dhe 2012 kur investimet nuk janë rritur por kanë psuar rënje. Në modelin M- A efekti i multiplikatoritnë rritjen e investimevezgjerohet nga mekanizmi akseleratorit. Në këtë proces një bashkëveprim zhvillohet ndërmjet multiplikatorit dhe akseleratorit, e cila mund të tregohet si vijon:

=rritja e të ardhurave çon në rritje tëinvestimeve (përmes akseleratorit)

=rritja investimeve(përmes multiplikatorit) do çojë në rritje të të ardhurave dhe rritja e të ardhurave(nëpërmjet akseleratorit) do të çojë në rritje të investimeve. Është e qartë se sistemi gjithashtu mund të punojë edhe në drejtim të kundërt, rast në të cilin akseleratori gjithashtu do të rrisi punën e multiplikatorit por në drejtim të kundërt.

Lidhjet midis elementëve të PBB dhe ndikuesve mund ti paraqesim edhe grafikisht si më poshtë:



Multiplikator

Formulimi i parimit të akseleratorit[39]. Formulimi i parimit të akseleratorit supozon që stoku i kapitalit i përshtatet në mënyrë të saktë prodhimit. Në qoftë se ekonomia ose degë të saj duan të rrisin prodhimin në një përqindje të caktuar duhet të shtojnë edhe kapitalin .

Kështu do të kemi:

I_{t+1} = investimi bruto në periudhën $_{t+1}$, I_{rt+1}= investimi për llogari të kuotës së amortizimit në $_{t+1.}$

D_{t+1} = kërkesa përfundimtare për $_{t+1,}$ P_t = prodhimi në kohën t, K_t = kapitali në periudhën t.

[39] *Bernard Bernier Yves Simon.“ Initiation a la macroeconomie”. 8 edition. F.131*

Kapitali i nevojshëm $K_{t+1} = vD_{t+1}$

Kapitali ekzistues $K_t = vP_t$. Nga këtu mund të shkruajmë.

$I_{n,t+1} = \Delta K = K_{t+1} - K_t$ dhe $I_{n,t+1} = vD_{t+1} - kP_t$

Investimi bruto $I_{t+1} = I_{n,t+1} + I_{r,t+1}$ dhe më tej

$I_{t+1} = v*(D_{t+1} - P_t) + I_{r,t+1}$ ku v quhet akselerator.

Përfshirja e parakohëshme. Parashikimi është i lidhur me burimet ndërmarrëse mbi kërkesën e ardhëshme, çmimet, koston e fitimeve, teknikat e prodhimit etj.Thuhet se skematikisht një manaxher vlerëson prodhimin e ardhshëm dhe shitjet e ardhshme duke u bazuar në prodhimet e realizuara.Ai krahason ndryshimin e shitjeve të kaluara me të sotmet duke disponuar në këtë mënyrë një koeficient të sigurt të parashikimit. Duke analizuar lidhjet për disa vjet rradhazi mund të nxjerrim një koeficient të vërtetë parashikimi. Ky koefiçient mund të futet në parimin e formulimit të akseleratorit. Kështu do kemi. $I_{t+1} = vsh(D_{t+1} - P_t)$ku sh është koeficienti i parashikimit të shitjeve. Nëse ndërmarrja parashikon të mbajë përqindje të njëjtë me ritmin aktual të prodhimeve dhe të shitjeve *sh, është i barabartë me 1*.Në këtë rast akseleratori luan normalisht. Nëse ndërmarrja pret një rritje të shpejtë të shitjeve të saj *sh>1* ajo do të presë edhe rritje të prodhimit.Akselerimin e makinerive nuk e tregon vetëm v por edhe akseleratori fleksibël. Në rastin e aplikimit të modelit Bernier- Simon ne do ta marim sh = 0 dhe akseleratorin fleksibël të barabartë me akseleratorin normal.

Akselerator fleksibël. Ekspozeja e mësipërme presupozon përshtatjen e kapitalit ndaj prodhimit. Në qoftë se ndërmarrja dyfishon prodhimin e saj ajo duhet të dyfishojë edhe kapitalin e saj. Ndërmarrjet investojnë një fraksion të α në sasinë midis kapitalit të nevojshëm dhe kapitalit disponibël. Kështu kemi:

$Int = \alpha(Kn_t - Kd_{t-1})$ *ku* In_t = janë investimet e reja në fund të periudhës t.

Kn_t = kapitali i nevojshëm në periudhën t, Kd_{t-1} = kapitali disponibël në t-1

Kapitali i nevojshëm është i barabartë me prodhimin e shumëzuar me koeficientin e kapitalit. Knt = kPt ose $In_t = \alpha(kP_t - Kd_{t-1})$ $In_t = \alpha kP_t - \alpha Kd_{t-1}$

Shprehja *αk quhet akselerator fleksibël.* Shembull teorik. Nëse α=0. 5 dhe v=2 investimet e reja në periudhën e dytë, sipas tabelës 1, do të jenë In =0. 5*2*105 – 0. 5*200 = 5 në vend të 10. Ndërmarrjet nuk do të investojnë në masën 50% midis kapitalit disponibël dhe atij të nevojshëm.

b)Përshkrimi i modelitM - Asipas Samuelson-Hiksit[40]

Në modelin e kërkesës efektive EDtështë e barabartë me Shpenzimet e konsumit Ct plus Investimet neto It.

[40] *Ŵ.J.M Heijman.“APPLIED MACROECONOMICS”. Faqe 77-78*

EDt = Ct + It

Konsumi përbëhet nga një pjese endogjene dhe nje ekzogjene.Pjesa endogjene varet nga të ardhurat kombëtare të periudhës së fundit. Funksioni makroekonomik i Konsumitdo të jetë:

$Ct = \gamma Y_{t-1} + \hat{C}t$

në të cilën **γ(c)** është prirje marxhinale për të konsumuar. Investimet endogjene varen nga rritja e të ardhurave kombëtare për një të periudhë kohe të caktuar (ΔY_{t-1}). Rritja e të ardhurave kombëtare për një të periudhë kohe të caktuar është përkufizuar e barabartë me $Y_{t-1} - Y_{t-2}$: Investimet varen nga rritja e të ardhurave kombëtare, pasi ne supozojmë se një Rritja e prodhimit do të çojë në një rritje të Kapacitetit të prodhimit tëdëshiruar. Pra stoku i rritjessë kapitalit, çon në një rritjen e kapacitetit të prodhimit.Në këtë proces kemi një periudhë kohe të humbur e cila i referohet kohës që humbasin sipërmarrësit për të reaguar ndaj ndryshimit të rrethanave. Duke përfshirëpjesën ekzogjene të investimit, funksioni i investimtmund të shkruhet si:

$It = \alpha(Yt\text{-}1 - Yt\text{-}2) + \acute{I}$

Në ekuacionin e mësipërmkoeficienti **α(v)**i reagimitna jepakseleratorin. Pjesa autonome e investimit Í mund të shpjegohet me optimizmin e mirë ose të keq të prodhuesve.Nëse ata janë optimist investimi autonomÍ do të jetë relativisht i lartë. Nëse ata janë pesimist investimi autonom do jetë i ulët oseedhe mund të jetë negativ. Së fundi, ekuacioni pasqyron gjendjen e ekuilibrit.Ashtu si ne e dimë, në modelin Keynesian ka ekuilibër në të ardhura nëse prodhimi është i barabartë me kërkesën efektive.

$Y_t = ED_t$

Në këtë moment mund të zgjidhim modelin për prodhimin Yt nëpërmjet zëvendësimit duke marrë:

$Yt = (\gamma + a)Y_{t-1} - aY_{t-2} + \hat{C}_t + \acute{I}_t$

Ekuacioni është një mënyrë e dytë e ndryshimit të ekuacionit. Nëse ne dimë vlerën e Y_{t-1} dhe Y_{t-2} dhe se Ĉt dhe Ít për çdo vit mund të llogarisim vlerën e Yt. Në varësi të vlerës së prirjes marxhinale për konsum γ dhe akseleratoritα kurba e prodhimit tregon forma të ndryshme. Sekuencat tregojnë oshilacionenëse:

$$(\gamma + \alpha)^2 - 4\alpha < 0 \; ose \; \gamma^-$$

Oshilacionet e zbutura do të rezultojë në qoftë se akseleratorido jetë më i vogël se një. Një model i pakufizuar ndodh nëse akseleratori është më i madh se një. Sekuenca është një monoton nëse a = 1.Ne supozojmë se ekonomia është në ekuilibër në periudhën 0.Nee përcaktojmë ekuilibrin si situata kur të gjithë

variablat janë të palëvizshme.Me fjalë të tjera: $Yt = Y_{t-1} = Y_{t-2}$. Duke zëvendësuar këtë kusht tëekuilibrit reduktimi formëssëekuacionit jep një shprehje të tillë për Y_0:

$$Y_0 = \frac{1}{(1-\gamma)}(\bar{I}$$

c)Modeli makroekonomik M-A sipas Bernier-Simon[41]

Konkretisht, le të marrim një ekonomi hipotetike në periudhën aktuale (t) me PBB të përcaktuar. Shpenzimet agregate llogariten nëpërmjet formulës së mëposhtëme.

AEt = Ct+ Î t+Gt+Nxt

Duke konsideruar një ekonomi pa sektor të jashtëm në kushtin e ekuilibrit do të kemi AEt=Yt

Yt = Ct+ Ît+Gt

Yt = E ardhura kombëtare ose PBB

Ct = Konsumi

Î t = Investimet

Gt = Shpenzimet qeveritare

Duke e marrë konsumin të varur prej të ardhurave në periudhën e kohës t mund të shkruajmë:

$Ct = c*Y_{t-1}$ku me c shënojmë prirjen marxhinale për konsum që më lartë e shënuam me γ.

Investimet do ti përgjigjen parimit të përshpejtuesit (akseleratorit) prandaj edhe funksionin e tyre e shkruajmë:

$\hat{I}\ t = v(C_t - C_{t-1})$.Me v shënojmë përshpejtuesin ose akseleratorin.Në këtë funksion nuk kemi përfshirë kuotën e amortizimit. Duke marrë nivelin e shpenzimeve shtetërore G të barabartë me 1 dhe duke zëvendësuar Ct me cY_{t-1} dhe $\hat{I}\ t$ me $v(C_t - C_{t-1})$ funksionin e PBB mund ta shkruajmë.

$$Yt = cY_{t-1} + v(C_t - C_{t-1}) + 1$$
$$Yt = cY_{t-1} + v(cY_{t-1} - cY_{t-2}) + 1$$
$$Yt = cY_{t-1} + vcYt_{-1} - cvY_{t-2} + 1$$
$$Yt = c(1+v)Y_{t-1} - cvY_{t-2} + 1$$

[41] *Bernard Bernier Yves Simon.“ Initiation a la macroeconomie”. 8 edition. F.543*

Tabela Nr. 2: Pesë vlerat e mundshme të përshpejtuesit me lëvizjen e tij të lidhur

a	Prezenca e oshilacionit	Kufizimi
0.25	γ -α, jo luhatëse	a<1, e zbutur
0.80	γ -α, luhatëse	a<1, e zbutur
1.00	γ -α, luhatëse	a=1, monotone
1.30	γ -α, luhatëse	a>1, i pakufizuar
3.00	γ -α, jo luhatëse	a>1, i pakufizuar

Në analizë do të marrim në konsideratë modelin e Bernier –Simon. Kjo sepse nëse u japim të njëjtat vlera multiplikatorit dhe akseleratorit marrim thuajse të njëjtat rezultate. Konkretisht nëse do marrim të dhënat nga 2003deri në 2013 me a dhe v sipas llogaritjeve do kemi të njëjtin rezultat. Me a shënojmë multiplikatorin dhe me v kemi shënuar akseleratorin.


Sipas modelit S-H kemi përdorur: $Yt = (\gamma + a)Y_{t-1} - aY_{t-2} + \hat{C}_t + \acute{I}_t$

Sipas modelit B-S kemi përdorur: $Yt = c(1+v)Y_{t-1} - cvY_{t-2}) + 1$

Tabela Nr.3 Krahasimi i dy modeleve të ciklit të biznesit

Vite	**Cikli teorik me v dhe a te cdo viti,Samuelson-Hiks**	**Cikli teorik me v dhe a te cdo viti, Bernier-Simon**
2004	615607.3	615820.6
2005	687104.5	684922.8
2006	752416.6	747349.6
2007	821468.5	819187.4
2008	895942.8	896314.7
2009	1002730	1001634
2010	1002814	1004407
2011	1148814	1143685
2012	1086520	1093944
2013	1203684	1202562

Figura Nr.2 Cikli teorik sipas dy varjanteve



Kurba tregon se te dyja modelet kalojne neper të njëjtat pika, në këtë mënyrë mund të aplikojmë njërin prej varjanteve. Kemi zgjedhur Samuelson-Hiks duke shmangur nga modeli shpenzimet dhe investimet autonome. Meqënëse edhe në modelin e parë mund të eleminonim G(shpenzimet qeveritare që zakonisht merret 1 supozojmë se koeficienti gabimit në konkluzionet e nxjerra është i vogël.

2. Dinamika e ciklit të biznesit në ekonominë shqiptare (2003-2013) dhe perspektiva e tij.

Dinamika e bustit të ciklit të Biznesit në Shqipëri është mbështetur në dinamikën e PBB-së nominale 2003-2013 duke marë në konsideratë edhe të dhënat e vitit 1998. Të dhënat e vitit 1998 janë marrë në konsideratë sepse në atë vit kemi të dhëna nga Banka Qëndrore për PBB-në reale, PBB nominale dhe çmimin e deflatorit. Në vijim kemi ndjekur rritjen reale dhe kemi bërë shtesë për çdo vit në PBB-në reale. Në këtë mënyrë kemi krijuar PBB-në reale për 11 vitet e mara në studim. Nuk janë përdorur deflatorët sipas INSTAT sepse janë mbështetur në vitin paraardhës, dhe për gjykimin tonë një pjesë e tyre janë tregues të dyshimtë sa i përkesë saktësisë së tyre. Me të dhënave të INSTAT mbi strukturën dhe dinamikën e PBB-sëështë hartuar Tabela e mëposhtëme.


Tabela Nr. 4 Struktura e PBB-së në 11 vjet

	Konsumi Final	Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	Kërkesa e brendshme (1+2)	Eksporti neto (5-6)	Eksportet e mallrave e shërbim-eve (fob)	Importet e mallrave e shërbim-eve (fob)	Ndry-shimet e gjendjeve	Mospër-puthje statistikore	Prodhimi i brend-shëm bruto (3+4++7+8)
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2003	597,453	280,921	878,374	-171,642	141,290	312,932	x	-12,635	**694,098**
2004	668,187	279,378	947,566	-168,169	165,097	333,265	x	-28,376	**751,022**
2005	724,171	301,354	1,025,525	-200,824	185,970	386,794	x	-9,904	**814,797**
2006	771,105	343,882	1,114,987	-208,067	219,970	428,057	x	-24,712	**882,209**
2007	874,937	374,058	1,248,995	-258,520	271,763	530,169	x	-22,805	**967,670**
2008	1,006,633	366,882	1,373,515	-290,128	319,774	609,903	19,767	-22,478	**1,080,676**
2009	1,047,649	374,169	1,421,818	-276,350	338,615	614,965	21,151	-22,682	**1,143,936**
2010	1,102,298	352,412	1,454,710	-255,175	402,141	657,316	23,308	16,801	**1,239,645**
2011	1,156,695	381,944	1,538,639	-295,703	442,390	738,093	26,628	31,060	**1,300,624**
2012	1,181,940	345,031	1,526,971	-248,372	444,514	692,887	36,964	19,926	**1,335,488**
2013	1,219,326	353,878	1,573,204	-243,525	478,759	722,284		35,13	**1,364,782**

Burimi:INSTAT

Në tabelë janë dhënë të gjithë elementët përbërës të PBB-së nominale.PBB-ja nominale ka ardhur në rritje për 11 vite por ka ndryshuar ritmi i rritjes së saj. Kështu në 5 vitet e fundit ka ardhur në rënje të dukëshme aq sa në 2013 arriti në 0.4% nga 7.5% që ishte në vitin 2008. Faktorët që kanë ndikuar në këtë dinamikë janë elementët përbërës të saj sipas shpenzimeve ku elementi kryesor është konsumi final.Për ta parë më hollësisht ndikimin e këtij elementi është hartuar një tabelë më vete së bashku me grafikun përkatës.

Figura Nr.3 Cikli biznesit me PBB nominale



Edhe në figurë shihen qartë fazat e tij të rënjes dhe të rritjes.Në vitet e fundit kurba ka ardhur në rënje.Këtu kemi vendosur edhe kurbën lineare sipas formulës përkatëse.Kjo është bërë për të parë uljet dhe ngritjet e ciklit. Megjithse jo të thella ato dallohen qartë.

Më poshtë kemi dhënë edhe bustin e ciklit me PBB-në reale duke mos marrë në konsideratë çmimet e një viti më parë por duke marrë në konsideratë PBB-në reale të 1998.

Figura Nr.4 Cikli biznesit me çmime konstante




Tabela Nr. 5. PBB, kërkesa e brendshme dhe konsumi final

Vitet	Prodhim i brendshëm bruto	Kërkesa e Brendshme	Konsumi Final
2003	694,098	878,374	597,453
2004	751,022	947,566	668,187
2005	814,797	1,025,525	724,171
2006	882,209	1,114,987	771,105
2007	967,670	1,248,995	874,937
2008	1,080,676	1,373,515	1,006,633
2009	1,143,936	1,421,818	1,047,649
2010	1,239,645	1,454,710	1,102,298
2011	1,300,624	1,538,639	1,156,695
2012	1,335,488	1,526,971	1,181,940
2013	1,364,782	1,573,204	1,219,326

Edhe në këtë rast kurba që tregon bustin e ciklit ka ulje dhe ngritje të saj që tregojnë për oshilacionet e PBB-së reale.Këtë e thekson edhe më shumë prania e interpretimit linear të saj.Kurba thuajse ka të njëjtën tendencë si ajo e PBB-së nominale por është edhe më e theksuar.

Rol të rëndësishëm në dinamikën e PBB-së ka dhënë kërkesa e brendëshme, dhe në këtë zë konsumi final i cili ka edhe koeficientin më të lartë të korelacionit. Lidhja është bërë me të gjithë elementët përbërës por lidhja më e fortë ka qënë ajo midis kërkesës së brendëshme dhe PBB-së.Lidhja midis investimeve, eksportit neto dhe PBB-sëështë mjaftë e ulët, ose e papërfillëshme.Ky konstatim hedh poshtë konstatimet e INSTAT e të BQ-së që në rritjen e PBB-së ka ndikuar rritja e kërkesës së huaj dhe fare pak e asaj të brendëshme. Treguesit e korelacionit tregojnë të kundërtën.

Figura Nr. 5 Dinamika e PBB-së, kërkesës së brendëshme dhe e konsumit final





Figura Nr. 6 Struktura e PBB-së sipas zërave kryesore



Koeficientët e korelacionit

Konsumi final	FBKFiks (Investime)	Kërkesa e brendëshme	Eksport neto
0.996678	0.743204	0.988669	-0.77294

Koeficienti i korelacionit midis PBB-së dhe KF është 0.996, ose thuajse 100%.

Koeficienti i korelacionit midis PBB-së dhe FBKF-sëështë 0.74. Tregues jo i kënaqshëm sepse ky duhej të ishte shumë më i lartë sepse janë investimet ato që ndikojnë direkt në rritjen e PBB-së dhe rënjen e papunësisë. Por nëse në Shqipëri janë kryer investime këto janë kryer përgjithësisht nëinfrastructure, përgjithësisht në ndërtimin e rrugëve dhe jo në prodhim. Kyështë një nga faktorët që investimet nuk kanë qënë në eficiencën e kërkuar.

Koeficienti korelacionit midis PBB-së dhe NX është negativ, por edhe nëse do ishte pozitiv nuk ka ndonjë lidhje të ngushtë. Lidhje shumë të fortë kemi midis PBB-së dhe Im-Ex, por ritmet e ritjes së tyre kanë bërë që pavarësisht se Bilanci Tregëtar është në ulje lidhja midis tij dhe PBB-së të jetë e vogël.

Në krijimin e Ciklit të Biznesit kemi llogaritur koeficientët si më poshtë:

Tabela Nr.6. Llogaritje e disa koeficientëve

	Y	C	ΔC	ΔY	c	ΔK	v
2002	637,987	535,551	55,774	61,996.12			
2003	712,986	597,453	61,902	74,999	0.83	44,900	0.60
2004	768,717	668,187	70,734	55,731	1.27	-1,542	-0.03
2005	831,090	724,171	55,984	62,373	0.90	21,976	0.35
2006	907,908	771,105	46,934	76,818	0.61	42,528	0.55
2007	994,534	874,937	103,832	86,625	1.20	30,176	0.35
2008	1,086,131	1,006,633	131,696	91,597	1.44	-7,176	-0.08
2009	1,125,751	1,047,649	41,016	39,620	1.04	7,287	0.18
2010	1,227,260	1,102,298	54,649	101,510	0.54	-21,756	-0.21
2011	1,297,032	1,156,695	54,396	69,772	0.78	29,532	0.42
2012	1,325,561	1,181,940	25,246	28,529	0.88	-36,914	-1.29
2013	1,367,742	1,219,326	37,386	42,181	0.89	8,847	0.21

Në konsideratë kemi marrë Y(E ardhura Kombëtare Bruto) si dhe PBB nominal (Prodhimin e Brendshëm Bruto).Meqënëse kanë afërsisht të njëjtat tendenca nuk e paraqitëm dinamikën së bashku me llogaritjet pasi të dhënat janë në material.

Tabela Nr.7 MPC dhe v duke marrë në konsideratë Y dhe PBB

	c(Y)	v(Y)	c(PBB)	v(PBB)
2003	0.83	0.60	0.87	0.63
2004	1.27	-0.03	1.24	-0.03
2005	0.90	0.35	0.88	0.34
2006	0.61	0.55	0.70	0.63
2007	1.20	0.35	1.21	0.35
2008	1.44	-0.08	1.17	-0.06
2009	1.04	0.18	0.65	0.12
2010	0.54	-0.21	0.57	-0.23
2011	0.78	0.42	0.89	0.48
2012	0.88	-1.29	0.72	-1.06
2013	0.89	0.21	1.28	0.30
Mes	0.94	0.10	0.93	0.13

Më poshtë po ndërtojmë disa buste të ciklit të biznesit për të parë tendencat që do kishin kurbat nëse do aplikoheshin M-A të ndryshëm

Tabela Nr. 8. Disa buste të ciklit të biznesit

Vite	Cikli teorik me v dhe a te cdo viti, Samuelson-Hiks	Cikli teorik me v dhe a te cdo viti, Yvje	c=0.86 dhe v=0.63	c=0.89 dhe v=0.13 (mesatare)	c=0.93 dhe v=-1.06
2004	615607.3	615820.6	641897.5	627027.1	569840.736
2005	687104.5	684922.8	681740.8	675809.4	638110.547
2006	752416.6	747349.6	740903.5	733459.8	690159.32
2007	821468.5	819187.4	801169.2	793929.4	748997.368
2008	895942.8	896314.7	886036.8	872336.3	809344.212
2009	1002730	1001634	1000575	976492.3	885242.365
2010	1002814	1004407	1023639	1026327	996804.748
2011	1148814	1143685	1126390	1115726	1051418.85
2012	1086520	1093944	1156954	1165483	1144942.13
2013	1203684	1202562	1170484	1193117	1205048.07

Figura Nr. 7 Buste të ciklit të biznesit me koeficientët c dhe v të viteve 2003-2013




Figura tregon se të trija varjantet kanë të njëjtat tendenca, përgjithësisht janë tendenca në rritje.

Më poshtë do të krijojmë për vitet 2014-2024 bustet e ciklit të biznesit për të parë se cila do të ishte e ardhmja e ekonomisë shqiptare nëse do të aplikonim këta çifte multiplikatori dhe akseleratori. Do ti japim përgjigje edhe disa pyetjeve teorike mbi madhësitë e tyre dhe se çfarë duhet të bëjënë politikanët dhe ekzekutivi shqiptar në të ardhmen.

Tablea Nr.9. Buste të ciklit të biznesit deri në vitin 2025të krijuar me c,v sipas viteve të llogaritur më sipër.

	me2003	me2004	me2005	me2006	me2007	me2008
2014	1156301.66	1745744.33	1242031.2	854088.57	1651465.8	1962148.4
2015	834642.1738	2223123.873	1074865.2	240112.64	2082098.2	2777704.4
2016	499757.3125	2831277.171	908870.64	-191218.05	2649239.2	3934649.8
2017	213867.6526	3605790.179	759885.47	-353874.89	3377586.4	5573340.1
2018	5976.35576	4592176.039	631752.11	-305324.95	4308025.2	7894514.6
2019	-119774.4028	5848393.754	523730.23	-159545.75	5495283.8	11182407
2020	-174863.2095	7448257.474	433549.55	-17144.347	7009881.1	15839635
2021	-178189.7479	9485773.655	358631.35	67862.719	8941966.4	22436496
2022	-149893.4138	12080664.79	296546.85	88150.144	11406590	31780805
2023	-107433.733	15385404.2	245162.59	64929.672	14550526	45016814
2024	-63694.18989	19594175.2	202661.84	26835.84	18561008	63765332

vijon

	me2009	me2010	me2011	me2012	me2013	mesatare
2014	1426433.1	728745.87	1108298.4	1150413.1	1222892.4	1286817.2
2015	1494587.6	527090.36	778915.63	1288899.4	1058577.4	1201811.7
2016	1566638.9	326976.45	484791.74	955584.1	907627.75	1121202.4
2017	1642273.7	218591.2	264301.35	1270890.8	776089.27	1045869.3
2018	1721578.9	140800.15	118835.12	711638.27	663096.37	975583.88
2019	1804717	92368.203	33972.279	1347677.4	566427.26	910020.3
2020	1891870.5	60049.539	-8464.5704	365465.63	483819.75	848862.72
2021	1983233	39213.67	-24595.133	1588662.9	413252	791815.2
2022	2079007.5	25550.914	-26450.943	-179901.15	352975.05	738601.54
2023	2179407.3	16666.673	-21940.194	2123134.7	301489.64	688964.08
2024	2284655.5	10865.694	-15657.641	-1102557.7	257513.84	642662.49

Figura Nr.8. Bustet e ciklit të biznesit deri në vitin 2025 me c,v sipas viteve






Figura tregon qartë se nëse do zbatohen ndikuesit e vitit 2004, 2007 dhe 2008 ekonomia do njihte vetëm rritje ekonomike. Ndërsa nëse do zbatoheshin ndikuesit e viteve të tjerë ekonomia do qëndronte në një gjendje stanjacioni.

Figura Nr.9 Bustet duke marrë c,v të 4 viteve të fundit



Kjo figurë tregon sesi do ishte ecuria e ekonomisë shqiptare nëse do aplikoheshin ndikuesit e katër viteve të fundit. Nëse do aplikoheshin c, v e vitit 2012 ekonomia do njihte ulje dhe rënje të përvitëshme, ndërsa nëse do aplikoheshin ato të viteve 2010, 2011 dhe 2013 ekonomia do njihte vetëm rënje por me tendenca rritje në një perspektivë të largët.

Fig. Nr. 10. Efekti i c,v në përcaktimin e bustit të ciklit



Kjo figurë tregon se në vitet 2004, 2007 dhe 2008 madhësia dhe raporti i c, v – së kanë qënë në shkallën e duhur sepse janë vitet e vetme që kanë nëse aplikohen vetëm rritje. Të gjitha vitet e tjera i kanë ndikuesit në madhësi dhe raporte jo efektive, gjë që e tregon edhe vija që qëndronmbi boshtin e X-ve. Në krahun e djathtë për ndikim negativ kemi marrë vitet 2010, 2012 dhe 2013.

Viti	MPC©, prirja marxhinale për konsum	v, përshpejtuesi ose akseleratori	Multi plika tori 1/1-c	Viti	MPC©, prirja marxhinale për konsum	v, përshpejtuesi ose akselera-tori	Multi plika tori 1/1-c
2004	1.27	-0.03	-3.7	2010	0.54	-0.21	2.2
2007	1.2	0.35	-5	2012	0.88	-1.29	8.3
2008	1.44	-0.08	-2.3	2013	0.89	0.21	9.1

Këto janë madhësitë dhe raportet më optimale për të përfituar në të ardhmen një rritje ekonomike të qëndrueshme.

Në bazë të tyre llogarisim Multiplikatorët përkatës duke treguar se kush e shkakton rritjen rritja e c, apo e s, rritja e apo ulja e v?

Konkluzioni është i thjeshtësa më e madhe të jetë MPC dhe sa më i vogël v aq më shumë rritje ekonomike do të ketë. E para sepse do të rriten shpenzimet e konsumit e për pasojë do të rritet kërkesa agregate që do stimulojë ofertën agregate. E dyta sa më i vogël të jetë v aq më eficient është kapitali. Kjo do të

thotë se për prodhimin e një njësie produkti duhet të vihet në qarkullim më pak kapital.Këto koeficientë kanë ndikuar edhe në formën e kurbave të bustit të ciklit të biznesit.Grupi i parë me MPC të lartë dhe v të ulët i ka kurbat me tendenca rritëse, ndërsa grupi i dytë i ka me tendencë, stanjacionin ose oshilacione të vazhdueshme.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

PBB dhe të Ardhurat Kombëtare nga viti 2003- 2013 kanë ardhur në rritje. Ritmi i ritjes së tyre ka ndryshuar në vite.Ndryshimi më i madh ka qenë në 5 vitet e fundit që përkojnë edhe me recesionin global.

Kërkesa e brendëshme është elementi kryesor i PBB-së që ka dhënë ndikimin më të madh në rritjen e PBB-së.

Konsumi final është pjesa kryesore e saj dhe në këtë grup është konsumi i popullatës i lidhur ngushtë me rritjen ekonomike.

Në total Nx ka dhënë një ndikim të ulët në rritjen ekonomike ndërsa duke i shkëputur nëEx dhe Im lidhja midis tyre dhe PBB-sëështë shumë e fortë. Meqënëse BT ka ardhur në rënje ndërsa C në rritje dhe diferenca midis tyre është mjaftë e madhe mund të thuhet se faktori kryesor në rritjen e ekonomisë shqiptare ka qënë kërkesaagregate(AD) e brendëshme.

Sa i përkest Formacionit Bruto të Kapitalit Fiks ka psur oshilacione të mëdha. Kjo tregon për paqëndrueshmëri në rritjen uniforme të këtij zëri.Është kjo arsye qëky element nuk ndihet me forcën e tij në rritjen ekonomike. Struktura e tij e brendëshme, në sferën e G-sëështë thuajse e investuar në infrastrukturë, gjë e cila nuk ka ndikuar në rritjen direkte të investimeve prodhuese.Nuk ka firma të prodhojnë mjete prodhimi për prodhimin e sendeve të konsumit, por më së shumti kapitali i huaj është futur në fushën e fasoneve.

Perspektiva e ekonomisë shqiptare deri në vitin 2015 nëse aplikohen koeficientët e 4 viteve të fundit shihet se nuk është e mirë.Tendencat e saj janë në rënje. Vetëm nëse aplikohen koeficientët e viteve 2004, 2007 dhe 2008 ekonomia do shënoi rritje.

Për këtë duhet:

Qeveria të investoi jo vetëm në infrastrukturë por të krijojë ndërmarrje me kapital shtetëror.

Qeveria të çeli një Bankë Tregëtare me kapital shtetëror.

Të largohet nga qarkullimi si monedhë zyrtare euro dhe dollari për ti lënë rolin e duhur lekut e për pasojë Bankës së Shqipërisë e cila deri tani ka qënë jashtë loje në fushën e trasmetimit të politikave monetare.

Të rishtetëzohen pasuritë nëntokësore, sektori naftës, kromit etj si dhe të anulohen koncensionet e miratuara në dëm të shoqërisë shqiptare.

BIBLIOGRAFI

INSTAT. TREGTIA E JASHTME FOREIGN TRADE 2009-2013.
Banka e Shqipërisë. Raport Vjetor: 2006.
Banka e Shqipërisë. Raport Vjetor: 2008.
Banka e Shqipërisë. Raport Vjetor: 2010.
Banka e Shqipërisë. Raporte Statistikore: 2012.
Banka e Shqipërisë. Raporte Statistikore: 2013.
Banka e Shqipërisë. Raporte Statistikore: 2014(tetor).
INSTAT. PBB 2013(16.12.2014). INSTAT, Njoftim për medjan Maj 2014.
Ŵ.J.M Heijman. "APPLIED MACROECONOMICS"
Bernard Bernier, Yves Simon. " Initiation a la macroeconomie". 8 edition. 2005

INFLACIONI NË SHQIPËRI - PASOJË E TRASMISIONIT NDËRKOMBËTAR TË INFLACIONIT

Alqi Naqellari
Mediterranean University of Albania
alqinaqellari@umsh.edu.al
Arjan Gjini
Mediterranean University of Albania
arjan.gjini@umsh.edu.al
Elona Shahini
Mediterranean University of Albania
elonashahini@umsh.edu.al

ABSTRACT

Inflation is the phenomenon and most controversial macroeconomic indicator in the world today. For him there is no universal recommendation to keep the desired quota. It is the result of an overall process of economic interaction - political. In this process included internal factors and external factors. Internal factors include pricing policies of all public or private firms operating in the country to fit the interests of the purchasers, applying government policies and structure of the property. An important role played by the Central Bank policies that rely largely in effect, transmission of monetary policy. External factors mentioned price effect, demand, liquidity and international expectations of inflation. In this article we will discuss the effect of external factors avoiding factors as interior. The aim is to show the key role today in the inflation rate in Albania has imported inflation. In this way the recommended Central Bank to change its primary objective. In the analysis will use the methods of comparison and synthesis, statistical and econometric methods.

Keywords: *GDP, demand, supply, monetary policy, external factor, imported inflation, unemployment, etc.*

HYRJE

Sot në Europë një mga problemet ekonomike më të rëndësishme që diskutohet është inflacioni. Inflacioni jo në aspektin e rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve por në efktin rënës, atë që quhet deflacion. Në këto kushte BQE do të hedhë në qarkullim 1.1 trilion euro nga marsi 2014 deri në shtator 2016 nga 60 miliardë euro në muaj duke blerë bono thesari duke mbajtur një normë bazë të interest 0.05% të vendsur që në shtator të vitit të kaluar. Ky process do fillojë me printimet e eurove nga BQE me të cilat do blihen bono thesari. Ky veprim do krijojë mundësi për uljen e normës së interest. Duke ulur normën e interest do rritet stoku i kredisë, dhe rritja e tij do nxitet ekonomia dhe për pasojë do të bjerë papunësia. Gjithë ky veprim i BQE-së do ketë ndikimin e vet edhe në ekonominë shqiptare. Ndikimi në këto kushte do të jetë negativ. Ky veprim i BQE-së do të ndikojë në rritjen e nivelit të inflacionit në Shqipëri. Kjo do të ndodhi në dy rrugë e para sepse do të rritet niveli i inflacionit të importuar. Niveli i inflacionit të importuar do rritet sepse mbi 75% të vëllimit të importeve të mallrave ekonomia shqiptare i realizon me vendet e Europës Perëndimore dhe së dyti do ndikojë në rritjen e kredisë në euro e cila do të jetë më e zhvlerësuar. Në këtë mënyrë politikat ekspansioniste që ka aplikuar dhe do vazhdojë të aplikojë Banka e Shqipërisë do të kenë një ndikim të vogël në nivelin e inflacionit. Në vijim ekonomia shqiptare do rezikojë të mos realizojë shifrat e rritjes së parashikuar. Kjo do të vijë jo vetëm për llogari të politikave të pa efektëshme të qeverisë por më së shumti nga mungesa e trasmisionit të politikave monetare të Bankës Qëndrore.

Transmisioni ndërkombëtar i inflacionit

Deri në vitet 90-të ekonomia shqiptare ka qënë një ekonomi e mbyllur. Kjo do të thotë se në atë periudhë kohe nuk kanë ekzistuar fenomene që janë karakteristike për ekonomitë e vogla të hapura siç është ekonomia shqiptare. Nuk ka ekzistuar koncepti i papunësisë dhe i inflacionit, fenomene që janë tipike për një ekonomi tregu. Kalimi nga ekonomia e mbyllur në një model të një ekonomie të vogël të hapur përballet me transmetimet e impulseve inflacioniste nga ekonomitë e hapura me të cilat ka marrëdhënie ekonomike tregëtare në ekonominë shqiptare. Për shpjegimin e këtij efekti, tipik është Modeli Skandinav i Inflacionit i cili mbështetet në lidhjen direkte të çmimit ndërkombëtar me çmimin e brendshëm si një mundësi e veçantë në kanalin e transmisionit. Ky

efekt është real në një ekonomi si ajo shqiptare sepse nje pjesë e konsiderueshme e mallrave të shportës mbi bazë të së cilës llogaristet Indeksi i Çmimeve të Konsumit importohen tërësisht, një pjesë e madhe mallrash dominojnë pjesën më të madhe të tregut duke decizuar mbi çmimin dhe një pjesë tjetër ndikon në disa prej zërave kryesorë të shportës. Duke ndjekur klasifikimin më të fundit të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim do shikojmë kanalet e transmisionit ndërkombëtar të inflacionit, ku në sistemin e dhënë me normë këmbimi fleksibile kemi:

1. *Efektet e çmimit* – transmisioni direkt i inflacionit nëpërmjet tregut ndërkombëtar të të mirave.
2. *Efektet e kërkesës* – kalimi i kërkesës së tepërt prej një vendi në një vend tjetër. Kjo gjen reflektimin e vet në Bilancin Tregëtar dhe në Bilancin e Llogarisë korente.
3. *Efektet e likuiditetit* – ndryshimet në bilancet e pagesave ndikojnë në ofertën monetare dhe për pasojë në të ardhurat monetare. Ky ndikim është i lidhur me llogarinë kapitale dhe financiare.
4. P*ritjet ndërkombëtare inflacioniste dhe efektet e "demonstrimit"*. Ndikimi i këtij faktori është pikërisht tek efekti i trasmisionit, ku ashtu siç përcillet inflacioni real ashtu përcillen edhe efektet e pritshmërisë së tij.

Në këtë analizë do të shikojmë ndikimet e mësipërme duke u përqëndruar kryesisht në efektin e çmimeve dhe në efektin e kërkesës. Para se të kalojmë në analizë le të shpjegojmë se cilat janë arsyet përse modelin Skandinav do ta marrim si referencë për ekonominë shqiptare?

E para, sepse ekonomia shqiptare është një ekonomi e vogël e hapur me lëvizje të lirë të të mirave dhe kapitaleve. Duke qënë e tillë ajo nuk ndikon as në nivelin e normave të interesit ndërkombëtar dhe as në nivelin e çmimeve përkundrazi ju përshtatet atyre.

E dyta, sepse ka ngjajshmëri në raportet e treguesve makroekonomikë, veçanërisht në raportin import/GDP.

E treta, sepse niveli i eksporteve është tepër i vogël dhe përgjithësisht konsiston në eksporte të lëndëve të para të pa përpunuara dhe në rieksporte në fushën e fasonerisë. Është kjo arsye që në këtë zë eksportet janë më të mëdhaja sesa importet. Në eksporte përfshihet edhe vlera e shtuar që përbën punën e punonjësve shqiptare mbi importet. Kryesisht këto realizohen me Italinë dhe me Greqinë në fushën e konfeksioneve dhe këpucëve.

E katërta, sepse kemi diferenca të dukëshme në ritmet e rritjes së zërave të GDP, në favor të sektorëve të ndërtimit, transporteve, shërbimeve etj, (mallra dhe shërbime të patregëtueshme). Në vitet e fundit, veçanërisht pas vitit 2008 këto ritme kanë ndryshuar.

E pesta, sepse banka qëndrore pavarësisht se kurset e këmbimit janë të deklaruara fleksibile dhe jo fikse ka ndërhyrë shumë herë në treg duke shitur dhe blerë valutë, etj.

I. Efektet e çmimit. Kur flasim për nivelin e çmimit në një ekonomi të vogël të hapur të krahasuar me vendet e tjera me të cilën bën tregëti mund të thuhet se ekziston hipoteza e barazisë së çmimeve, që do të thotë se çmimi i një malli në Shqipëri është i barabartë me çmimin e të njëjtit mall në Itali apo në Greqi të indeksuar me kursin e këmbimit. Kjo hipotezë shumë e përhapur, është përdorur prej mbështetësve të teorisë monetariste në "Modelin e Bilancit të Pagesave". Pikërisht kjo teori është mbështetur edhe prej ekonomistëve strukturalistë skandinavë. Duke u bazuar në këtë hipotezë Këshilli Gjerman i Ekonomisë ka argumentuar se drejtimi i çmimit ndërkombëtar lidhet me përbërjen dhe burimin e inflacionit të importuar. Kjo ka ndodhur edhe në ato raste kur Bilanci i Pagesave ka rezultuar me deficit. Për vendet që aplikojnë kurse këmbimi fikse nënkuptohet se norma e brendëshme e inflacionit dhe norma ndërkombëtare e inflacionit do të jenë të barazuara, ose që përgjithësisht normat e inflacionit do të konvergjojnë në të njëjtin nivel në vende të ndryshme. Arsyet pse normat e inflacionit ndryshojnë në botën reale me kurse fleksibile këmbimi ose edhe me kurse të fiksuara këmbimi, është ekzistenca e dy kategorive të mirash, në grupin e parë përfshijmë të mirat jo të tregëtueshme me normat e ndryshme të inflacionit midis vendeve.

Në shqipëri pas vitit 1990, zbatohen të njëjtat teknika të llogaristjes së treguesve makroekonomikë që zbatohen edhe në vendete tjera të europës perëndimore. Vahdimisht janë bërë ndëryshime të rëndësishme strukturore sidomos në strukturën e shpërtës së mallrave mbi bazë të së cilës llogaritetdit ka ndodhur në vitin 2007. Në shportë nga 2661 të mira dhe shërbime numri i tyre shkoi në 272, ndërsa numri i grupeve ka mbetur 12. Këtu kemi edhe diferencimin e grupeve të mallrave të tregëtueshme dhe jo të tregëtueshme. Nëse në vitn 2001 raporti midis tyre ka qënë 54% me 46% sot më ndryshimet e vitit 2007 ky raport ka ndryshuar. Kështu kemi:

Tabela Nr. 1 Pesha e mallrave të shportës sipas ndryshimeve përkatëse

		2007	2001	1993
01	Ushqime dhe pije jo alkolike	39.3	42. 6	72. 4
02	Pije alkolike dhe duhan	3.6	3.1	x
03	Veshje dhe këpucë	5.1	3. 9	2. 8
04	Qera, ujë, lëndë djegse dhe energji	16.3	24. 4	6. 4
05	Mobilim, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	10	4. 6	8. 3
06	Shëndeti	3.4	2. 1	0. 8
07	Transport	6.1	4. 8	5. 2
08	Komunikim	2.6	1. 3	x
09	Argëtim dhe kulturë	3.1	2. 6	3. 6
10	Shërbimi arsimor	1.4	1. 0	x
11	Hotele, kafene dhe restorante	4.2	7. 2	x
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	4.9	2. 4	0. 5

INDEKSI ÇMIMEVE TË KONSUMIT. INSTITUTI STATISTIKAVE. GUSHT 2013.F.4

Karakteristikë e strukturës së mallrave të shportës nga 1993 në 2007 janë:
-Është ulur gati 200% pasha që zë grupi "ushqime dhe pije joalkolike"
-Është rritur zëri "veshje dhe këpucë" afro 200%,
-Janë shtuar edhe 4 grupe që nuk kanë qënë në vitin 1993.
Në grupin e mallrave të tregëtueshëm përfshijmë
-ushqime dhe pije joalkoolike, 39.5%
-pije alkoolike dhe duhan, 3.6%
-veshje dhe këpucë, 5.1%
-paisje shtëpie dhe mirëmbajtje 8%
-mallra dhe shërbime të ndryshme 3%

që në total kapin 59.2% të shpenzimeve, ndërsa qira, ujë, karburant, energji, kujdes mjekësor, transport, komunikim, arsim, kulturë, argëtim, hotele, kafene, restorante e tjera shërbime i përfshijmë në mallrat e pa tregëtueshëm dhe që zënë 40.8% të totalit të shpenzimeve. Në krahasim me vitin 2004 kemi rritje të mallrave të grupit të parë nga 54% në 59.2% ndërsa kemi rënje në grupin e dytë me rreth 5%. Ky fakt e forcon edhe më tej efektin e trasmisionit të inflacionit midis vendeve.

Në zërin e parë 37.2 i zënë ushqimet dhe 2.1 pijet jo alkolike. Në ushqime 8.9% e zë mishi, 6% e zënë bukë e drithra, 6.4% qumësht, djathë dhe vezë,

vaj dhe yndyrna 2.9%,Fruta 3.5%, Zarzavate plus pataten 5.5%, sheqer, reçel, mjllata dhe ëmbëlsira 2.2%. Në zërin e dytë janë të ndara në mes. Në zërin e tretë lëndë djegëse dhe energji zënë 4.3%. Duke i marrë të gjithë zërat me rradhë afro 50% e tyre janë importe, ose shërbime që varen nga importet.

Tabela Nr. 2. Importet e disa prej produkteve kryesore në milionë lekë

	Emërtimi	2009	%	2010	%	2011	%	2012	%	2013	%	13/09
	Gjithsej	428.839	100	477.768	100	544.004	100	528.49	100	517.312	100	121
0	Ushqime dhe kafshë të gjalla	52.035	12.1	60.717	12.7	65.925	12.1	66.292	12.5	66.83	12.9	128
1	Pije dhe duhan	16.343	3.8	19.672	4.12	17.937	3.3	18.622	3.5	19.113	3.7	117
2	Materiale të papërpunuara	9.762	2.3	16.836	3.52	21.734	4	13.961	2.6	13.065	2.5	134
3	Lëndë djegëse	50.739	11.8	65.871	13.8	95.58	17.6	105.22	19.9	88.504	17.1	174
4	Yndyrna bimore dhe shtazore	5.053	1.2	5.553	1.16	6.558	1.2	6.487	1.2	5.309	1	105
5	Produkte kimike	42.711	10	48.33	10.1	52.687	9.7	57.987	11	59.806	11.6	140
6	Mallra të përpunuara	108.061	25.2	115.858	24.2	118.365	21.8	109.25	20.7	113.682	22	105
7	Makineri e pajisje transporti	94.779	22.1	89.528	18.7	106.292	19.5	95.023	18	93.068	18	98.2
8	Mallra të tjera të përpunuara	49.005	11.4	55.084	11.5	58.571	10.8	54.961	10.4	57.673	11.1	118
9	Mallra të paklasi kuara diku tjetër	0.353	0.1	0.318	0.07	0.355	0.1	0.69	0.1	0.262	0.1	74.2

Burimi: TREGTIA E JASHTME FOREIGN TRADE 2009-2013

-Të dhënat e tabelës tregojnë se importet në total, në 5 vite janë rritur me 21%, ushqime dhe kafshë të gjalla me 28%. Pesha e këtij zëri ndaj totalit ka ndryshuar fare pak me 0.8%. Kjo tregon se importet e tyre kanë qënë thuajse e njëjtë për çdo vit. Gjykojmë se arsyeja e këtij ndryshimi të vogël është mosndryshimi i kërkesës për këto lloj mallrash që varen direct nga numri i popullsisë. Meqënëse

numri i popullsisë thuajse nuk ka ndryshuar edhe kërkesa për këto mallra ka ndryshuar pak, vetëm në strukturën e brendëshme.

-Zëri "Pije dhe duhan" ka ndryshuar pak sin ë strukturë ashtu edhe në dinamikë, është rritur vetëm me 17%.

-Zëri "Materiale të papërpunuara" ka ndryshuar peshë në strukturë me +0.2%, ndërsa në 2013 ndaj 2009 është rritur me 34%. Ky është një tregues pozitiv sepse rënja e çmimeve në këtë zë ka ndikuar në zërat e produkteve përfunadimtare që realizohen në Shqipëri.

- Zëri "Lëndë djegëse" ka rritjen më të madhe sin ë peshë ndaj totalit ashtu edhe si 5 vjeçar. Çfarë tregon ky zë? Ky zë tregon se megjithëse në Shqipëri prodhohen karburante në mbi 1 milion tonë në vit Shqipëria importon pjesën më të madhe për plotësimin e nevojave të saj. Në këtë mënyrë çmimi i karburanteve në vend nuk përcaktohet nga prodhimi vendas por përcaktohet nga prodhimi i huaj. Ky veprim është një nonsense në kushtet kur mund të plotësoheshin nevojat 100% me prodhimin vendas. Duke u bërë ky veprim çmimet do përcaktoheshin nga prodhimi vendas dhe jo nga importet.

-Zëri "Produkte kimike" ka psuar një rritje të dukëshme me 40%, pavarësisht se në peshë ka vetëm 1.6 pikë ndryshim. Ky zë jep ndikim në produktet përfundimtare që realizohen në vend, prandaj ka ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e çmimeve të vendit.

-Zëri "Mallrat ë përpunuara" zë peshën kryesore në strukturën e importeve me 25.2% në 2009 dhe 22% në 2013. Nga 2009 në 2013 është rritur me 5%. Ky zë jep ndikimin e tij direct në çmimet e mallrave të konsumit të gjerë. Edhe zëri "mallrat ë tjera të përpnuara është rritur me 18% pa shumë ndryshime në strukturë.

- Zëri "Makineri e paisje transporti" është ulur në peshë ndaj totalit me 4.1$ ndërsa në vëllim 13/09 ka rënë me 1.8%. Është zëri i dytë në peshën ndaj totalit pas mallrave të përpunuara me 18%. Rënja e këtij zëri është e pritëshme sepse në Shqipëri në vitet e para u futën me qindramijë mjete transporti, ndërsa në vitet e fundit ka pak shpenzime vetëm për mjete transporti luksoze dhe përgjithësisht të atyre urban. Ky zë ka ndikim indirekt në nivelin e çmimeve të transportit.

Të dhënat tregojnë se vetëm 5 grupe mallrash zënë 92.7% të importeve(rreshtat 0, 3, 5, 6, 7, 8). Këto janë grupet që ndikojnë dhe përcaktojnë përgjithësisht nivelin e çmimeve në Shqipëri.

Tabela Nr. 3 Importet në milionë lekë sipas rajoneve.

Vitet	Importet në milionë lekë					Në %	
	2009	2010	2011	2012	2013	2009	2013
Gjithsej	**428.84**	**478**	**544**	**528**	**517.31**	100	100
Vendet e BE-së	279.76	318	355.07	334	332.8	**65.2**	**64.3**
Vendet e Ballkanit Perëndimor	24.085	33.8	39.809	41.6	34.846	**5.6**	**6.7**
Vendet e tjera të botës	124.99	126	149.12	153	149.66	**29.1**	**28.9**

Burimi: TREGTIA E JASHTME FOREIGN TRADE 2009-2013

Të dhënat e tabelës së mësipërme tregojnë se pjesa më e madhe e importeve realizohet me vendet e BE-së. Me vendet e Ballkanit Perëndimor realizohet vetëm 6.7%. Me Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë realizohet vetëm 3.3%. Këtë strukturë e tregon edhe tabela Nr.4 në të cilën janë renditur 13 vendet sipas peshës që zënë në importet e Shqipërisë.

Tabela Nr. 4 vendet kryesore që Shqipëria realizon importet e saj. Në milionë lekë

	Emërtimi	**2009**	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**Në %**
1	Itali	112.175	134.6	166.05	168.372	170.403	32.9
2	Greqi	66.61	62.62	57.796	50.117	45.692	8.8
3	Kinë	31.053	30.23	34.731	33.574	34.984	6.8
4	Turqi	27.709	27.05	30.2	30.379	32.816	6.3
5	Gjermani	27.726	26.77	31.163	31.936	29.978	5.8
6	Francë	8.99	10.42	13.089	8.458	15.528	3.0
7	Serbi	11.455	17.71	19.607	23.321	15.145	2.9
8	SHBA	6.116	7.348	7.78	11.423	12.443	2.4
9	Rusi	11.625	10.48	10.54	13.474	10.14	2.0
10	Bullgari	8.116	8.51	6.916	6.838	9.601	1.9
11	Maqedoni	7.848	7.543	8.882	8.365	8.599	1.7
12	Kosovë	2.967	3.8	4.51	5.106	6.007	1.2
13	Mal i Zi	0.774	0.925	1.381	1.086	1.829	0.4


Burimi: TREGTIA E JASHTME FOREIGN TRADE 2009-2013

Të dhënat tregojnë se vendin e parë në importet shqiptare e zë Italia me 32.9%. Importet që realizohen nga Italia janë të barabarta me importet që realizohen së

bashku nga Greqi, Kinë, Turqi, Gjermani, Francë dhe Mali i Zi. Nga të dhënat e mësipërme shihet se ekonomia shqiptare është e lidhur ngushtësisht me vendet e rajonit dhe më gjerë. Këto vende nëpërmjet eksporteve të tyre drejt Shqipërisë kanë përcjellë njëkohësisht krahas mallrave dhe shërbimeve edhe shkallën e inflacionit të tyre. Më poshtë është dhënë një tabelë e normës së inflacionit të disa prej vendeve kryesore dhe nëpërmjet koeficientit të korelacionit shkalla e lidhjes së tyre me nivelin e inflacionit në Shqipëri.

Tabela Nr.5. Inflacioni në eurozonë dhe në vendet kryesore importuese të Shqipërisë

		Inflacioni në %					
Nr	Vendet	2008	2009	2010	2011	2012	2013
1	Eurozonë	3.3	0.3	1.6	2.7	2.5	1.4
2	Gjermani	2.8	0.2	1.1	2.3	2.1	1.5
3	Greqi	4.2	1.3	1.4	3.1	1	-0.8
4	Itali	3.5	0.8	1.8	2.9	3.3	1.2
5	Turqi	10.5	6.3	5.6	6.5	8.9	7.6
6	Kosovë	9.4	-2.4	3.5	7.3	2.5	1.8
7	Maqed	8.3	-0.8	1.1	3.9	3.3	2.8
8	Shqip	3.4	2.3	3.6	3.5	2	1.7



BANKA E SHQIPËRISË. RAPORTE VJETORE 2008-2013

Grafikisht për vendet kryesore është paraqitur në grafikun e mëposhtëm

Grafiku Nr.1 Dinamika e inflacionit në Itali, Greqi, Eurozonë dhe në Shqipëri

Në tabelën Nr.5 dhe grafikun Nr. 1 është dhënë dinamika e normës së inflacionit për vendet kryesore me të cilat Shqipëria realizon importet e saj. Nga këto vende importohen mbi 56.7% e totalit. Janë këto vende që ndikojnë direkt


në normën e inflacionit në Shqipëri. Të dhënat tregojnë se inflacioni në Shqipëri ka ndjekur të njëjtat tendenca që ka inflacioni në vendet e BE-së, Itali dhe Greqi. Është më i lartë se në këto vende por ka thuajse të njëjtat tendenca. Kjo tregon për shkallën e lartë të lidhjes midis tyre. Është më i lartë se në këto vende sepse kur futen mallrat në teritorin shqiptar ju nënështrohen një sërë taksash doganore.

Lidhja midis ekonomisë shqiptare dhe ekonomive të rajonit dhe më tej jepet edhe nëpërmjet treguesit të Prodhimit të brendshëm Bruto(PBB).

Rritja e PBB-së për disa vende të rajonit dhe më gjerë jepet në tabelën Nr.6.

Tabela Nr.6. Dinamika e PBB-së

		Rritja e PBB-së në %					
Nr	Vendet	2008	2009	2010	2011	2012	2013
1	Eurozonë	0.9	-4	0.7	1.4	-0.7	-0.4
2	Gjermani	1.3	-5	1.2	3	0.7	0.4
3	Greqi	3	-2	-0.3	-5.5	-6.3	-3.8
4	Itali	-0.9	-4.8	0.7	0.4	-2.2	-1.8
5	Turqi	0.9	-5.8	2.8	6.6	2.7	3.8
6	Kosovë	5.4	4	4.6	4.5		2.3
7	Maqed	5.5	-0.2	1.5	5.5	-0.6	3.1
8	Shqip	7.5	3.3	3.8	3	1.62	0.7



BANKA E SHQIPËRISË. RAPORTE VJETORE 2008-2013

Grafikisht për Eurozonën, Italinë, Greqinë dhe Shqipërinë kemi këtë paraqitje:

Figura Nr.2 Dinamika e rritjes së PBB-së

Të dhënat e tabelës dhe dinamika e kurbave në grafikun përkatës tregojnë se vendet e eurozonës në vitin 2008 dhe 2009 kanë pasur PBB në rënje me minus.

Në vitin 2010 kanë marrë vlera pozitive, ndërsa në vitet 2012 dhe 2013 kanë marrë vlera negative. Në vitin 2014 këto vende kanë tregues pozitiv. Ekonomia greke nga vitit 2009 dhe deri në 2014 ka qënë me shifra negative në rritjen e PBB-së. Ajo vazhdon edhe sot të bëjë tratativa për faljen ose shtyrjen e borxhit të saj, megjithatë ka shënja të mira në stabilizimin dhe rritjen ekonomike. Dinamika e PBB-së shqiptare është mbi të gjitha kurbat e tjera. Tendenca e saj vjen vazhdimisht në rënje duke tentuar zeron në vitin 2013. Kjo do të thotë se edhe ky tregues ka lidhje direkte me dinamikën e kurbave të PBB-së së vendeve të Europës, në veçanti të Italisë dhe vendeve të tjera të fuqishme me të cilat Shqipëria ka lidhje ekonomike.

Shkalla e lidhjes së inflacionit, PBB-së dhe normës së papunësisë në Shqipëri me normën e inflacionit, PBB-në dhe papunësinë në këto vende paraqitet në tabelën e mëposhtme.


Tabela Nr.7. Koeficienti korelacionit midis normës së inflacionit në Shqipëri dhe në vendet kryesore europiane që eksportojnë në Shqipëri.

	Eurozonë	Gjermani	Greqi	Itali	Turqi	Kosovë	Maqedoni
PBB	0.26	0.091	0.85	0.21	-0.233	0.90	0.47
Inflacion	0.45	0.314	0.78	0.39	-0.132	0.67	0.324
Papunësi	0.70	-0.63	0.62	0.76	-0.22	-0.65	-0.84

Llogaritjet e koeficientëve të korelacionitjanë bërë nga ana e autorëve.

Shkalla e lidhjes midis PBB-së dhe inflacionit jepet edhe nëpërmjet grafikut të mëposhtëm.

Figura Nr.3 Shkalla e lidhjes midis PBB-së dhe normës së inflacionit sipas vendeve bazuar në të dhënat e Tabelës Nr. 7



Të dhënat e tabelës dhe të grafikut përkatës tregojnë se kemi një lidhje direkte, herë të fortë dhe herë të dobët, por që përgjithësisht në të gjitha treguesit kemi lidhje të vlerësueshme.

- Shkalla e forcës së lidhjes për PBB-në është e fortë me Greqinë(0.85), Kosovën(90), Maqedoninë(0.47) dhe eurozonën me 0.26.
- Shkalla e forcës së lidhjes për normën e inflacionit është e fortë me Greqinë(0.78), me Kosovën(0.67), me Maqedoninë(0.32), me Italinë(0.39) dhe me eurozonën 0.45.
- Shkalla e forcës së lidhjes për normën e papunësisë është e fortë me Italinë(0.76), me Greqinë(0.62) dhe me eurozonën 0.70.

Nga lidhjet e mësipërme konkluzioni është i thjeshtë, Italia, Greqia dhe përgjithësisht vendet e Eurozonës janë ekonomitë me të cilat është më e lidhur ecuria e treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri, si Prodhimi i Brendshëm Bruto, Norma e Inflacionit dhe Norma e Papunësisë. Ato kanë përcaktuar dhe vazhdojnë të përcaktojnë ecurinë e këtyre treguesve të rëndësishëm.

Më lartë u analizua faktori i huaj në ndikimin e tij në ekonominë shqiptare. Nëse do të shikonim sesi ndikojnë politikat fiskale dhe monetare në këta tregues, në rastin e marrë në analizë, në normën e inflacionit do të konkludohet thjeshtë se politikat monetare nuk kanë ndonjë efekt përcaktues në kontrollin e këtij treguesi. Meqënëse nuk është në objektin e analizës shkurt po japim lidhjen midis dy treguesve themelorë që duhej të kishin lidhje të forta inverse.

Tabela Nr.8 Dinamika e normës së Inflacionit dhe e REPO-ve

Emërtimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Norma Bazë e Interesit REPO, %	6.25	5.25	5	4.75	4	3
Norma e Inflacionit në %	2.2	3.5	3.6	1.7	2.4	1.9

Shkalla e lidhjes midis këtyre dy treguesve është 0.32. Ky koeficient tregon se midis tyre jo vetëm që nuk ka ndonjë lidhje inverse por përkundrazi ka lidhje pozitive jo shumë të fortë.

Nga analizat e mësipërme mbi normën e inflaconit doli qartë roli themelor i këtyre vendeve në madhësinë e tij.

Efekti i kërkesës

Kërkesa agregate në ekonomitë e hapura ndryshon nga kërkesa agregate në ekonomitë e mbyllura. Arsyeja është sepse në kërkesën e brendëshme agregate në ekonomitë e hapura nuk kemi vetëm shpenzimet e brendëshme por kemi edhe shpenzime të huaja, njëkohësisht kemi edhe shpenzime të brendëshme të dala jashtë vendit. Kjo sepse në ekonomitë e hapura kemi lëvizje të lirë jo vetëm të mallrave por edhe të kapitaleve. Shprehja e kësaj lëvizjeje është pikërisht Bilanci i Pagesave. Në ekonomitë e mbyllura, siç ka qënë Shqipëria para viteve 90 ka pasur marrëdhënje tregëtare me 128 vende të botës por kjo nuk do të thotë që ekonomia shqiptare ka qënë një vend i vogël i hapur. Hapja e një ekonomie nuk shikohet në zërin e Bilancit Tregëtar por shikohet në Llogarinë Financiare dhe Kapitale që ka të bëjë me lëvizjen e lirë të kapitaleve. Vetëm pas vitit 1990 ekonomia shqiptare mund të quhet një ekonomi e vogël e hapur. Pas këtij viti parlamenti shqiptar miratoi futjen e kaptaleve të huaja në Shqipëri dhe daljen e kapitaleve shqiptare jashtë Shqipërisë. Në Tabelën e mëposhtëme është dhënë dinamika e eksporteve dhe importeve për vitet 2009- 2013. Të dhënat tregojnë se kemi një rrjedhje mjaftë të rritur të kërkesës shqiptare ndaj vendeve të tjera të botës. Eksportet janë rritur mbi 2.3 herë ndërsa importet janë rritur vetëm 20.6%. Ecuria e ekonomisë në këndëvështrimin e këtyre treguesve tregon se tendenca është mjaftë pozitive. Bilanci tregëtar ka ardhur në vijimësi në rënje duke dhënë një kontribut pozitiv në rritjen e Prodhimit të Brendshëm.

Tabela Nr. 9. Qarkullimi i mallrave në tregëtinë e jashtme. Në milionë lekë

Emertimi	2009	2010	2011	2012	2013	013/009
Eksport (FOB)	104.515	161.548	196.897	213.03	246.391	**235.7**
Import (CIF)	428.839	477.768	544.004	528.49	517.312	**120.6**
Bilanci tregtar	**-324.32**	**-316.22**	**-347.11**	**-315.46**	**-270.92**	**83.5**
Volumi tregtar	533.353	639.315	740.901	741.52	763.703	**143.2**

Të dhënat tregojnë se Bilanci Tregëtar ka rënë në 83.5% në 2013 në krahasim me vitin 2009. Volumi tregëtar është rritur me 43.2%. Rritja e tij tregon se ekonomia shqiptare ka nisur të fitojë parametrat e një ekonomie tregu.

Tabela Nr. 10 Lidhja midis PBB-së dhe Të Ardhurave Kombëtare Bruto në milionë lekë

	2008	2009	2010	2011	2012	2013
I. PBB	1,080,676	1,143,936	1,239,645	1,300,624	1,335,488	1,364,782
1. Pagat e të punësuarve neto(a-b)	21,285	20,784	22,495	18,021	12,441	1,794
a. nga bota e jashtme	22,595	21,602	24,092	19,455	16,470	6,717
b.në botën e jashtme	1,310	819	1,598	1,434	4,028	4,923
2. Të ardhura nga prona neto(c-d)	-15,830	-38,969	-34,879	-21,613	-22,369	1,166
c.nga bota e jashtme	16,866	14,140	15,360	10,919	9,731	12,618
d.në botën e jashtme	32,697	53,109	50,239	32,531	32,100	11,453
II. E ardhura Kombëtare Bruto(I+1+2)	1,086,131	1,125,751	1,227,260	1,297,032	1,325,561	1,367,742

Burimi. Banka e Shqipërisë.

Të dhënat e tabelës së mësipërme plotësojnë konkluzionet e nxjerra nga analiza e tabelës Nr. 9. Të ardhurat e siburuara neto nga pagat e punonjësve neto si rezultat i diferencës së prurjeve nga vendet e tjera të botës dhe daljeve nga Shqipëria janë faktori kryesor që ka ndikuar në rritjene të ardhurave kombëtare më shumë sesa rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto. Ndikim në këtë tregues kanë dhënë të ardhurat nga prona. Kjo do të thotë se daljet nga Shqipëria janë më të mëdhaja sesa prurjet nga pronat e shqëiptarve nga jashtë Shqipërisë.

Efekti likujditetit

Likujditeti është më së shumti i lidhur me llogarinë financiare dhe kapitale por ka të bëjë edhe me zërin e remitancave. Më poshtë kemi dhënë një pasqyrë mbi dinamikën e IHD-ve dhe remitancave. Të dhënat tregojnë se shuma e prurjeve të valutës në Shqipëri ka ardhur në rritje në vijimmësi por duke ndryshuar strukturën e saj. kjo ngase janë ulur remitancat dhe janë rritur IHD-të. Përveç këtyre dy zërave kemi edhe një sërë zërash të bilancit të llogarisë finaciare dhe kapitale.

Është pikërisht kjo llogari që mbulon deficitin e Llogarisë Korente dhe krijon mundësi për një qarkullim normal të të mirave dhe kapitaleve nga Shqipëria drejt venmdeve të tjera dhe nga vendet e tjera drejtë Shqipërisë.

Tabela Nr. 11 Dinamika e investimeve të huaja neto dhe e remitancave në milionë euro

Emërtimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013	013/08 %
Investimet direkte neto	609.8	688.7	788.5	608.9	647.9	923.2	151.3
Remitancat	833.3	781.3	689.8	664.5	675.3	543.8	65.2
Shuma	1443.1	1470	1478.3	1273.4	1323.2	1467	102

Të dhënat tregojnë se nga viti 2008 deri në 2010 janë rritur prurjet, ndërsa në 2012 ka një rënje tepër të madhe me rreth 200 milionë që nuk është shifër e vogël për një ekonomi si ekonomia shqiptare. Në vijim kanë ardhur në rritje dhe kjo rritje ka ardhur prej rritjes së IHD-ve. Treguesi është i mirë sepse ka të bëjë me investimet e huaja në ekonominë shqiptare. Këto investime janë një favour për ecurinë e saj në të ardhmen.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ekonomia shqiptare është e lidhur ngushtë me ekonomitë e rajonit dhe në përgjithësi me ekonominë e botës. Italia, Greqia dhe vendet e Eurozonës përcaktojnë në përgjithësi ecurinë e ekonmisë shqiptare. Kjo lidhje shikohet në treguesit kryesorë makroekonomikë si në Prodhimin e Brendshëm Bruto, Normën e Inflacionit dhe Normën e Papunësisë. Këta tregues kanë një shkallë lidhe të rëndësishme me këto ekonomi. Çdo ndryshim në ekonomitë e mësipërme reflektohet menjëherë në ekonominë e shqipërisë. Kjo më e theksuar në treguesin e inflacionit i cili sipas të dhënave është plotësisht i varur nga këto vende. Ky konstatim është shumë i rëndësishëm për hartimin e politikave monetare dhe fiskale prej BQ-së dhe qeverisë shqiptare. Ky fenomen më tej, tregon se Banka e Shqipërisë duhet të ndryshojë tërësisht politikat e saj monetare në mënyrë që të bëhet faktor i rëndësishëm në rritjen e ekonomisë, sepse deri sot ka qënë një faktor jo ndikues. Ndikimi i inflacionit ndërkombëtar në inflacionin e brendshëm është i lidhur përgjithësisht me importet e të mirave dhe shërbimeve si dhe nga ndryshimi i strukturës së peshës së produkteve të mallrave në shportën e inflacionit.

Një ndikim të rëndësishëm të rëndësishëm në nivelin e inflacionit ka dhënë edhe kërkesa e importuar që shprehet pikërisht në nivelin e importeve shqiptare. Rritja e tyre megjithëse më e ulët në përqindje se ekportet ka një peshë të madhe në vëllimin e konsumit të brendshëm të ekonomisë shqiptare

Rol të rëndësishëm në normën e inflacionit kanë dhënë edhe treguesi i remitancave dhe i Investimeve të Huaja Neto. Këto janë të lidhura me madhësinë e likujditetit në valutë në tregun e brendshëm të Shqipërisë. Ndikimi i tyre është pozitiv në kurset e këmbimit duke dhënë një ndikim pozitiv në staboilitetin e inflacionit.

Rekomandohet që Banka e Shqipërisë të ndryshojë objektivin e saj themelor dhe si të tillë të marrë rritjen e PBB-së dhe uljen e normës së papunësisë. Norma e inflacionit të shikohet në funksion të këtyre dy objektivave.

Bibiografia

Instat. tregtia e jashtme foreign trade 2009-2013
Instituti statistikave. Indeksi çmimeve të konsumit. gusht 2013.f.4
Banka e Shqipërisë.raporte vjetore 2008
Banka e Shqipërisë.raporte vjetore 2009
Banka e Shqipërisë.raporte vjetore 2010
Banka e Shqipërisë.raporte vjetore 2011
Banka e Shqipërisë.raporte vjetore 2012
Banka e Shqipërisë.raporte vjetore 2013
Banca Italiana. Bollettino economico. 2014
Abel/bernanke. Macroeconomics.third edition. Neŵ York.1998
N.Gregory Mankiŵ . Macro-economics. Fourth edition. Neŵ York. 2000.

TREGËTIA RAJONALE DHE NDIKIMI SAJ NE EKONOMINË SHQIPTARE, RASTI I ITALISË

Elona SHAHINI
Mediterranean University of Albania
elonashahini@umsh.edu.al

Altin HOTI
Luarasi University
altin.hoti@yahoo.com

ABSTRACT

Italy has been and is a key partner in trade relations with Albania. Albania's return from a closed to an open economy brought many positive effects on trade. It increases the volume of imported and exported. It increases their diversity. It increases the number of countries with which the Albanian merchants bound trading relationship. Change the structure of goods imported and exported. Started exporting processed goods. In this way trade with other countries of the world began to play an important role in the country's macroeconomic indicators, such as GDP, inflation rate and the unemployment rate. An important role in trade with Albania has played Italy. It has been and remains the main partner of Albania. The reasons for this connection are Albanian refugees working in Italy, Italian investment, socio-cultural connections etc. The aim of the analysis is to highlight the extent of connections main macroeconomic indicators and the prospect of improving them. In the analysis of comparison methods are used, description and synthesis, statistical methods etc.

Keywords: *Export, import, inflation, unemployment, GDP, economic growth, trade balance.*

HYRJE

Kthimi i ekonomisë shqiptare nga një vend i mbyllur në një ekonomi të hapur tregu i krijoj asaj mundësi të mëdha në lidhjen dhe shkëmbimet tregëtare me vendet e tjera të botës në mënyrë të veçantë me vendet e rajonit. Pas viteve 90, Italia dhe Greqia u bënë dy vendet kryesore ku u mbështet fuqishëm ekonomia shqiptare. Italia dhe Greqia përballuan fluksin e madh të refugjatëve shqiptarë. Mbi një milionë emigrant shqiptarë punojnë dhe jetojnë edhe sot në këto vende. Shkëmbimet tregëtare me Italinë kanë njohur vetëm rritje në shifër absolute. Italia ka qënë dhe mbetet partneri kryesor dhe strategjik për ekonominë shqiptare.Nëse roli i ekonomisë greke në ekonominë shqiptare ka ardhur në rënje roli dhe vendi ekonomisë italiane është rritur dukshëm. Italia është jo vetëm partneri kryesor në tregëti por edhe një nga investuesit më të mëdhenj në ekonominë shqiptare. Në Shqipëri veprojnë me dhjetra kompani me pronarë Italian si dhe me dhjetra të tjera ndërmarrje të përbashkëta italo-shqiptare. Italia është partneri kryesor në fushën e fasoneve duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në punëzënjen e poopullsisë shqiptare, jo vetëm në Tiranë por edhe në shumë rrethe të largët dhe të varfër të vendit. Ky vend ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e mirëqënies së popullit shqiptar në disa drejtime.

Së pari, janë mbi 250 mijë emigrantë shqiptarë që punojnë e jetojnë në Itali dhe që ndikojnë në rritjen e remitancave.

Së dyti, italianët kanë investuar direkt në kompanitë që veprojnë në Shqipëri duke rritur shkallën e punësimit.

Së treti,vëllimi më i madh tregëtar bëhet me këtë vend. Kjo ka ndikuar në rritjen e firmave shqiptare eksportuese, në rritjen e PBB-së dhe në uljen e normës së papunësisë.

Së katërti, italia ka ndikim në fushën e arsimit. Janë disa universitete të ngritura në Shqipëri. Italia pret me qindra student shqiptarë çdo vit në Universitetet e saj.

Së pesti, në fushën e mjkësisë, janë ngritur spitale dhe klinika moderne në shërbim të qytetarëve shqiptarë.

Së gjashti,me mijra italianë kanë ardhur dhe punojnë në Shqipëri jo vetëm në kompanitë e tyre por edhe si specialist në fusha të ndryshme të prodhimit.

Edhe në të ardhmen ekonomia italiane do të mbetet partneri kryesor për ecurinë e ekonomisë shqiptare në të gjitha aspektet. Kjo sepse është ekonomi e fuqishme që renditet në vendin e 8-të në botë si dhe është një nga vendet më të zhvilluara të saj. Prej saj ekonomia shqiptare ka pasur dhe do ketë vetëm përfitime.

Vështrim i përgjithshëm mbi zhvillimin e ekonomisë italiane dhe asaj shqiptare në vitet e fundit

Ekonomia italiane renditet e 8 ta në botë për madhësi të GDP-së.Vlera e PBB italiane përfaqëson 3.34 përqind të ekonomisë botërore. PBB nominalnë vitin 2013 ka qënë 2,139 miliardëdollar.

Tabela Nr. 1. Rritmi i ritjes së ekonomisë italiane 2008-2014 dhe parashikimi për 2015 në %

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015
%	-1.16	-5.51	1.68	0.49	-2.39	-1.40	0.40	0.70

Produkti i Brendshëm Bruto (GDP) në Itali është rrudhur me 0,30 për qind në tremujorin e katërt të 2014 në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2013. Norma e rritjes vjetore e PBB në Itali mesatarisht nga 1961 deri 2014 ka qënë 2,51 për qind, duke arritur gjatë gjithë kësaj periudhe kohe normën më të lartë prej 10,30 për qind në tremujorin e katërt të vitit 1961 dhe rekordin më të ulët prej -6,90 për qind në tremujorin e parë të vitit 2009. Norma vjetor e rritjes së PBB-së në Itali raportohet nga Instituti Kombëtar i Statistikave (ISTAT). Italia jo vetëm që është ekonomia e tetë më e madhe në botë por edhe vend i tretë më i madh në zonën e euros.

- Shërbimet janë sektori më i madh i ekonomisë dhe përbëjnë *73 për qind të PBB-së* totale. Në kuadër të shërbimeve segmentet më të rëndësishme janë:

-shitjet me shumicë dhe pakicë, transportet, magazinimet, restorantet dhe hotelet që japin 20 për qind e PBB-së totale;

-administrata publike, mbrojtja dhe siguria sociale (17 përqind);

-pasuritë e patundshme (13 për qind);

-shërbimet financiare (6 për qind), të informimit dhe komunikimit (5 për qind).

- Industria kontribuon *25 për qind të PBB-së* së vendit. Brenda industrisë, sektori i prodhimit jep prodhimit 17 përqind dhe ai i ndërtimi 5 për qind. Këta janë edhe sektorët më të rëndësishëm të industrisë.
- Bujqësia kontribuon e mbetur *2 për qind të PBB-së*.

PBB për frymë, 35,925$ (nominal), 35,597$ (PPP). PBB nga sektori shërbime (73%), industria (25%), bujqësia (2%).

- Inflacioni (IÇK) 1,2%. Popullsia nën nivelin e varfërisë, 8% (4.814.000

njerëz nën 520 €/muaj). Forca e Punës 25.7 milionë. Forca e punës sipas sektorve: shërbime (68%), industria (28%), bujqësia (4%).

Papunësia 12,4%. Paga mesatare bruto 2378 € / 3270$[42]. Paga mesatare neto 1898 €/2610$.

Industritë kryesore hekur dhe çelik, çimento, kimikate, plastike, makineri prodhimi, mjete motorrike, industria e ndërtimit të anijeve, industria e ndërtimit të mjeteve hapësinore dhe të aeroplanëve, paisje dhe pjesë këmbimi të automjeteve, e aparateve të komunikimit, aparateve mjekësore, farmaceutike, e përpunimit të ushqimeve dhe të pijeve, industria e përpunimit tëtekstileve, veshjeve, modës, pajisjeve shtëpiake, turizmit etj.

*Eksportet.*474 miliardë $[43]. Mallrat kryesore të eksportit janë: produktet inxhinierike; pajisjet elektrike; automjetet, aeroplanët dhe anijet; metalet bazë dhe çeliku; tekstile, veshje dhe këpucë; kimikatet; ushqim dhe pije; metalet e çmuara; optika dhe aparate mjekësore; përpunime dhe prodhime guri, çimentoje dhe produkte të qelqit; letër, etj.

Partnerët kryesorë të eksportit: Gjermania 12.6%,Francë 11,1%, Shtetet e Bashkuara 6.8% Zvicra 5.7%, Mbretëria e Bashkuar 4.7%, Spanja 4,4%,etj.

*Importet.*435 miliardë $[44]. Mallrat kryesore të importit janë: mineralet; produktet inxhinierike; kimikatet; automjetet motorike; metale bazë; plastika; tekstile, etj.

Partnerët kryesorë të importit janë: Gjermania 14.7%, Franca 8.4%, Kina 8,4%, Rusia 6.3%, Holanda me 5,8%, Spanja me 4,5%, etj.

Borxhi i jashtëm bruto $ 2604000000000.Borxhi publik 133% e GDP-së

Donator ndihma ekonomike: $ 2480000000, 0,15% të PBB-së.

Rezerva valutore: $ 142.200.000.000.

Në 2008 Italia u godit rëndë nga recensioni global dhe kriza financiare e borxheve evropiane. Ekonomia kombëtare u tkurr me 6,76% gjatë gjithë periudhës. Në nëntor 2011 yield-i i obligacioneve italiane ishte 6,74 për qind për obligacionet 10-vjeçare. Me këtë normë interesi Italia mendohet të humbasë qasje në tregjet financiare. Sipas Eurostat, në 2015 borxhi i qeverisë italiane do qëndroi në 128% të PBB-së, duke u renditur si raport i dytë më të madh i borxhit pas Greqisë me 175%. Megjithatë, pjesa më e madhe e borxhit publik Italian është në pronësi të subjekteve nacionale. Italia ka nivele relativisht të larta të

[42] *Source: Ẇorld Bank Global Economic Prospects, March 2014*

[43] *"CIA Ẇorld Factbook: Italy". CIA.Retrieved 8 February 2015.*

[44] *Po aty*

kursimeve private dhe nivel të ulët të borxhit privat. Këto dy pika e bëjnë atë më të sigurt në mesin e ekonomive që veprojnë në Evropë. Si rezultat i masave shtrënguese, Italia synon një deficitit publik buxhetor prej 2.8% në 2015, duke mbetur brenda tavanit të Bashkimit Evropian me 3 për qind.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se ekonomia italiane është nga ekonomitë më të fuqishme të botës, pavarësisht nga recesioni që pësoi në vitet e fundit. Ajo parashikon që në vitin 2015 tëdali nga ky recension dhe të filloj ngritjen e ekonomisë. Treguesit e deritanishëm flasin se reformat e marra nga qeveria italiane po japin rezultate mjaftë premtuese për të ardhmen. Italia ka një vëllim tregtar prej 910 miliardë dollar. Gjashtë vendet kryesore ku ajo eksporton produktet e saj, të përmendura më lartë zënë 47.3% të vellimit total të eksporteve, ndërsa gjashtë vendet kryesore prej të cilave importon zënë 48.1% të totalit. Vendet me të cilat Italia realizon vëllimin kryesor tregëtar janë vendet nga më të fuqishmet e botës, duke filluar nga SHBA dhe deri te Kina si ekonomia e parë dhe e dytë e botës. Duke parë marrëdhëniet tregëtare të Italizë me këto vënde roli dhe vendi i Shqipërisë në këtë ekonomi është i pa përfillshëm. Kjo sepse me Italinë ne nuk realizojmë as 1 miliardë eksporte në një kohë që ajo ka 435 miliardë importe. Shqipëria për Italinë nuk është ndonjë partner i vlerësueshëm por prej saj vlerësohet prej afërsisë sesa prej qënies së tregut shqiptar si një treg joshës. Shqipëria ka interesa të padiskutueshme ndaj Italisë prandaj konsiderohet si partneri kryesor ekonomik.Italia mund të kalojë në recension por ndikimi i kësaj rënie nuk ndihet fare në ekonomminë shqiptare për llogari të madhësisë së ulët të eksporteve shqiptare. Në këtë mënyrë bie poshtë thënia që dëgjojmë shpesh se"është rritur kërkesa e huaj" dhe se ajo ka dhënë ndikim pozitiv në ekonomi. Në fakt kërkesa e huaj sipas këtyre të dhënave nuk ka ndryshuar por është rritur gatishmëria e firmave shqiptare për të rritur eksportet e tyre. Ndërsa sa i përket ndikimit të kërkesës së huaj, theksojmë se një ndikim të madh në rritjen e PBB-së shqiptare ka dhënë kërkesa e brendëshme dhe jo kërkesa e huaj.

Marrëdhëniet ekonomike me Italinë janë të herëshme, por vetëm në 20 vitet e fundit ato janë intensifikuar në mënyrë të dukëshme

Me Italinë nga viti 1991 deri në vitin 2011 janë lidhur 60 marrëveshje dy palëshe në të gjitha fushat. Ndër marrëveshjet më të rëndësishme në fushën e ekonomisë përmendim: Marrëveshja për Mbrojtjen dhe Nxitjen e Investimeve (1991), Marrëveshja për Bashkëpunimin Ekonomik Industrial dhe Tregtar (1992),

Marrëveshja per heqjen e Taksimit te Dyfishte (1999),

Marrëveshja për financimin prej 25 milionë euro të një projekti në mbështetje

të sipërmarrjeve të mesme e të vogla, në kuadër të programit të Kooperacionit për Zhvillim të Ministrisë së Punëve të Jashtme italiane, 27.10.2008, Protokolli i ri i Kooperacionit per Zhvillim, 12 prill 2010, Marrëveshje për pjesëmarrjen në Fondin Shqiptar të Garancisë në kuadër të Programit të Zhvillimit të Sipëmarrjeve të Mesme dhe të Vogla, mbështetur nga Kooperacioni italian për Zhvillim, 26 prill 2011etj.

Marrëdhëniet me Italinë në kuadrin e ndikimit në treguesit ktryesorë makro ekonomikë

Disa nga aspektet e rëndësishme të bashkëpunimit midis Italië dhe Shqipërisë janë:

Identifikimi dhe implementimi i projekteve të parashikuara në paketën e kooperacionit.

Projektet akordohen në bazë tre vjecare (Protokolli i fundit 2002-2004) dhe përqëndrohen në rehabilitimin e infrastrukturës, përmirësimin e shërbimeve bazë dhe të kushteve sociale e shëndetësore në forcimin e institucioneve dhe në zhvillimin e sektorit privat.

Synohet nje angazhim i madh i shoqërise civile, nëpërmjet OJQ-ve dhe aktiviteteve të bashkëpunimit të decentralizuar.

Italia përfaqeson donatorin më të madh dypalësh për vendin tone dhe të tretin, pas BE dhe Bankës Botërore, ndër donatorët shumëpalësh;

Vendosja dhe zgjerimi i lidhjeve ndërmjet institucioneve qëndrore, rajonale e lokale në fushën e ekonomisëdhe të biznesit, përsa i përket bazës ligjore ashtu edhe mbështetjes së inisiativave konkrete sipërmarrëse të firmave të të dy vendeve; Informimi dhe mbështetja e pjesëmarrjes në panairet dhe ekspozitat që zhvillohen në të dy vendet.

Sigurimi i informacionit për kompanitë që kërkojnë të investojnë në vendin tonë dhe vendosja e kontakteveme organet tona të specializuara.Shkëmbimet dypaleshe kanë ardhur në rritje të vazhdueshme dhe per vitin 2013 ato shënonin 284 miliarde lekë ose 2 miliardë euro. Eksportet tona shënojnë 114 miliardë lekë dhe importet me 170 miliardëlekë .


Identifikimi i mundësive të bashkëpunimit që krijohen në kuader të fondeve komunitare të destinuara përbashkëpunimin nderkufiar dhe të atyre që lidhen me politikat ekonomiko-tregtare të Italisë drejt rajonit tone (veçanërishtme ligjet 84 & 212);

Organizatat ndërkombëtare me bazë në Romë dhe në veçanti FAO, ẆFP dhe IFAD dhe që përfshin ndjekjene takimeve të organeve më të larta të tyre dhe trasmetimin e pozicionit të vendit tonë për problematikën etrajtuar, si dhe ndjekjen e problematikës së lidhur me projektet e këtyre organizatave në vendin tonë; Lidhja e fuqishme e ekonomisë shqiptare me ekonominë italiane shihet edhe në forcën e lidhjeve të dinamikës së treguesve kryesorë makroekonmikë.

Tabela Nr.2. Dinamika e PBB-së, normës së inflacionit dhe normës së papunësisë për ekonominë italiane dhe ekonomminë shqiptare


	Vendet	**Itali**	**Shqip**
Rritja e PBB-së në %	2008	-0.9	7.5
	2009	-4.8	3.3
	2010	0.7	3.8
	2011	0.4	3
	2012	-2.2	1.62
	2013	-1.8	0.7
Inflacioni në %	2008	3.5	3.4
	2009	0.8	2.3
	2010	1.8	3.6
	2011	2.9	3.5
	2012	3.3	2
	2013	1.2	1.7
Papunësia në %	2008	6.7	12.7
	2009	7.8	13.7
	2010	8.4	13.5
	2011	8.4	13.3
	2012	11.2	13.3
	2013	12.4	16.9

Burimi: Banka e Shqipërisë. Raporte Statistikore: 2012- 2014.
Koeficientët e korelacionit për PBB 0.211, Inflacion 0.391, Papunësi 0.76




Të dhënat e tabelës dhe kurbat në grafik tregojnë se tendencat e dy ekonomive janë të njëjta pavarësisht nga ritmi i ndryshimit të tyre. Në vitin 2009 kanë ardhur në rënje, në 2010 në rritje dhe në vijim kanë ardhur në rënje. Në këtë mënyrë mund të theksojmë se ekonmmia italiane e tërheq ekonominë shqiptare nëpërmjet shkembimeve tregëtare në rrugën e saj të ndryshimit. Koeficienti korelacionit është 0.211, tregues që nuk tregon ndonjë forcë të madhe por që tregon se këto dy tregues kanë të njëjtat tendenca në dinamikën e tyre.

Figura Nr.2 Përqindja e ndryshimit të inflacionit



Koeficienti i korelacionit i normës së inflacionit në Shqipëri dhe asaj në Itali është është 0.4.Ky është një tregues sinjifikativ sepse tenton në 50% që do të thotë se norma e inflacionit në Shqipëri jo vetëm që ka të njëjtën tendencë më normën e inflacionit në Itali por është e varur edhe prej saj. Vartësinë prej saj do ta shikojmë në importet shqiptare nga ekonomia italiane.

Figura Nr.3 Përqindja e ndryshimit të papunësisë



Marrëdhëniet tregëtare me Italinë dhe perspektiva e tyre

Marëdhëniet tregëtare të Shqipëri kanë ardhur në rritje nga viti në vit. Në tabelën Nr. 3 kemi dhënë dinamikën e tyre për vitet 2009-2013. Nga të dhënat shihet qartë se eksportet janë rritur mbi 2.3 herë, ndërsa importet vetëm 20.6%. Këto janë tregues shumë domethënës sepse së pari, rritja e eksporteve tregon për rritjen e ekonomisë (PBB-së) si dhe rritjen e aftësisë eksportuese të kësaj ekonomie. Tregon që në mënyrë graduale mallrat e importit po zëvendësohen me mallra që prodhohen në vend dhe nga importet gjithnjë e më shumë vendin kryesor po e zënë mallrat e grupit makineri e paisje, mjete transporti, bujqësore, etj. Kjo diferencë në rritje ka dhënë ndikimin e vet edhe në bilancin tregëtar të Shqipërisë i cili ka ardhur duke u zvogëluar në mënyrë të vazhdueshme. Nga 4/1 që ka qënë raporti midis importeve dhe eksporteve në 2009 në vitin 2013 është ulur në 2.1/1. Në këtë mënyrë është dyfishuar aftësia mbuluese e eksporteve shqiptare ndaj importeve. Para viti 2009 ky raport ka qënë 8/1, ku vendin kryesor e zinin mallrat e bujqësisë.

Tabela Nr. 3. Eksport importet e ekonomisë shqiptare 2009-2013

Emertimi	2009	2010	2011	2012	2013	013/009
Eksport (FOB)	104.515	161.548	196.897	213.03	246.391	**235.7**
Import (CIF)	428.839	477.768	544.004	528.49	517.312	**120.6**
Bilanci tregtar	**-324.32**	**-316.22**	**-347.11**	**-315.46**	**-270.92**	**83.5**
Imp/Eksporte	4.1/1	3.0/1	2.8/1	2.5/1	2.1/1	**-51.2**

Burimi: INSTAT.TREGTIA E JASHTME FOREIGN TRADE 2009-2013.

*Eksportet.*Marrëdhëniet tregëtare me Italinë kanë njohur vetëm rritje në shumë absolute.Italia është partneri më i madh tregtar i Shqipërisë. Shqipëria me Italinë në vitin 2013 ka realizuar 46.3 për qind të eksporteve dhe 32.9 për qind të importeve. Në vitin 2000 (viti që ka të dhëna të plota pas vitit 1990) tregëtia me Italinë ishte afërsisht 575 milionë dollarë amerikanë. Eksportet shqiptare ishin 182 milionë $, ndërsa importet e Shqipërisë prej Italisë ishin 393 milionë $, me një bilanc të tregtisë në favor të Italisë për një shumë të barabartë me 211 milion $. Të dhënat mbi eksportet në përgjithësi dhe në veçanti i kemi dhënë në Tabelat Nr. 4, 5, dhe 6

Tabela Nr. 4 Eksporti sipas rajoneve

Vitet	Eksportet në milionë lekë					Në	%
	2009	2010	2011	2012	2013	2009	2013
Gjithsej	**104.515**	**161.5**	**196.897**	**213**	**246.391**	**100**	**100**
Vendet e BE-së	82.335	113.5	143.643	161.2	189.037	**76.7**	**78.8**
Vendet e Ballkanit Perëndimor	12.621	16.2	24.286	25.22	26.413	**10.7**	**12.1**
Vendet e tjera të botës	9.559	31.88	28.968	26.66	30.942	**12.6**	**9.1**

Burimi: INSTAT. TREGTIA E JASHTME FOREIGN TRADE 2009-2013

Të dhënat e tabelës tregojnë qartë se mbi 78.8% e eksporteve shqiptare realizohen me vendet e BE-së, ku vendin kryesor në këtë vëllim e zënë, Italia, Greqia, Gjermania, Spanja etj. Ballkani perëndimor zë vetëm 12.1%, një shifër kjo jo e kënaqëshme pasi kemi të bëjmë me ekonominë e Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë etj. Me vendet e tjera të botës realizohet vetëm 9.1% e saj.Peshë këtu zë ekonomia Kineze e cila ka ardhur vazhdimisht në rritje.

Tabela Nr.5 Eksportet me Italinë në milionë lekë dhe %

Nr	Vitet	2009	2010	2011	2012	2013	%
	Gjithsej	**104.515**	**161.548**	**196.897**	**213.03**	**246.391**	
1	Itali	64.776	82.114	104.998	108.865	114.153	46.3

Burimi: TREGTIA E JASHTME FOREIGN TRADE 2009-2013

Italia është vendi kryesor që zë mbi 46.3% të eksporteve shqiptare. Kjo do të thotë se ka një ndikim në treguesit makroekonomikë sepse prej saj importohen një sërë mallrash që përcaktojnë çmimet e konsumit sit ë mallrave të tregëtueshme edhe të atyre të pa tregëtueshme.

Tabela Nr. 6 Eksportet në milionë lekë me Italinë,

Emërtimi	Italia				
	2009	2010	2011	2012	2013
Gjithsej	**64.776**	**82.1**	**105**	**109**	**114.15**
Ushqim, pije, duhan	3.403	4.04	4.222	4.41	5.52
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	6.599	10.9	23.045	29.3	23.009
Produkte kimike dhe plastike	355	402	1.232	586	918
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	1.326	2.01	2.14	2.04	2.326
Prodhime druri dhe letre	2.314	2.79	2.817	3.03	5.037
Tekstile dhe këpucë	40.2	46.2	53.937	53.4	59.567
Materiale ndërtimi dhe metale	6.211	10.2	10.972	10.1	10.769
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	3.008	4.05	4.894	4.28	5.155
Të tjera	1.361	1.63	1.74	1.66	1.853

Burimi: TREGTIA E JASHTME FOREIGN TRADE 2009-2013

Vendim kryesor në eksportet shqiptare drejt Italisë e zë grupi "Tekstile dhe këpucë" me rreth 60%. Kompanitë italiane janë rritur në fushën e fasonëve dhe të këpucëve, kjo sepse ekonomia shqiptare ka avantazh çmimin e lirë të fuqisë punëtore. Thuajse të gjitha produktet e tekstileve dhe këpucëve rikthehen përsëri në Itali për në tregjet vendase dhe në tregjet e huaja, shumë pak prej tyre qëndrojnë në tregun e brendshëm shqiptar. Në këtë mënyrë një pjesë e tyre janë mallra që importohen për eksportim. Është kjo arsye që në këtë zë është më i lartë eksporti sesa importi sepse në eksport është përfshirë edhe vlera e shtuar. Grupi "Mineralet, lëndë djegëse, energji elektrike zë vendin e dytë, ndërsa grupi "Materiale ndërtimi dhe metale zë vendin e tretë me 10.7%, etj. Këto zëra tregojnë se nga Shqipëria nuk eksportohen më materiale të papërpunuara, kafshë të gjalla dhe bimë medicinale por kanë filluar të eksportohen edhe materiale të përpunuara, vëllimi i të cilave po rritet nga viti në vit.

*Importet.*Importet nga Italia përfshijnë të gjitha llojet e makinerive, por edhe materiale për ndërtim, transport, produkte kimike, ushqime dhe pije.

Aktualisht në Shqipëri ka rreth 400 kompani në pronësi apo pjesëmarrje nga operatorët italianë, të cilat punësojnë rreth 20.000 punëtorë.Rreth 60-70% e operacioneve të kompanive italiane janë të përqendruara në sektorin e veshjeve dhe të prodhimit të këpucëve, zonat ku kompanitë italiane janë tradicionalisht shumë të forta. Sipas zyrës tregtare të Ambasadës Italiane këto kompani janë të përqëndruara:

35% ne sektorin e ndërtimit,

21% në industrinë tekstile dhe atë të prodhimit të këpucëve,

16% në fushën e tregtisë dhe shërbimeve dhe

8% në industrinë agroushqimore.

Afro 90% e këtyre sipërmarrësve i takojnë Jugut të Italisë, ndaj edhe perspektivën e biznesit të tyre në Shqipëri dhe më tej e shikojnë të lidhur ngusht me ndërtimin e Korridorit të Tetë.

Sipas statistikave, në Itali operojnë rreth 20 mijë sipërmarrje shqiptarë të licensuara dhe një numër disi më i vogël në Greqi.

Kompanitë italiane kanë penetruar edhe në fushën e ndërtimit dhe të materialeve të ndërtimit, nga zhavorrishtet (inertet), në prodhimin e tullave dhe të betonit.

Sektorë të tjerë me një prani të rëndësishme të biznesit Italian janë sektori i ushqimeve dhe pijeve, sektori i industrisë, i përpunimit të drurit, si dhe industria e lehtë në përgjithësi.

Në sektorin e shërbimeve, ENEL ka qenë e përcaktuar përgjegjëse për ofrimin e ndihmës të menaxhimit të KESH-it, ndërsa një konsorcium italian (AMGA) ishte zgjedhur kohët e fundit për të ofruar ndihmë për menaxhimin e sistemit të ujit të qytetit të Tiranës.

Kompanitë italiane janë të vendosura në në të gjithë Shqipërinë por kryesisht i kemi 64.3% në Tiranë, 14.3% në Durrës, 3.4% në Kavajë, 4.2% në Shkodër, 2.5% në Vlorë dhe në Fier, etj.

Më poshtë po japim disa tebela me të dhënat e importeve të ekonomisë shqiptare prej ekonomisë italiane.

Tabela Nr.7. Në total, në milionë lekë importet janë si vijon:

Emertimi	2009	2010	2011	2012	2013	2013/2009
Import (CIF)	428.839	477.768	544.004	528.49	517.312	**120.6**

Tabela Nr. 8. Importet italiane në milionë lekë.

	Emërtimi	2009	2010	2011	2012	2013	Në %
1	Itali	112.175	134.6	166.05	168.372	170.403	32.9

Të dhënat tregojnë se Italia eksporton në Shqipëri mbi 170 miliardë lekë mallra duke zënë 33% të totalit të importeve shqiptare. Me gjithëse zë më pak sesa eksportet në shumë absolute eksportet italiane janë 50% më të larta sesa importet. Ato kanë ardhur në rritje por me një ritëm më të ulët sesa eksportet, gjithësesi Italia mbetet partneri kryesor si në eksporte ashtu edhe në importe.

Tabela Nr. 9. Importet në milionë lekë sipas rajoneve.

Vitet	Importet në milionë lekë					Në	%
	2009	2010	2011	2012	2013	2009	2013
Gjithsej	**428.84**	**478**	**544**	**528**	**517.31**	100	100
Vendet e BE-së	279.76	318	355.07	334	332.8	**65.2**	**64.3**
Vendet e Ballkanit Perëndimor	24.085	33.8	39.809	41.6	34.846	**5.6**	**6.7**
Vendet e tjera të botës	124.99	126	149.12	153	149.66	**29.1**	**28.9**

Burimi: INSTAT. TREGTIA E JASHTME FOREIGN TRADE 2009-2013.

Sa u përket importeve biznesi shqiptar i është drejtuar vendeve të tjera të botës duke prishur raportin e eksporteve ku predominonin vendet e BE-së me mbi 78%. Me BE-realizohet vetëm 63.4% e importeve ndërsa është rritur në

28.9% importi nag vendet e tjera të botës. Po kështu janë ulur edhe importet nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Treguesi i fundit është negativ për ekonominë shqiptare sepse më shumë interes ka të importojë të mira e shërbime nga vendet e Ballkanit Perëndimor sesa nga Lindja e Largët, pavarësisht nga çmimi i tyre.

Tabela Nr.10. Importet nga Italia

Emërtimi	Italia				
	2009	2010	2011	2012	2013
Gjithsej	**112.175**	**134.6**	**166.045**	**168.4**	**170.403**
Ushqim, pije, duhan	13.409	14.57	14.389	14.37	14.276
Minerale, lëndë djegëse, ener. elek.	5.229	18.54	43.294	50.4	47.61
Produkte kimike dhe plastike	12.106	12.72	13.272	13.86	13.777
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	6.066	7.466	8.263	8.352	9.634
Prodhime druri dhe letre	4.666	4.817	4.707	4.718	6.79
Tekstile dhe këpucë	22.382	27.46	31.073	28.63	31.466
Materiale ndërtimi dhe metale	17.898	18.59	17.929	16.77	16.241
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	26.277	26.11	28.378	27.25	26.297
Të tjera	4.143	4.3	4.738	4.027	4.312

Burimi: INSTAT. TREGTIA E JASHTME FOREIGN TRADE 2009-2013.

Grupi kryesor i importeve nga Italia është“ Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me 47.61%. Grupi i dytëështë “Tekstile dhe Këpucë”, është pikërisht grupi që importohet për tu eksportuar.Ky grup zë 31.4% të totalit të importeve. Grupi i tretë është “Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi” me 26.3%.Grupi i katërt është”Materiale ndërtimi dhe metale” me 16.2%.Grupi I pestë me 14.2% është grupi “Ushqime, pije dhe duhan”. Është e rëndësishme të theksojmë se importet po ju drejtohen në përgjithësi lëndëve të para për përpunim të mëtejshëm. Kjo tregon se importi i mallrave të përpunuara ka ardhur në rënie.

Sektori financiar. Italianët jane përfshirë edhe në sektorin Bankar. Prania kryesore e biznesit italian në sektorin financiar përfaqësohet nga Intesa San Paolo dhe Unicredit. Biznesmenët italianë janë gjithashtu aktivë në Shqipëri, me dy kompani të investimeve publike, që kontribuan në financimin e disa projekteve të ndërmarra nga Italianët. Italianët kanë çelur Call Center në disa zona të kryeqytetit ku janë punësuar me qindra të rinj e të reja. Së fundi, qeveria italiane

kontribuon financiarisht për të financuar investimet (Aref), i cili siguron kapitale për ndërmarrje të vogla dhe të mesme që veprojnë në Shqipëri (8 investime të kryera ose në proces).

KONKLUZIONE

Dinamika e ekonomisë italiane ndikon direkt në dinamikën e ekonomisë shqiptare gjë e cila shprehet në treguesit kryesorë makroekonomikë siç janë PBB-ja, norma e inflacionit dhe norma e papunësisë. Ekonomia shqiptare përcjell çdo fenomen negativ të ekonomisë italiane nëpërmjet kanaleve të analizuara më sipër pavarësisht nga përmasat e tij. Në situatën aktuale pasojat do të jenë edhe më negative sepse ekonomia jonë është në stanjacion dhe me tendenca rënëse.

Në përgjithësi rënia e ekonomisë italiane nuk ka ndikuar në frenimin e rritjes së ekonomisë shqiptare me përjashtim të rënies së dërgesave të emigrantëve. Kjo sepse eksportet shqiptare nuk ndikojnë fare mbi importet italiane.

Ekonomia italiane ka ndikuar dhe ndikon në ekonominë shqiptare në disa fusha si:

*Eksporte dhe importe.*Në fushën e eksporteve italiane në Shqipëri nuk ka ndonjë ndikim negativ pasi niveli i çmimeve për mallrat që Shqipëria importon prej Italisë nuk ka ndryshim ndikues. Sa i përket vëllimit të eksporteve italiane ato nuk kanë asnjë ndikim prej recesionit të ekonomisë sepse zënë në tërësi ndaj eksporteve një peshë të parëndësishme. Eksportet dhe importet shqiptare në vëllimin e eksport-importeve italiane nuk kanë asnjë peshë dhe asnjë ndikim, afërsisht janë në raportet 1/460. Në këtë kontekst çfardo ndryshimi të ndodhë në këtë ekonomi pasojat në ekonominë shqiptare do jenë të pa ndjeshme.

Remitancat e emigrantëve shqiptarë. Ndikojnë në Prodhimin Kombëtar Bruto. Në Itali sipas të dhënave përkatëse janë rezidentë mbi 300 mijë emigrantë shqiptarë[45]. Prurjet e tyre kanë ardhur në rritje me përjashtim të viteve të fundit.

[45] *Migrimi në Itali.Italia është destinacioni i dyte me i preferuar për emigrim i shqiptareve.në fund të 2005 kishte 348.813 shqiptare të vendosur legalisht në Itali, nga të cilet 196.744 ishin meshkuj dhe 152.069 ishin femra. në 2000 dhe 2001 Italia percaktoi kuota sipas profileve të caktuara profesionale për imigrantet dhe kjo pati efektet e veta në zvogelimin e migrimit ilegal. Emigrantet meshkuj janë kryesisht të angazhuar në ndertim (43%), industri (19%) dhe sherbime (16%), ndersa femrat në sherbim në familje (56%).Perqindja e të vetepunesuarve vleresohet të jetë me e larte në Itali sesa në Greqi (8% krahasuar me 5%). Burimi: Qeveria Shqiptare dhe IOM; "Strategjia Kombëtare për migracionin"; Tiranë 2005.*

Kjo jo vetëm për arsye të rënies së ekonomisë italiane por edhe për arsye të stabilizimit të vetë emigrantëve shqiptarë në shtetin italian. Këto prurje kanë ndikuar direkt në treguesin e të Ardhurave Kombëtare i cili ndryshon nga treguesi i PBB-së.

Prurjet nga firmat shqiptare që veprojnë në Itali. Këto prurje ndikojnë në Prodhimin Kombëtar Bruto. Rënia e ekonomisë italiane në përgjithësi ka ndikuar edhe në rënien kërkesës agregate në përgjithësi. Rënia e saj ka ndikuar sigurisht edhe mbi të ardhurat e firmave shqiptare që operojnë në këtë vend. Por kjo ka ndikuar në rënien e PKB dhe jo në rënien e PBB.

Investimet direkte në firmat italiane që veprojnë në Shqipëri. Kjo është shifra që ka psuar një ulje por nuk përbën ndonjë shqetësim të madh pasi subjektet italiane që veprojnë në Shqipëri janë tashmë të stabilizuara dhe shumë pak kanë hyrë me investime direkte në ekonominë shqiptare. Kapitalet e tyre së fundmi i kanë drejtuar mbi objektet e privatizimit dhe jo në investime të reja direkte. Kështu që ky zë nuk përbën ndonjë problem shqetësues për ekonominë shqiptare. Më së shumti në vitet e fundit, ato janë futur në Fasoneri dhe në coll centër.

*Normën e papunësisë.*Ecuria e ekonomisë italiane ka ndikim në normën e papunësisë në Shqipëri sepse ajo është e lidhur me eksport-importet të cilat janë të lidhura me aktivitetet italiane në Shqipëri. Në këtë sektor nuk ka pasur ndikim pasi prodhimi i tyre në fasone apo konfeksione nuk ka pasur ndonjë rënie të ndjeshme ndikuese. Rënia e ekonomisë italiane nuk ka ndikuar shumë në kthimin e refugjatëve shqiptarë. Emigrantët shqiptarë kanë zënë pozicione stabël në ekonomi. Këto pozicione kanë bërë që çdo rënie ekonomike të mos ndikojë shumë në daljen e tyre jashtë tregut të punës.

Kursin e këmbimit të lekut shqiptar. Duke qënë se ekonomia shqiptare pjesën më të madhe të tregëtisë së jashtme të saj e realizon me Italinë çdo ndryshim i këtyre raporteve do ndikojë në rënien e valutës drejt Shqipërisë. Kjo rënie do ndikojë në rritjen e kërkesës për valutë dhe uljen e ofertës kështu çdo tronditje ne tregun italian ndikon në klursin e këmbimit të lekut në Shqipëri.

BIBLIOGRAFI

INSTAT. TREGTIA E JASHTME FOREIGN TRADE 2009-2013.
Banka e Shqipërisë. Raporte Statistikore: 2012.
Banka e Shqipërisë. Raporte Statistikore: 2013.
Banka e Shqipërisë. Raporte Statistikore: 2014.
INSTAT. PBB 2013(16.12.2014). INSTAT, Maj 2014
"Doing Business in Italy 2012". Ŵorld Bank. Retrieved 2011-11-21.
"Export Partners of Italy". CIA Ŵorld Factbook. 2012. Retrieved 22 July 2013.
"Import Partners of Italy". CIA Ëorld Factbook. 2012. Retrieved 22 July 2013.
Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Itali dhe CIA Ŵorld Fact Book
ISTAT: Rapporto annuale 2013, cap.1, p.53, tav. 1.18
IMF Ŵorld Economic Outlook - Aprile 2014
"Nominal 2014 GDP for the ŵorld and the European Union.". Ŵorld Economic Outlook Database, April 2014. International Monetary Fund. Retrieved 3 May 2014.
"Italian 2011 PBB Groŵth Sloŵs To 0.4%". RTT Neŵs. 2012-03-02. Retrieved 2012-04-09
"CIA Ŵorld Factbook; Italy; Economy". CIA. 2009-03-19. Retrieved 2009-03-26.
Eurostat Unemployment
"Export Partners of Albania". CIA Ŵorld Factbook. 2012. Retrieved 2013-07-22
"Import Partners of Albania". CIA Ŵorld Factbook. 2012. Retrieved 2013-07-22.
http://ŵŵŵ.inea.it/public/pdf_articoli/1679.pdf

RISTRUKTURIMI I MFI NË BANKA, SFIDË DHE DOMOSDOSHMËRI (RASTI I NOA)

Etleva Dashi
Agricultural University of Tirana
Natasha Hodaj
Agricultural University of Tirana
Elton Muça
NOA
Flora Merko
Aleksander Xhuvani University of Durres
Nertila Arapaj
Agricultural University of Tirana

ABSTRACT

Poverty is one of the challenges that most of countries should effort. Poverty reduction measures are criticized and for the poor the only open gate is microfinance. Usually for the great part of the people microfinance is misunderstanding with the concept of microcredit. Microfinance defines the methods to offer small credits to the poor, in order to develop productive activities such as opening small businesses. Actually finance sector development has increased services (credit, saving, insurance, money transfers etc) and the clients number. So, we can't define microfinance only as an institution that gives credits to the poor, but as a set of finance services for all of them that are excluded from the classic financial system. For this reason microfinance system needs to be restructured in the future through legal, institutional and commercial aspects.

We will make with an empiric analyze of mix market database and we will follow with NOA Case study. At the end we can conclude that microfinance industry in Albania has known positive results and as consequence this sector can go through a commercialization process. On the other side the demand growth for financial services will ask in the future a complex offer for such products. As consequence microfinance institutions will be obliged to be part of full institution services that are banks.

***Keywords**: microfinance, NOA, Mix market, bank*

HYRJE

Varfëria është një nga sfidat e pakta që çdo vend në botë duhet të përballet për ta reduktuar atë.

Megjithëse masat për ta reduktuar atë janë kritikuar, njerëzit vazhdojnë të kërkojnë thjesht një rritje të të ardhurave neto nga aktivitetet e realizuara prej tyre, ose rritje të buxhetit familjar. Rritja e nivelit të të ardhurave gjithashtu lidhet dhe me idenë e qëndrueshmërisë ekonomike të mënyrave të jetesës.

Në vendet në zhvillim është shumë e rendësishme kontributi që ekonomia informale jep në zhvillimin ekonomik kombëtar. Aktivitetet e vogla, jo formale të fermerëve, artizanëve, tregtarëve të vegjël përpiqen të mbijetojnë në këtë ekonomi tregu. Aktivitetet e këtyre mikrondërmarrjeve dhe projektet e tyre ekonomiko-sociale, të marra së bashku mund të përbëjnë deri 50% te ekonomive të disa vendeve. Duke venë theksin në zhvillimin e këtyre aktiviteteve kërkohet të forcohen ato sektorë që mund të rrisin nivelin e punësimit, qarkullimin e burimeve dhe mundësinë për investime.

Problematika që i shoqëron Institucionet e mikrofinancës sot në Shqipëri lidhet me një sërë faktorësh si më poshtë:

1. Fonde të kufizuara nga investitoret strategjikë
2. Leva Financiare
3. Institucione financiare të mbikqyrura nga Banka Qendrore

Mbikqyrja e MFI është e limituar dhe nuk i lejon që të aksesojnë në treg për mbledhjen e depozitave kështu që i vetmi orientim i rregulluar ligjor është banka. Në këto kushte për ne është e rëndësishme të kuptojmë se kush do të jetë e ardhmja e mikrofinancës.

Ajo do të vazhdojë të jetë mbështetësja kryesorëve e të varfërve apo do të shkohet drejt komercializimit të saj?

Përparësia dhe roli i mikrofinancës në sigurimin e mjeteve të jetesës, së pjesës kryesore të popullsisë është mjaft i rëndësishëm dhe për Shqipërinë krahasuar edhe me vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Zhvillimi i ekonomik i vendit, në kushtet e ekonomisë së tregut kërkonte dhe kërkon një mbështetje financiare të konsiderueshme, për të realizuar jo vetëm ato pjesë të aktiviteteve, (që në disa prej familjeve ishin dhe janë pjesë e mbijetesës) por edhe për të mbështetur objektiva disi më ambicioze si, për shembull, zhvillim te metejshem dhe investime më të mëdha.

Shqipëria po bëhet një treg gjithnjë e me artaktiv dhe kjo dëshmohet dhe nga numri i lartë i institucioneve të mikrofinancës që operojnë në vend. Por në qoftë se do ti referoheshim opinionit të Malcolm Harper dhe Sukhwinder Singh Arora, kjo do të nënkuptonte që "*Institucionet e mikrofinancës janë të tepërta*". Ajo për të cilën të varfërit kanë nevojë gjithmonë është zgjerimi i sektorit financiar zyrtar, që aktualisht po konsiderohet si komercializim i mikrofinancës.

Sipas Jean Philippe de Screvel : "*Komercializimi nuk është një qëllim në vetvete, por ndërmjetëson sigurimin e produkteve apo shërbimeve financiare në mënyrë të efektshme*". Në të vërtetë ai sygjeron që mikrofinanca mund të bëhet një biznes i përfitueshëm me norma interesi në nivelin e tregut dhe shlyerje të kredisë në masën 97 %, shifër kjo shumë herë më e lartë se bankat tregtare.

Në këtë stad ne mund të ngremë pyetjet e studimit

- Cila është gjendja aktuale e institucioneve të mikofinancës që operojnë në Shqipëri?
- Cila është gjendja e sektorit financiar si dhe cili eshte roli i mbikqyrjes në mikrofinancë?

Nisur nga pyetjet e kërkimit dhe problematika kemi ngritur dhe hipotezën e mëposhtme:

Ho: Strukturimi i institucioneve të mikrofinancës do të sjellë efekte pozitive në tregun financiar.

Institucionet e mikrofinancës kanë treguar se janë ndërmjetës financiarë të suksesshëm, pasi me aftësitë e tyre meaxhuese dhe profesionale kanë mëkëmbur një treg financiar inegzistent duke dhënë kredi në rajone të përjashtuara nga bankingu tradicional.

Por megjithë këtë rol të madh që ato luajnë, MFI-të kanë një disavantazh përsa i përket kostove të larta të kapitalit. Ato duhet të tentojnë të ulin koston e pergjithshme te kredidhënies për të balancuar koston e lartë të operacioneve që shkaktohet nga shumat e vogla të kredive. Kjo nënkupton që një institucion mikrofinance ka shumë më tepër shpenzime operative si në staf, logjistikë etj.

Metodologjia

Nëpërmjet këtij artikulli ne kemi siguruar një lidhje mes teorive aktuale të mikrofinancës dhe variablave të karakterit empirik që kanë shërbyer për të përfunduar analizën dhe për ti dhënë përgjigje hipotezës dhe pyetjeve të kërkimit.

Një pjesë shumë e rëndësishme e informacioneve është përpunuar nga data baza e Mix Market. Kjo platformë siguron një burim transparent dhe te

besueshëm informacioni mbi MFI-të, burimet e tyre financiare si dhe mënyrën e operimit të tyre. Mix Market për çdo institucion mikrofinance bën një analizë përshkruese statistikore, jep të dhëna financiare dhe të dhëna për informimin e publikut të gjerë.


Të dhënat statistikore japin informacion për vitin e fillimit të aktivitetit të MFI, statusin ligjor, historinë e aktivitetit, proçesin e zhvillimit, tipet e produkteve që ofrohen si dhe burimet kryesore të fondeve.

Të dhënat financiare përshkruajnë strukturën e brendshme të çdo MFI-e dhe përfshijnë të dhëna të tilla si bilanci, struktura financiare, ROA, ROE, marzhet e fitimit, kostot dhe risku.

Të gjitha informacionet e mbledhura na shërbyen për të realizuar një kërkim me natyrë atomiste pasi nisur nga fenomene dhe raste konkrete të mikrofinancës në Shqipëri dhe në botë për të shpjeguar fenomenin në përgjithësi i cili lidhet me shndërrimin e këtyre të fundit në institucione bankare.

Situata e tregut financiar


Sistemi bankar ne vend është i privatizuar, dhe pjesa më e madhe e kapitalit zotërohet nga entitete të huaja. Megjithatë duhet thënë se aktualisht Banka e Shqipërisë ka ndaluar shtimin e numrit të bankave të nivelit të dytë pasi marzhi neto i fitimit është ulur ndjeshëm. Këtë fakt e pasqyrojnë dhe grafikët e mëposhtëm të nxjerra nga të dhënat e Bankës së Shqipërisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Krahasuar me vendet e rajonit, vërehet se në vendin tonë ekzistojnë hapësira për më shumë rol aktiv të ndërmjetësve financiarë ne lidhje me zhvillimin e mikrokredisë. Niveli më i lartë i kredise mesatare ne raport me të ardhurën kombëtare bruto për frymë të analizuar në grafikun e mëposhtëm, krahasuar me vendet e rajonit (duke përjashtuar Kosovën), tregon se në popullsinë me të ardhura të ulta depërtimi i mikrokredisë rezulton i pamjaftueshëm.

Grafiku 2. Krahasimi i raportit "Kredia mesatare/AKB 1 për frymë" me vendet e rajonit



Burimi: Banka e Shqipërisë

Aktualisht, oferta e mikrokredisë është e orientuar kryesisht drejt zonave urbane të vendit, duke lënë të pambuluar me shërbime financiare zonat rurale. Në varësi të llojit të institucionit dhe të nivelit të zhvillimit të tij, vërehen nivele të ndryshme të grupeve të synuara të klientelës si dhe nivele të ndryshme të kreditimit, të cilat materializohen në nivelin e zhvillimit të kredisë mesatare. (Nako A. etj. 2011)


Kështu NOA dhe Fondi Besa, përveç kreditimit të individëve, financojnë edhe biznese të vogla dhe shumë të vogla. Ndërkohë, edhe bankat janë të përqendruara në kreditimin e bizneseve të vogla dhe të një pjese të bizneseve të mesme. Por ndryshe nga institucionet jobanka, bankat duke pasur burime më të shumta financiare, zbatojnë shuma maksimale kreditimi më të larta.

Në fund të vitit 2012 tregu i mikrofinancës në Shqipëri, jashtë sistemit bankar, rezulton me një tepricë kredie bruto 34.939 milionë lekë, e shpërndarë në rreth 80.750 klientë aktivë. Ecuria e këtij portofoli paraqitet në rritje, por me ritme

të reduktuara gjatë viteve 2009 - 2010. Për rrjedhojë, edhe kredia mesatare ka ardhur në rënie. Në kushtet kur numri i kredimarrësve aktiv është rritur nga njëri vit në tjetrin, rënia e kredisë mesatare vjen si pasojë e reduktimit të tepricës së disbursuar të kredisë për kredimarrësit e rinj, kryesisht gjatë vitit 2010. Kjo përfaqëson një nga masat e marra në përgjigje të zhvillimeve financiare në vend.


Niveli i kredive me probleme paraqitet me rritje të lehtë në kohë, përjashtuar këtu vitin 2010, ku vërehet një përkeqësim i ndjeshëm i tij. Zhvillimet në tregun e mikrokredisë analizojnë subjektet financiare jobanka dhe rrjetin e SHKK-ve. Treguesit përkatës të sistemit bankar nuk janë përfshirë, nisur nga karakteristika të ndryshme të aktivitetit të bankave përsa i përket natyrës së klientelës, shumës maksimale të kreditimit si dhe specifikave të kuadrit rregullativ dhe mbikëqyrës.

Grafiku 3. Ecuria e portofolit të kredisë bruto në vite (min lekë)




Burimi: Mix Market, 2013

Grafiku 4. Trendi i ecurisë për klientët aktivë në vite



Burimi: Mix Market, 2013


Grafiku 5. Ecuria e portofolit në risk për çdo MFI në vite



Burimi: Mix Market, 2013

Gjithashtu nga gafiku 5 shohim se rritja e kredisë me probleme është reflektuar me vonesë në portofolin e mikrokredive. Kreditë me probleme kanë shënuar rritje të ndjeshme të Procredit banka dhe ASC union, ndërsa Fondi Besa dhe NOA kanë patur rënie të saj pas vitit 2011. Kreditë me probleme në rastin e NOA dhe të BESES janë ulur si pasojë rritjes së kuadrit rregullator dhe mbikqyres nga ana e Bankës së Shqipërisë mbi institucionet mikrofinanciare. Realizimi i saj paraqet ende vështirësi për ASC union pasi ai funksionon mbi bazën e SHKK-ve.


Grafiku 6. Trendi i kredisë mesatare për çdo MFI në vite (në mijë lekë)



Burimi: Mix Market, 2013

Nga grafiku 6 shohim qartë diferencën e kredisë mesatare mikro në portofolin e MFI dhe të bankave. Kjo diferencë është pjesë e tregut që mbulojnë këto dy lloj institucionesh(bankat mbështeten kryesisht në tregun formal, ndërsa MFI në atë informal)

Grafiku 7. Rendimenti në vite për çdo MFI



Burimi: Mix Market, 2013

Në grafikun 7 edhe një herë vërejmë diferencën që kanë MFI dhe bankat me SHKK per të njëjtin treg mikro. Kjo diferencë shpjegohet me kostot e ulta të kapitalit që përdorin këto të fundit si dhe kostos së lartë që u duhen MFI për të realizuar përfitueshmërinë e nevojshme për cdo biznes i orientuar nga fitimi pozitiv.

Krahasuar me disa nga vendet e rajonit, mikrokredia në Shqipëri ka potenciale për tu zgjeruar. Rritja mesatare vjetore e portofolit të kredisë në Shqipëri për periudhën 2005 - 2009 paraqitet më e ulta (19.04 për qind), ndikuar kjo kryesisht edhe nga rritja e shpejtë e këtij tregu në rajon.

Niveli i treguesit ROA për fundin e vitit 2010 paraqitet në nivelin 1.58 për qind për institucionet financiare jobanka dhe 0.36 për qind për rrjetin e shoqërive të kursim kreditit.

Analiza e nivelit të kapitalizimit bazohet në nivelin e raportit "kapital/ totali i aktivit" për subjektet jobanka dhe "kapital/portofoli i kredisë" për rrjetin e shoqërive të kursim kreditit. Niveli minimal rregullativ i tyre është respektivisht 10 për qind dhe 8 për qind.

Sfida kryesore e subjekteve të mikrofinancës, përtej subjekteve bankare, mbetet sigurimi i fondeve për vazhdimësinë e aktivitetit. Sigurimi i këtyre fondeve është jetik pasi kapitalizimi nga fitimet ushtrimore nuk është i mjaftueshëm të përballojë këtë fluks paraje, dhe rritja e kapitalit të pronarëve gjykohet si e padëshirueshme nga investitorët për sa kohë ndikon në normen e rikthimit të këtij kapitali duke e ulur atë. Shpesh herë fondet sigurohen nga institucione ndërkombëtare dhe për rrjedhojë akordohen në valutë.

Fondet në valutë i hapin rrugën një tjetër sfide, asaj të ekspozimit ndaj pozicioneve të hapura valutore. Duke qenë se mikrokredia akordohet kryesisht në lekë, atëherë subjektet e mikrofinancës ndërrmarin kosto të tjera duke përdorur

metoda hedging për t'i konvertuar këto fonde në lekë. Për rrjedhojë edhe kosto e transmetuar tek klientët është më e lartë.

Si rezultat i kostove shtesë që subjektet mikrofinancë ndërrmarrin, rritet edhe norma e interesit për klientët. Në krahasim me tregje të tjera mikrofinance, vihet re se klientët shqiptarë paguajnë norma më të larta interesi. Cmimi i lartë për të njëjtët klientë edhe pse ata e njohin tashmë formalizimin e tregut i orienton këta të fundit drejt shërbimeve më të lira në sektorin financiar.

Përqasja rregullative dhe roli i Bankës së Shqipërisë në zhvillimin dhe rregullimin e mikrokredisë.

Sic vlerësohet dhe nga nenet e ligjit "Per bankat" edhe institucionet financiare jobanka licensohen dhe mbikqyren po nga Banka e Shqipërisë. Formati i raportimit për mbikqyrjen financiare dhe administrimin e rrezikut është i njëjtë në parim por me zëra të reduktuar si rrjedhojë e aktiviteteve për të cilat mbulon një institucion bankë dhe një jobankë. Kjo mënyrë mbikqyrje e ka edukuar kulturën e raportimit dhe të administrimit të rrezikut si në kredidhenie dhe manaxhim të tyre edhe në raporte financiare sistematike.

Sistemi i administrimit të kredisë në institucionet banka dhe jobanka drejtohet nën të njëjtën frymë rregullatore nga ana e Bankës së Shqipërisë por me specifika analitike më të hollësishme në ato banka.

Gjate vitit 2013 u bene 382 395 kerkime per kredi ne rregjistrin e kredive (sipas raportit vjetor te viti 2023 nga te cilat rreth 26% prej tyre rezultojne te jene kryer nga operatoret e institucioneve jobankare.

Raportimet e rregulluara per Banken e Shqiperise per te dyja keto institucione eshte sipas Sistemit Raportues te Unifikuar. Kjo menyre raportimi eshte e njejta pasqyre ne zera dhe menyre llogaritje e cdo raporti por koha e raportimit dhe fushta qe detyrohet te plotesoje secili prej tyre eshte e ndryshme. Qëllimi i sistemeve raportuese është marrja e informacionit të standardizuar nga subjektet raportuese si dhe përpunimi i tyre për efekte të mbikëqyrjes bankare dhe përgatitjes së statistikave monetare e financiare.

Analiza e NOA dhe rezultatet e studimit

NOA është një entitet financiar i licensuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë dhe është duke operuar në tregun financiar shqiptar që nga viti 1999, e njohur më parë si PSHM, Opportunity Albania dhe sot është në zotërim nga NOA Holding N.V. dhe NOA Cooperatief UA.

PSHM filloi aktivitetet e tij të kreditimit në 17 Qershor 1999; fokusohet në klientët e biznesit në zonat urbane dhe para –urbane; ofron kredi individuale, për fermerin dhe bizneset mikro dhe SME; është krijuar si një projekt i inicuar nga USAID në Shqipëri.

NOA shënon 16 vjet eksperiencë në biznesin e mbështetjes financiare nëpërmjet kredidhënies për individë, familje, bizneset e vogla dhe të mesme duke qenë një derë e hapur për të aksesuar shpejt dhe lehtë shërbimet financiare me qëllimin final për të bërë një diference pozitive në prosperitetin dhe standartin e tyre të jetës.

Vizioni i NOA është: "Të jemi kompania financiare e përzgjedhur nga klientët duke siguruar Shpejt dhe Lehtë shërbime dhe produkte financiare".

Ajo operon nëpërmjet 18 degëve në të gjithë vendin duke shërbyer në të dyja zonat urbane dhe rurale duke përfshirë disavantazhet minoritare.

NOA eshtë një kredidhënës Shqiptar në një bazë të gjerë për bizneset e vogla jo të shërbyera nga bankat tradicionale, duke operuar në të gjithë sektorët e ekonomisë; tregti, prodhim, blegtori dhe bujqësi.

Kreditë Individuale: Kreditë individuale janë për biznesin, si edhe për bujqësi e blegtori; ato mund të jenë si për bizneset ekzistuese, ashtu edhe për ata fillestare. Interesi i kredisë është rreth 2% në muaj mbi pjesën e mbetur të principalit dhe 2% komision për të perballuar shpenzimet administrative fillestare. Numri mesatar i kredive / oficer kredie është 110-120 kredi.

Sasia fillestare. 100,000 Leke. Zgjatja e kredisë: 12-60 muaj. Ripagesa mujore dhe sezonale.

Ky komercializim është e vetmja zgjidhje për arsye se:

- Përvoja në tregun shqiptar me klientë të mikrokredisë vlerësohet e konsiderueshme (mbi 10 vjet)
- Përvojë dhe ekspertizë e mjaftueshme nga ana institucionale dhe e burimeve njerëzore për vlerësim dhe manaxhim të riskut financiar në Shqipëri
- Kostot e kapitalit vazhdojnë të qëndrojnë në nivele të larta duke ndikuar direkt në koston e kredive për këta klientë
- Ripagimi i këtyre kostove është nga fonde kryesisht në valutë, veprim ky që e ekspozon NOA në pozicione valutore
- Niveli i riciklimit të të njëjtëve klientë ka njohur tendenca ulje, kjo shpjegon tendencën e këtyre klientëve për shërbime më të shumta dhe të konkurueshme financiare


- Mikrokredia është një biznes i fundëm (për klientë) në terma afatgjatë, për shkak të rritjes së kërkesave të klienteve për fonde më të mëdha si rezultat i rritjes së aseteve të tyre
- Mbikqyrja nga ana rregullatore dhe ligjore e Bankës së Shqipërisë i ka krijuar kulturën e nevojshme për operimin fleksibël për objekt veprimtarie më shumë se një jobankë.

Mbledhja e depozitave në publikun e lirë i siguron një kosto kapitali të mjaftueshme për të ruajtur rritjen e kërkesave të klientëve të segmentit ekzistues.

Sigurimi i fondeve për rifinancim të portofolit të kredive brenda vendit ul ekspozimin ndaj pozicionit te hapur valutor.

Përvec ekzistencës në treg njëkohësisht shihet dhe një përfitueshmëri më e mirë se ajo që ka aktualisht (ROE=6.5%).

Grafiku 8. Net Interest Margin në NOA përgjatë tre viteve të fundit




Burimi: NOA sh.a.

Analizimi i Net Interest Rate në NOA për 3 vitet e fundit ka treguar se megjithese është përmirësuar treguesi i ROE përsëri ky institucion vazhdon të ketë fitime të ulta. Kjo tregon qartë detyrimet që ka për të paguar NOA tek huadhënësit, është në rritje për shkak të nivelit të lartë të interesave të borxhit për tu paguar krahasuar me të ardhurat nga interesat mbi aktivet e dhëna në kredi në klientët e mikrokredisë.

Megjithëse Net Interest Rate është pozitiv tek NOA për tre vitet e fundit edhe fitimi ka qenë pozitiv sipas grafikut më poshtë:

Grafiku 9. ROE tek NOA për tre vitet e fundit



Burimi; NOA sh.a.

Duke i përfshirë analizat e të dy zërave Net Ineterest rate dhe ROE duket qartë se megjithëse NOA ka një Ineterest rate pozitiv, përsëri ky institucion ka tendencë që të rezultojë me fitime jo shumë të larta.

KONKLUZIONE

Nga analiza e bërë në lidhje me institucionet e mikrofinancës kemi nxjerre disa konkluzione të cilat po i listojmë si më poshtë:

- Industria e Mikrofinancës në Shqipëri ka patur rezultate pozitive dhe si pasojë mund të shkojë drejt një proçesi komercializimi. Nga ana tjetër rritja e kërkesës për shërbime financiare do të kërkojë gjithnjë e më tepër ofertë për produkte më komplekse dhe si pasojë do të kemi nevojë për adaptimin e metodave dhe paradigmave të reja në këtë fushë. E thënë ndryshe institucionet e mikrofinancës do të jenë të detyruara të bëhen pjesë e një tregu më formal që jane institucionet banka me shërbim të plotë.
- Analizimi i të dhënave financiare dhe rezultateve nga databaza e MixMarket na bëri të kuptojmë se nuk egziston një lidhje mes faktorëve të komercializimit dhe madhësisë së kredive. Por nga ana tjetër kuptuam se dhe sektori i mikrofinancës në Shqipëri nuk i ka shpëtuar krizës globale 2007-2009. Gjithashtu nga të dhënat e databazës së Mixmarket konkluduam se ROE në institucionet e mikrofinancës në Shqipëri ka krijuar luhatje të thella si mungesë e mbikqyrjes së fortë në këtë segment financiar.

- Shndërrimi i institucioneve të mikrofinancës do të ndikojë që kjo industri në të ardhmen të bëhet e vetëqëndrueshme, transparente dhe ligjërisht ë rregulluar. Pjesëmarrja e mikrofinancës si bankë tregtare, por jo si konsumues financiar, kërkon në rradhë të parë konsolidimin e një rrjeti degësh, gjithashtu një mirëkuptim të kulturës lokale, si dhe vëniën në përdorim të ekonomise së shkallës dhe trajnimit të specialistëve të kreditit me qëllim një monitorim të suksesshëm të kredive.
- Procesi i shndërrimit të institucioneve të mikrofinancës ka dy mundësi zhvillimi në të ardhmen:

a) Të jenë pjesë e një banke tregtare
b) Të kërkojnë të marrin vetë liçensë për tu shndërruar në bankë.

Në të dy rastet ka dhe vështirësi që nuk duhet të anash kalohen. Pa dyshim që përfshirja direkte në një bankë tregtare pa eksperiencë mund të jetë e kushtueshme dhe për të gjithë proçesin e mikrofinancës në të ardhmen. Pjesëmarrja më e pëlqyeshme është konsolidimi brenda një banke tregtare në mënyrë indirekte si sigurim nëpërmjet obligacioneve të mikrofinancës dhe fondeve të huazuara. Ky sygjerim duhet të bëhet pasi të sigurohet se industria e mikrofinancës po shkon në drejtimin e duhur, për të krijuar një lidhje me sistemin financiar formal në mënyrë që të arrijë shkallën e nevojshme për të bërë ndryshimet e kërkuara.

Nga ana tjetër dhe marrja e një liçense individuale kërkon një kapital fillestar të konsiderueshëm, shpenzime fillestare për mbulimin e operacioneve bankare dhe kostove operacionale të kushtëzuara nga Banka e Shqipërisë, mjaftueshmëri likujditeti më të mirë krahasuar me statusin e mëparshëm.

REKOMANDIME

- MFI njësoj si shumë organizata të tjera janë në proces ristrukturimi dhë në këtë mënyrë ato duhet të guxojnë të ndërmarrin ndryshime rradikale duke lënë pas në këtë mënyrë formën e vjetër të të bërit biznes e cila ka aktualisht një performancë të kufizuar.

- Banka e Shqipërisë duhet të mbështesë më shumë sektorin e mikrofinancës nëpërmjet formulimit të politikave më të mira lehtësuese. Këto politika mund të fokusohen :

- ❖ Në krijimin e një fondi asistence për të ndihmuar të gjitha institucionet e mikrofinancës që të ofrojnë produkte të suksesshme në afatin e gjatë. Aktualisht Banka e Shqipërisë i ka pothuajse të bllokuar shtimin e objektit të veprimtarisë për institucionet mikrofinanciare me qëllim kalimin në banka.
- ❖ Ulje e detyrimeve që duhet të paguajnë MFI-të në fazën e parë të komercializimit. NOA ka aplikuar një stress test, nga ku ka rezultuar se në dy vitet e para kjo mbështetje është mëse e nevojshme për të arritur qëndrueshmërinë në treg.

- ➢ Nga ana tjetër qeveria duhet të adoptojë një politikë mikro sigurimi të cilës duhet ti atashojë dhe një kuadër ligjor të kompletuar.

BIBLIOGRAFIA

Alexander, Gwendolyn, (2000), "Microfinance In The 21StCentury: How New Lending Methodologies May Influence Who Reach and the Impact That We have on The Poor", College Park, University Of Maryland.

Alma Nako, Jona Prifti, "Mikrokredia Në Shqipëri", Buletini i Bankes se Shqiperise, 2011

Augusto de la Torre, Juan Carlos Gozzi dhe Sergio L. Schmukler: "Innovative Experiences in Access to Finance: Market Friendly roles for the Vizivle Hand?", World Bank, August 2007.

Banka e Shqiperise : www.bankofalbania.org

CGAP /World Bank (2012) "A Guide to Regulation and Supervision of Microfinance", publikim i Bankes Boterore, 2012.

Daryl Collins, Jonathan Morduch, Stuart Rutherford dhe Orlanda Ruthven, : "Portofolios of the poor: How the World's Poor Live on $2 day", 2009

Daniel Hardy, Paul Holden, Vasili Prokopenko: "Microfinance Institutions and Public Policy", IMF Working Paper , 2003

Finance for the Poor . Retrieved April 5th , 2009, from http://www.adb.org/Documents/Policies/Microfinance/default.asp?p=policies

Grameen Bank. (April 12, 2009c) A Short History of Grameen Bank. Retrieved April 23, 2009, from : www.grameeninfo.org/index.php?option=com_content&task=view&id=19&Itemid=114

INSTAT : www.instat.gov.al

INSTAT " Tregu i punës", Buletin i publikuar nga INSTAT, 2008, 2010, 2012

Ledgerwood J. 1999. Case Studies in Microfinance: Albania, Albanian Development Fund. (http://www-esd.worldbank.org/html/esd/agr/sbp/end/albania.htm)

Marguerite S.Robinson (2001) "The Microfinance Revolution: Sustainable Finance for the Poor"
Microfinance, Commission Europeene, (2000) www.european-**microfinance**.org/
Ministria e Financave : www.minfin.gov.al
Mixmarket data: www.mixmarket.org
Nako A., Prifti J. "Mikrokredia ne Shqiperi" Buletini i Bankes se Shqiperise, 6 M-1, 2011
Robert P. Christen and Deborah Drake, (2002). "*Commercialization: The New Reality of Microfinance",* Botuar nga Deborah Drake
SALKO D, (Co-author) 2000 *"Savings and Credit Association and their role in financing of rural sector*" **Bulletin of Agriculture Sciences** Number 2. September 2000
SALKO D (Bashke autor) 2004, *"Rural Financial institutions and Albanian Reality"*, Monografi
Stuart Rutherford dhe Sukhwinder Singh Arora (Mar 2010) "The Poor and Their Money: Microfinance From a Twenty-First Century Consumer's Perspective", Amazon publications 2010.
Todd G. Buchholz "Ide te gjalla nga ekonomiste te vdekur", 2008

RËNDËSIA E AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE NË NXITJEN E INVESTITORËVE TË HUAJ NË SEKTORIN PRIVAT NË KOSOVË

Leonora Rudhani-Haliti
University of Prishtina
leonora.rudhani@uni-pr.edu
Hysen Ismajli
University of Prishtina,
Albulena Mustafa-Zatriqi
ProCredit Bank, Prishtinë,

ABSTRACT

Within globalization of the business environment in the international world the need to have reliable and comparable audited financial statement to other companies has become very important, and consequently a vital need to implement international financial reporting standard has been added. Foreign investments in Kosovo, as a new developing country are growing. The purpose of this paper is to show how important audited financial statements are in order to encourage foreign investors in the private sector in Kosovo. To examine this issue, we have analyzed three factors which are determinant in presenting the importance of the financial statements to the following foreign investors: Audit's Report, Audit's Reputation and Relevance of Auditor's Findings. Results of this study indicate that these variables have a positive effect on promotion of foreign investors. These results also reveal that audited financial statements are very important to Kosovo companies in order to have an equal worldwide treatment.

Keywords: *Audited financial statements, foreign investments, audit report, findings, auditor reputation*

HYRJE

Me globalizimin e ambienteve biznesore në botën ndërkombëtare dhe përfshirja e këtyre kompanive në bursa të shumë shteteve, ka shtuar nevojën vitale në zbatimin e standardeve ndërkombëtare për raportim financiar (SRNF).

Një ndër qëllimet e aplikimit të Standardeve Ndërkombëtare për raportim dhe financim, është që të krijoj pasqyra të ngjashme, të besueshme dhe transparente, të cilat ndihmojnë në rritjen e kapitalit dhe tregtisë në mbarë botën. Investitorët janë të interesuar në tregje që i kuptojnë, dhe në të cilat kanë besim. Auditimi i pasqyrave financiare në bazë të Standardeve Ndërkombëtare për raportim dhe financim, krijon besueshmëri të të dhënave tek investitorët e huaj.

Konsiderohet që auditimi i pasqyrave financiare dhe intervista personale, janë informatat, më të rëndësishme, që i sheh një investitorë (Berry dhe Robertson 2006).

Përveç investitorëve dhe analistëve, palë të tjera të interesuara për informacione kualitative dhe që mbështesin vendimet e tyre për investime janë edhe kreditorët, furnizuesit, klientët, organizatat etj. Ata dëshirojnë t'i krahasojnë të dhënat e publikuara nga kompania e caktuar me konkurrentët e saj, nëse shtrihen në të njëjtin shtet apo në vende të tjera të botës.

Për të rregulluar këto ndryshime globale dhe për të lehtësuar vendimet e investitorëve të huaj, Qeveria Kosovës dhe komuniteti biznesor kanë lëvizur shpejtë drejt miratimit të këtyre standardeve të cilat janë shumë të rëndësishme për klimën biznesore. Korporatat ndërkombëtare nuk kanë nevojë të miratojnë standarde specifike për Kosovën nëse ata zbatojnë SNRF në selitë e tyre. Këto standarde janë të pranueshme dhe të zbatueshme për të dyja qëllimet: raportuese dhe tatimore (Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë – arsyet për të investuar në Kosovë).

Në disa vende të botës si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Japoni, firmat private operojnë pa pasur ndonjë kërkesë ligjore për t'i bërë publike pasqyrat financiare (Arrunade 2011). Në vende të tjera, ato të cilat janë brenda Bashkimit Evropian, firmat private duhet të përgadisin pasqyra financiare dhe ato t'i bëjnë publike. Në vitin 2011 Parlamenti i Republikës së Kosovës, ka miratuar Ligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, i cili rregullon sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar të shoqërive tregtare, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF). Shoqëritë tregtare që janë të ranguara si shoqëri tregtare të mëdha, sipas ligjit për kontabilitet, janë të obliguara t'i dorëzojnë dhe publikojnë, pasqyrat financiare të audituara. Përderisa ndërmarrjet e mesme dhe të vogla janë të detyruara vetëm

të përpilojnë pasqyra financiare.

Sa është i rëndësishëm auditmi i pasqyrave financiare për investitorët e huaj në sektorin privat në Kosovë si një vend në zhvillim, do të shohim duke ju referuar analizës që do të bëjmë në ketë punim.

Duke pasë parasysh që në botën e zhvilluar auditmi i pasqyrave financiare është shumë i rëndësishëm për të krijuar besueshmëri te investitorët potencial për të investuar në kapitalin e kompanive private, apo për të investuar në formë të grantit, kredisë apo konsulences. Ne u fokusuam në analizimin e çështjes se: a ekziston kjo lidhje pozitive edhe tek investimet e huaja në sektorin privat në Kosovë.

Ka pasur shumë përpjekje për të definuar cilësinë e auditimit në të kaluarën, megjithëse nuk ka rezultuar në një definim i cili do të ishte i njohur dhe i përgjithshëm për të gjithë. Cilësia e auditimit është subjekt i ndikimit të drejtpërdrejt dhe të tërthortë.

Punimi në fjalë është i ndërtuar në shtatë pjesë, ku nga hyrja do të pasohet me seksionin e Rishikimit të literaturës, në të cilën do të paraqiten mendimet në lidhje me rendësin e auditimit tek investitori, cilësinë e auditimit, raportin e auditorit, reputacioni e auditorit, dhe relevancës së gjetjeve. Në Seksionin e tretë do të paraqiten disa koncepte mbi rëndësinë e adutimit dhe investimeve të huaja në Kosovë. Metodologjinë e hulumtimit do të jetë pjesë e seksionit të katërt dhe në seksionet e fundit do të jetë testimi i hipotezave dhe përmbledhja e rezultateve të hulumtimit.

Rishikimi i literaturës

Auditimi i jashtëm ka të bëjë me angazhimin e një kompanie të pavarur të auditimit e cila përmes auditorëve të saj bënë kontrollin në mënyrë të detajuar të raporteve financaire të cilat janë përgaditur nga kompanitë e ndryshme dhe bënë vërtetimin e kontrollës së brendshme (Comptroller's Handbook, 2003).

Sipas (AU-C Section 200, 2012) qëllimi i auditimit të jashtëm është që auditori përmes opinionit të tij të informoj përdoruesit e jashtëm rreth mënyrës së paraqitjes së pasqyrave financiare, si nga aspekti material ashtu edhe nga zbatueshmëria e rregulloreve në fuqi mbi raportimin financiar. Ky proces është i nevojshëm sepse vetë menaxhmenti i kompanisë është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare prandaj auditori paraqitet si palë e tretë, i cili vërteton saktësinë e tyre. Procesi i Auditimit të jashtëm paraqitet në 5 hapa (Larcker.F.D and Tayan.B, 2011).

- Hapi i parë – Ka të bëjë me përgatitjen e Auditimit ku bëhet vlerësimi i zonave të cilat kërkojnë një kujdes të veçantë.
- Hapi i dytë – ka të bëjë me rishikimin, vlerësimin dhe zbulimin e parregullsive.
- Hapi i tretë – ka të bëjë me vlerësimin e mundësive rreth mashtrimeve të mundshme.
- Hapi i katërt – vlerësimi i kontrollit të brendshëm duke u fokusuar në dobësitë.
- Hapi i pestë – ka të bëjë me gjetjet dhe opinionin e auditorit të cilat janë të përfshira në Raportin e auditorit.

Duke u mbështetur në burimet e më sipërme ne mund të themi se përdorues potencial të pasqyrave financiare janë investitorët. Investitorët mbështetën në raportin e auditorit mbi pasqyrat financiare për të fituar rahatin në të dhënat e paraqitura nga kompanitë e ndryshme. Duke u mbështetur gjithashtu në këtë burim investitorët dëshirojnë që raporti i auditorit të paraqet tri çështje si: (PWC, 2011)

- Rrezikun e anomalive material;
- Aplikimin e standardeve të kontabilitetit; dhe
- Zonën e rëndësishme të debatit në mes Auditorit, menaxhmentit dhe Komitetit të Auditimit.

Në literaturat e rishikuar theksohet në vazhdimësi roli i auditimit të pasqyrave financiare dhe rëndësia e Auditimit në vendimmarrje. Palët e jashtme të cilat janë të interesuara për auditim të pasqyrave financiare të sektorit private, janë: Konsumatoret, Furnitoret, Investitorët, Bankat, analistët etj. Me këtë çështje janë marrë shumë hulumtues të cilët kanë paraqitur mendimet e tyre se nga auditimi i pasqyrave financiare të kompanive kanë përfitime të shumta. Auditimet e pasqyrave financiare duke zvogëluar rrezikun e investimit financiare, ndikojnë në besueshmërinë e tyre (Fallatah, 2008).

Monitorimi i entitetit nga auditorët e nxit menaxhmentin të angazhohet në monitorimin e brendshëm duke përmirësuar kështu sistemin e kontrollit të brendshëm (Ghosh, 2007). Auditimi i jep besueshmëri pasqyrave financiare duke zvogëluar pasigurinë dhe rrezikun (Broadley, 2006). Institucionet kredidhënëse i konsiderojnë informacionet e audituesit si informacione relevante dhe të dobishme për vendimmarrje për investime dhe për kredidhënie (Guillamon, 2003).

Investitorët dhe bizneset në tërësi kanë nevojë për informacione financiare të besueshme dhe në këtë kontekst auditori luan një rol kyç në mbrojtjen e interesit publik dhe të investitorëve potencial (Elorrieta, 2002).

Shikuar nga perspektiva e investitorëve apo kredidhënsve elementet kyçe për të cilat ata janë të interesuar janë : Raporti i Auditorit, Reputacioni i Auditorit dhe Relevanca e gjetjeve të auditorit (IFAC, 2014).

Rëndësia e Auditimit të pasqyrave financiare është e pa kontestueshme për investitorët e huaj, pamarrë parasysh se në cilin vend ai investon. Duke pasë parasysh faktin që ky punim ka në fokus rolin e auditimit të pasqyrave financiare nga perspektiva e investitorit të huaj në sektorin privat në Kosovë, ne kemi analizuar faktorët të cilët bëjnë që auditimi të jetë më apo më pak i rëndësishëm për investitorët, siç janë: Raporti i Auditorit, Reputacioni i Auditorit dhe Relevanca e gjetjeve të auditorit.

Në një hulumtim k'u është studiuar opinion i auditorit si informacion i ndërmjetëm, në mes të kompanisë dhe përdorueseve të jashtëm të raportit të auditorit. Rezultati i këtij studim tregon se raporti i auditorit shërben si gurthemel në marrjen e vendimeve investive. (Commer.J.P, Salehi.M, Corresponding author, 2010).

Sipas një hulumtimi (The Institute of Chartered Accountants in Australia, 2008), Auditori përmes raportit shpreh opinionin tij, nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejt pozicionin financiar të kompanisë. Sipas këtij raporti, Opinioni i Auditorit ngritë besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe bënë që përdoruesit e pasqyrave financiare (si.p.sh Investitorët) t'i përdorin ato me besim më të madh. Auditori mund të jep një opinion të pa kualifikuar atëherë kur ai beson se nuk ka vend për shqetësime dhe po ashtu mund të jep një opinion të kualifikuar atëherë kur shpreh rezerva, tek shpalosja e pasqyrave financiare.

Raporti i Auditorit (Moradi. M at al, 2011) është një mjet komunikimi shumë i rëndësishëm në mes të Auditorit dhe përdoruesve të pasqyrave financiare. Ky burim ka hulumtuar lidhjen në mes të opinionit të auditorit, çmimit të aksioneve dhe vlerës së kthimit në shtetin e Iranit. Dhe sipas rezultateve të këtij hulumtimi opinion i auditorit nuk është i rëndësishëm në çmimin e aksioneve dhe vlerën e kthimit mirëpo është shumë i rëndësishme tek palët që dëshirojnë të investojnë në kompani.

Si element i kyç i rëndësisë se Auditimit tek investitorë është edhe reputacioni i Auditorit i cili është një faktor bazik që ka ndikim në cilësinë e auditimit. (Khaddash.A.H, Nawas.A.R and Ramadan.A, 2013) reputacioni i auditorit ndërtohet me mjaft vështirësi, duke ofruar punë të qëndrueshme dhe cilësore. Nëse auditori ka një reputacion atëherë siguria për vendimmarrje është më e madhe tek investitorët dhe po ashtu të gjitha rekomandimet për gjetjet janë me të zbatueshme.

Kompanitë e auditimit me reputacion kanë me shumë frikë nga humbja reputacioni dhe ndnje herë nuk e raportojnë gjendjen reale të klientit.(McLennan & Park , 2004)

Në dekadatë e fundit janë hapur shumë kompani të cilat kanë themeluar shumë filiale nëpër të gjitha qytetit e botës. Duke pasë parasysh numrin e tyre është bërë një ndarje, që shumë shpesh njihet në bote si (Big 5, Big 4, ose Big 8), varësisht nga industria se ku ato operojnë dhe kanë një reputacion pothuajse të veçantë në industrinë ku operojnë. (McLennan & Park , 2004)

Pasi që investitorët nuk janë në gjendje për të vëzhguar drejtpërdrejt në cilësinë e auditimit dhe të përcaktojë nëse informacioni i raportuar është një tregues i paanshëm i performancës financiare të firmave, reputacioni i auditorit shërben si një shtyllë e rëndësishëm për cilësinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare të klientit" (Khaddash.A.H, Nawas.A.R and Ramadan.A, cited: DeAngelo1981).

Të dhënat e auditimit janë të gjitha informacionet që përdoren nga auditori për të arritur në përfundimet mbi të cilat opinioni i auditorit është i bazuar. Evidencat në auditim janë të domosdoshme për të mbështetur opinionin e dhënë të auditorit. Zakonisht është një komulativ i marrë nga procedurat e auditimit të cilët mund të përfshinë informata nga auditimi i kalauar. Procedurat e auditimit për të marrë dëshmitë e auditimit mund të përfshijnë inspektimin, vëzhgimin, konfirmimin, rillogaritje e performacës dhe procedurat analitike. Përshtatshmëria është masë e cilësisë së evidencës së auditmit, e cila paraqetë relevancën dhe kualitetin e gjetjeve të rëndësishme në mënyre që të ofroj mbështetje për zbulimin e anomalive dhe mos përputhjeve në pasqyra financiare. Relevanca dhe besueshmëria e gjetjeve ndikohen nga burimi dhe natyra e gjetjeve dhe janë të varura nga rrethanat e caktuara (IFAC, 2009).

Pasqyrat financiare të adituara kanë për qellim të paraqesin informata në treg, duke paraqitur informata specifike, relevante dhe të besueshme të cilat mundësojnë parashikim të rrjedhës se parasë dhe të reduktojnë pasigurinë ku me anë të kësaj krijohet një qasje më e lehet për financim dhe rritje të investimeve. (Ch.Langli, T Svatsrom, 2013).

Përderisa në vendet e ndryshme të botës invesitorët potencial mbështetën në Raportin e Auditorit, në Kosovë duke mos e anashkaluar rëndësinë e raportit të auditorit, investitorët e jashtëm u stimuluan në mënyra të ndryshme. Sipas një hulumtimi të bërë (Shaipi.K, Krasniqi .B, Mati.B and Gashi.E, 2014) autorët kanë vërtetuar se invesitorët e huaj u stimuluan nga Qeveria e Kosovës në mënyrë financiare dhe jo financiare, si: përjashtimi nga detyrimi doganor (26%), shtyrja e pagesës së TVSH-së (15%), amortizimi i përshpejtuar për makinerit

(16%), përjashtimi nga taksat rregullative dhe licencimet (83%) dhe sigurimi i infrastrukturës fizike me kosto të përballueshme ose pa kosto fare (82%). Po ashtu duke u mbështetur në këtë hulumtim 72 % e investitorëve aktual kanë raportuar se stimulimet e Qeverisë së Kosovës kanë qenë një faktor shumë i rëndësishëm që kanë ndikuar në vendimet e tyre për të investuar në Kosovë.

Sa është roli i auditimiti të pasqyrave financiare në nxitjen e investimeve të huaja në Kosovë në sektorin privat do të shohim nga analiza e empirike e këtij punimi.

Një vështrim mbi auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë dhe mbi investimet e huaja në Kosovë.

Auditimi i pasqyrave financiare të kompanive në Kosovë

Çështja e auditimit në Kosovë, me ligj është e rregulluar me disa mangësi, ose me mirë të themi jo njëjte si në vendet e zhvilluara. Në aspektin ligjor, derisa në vendet tjera në rajon ashtu edhe më gjerë, me ligj janë përcaktuar bizneset të cilat janë të detyruara t'i auditojnë pasqyrat financiare, në Kosovë janë të përjashtuara ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Vetëdija e ulët e bizneseve për përfitimet nga auditimi i pasqyrave financiare ka ndikuar që vetëm një numër i vogël i bizneseve kosovare të bëjë auditimin e tyre.

Auditimi i kompanive të mëdha në Kosovë është i domosdoshëm për një treg të mirëfilltë financiar, besueshmëri për investitorët ndërkombëtarë, besueshmëri të raportimit të tyre financiar dhe garantim të transparencës.

Ashtu siç u potencua më lartë në Kosovë, sipas Ligjit për kontabilitet dhe financa, jo të gjitha bizneset kanë obligim që t'i nënshtrohen procesit të auditimit. Sipas ligji, këtij procesi i nënshtrohen vetëm kompanitë e mëdha, kurse ndërmarrjet e vogla dhe të mesme bëjnë vetëm raportimin financiar. Bazuar në të dhënat nga Ministria e Financave e Kosoves, vetëm afër 270 kompani në Kosovë, përgatisin pasqyra financiare dhe bëjnë auditim të këtyre pasqyrave.

Investimet e huaja në Kosovë

Investimet e huaja direkte janë një burim shumë i rëndësishëm i flukseve të kapitalit dhe zhvillimit të ekonomisë. Gjatë vitit 2013 shteti nga ku e kanë origjinën pjesa më e madhe e Investimeve të Huaja Direkte në Kosovë është Turqia me 82.8 milion euro ose 28% të totalit. Shtete të tjera më me peshë sa i takon Investimeve të Huaja Direkte janë Zvicra (14%), Gjermania dhe Shqipëria (7%) etj.

Tabela Nr. 1 "Investimet e Huaja Direkte në Kosovë sipas shtetit të origjinës gjendja me 31 Mars 2014"

Vlera në milionë euro

Rajoni	**IHD Hyrëse**	**IHD Dalëse**
Bashkimi Europian	962.83	53.81
Shtete të tjera Joeuropiane	111.31	11.41
Shtetet e tjera Europiane	534.32	75.4
TOTALI	2,807.80	140.62
Te paspecifikuara	1,199.34	

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Në total më 31 Mars 2014 gjendja e Investimeve të Huaja Direket shënon 2.8 miliardë euro Investime Hyrëse dhe 141 milionë euro Investime Dalëse.

Këto janë të gjitha investimet e huaj, ku një pjese e tyre është edhe në kompani private, si bashkë investim, investime në kapital, kredi apo forma tjera të investimit. Në këtë punim ne jemi fokusuar tek kategoria e kompanive private, ku kryesisht investimin në kredi apo forma të tjera e kanë marrë nga kompanitë ndërkombëtare (EIB, EIF, KFW, apo Banka Botërore), mirëpo nuk janë të përjashtuar edhe ato kompani private që kanë bashkëfinancim nga investitorët e huaj.

Duke shikuar në termat e referencës që paraqiten nga investitorit dhe që duhet të plotësohen nga kompanitë në Kosovë, për të marrë një kredi, grant, konsulence apo forme tjetër të financimit, nuk shihet që është kriter i domosdoshëm çdoherë që kompania të ketë të audituara pasqyrat financiare, vetëm në rastet kur është fjala për kredit, apo investim në kapital.

Se cilat elemente të auditimit të pasqyrave financiare janë të rëndësishëm për të nxitur një investitor të huaj që të investoj në kompani private në Kosovë do të shohim në analizën në vijim.

Hipotezat dhe metodologjia e hulumtimit

Hipotezat e hulumtimit

Për temën në fjalë kemi ngriturë tri hipoteza të cilat ndërtohen mbi supozimin e rëndësisë së auditimit të pasqyrave financiare në nxitjen e investimeve të huaja në sektorin privat në Kosovë e ato janë:

H1 : Rëndësia e Auditimit të Pasqyrave financiare ka një lidhje pozitive me Raportin e auditorit.

H2 : Rëndësia e Auditimit të Pasqyrave ka një lidhje pozitive me Reputacioni e Auditorit

H3 : Relevanca e gjetjeve ka një lidhje pozitive me rendësin e auditimit të pasqyrave financiare

Qe të tri variablat të cilat e rrisin rendësin e audititmi dhe të cilat mendojmë që ndikojnë pozitivisht në nxitjen e investimeve të huaja në kompanitë private në Kosovë.

Në bazë të hulumtimeve të shumta në lidhje me temën mbi " Rëndësinë e auditimit të pasqyrave financiare në nxitja e investimeve të huaja në sektorin privat" vërehet që në vendet e zhvilluara dhe në shumicën e vendeve në zhvillim, auditimi i pasqyrave financiare të kompanive private është shumë i rëndësishëm për investitorët e huaj.

Për të paraqitur rendësin e auditimit tek kompanitë private në Kosovë, ne kemi shpreh një interesim edhe në disa pyetje të cilat lidhen direkt mbi arsyen e auditimit të pasqyrave financiare nga kompanitë private në Kosovë të cilat n'a dërgojnë në disa konkludime mbi rendësin e auditimit.

Metodologjia e punimit

Metodologjia për mbledhjen e informacioneve përbëhet nga një përzierje e metodave kualitative dhe atyre kuantitative. Aspekti kualitative është zbatuar përmes një shqyrtimi të burimeve dytësore (hulumtime të quajtura në tavoline), hulumtime të ndryshme, ligje të caktuara, informata nga linqe të ndryshme, ndërsa komponenti kuantitave është zbatuar përmes një pyetësori të strukturuar.

Për shkak të kohës së kufizuar, lokacionit të ndryshëm të anketuesve dhe kostos, kryerja balle për balle me të gjithë të anketuarit ka qenë e pamundur. Anketa është dërguar në forme online të respodentet dhe përgjigjet janë marr brenda 3 jave. Duke pasë parasysh që personat e targetuar për tu anktuar kanë qenë firmat private që kanë pasqyra të audituara dhe financim nga investitorët në Kosovë, informatat për këto kompani i kemi gjetur përmes kontakteve private të disa personave që punojnë në kompanitë e auditimit në Kosovë, janë shfrytëzuar kontaktet shoqërore për të marrë sa me shumë informata për kompanitë të cilat kanë fituar ndonjë kredi, investim në kapital apo grant nga ndonjë investitor i huaj në Kosovë.

Të gjitha të dhënat janë marrë online, duke pas parasysh faktin që anketa nuk ishte sy me sy, ju kemi ridërguar më shumë se tri herë personave të targetuar, po ashtu në raste të caktuar kemi shfrytëzuar edhe rrjetin shoqëror për të ndërhyre të ndonjë kompani për të kryer anketën, dhe i kemi kontaktuar disa edhe me telefon.

Mostra e anketës përfshin 31 kompani private në Kosovë, të cilat përgatisin pasqyra financiare në baze të SNRF, dhe 20 prej tyre që kanë edhe financim nga ndonjë investitor i huaj. Pyetësori është dërguar në forme elektronike tek 70 kompani private në Kosovë. Nga anketat e dërguara në kemi marr 40 përgjigje, ku 31 prej tyre konsiderohen të vlefshëm për analizë.

Të dhënat e marra nga pyetësori janë përpunuar në bazën e të dhënave SPSS.

1. Rezultatet përshkruese të analizës

Karakteristikat e përgjithshme të respodenteve.

Nga rezultatet e të dhënave të përgjithshme të të anketuarve vërehet që 19.4% apo 6 e të anketuarve kanë përfunduar nivelin e shkollimit Bachelor, 77.4 % apo 24 prej tyre nivelin master dhe 3.2% apo 1 i anketuar ishte me doktoratë. Sa i përket çështjes se specializimit në fushën e kontabilitetit apo auditimit, 25.8 % apo 8 e të anketuarve ishin Teknik të kontabilitetit, 22.6% apo 7 prej tyre ishin Kontabilist të certifikuar, 13 % apo 4 prej tyre ishin auditor ligjor apo të certifikuar, përderisa pjesa tjetër e të anketuarve prej 38.7 apo 12 anketues ishin pa kualifikime të lartpërmendura.

Tabela Nr.2:"Karakteristikat e të anketuarve"

Variablat		**Frekuenca**	**Frekuenca %**
Shkollimi	Bachelor	6	19.4%
	Master	24	77.4%
	Doktoratur	1	3.2%
	Total	31	100.0%
Specializimi	Teknik i kontabilitetit	8	25.8%
	Kontabilist i çertifikuar	7	22.6%
	Auditor i çertifikuar	2	6.5%
	Auditor ligjor	2	6.5%
	Asnjëra	12	38.7%
	Total	31	100.0%

Duke ju referuar rezultateve të anketës, në tabelën e Nr. 3, shohim se veprimtarit e kompanive i përkasin këtyre sektoreve: 3.2% sektorit të tekstilit, 9.7% sektorit të metalurgjisë, 3.2% sektorit të drurit, 41.9 % sektorit të ushqimit dhe 41.9% sektorëve të tjera. Po ashtu duke iu referuar këtyre të dhënave, nga kompanitë e anketuara, rezultatet tregojnë se 54.8% e këtyre kompanive janë kompani aksionare me aksionar vendor, 16.1 % aksionar ndërkombëtar, 19.4 % aksionar vendor dhe ndërkombëtar dhe 9.7% e këtyre kompanive veprojnë me ndonjë forme tjetër ligjore në Kosovë. Sa i përket madhësisë se këtyre kompanive me numër të të punësuarve, 74.2 % apo 23 kompani kanë mbi 50 punëtore dhe 25.8% apo 8 prej tyre kanë deri në 50 punëtor.

Nga rezultatet e karakteristikave mbi auditimin e pasqyrave financiare të këtyre kompanive dhe qasjen në investime të huaja, shohim se: 90.3 % ose 28 kompani, pasqyrat financiare i përgatisin dhe raportojnë në bazë të Standardeve ndërkombëtare për raportim dhe financim (SNRF) dhe 93.5 % apo 29 kompani bëjnë auditim të rregullt të pasqyrave financiare. Me këtë vërtetojmë kriterin e parë të përcaktuar që kompanitë të cilat bëjnë auditim të rregullt të pasqyrave financiare janë të targetuara. Sa i përketë qasjes në financim të këtyre kompanive rezulton se 67.7 % e kompanive apo 21 prej tyre kane financim nga investitorët e huaj ndërsa 10 prej tyre nuk kanë. Format e financimit të invesitorëve të huaj në këto kompani janë në këtë shpërndarje: 12.9 % në formë të grantit, 6.5 % në formë të kredisë, 9.7% në formë të konsulencës financiare, 35.5% në formë të investimit kapital dhe 3.2% në formë tjetër.

Tabela Nr.3: "Karakteristikat e përgjithshme të kompanive"

Variablat		**Frekuenca**	**Frekuenca %**
Veprimtaria e kompanisë	Tekstil	1	3.2
	Metalurgji	3	9.7
	Drurit	1	3.2
	Ushqimore	13	41.9
	Tjetër	13	41.9
	Total	**31**	**100.0**
Lloji i kompanisë	Aksionar vendor	17	54.8
	Aksionar ndërkombëtar	5	16.1
	Aksionar vendor the ndërkombëtar	6	19.4
	Tjetër	3	9.7
	Total	**31**	**100.0**

Numri mesatar i të punësuarve në kompaninë tuaj është:	Deri në 50 punëtor	8	25.8
	Mbi 50 punëtor	23	74.2
	Total	**31**	**100.0**
Përgatitja e pasqyrave sipas SNRF	Po	28	90.3
	JO	3	9.7
	Total	**31**	**100.0**
Auditim të rregullt të pasqyrave	Po	29	93.5
	JO	2	6.5
	Total	**31**	**100.0**
Investime të huaja	Po	21	67.7
	JO	10	32.3
	Total	**31**	**100.0**
Forma e financimit	Grantit	4	12.9
	Kredisë	2	6.5
	Konsulenca Financiare	3	9.7
	Investim në kapital të kompanisë	11	35.5
	Tjetër	1	3.2
	Total	21	67.7
	Nuk kanë financim të huaj	10	3.3
	Total	**31**	**100.0**

Rëndësia e Auditimit të Pasqyrave Financiare

Për të përshkruar rendësin e auditimit të pasqyrave financiare nga kompanitë private në Kosovë, ne kemi krijuar 5 pyetje, të cilat paraqesin arsyen e auditimit të pasqyrave financiare nga këto kompani. Nga përgjigjet e respodentëve shihet që pajtohen pothuajse në shumicën e rasteve që auditimi është i rëndësishëm për të marrë kredi në bankë, për të dhënë informata të besueshme tek investitorët, për aksionaret e kompanisë, për të kryere obligimet që dalin nga ligji dhe për t'u krahasuar me kompanitë e tjera. Mesatarja e këtyre përgjigjeve është 4.24 me një devijim standard prej 0.6 që tregon se auditimi i pasqyrave financiare në kompanitë private në Kosovë është i domosdoshëm në mënyrë që të krijojnë informata të besueshme tek palët e treta. (Niveli i vlerësimit nga 1- 5, 5 pajtohem plotësisht dhe 1 nuk pajtohem fare).

Tabela Nr. 4: "Faktorët përcaktues të Rëndësisë së Auditimit të pasqyrave financiare"

Përgjigjet	N	5	4	3	2	Te shpre-hura në mesatare	Devijimi Standard
13. APF është i rëndësishëm për të marr kredi në bankat në Kosovë.	31	16%	52%	29%	3%	3.7742	0.84497
14. APF është i rëndësishëm për të dhënë informata të besueshme tek investitorët potencial të jashtëm që ndikojnë në përfitimin ose jo të investimeve nga ata.	31	48%	52%			4.4839	0.508
15. APF është i rëndësishëm për të dhënë informata të besueshme mbi përformancën e kompanisë tek aksionaret.	31	48%	45%	7%		4.4194	0.62044
16. APF është i rëndësishëm për të përmbushur obligimet dhe detyrimet që vijnë nga ligji në fuqi mbi raportimin dhe auditimin e pasqyrave financiare(LIGJI Nr. 04/L-014 PËR KONTABILI-TET,RAPORTIM FINANCIAR DHE AUDITIM).	31	39%	58%	3%		4.3548	0.55066
17. APF në bazë të standardeve ndërkombëtare të auditimit (ISA) është i rëndësishëm për Kompaninë për të qenë i krahasuar me të gjitha kompanitë (kombëtare ose ndërkombëtare që përgatisin pasqyrat financiare sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiare (SNRF).	31	23%	71%	7%	3%	4.1613	0.52261
Totali						4.23872	**0.609336**

Rëndësia e Raportit të Auditorit

Rendësin e Raportit të Auditorit ne e kemi përcaktuar nga faktorët e paraqiturë në tabelën e mëposhtme. Nga përgjigjet e paraqitura në tabelën nr.5 shohim se: të anketuarit e kanë vlerësuar si të rëndësishëm, opinionin e auditorit për invesitorët e huaj, preferencën e invesitorëve që të investojnë në kompanitë ku raporti i auditorit është i pakualifikuar pastaj presionin e invesitorëve në

kompanit për adresimin e problemeve, të cilat kanë bërë që raporti i auditorit të jete i kualifikuar, po ashtu si të rëndësishme të anketuarit e kanë vlerësuar edhe mendimin e auditorit lidhur me përpilimin e pasqyrat financiare në përputhje me standardet e korrnizës raportuese dhe me legjislacionin në fuqi. Mesatarja e përgjigjeve nga të anketuarit për të gjithë faktorët e paraqiturë është 3.99, me devijim standard 0.87. (Niveli i vlerësimit nga 1-5, 5 pajtohem plotësisht, 1 nuk pajtohem fare)

Tabela Nr. 5. Faktorët përcaktues të Rëndësis së Raportit të Auditimit

Përgjigjet	**Nr.**	**5**	**4**	**3**	**2**	**Te shpre-hura në mesatare**	**Devijimi Standard**
18. Opinioni i auditorit të pavarur është i rëndësishëm për investitorët e huaj:	31	19%	26%	55%		4.3548	0.79785
19. Investitorët preferojnë të investojnë në kompanitë tek të cilat opinioni i auditorit është i pakualifikuar:	31	26%	16%	13%	45%	3.1935	1.3271
20. Investitorët bëjnë presion që kompania të merr masat e nevojshme që kualifikimet e auditorit të adresohen dhe të mos përsëriten në të ardhmen:	31	19%	36%	39%	65%	3.6774	0.87129
21. Është e rëndësishme që auditori të shpreh mendimin që pasqyrat janë përpiluar në pajtim me standardet e kornizës raportuese:	31	48%	52%			4.4839	0.508
22. Është e rëndësishme që pasqyrat financiare të jenë në përputhshmëri me kërkesat e institucioneve rregullatorë dhe tatimore në Kosovë:	31	42%	52%		6%	4.2581	0.89322
						3.99354	0.879492

Rëndësia e Reputacionit të Auditorit

Rendësin e reputacionit të auditorit e kemi paraqitur me 5 pyetjet si faktorët përcaktues të tyre, të cilët të anketuarit i vlerësuan si të rëndësishme përmes përgjigjeve të tyre. Nga tabela nr.6 shohim se, pjesa dërmuese e të anketuarave e vlerësuan si të rëndësishme, besueshmërinë e auditorit, përvojën e auditorit në

industrin e kompanisë që vepron, rëndësinë e prestigjitë të kompanisë së auditimit në tregun ndërkombëtar dhe rëndësin nëse kompania e auditimit është pjesë e top 4-shës së kompanive më të mëdha ndërkombëtare. Mesatarja e përgjigjeve nga për këta faktor është 3.88%, me një devijim standard 0.89%. Nga vetë vlerësimi i pyetjeve shihet se cila është konsideruar me rendësi me të madhe. (Niveli i vlerësimit nga 1-5, 5 pajtohem plotësisht, 1 nuk pajtohem fare).

Tabela Nr. 6: " Faktorët përcaktues të Reputacionit të Auditorit"

Përgjigjet	**N**	**5**	**4**	**3**	**2**	**Te shprehura në mesatare**	**Devijimi Standard**
23. Kompanitë ndërkombëtare të auditimit janë me të besueshme se kompanitë vendore të auditimit:	31	41.90%	19.40%	19.40%	19.40%	3.8337	1.1859
24. Kompania e auditimit është e rëndësishme të ketë përvojë të gjatë në auditim:	31	32.30%	51.60%	16.10%		4.1613	0.6878
25. Kompania e auditimit është e rëndësishme të ketë përvoje të gjatë në industrinë ku kompania juaj vepron:	31	16.10%	41.90%	41.90%		3.7419	0.72882
26. Kompania e auditimit është e rëndësishme që të jetë e njohur në tregun ndërkombëtar:	31	25.80%	48.40%	22.60%	3.20%	3.9677	0.79515
27. Auditimi nga kompanitë ndërkombëtare që opërojnë edhe në Kosovë dhe që gjinden në top 4-shen e kompanive me të mëdha ndërkombëtarë të auditimit (Delloite, KPMG, PWC dhe E&Y) është shumë i rëndësishëm:	31	32.30%	25.80%	25.80%	16.10%	3.7419	1.09446
	3.8893	0.898426					

Rëndësia e relevancës së të gjeturave

Relevanca e të gjeturave si faktorë që ndikon në rëndësinë e auditmit të pasqyrave financiare, e kemi paraqitur përmes 5 pyetjeve të paraqitura tabelën Nr.7. Të anketuarit i kanë vlerësuar si të rëndësishme plotësimin, përmirësimin e rekomandimeve nga ana e menaxhmentit të kompanisë dhe rëndësinë e përmirësimit të tyre për investitorët në periudhat vijuese, pastaj letër-menaxhmentit mbi gjetjet e auditorit. Poashtu nga tabela nr.7 vërehet, se sa të rëndësishme e vlerësuan edhe ofrimin e dëshimve të mjaftueshme nga auditori mbi gjetjet dhe rrezikun e çdo gjetje. Mesatratja e përgjigjeve nga të anketuarit është 4.29 me devijim standard 0.60. (Niveli i vlerësimit nga 1-5, 5 pajtohem plotësisht, 1 nuk pajtohem fare)

Tabela Nr. 7:"Faktorët përcaktues të relevancës së të gjeturave"

Përgjigjet	**N**	**5**	**4**	**3**	**2**	**Te shpre-hura në mesatare**	**Devijimi Standard**
28. Është e rëndësishme për Menaxhmentin e kompanisë që rekomandimet e dhëna të plotësohenpërmirësohen në përiudhat vijuese:	31	48.40%	48.50%	3.20%		4.4516	0.56796
29. Investitorët e jashtëm gjithashtu kërkojnë Letër Menaxhmentin që përfshinë gjetjet dhe rekomandimet e dhëna nga auditori i jashtëm:	31	22.60%	74.20%	3.20%		4.1935	0.47745
30. Është e rëndësishme për Investitorët e jashtëm që rekomandimet e dhëna të përmirësohen në përiudhat vijuese:	31	29.00%	67.70%	3.20%		4.2581	0.51431
31. Është e rëndësishme që të jepen dëshmi të mjaftueshme nga auditori mbi gjetjet e dhëna:	31	51.60%	48.40%			4.5161	0.508
32. Është e rëndësishme të paraqitet rreziku i çdo gjetjeje nga auditori i jashtëm:	31	32.30%	48.40%	12.90%	6.4%	4.0323	0.94812
	0.603168						4.29032

Duke ju referuar përgjigjeve, të cilat janë në nivelin Pajtohem dhe Pajtohem Plotësisht, pra në një mesatare mbi 4, në mund të themi që të anketuarit kane vlerësuar se të tri faktorët e pavarur të këtij punimi janë të konsideruar si të rëndësishme që një auditim i pasqyrave financiare është i rëndësishëm.

Testimi i Hipotezave

Në testimin e hipotezave të ngritura është përdorur Korelacioni , me të cilin testojmë se a ekziston lidhje në mes të variablave të pavarura veç e veç me variabilen e varur që është rëndësia e auditimit.

Nga rezultati kuptojmë së koeficienti i Sig. 0.032 është më i vogël se 0.05 që na tregon se ekziston një marrëdhënie signifikante në mes të Rëndësisë së Auditimit të Pasqyrave financiare dhe Raportit të auditorit. Duke u bazuar po ashtu në këto rezulatate, koeficienti i korrelacionit Pearson prej 0.386 na vërteton se lidhja në mes tyre është pozitive dhe fortësia e lidhjes është mesatare. Në bazë të këtyre rezultateve mund të konkludojmë se Hipoteza e parë vërtetohet plotesisht.

Tabela nr.8 Lidhja në mes të rendesisë së auditmit dhe raportit të auditorit

Correlations			
		Rendesia	Raporti
Rëndësia	Pearson Correlation	1	.386*
	Sig. (2-tailed)		.032
	N	31	31

Duke i vënë në raport rëndësin e auditimi me reputacionin e auditorit, të dhënat tregojnë se, ndjeshmëria (signifikanca) është 0.025 e cila është më e vogël se 0.05 që vërteton se ekziston një marrëdhënie e signifikante në mes të këtyre variablave. Nga rezultati i koeficientit të korrelacionit Pearson prej 0.401, kuptojmë se lidhja në mes këtyre variablave është pozitive dhe fortësia e lidhjejs është mesatare. Në bazë të këtyre rezultateve po ashtu mund të konkludojmë se Hipoteza e dytë vërtetohet.

Tabela nr.9. Lidhja në mes të reputacionit të auditorit dhe Raportit të Auditorit

Correlations			
		Rendesia e Auditimit	Reputacioni I auditorit
	Pearson Correlation	1	.401*
	Sig. (2-tailed)		.025
	N	31	31

Duke i vene në relacion rendisin e auditimit dhe relevancen e gjetjeve nga auditori shohim se koeficienti Sig 0.036 është më i vogël se 0.05 që na tregon se ekziston një marrëdhënie e signifikante në mes të Relevancës së gjetjeve dhe rëndësisë së auditimit të pasqyrave financiare Nga rezultati i koeficientit të korrelacionit Pearson prej 0.377, kuptojmë se lidhja në mes këtyre variablave është pozitive dhe fortësia e lidhjes është nen mesatare. Në bazë të këtyre rezultateve po ashtu munde të konkludojmë se edhe Hipoteza e tretë vërtetohet.

Tabela nr.10 Lidhja në mes të Relevancës së gjetjeve dhe rëndesisë së auditimit

Correlations			
		Rendesia	relevanca
Rendesia	Pearson Correlation	1	.377*
	Sig. (2-tailed)		.036
	N	31	31

PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMET

Një ndër qëllimet e aplikimit të Standardeve Ndërkombëtare për raportim dhe financime, është që të krijoj pasqyra të ngjashme, të besueshme dhe transparente, të cilat ndihmojnë rritjen e kapitalit dhe tregtisë në mbarë botën. Investitorët janë të interesuar në tregje që i kuptojnë, dhe në të cilat kanë besim. Auditimi i pasqyrave financiare në bazë të Standardeve Ndërkombëtare për raportim dhe financim, krijon besueshmëri të të dhënave tek investitorët e huaj.

Nga rezultatet e punimit mund të themi që auditimi i pasqyrave financiare është shumë i rëndësishëm për kompanitë private në Kosovë, në mënyre që ato të qasen me lehte për të marrë kredi në banka, për të dhënë informata të besueshme tek kontraktorët e ndryshëm, për të dhënë informata të besueshme tek investitorët potencial, për të qene të krahasueshme me kompanitë të cilat i përkasin industrisë së njëjte.

Nga testimi i hipotezave të ngritura, me analizën e bërë, ne vërtetojmë një

lidhjen të ndjeshme pozitive në mes të**:** Rëndesisë së Auditimit të Pasyrave financiare me Raportin e auditorit, Reputacionin e Auditorit dhe Relevancen e gjetjeve. Të gjitha këto variablta të konsideruara që ndikojnë pozitivisht në rendësin e adutitimit të pasqyrave financiare, si element për nxitjen e investimeve të huaja tek kompanitë private në Kosovë edhe në basë të rezultate të koeficientit të ndjeshmërisë P që ishte më i ulët se 0.05 dhe koeficientit te korrelacionit Pearson-it që ishte pozitive janë vërtetuar si të tilla.

Duke u bazuar në rezultate e këtij hulumtimit në rekomandojmë se kompanitë private në mënyrë që të nxisin investitorët e huaj duhet që:

- Pasqyrat financiare t'i përpilojnë dhe të bëjnë raportimin e tyre në baze të standardeve ndërkombëtare për raportim dhe financim (SRFN), në mënyrë që të krijohet unifikim dhe të mund të jenë të krahasueshme me kompanitë e tjera.
- Kompanitë private në Kosove duhet të rrisin vetëdijen edhe me shumë që të bëjnë auditim të rregullt të pasqyrave financiare, duke pasë në ko-nsideratë përfitimet që mund të vijnë qoftë në evitimin e problemeve, po ashtu edhe lehtësim në qasje tek investitorët e huaj dhe në financime tjera.
- Kompanitë private në Kosove duhet të fokusohen në kualitetin e raportimit të pasqyrave financiare, e me ketë të ndikohet që mendimi i auditorit për e pasqyrave financiare të tyre jetë i pakualifikuar.

Po e mbyllim me fjalinë e mëposhtme:

*"Nëse dëshirojmë investitorë të huaj, nëse dëshirojmë besueshmëri të ndërmarrjeve që veprojnë në Kosovë, atëherë vërtetë auditimi është një nga instrumentet kryesore që i rregullon këto dhe krijon një lloj besueshmërie edhe për investitorët e huaj. Investitorët e huaj ende nuk kanë një lloj besueshmërie, se në Kosovë, pasqyrat financiare të përpiluara nga kompanitë private q*ë në *realitet paraqesin gjendjen reale të tyre ".*

BIBLIOGRAFIA

ACCA Association of Chartered Certified Accountants. (2011). The value of audit: views from retail. Singapore. Retrieved 10 26, 2014

Asare.K.S, Wright.A. (2012, June). INVESTORS', AUDITORS', AND LENDERS' UNDERSTANDING OF THE MESSAGE. Accounting Horizons, American accounting association, 26, 193-217.

AU-C Section 200. (2012). Overall Objectives of the Independent Auditor and the Conduct of an Audit in Accordance With Generally Accepted Auditing Standards. Retrieved 11 07, 2014, from http://www.aicpa.org/research/standards/auditattest/downloadabledocuments/au-c-00200.pdf

Broadley D. (2006), Auditing and its role in Corporate governance, FSI Seminar on Corporate Governance for Banks.

Commer.J.P, Salehi.M, Corresponding author. (2010). Evaluating Effectiveness of External Auditors' Report: Vol 4, 1. Retrieved 10 26, 2014, from http://www.jespk.net/publications/30.pdf

Comptroller's Handbook. (2003). Internal and External Audits. Comptroller of the Currency Administrator of National Banks.

Elerroita A. M. (2002), Disclosure and Transparency Accounting and Auditing, The Third Meeting of the Latin American Corporate Governance Roundtable, OECD & World Bank Group.

Fallatah Y. (2008), The role of asset reliability and auditor quality in equity valuation, Global Conference on Business & Economics.

Firth M. (1980), A note on the impact of audit qualifications on lending and kredit decisions, Journal of Banking & Finance, Vol. 4,

Geiger.A.M, Epstein.J.M. (1994, January). Investor Views of Audit Assurance: Recent Evidence of the Expectation Gap. Journal of Accountancy,, 1, 60-66.

Ghosh S. (2007) External Auditing, Managerial Monitoring and Firm Valuation: An Empirical Analysis for India, International Journal of Auditing

Guillamon, A. G. (2003), The usefulness of the audit report in investment and financing decisions, Managerial Auditing Journal

Hylas, E. R. & Ashton H. R. (1982), Audit Detection of Financial statement Errors, The Accounting Review, Vol. L VII, No.4 .

Khaddash.A.H, Nawas.A.R and Ramadan.A. (2013). Factors affecting the quality of Auditing: The Case of Jordanian Commercial Banks. International Journal of Business and Social Science, Vol 4,, 211. Retrieved 10 26, 2014, from http://www.ijbssnet.com/journals/Vol_4_No_11_September_2013/20.pdf

Langli Ch, J., Svanstom.T., (2013) "Audits of private firms" Norwegian Bussines School-Working papër January 2013.

Larcker.F.D and Tayan.B. (2011). Financial Reporting and External Audit. Retrieved 11 07, 2014, from file:///C:/Users/Az-Tech/Downloads/10.Audit_.pdf

McLennan.A., Park. I., 2004, The market for Liars: Reputation and Auditor Honesty, university of Bristol, UK

Moizer.P. (1997). Auditor Reputation: the International Empirical Evidence. International Journal of Auditing, 1, 72.

Moradi. M at al. (2011, 04 18). The effect of qualified audit report on share prices and returns. African Journal of Business Management, vol.5 (8), 1. Retrieved 10 24, 2014, from http://www.academicjournals.org/article/article1380880409_Moradi%20et%20al%204.pdf

PWC. (2011, July). Investor view. Insight from the investment community . Retrieved 11 08, 2014, from http://www.pwc.com/en_GX/gx/audit-services/corporate-reporting/publications/investor-view/pdf/pwc-changes-investors-would-like-to-see-in-an-audit.pdf

Qualiy, Center for Audit. (2012). A Guide to Pcaob Inspections. Washington. Retrieved 10 16, 2014

Shelton, W. S. & Whittington O. R. (2008) The influence of the auditor's report on investitors' evaluation after the Sarbanes-Oxley Act, Managerial Auditing Journal

Shelton, W. S. & Whittington O. R. (2008) The influence of the auditor's report on investitors' evaluation after the Sarbanes-Oxley Act, Managerial Auditing Journal

The Institute of Chartered Accountants in Australia, A. U. (2008). The role and function of external auditors. Australia : Chartered Accountants Auditing & Assurance Handbook 2008

ROLI I ARSIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK, NË RRITJEN E BASHKËPUNIMIT RAJONAL DHE TË INTEGRIMIT EVROPIAN

EDUKIMI UNIVERSITAR, SIPERMARRJA DHE VLERA E STOKUT TE KAPITALIT NJEREZOR NE SHQIPERI

Niko Pano
Logos University, Tirana
Ira Zoga (Gjika)
Mediterranean Universitety, Tirana
iragjika@yahoo.com

ABSTRACT

The study intends to argue the neccessity and the primary role of the "university market" in development of a new entrepreneurs' generation. It is analysing the reasons and factors why the 'entrepreneur' image is not becoming (yet) the model of Albanian students, why only a few students from Albanian univeristies have 'the dream' to become entrepreneurs.
The interaction of university market with the economic development of a country is closely related to the work market and its limits, as well as to the entrepreneur activity, that is going to develop in an open and increasing market. The development of 'personal capitalism' and companies without employees is supporting more and more this conclusion.
The value of human capital stock concept is the new parameter this study is trying to inlcude and integrate in the relationship between education and economic development. There are efforts done to indirectly calculate the intellectual investment in Albania (value of Albanians human capital) and how it can be transformed into a national wellth. The main finding of the research study is that innovation, from its origin, is closer to the university, in the economic field as well. At the same time the university is the best instrument to transform the knowledge in ideas, which will generate more money.

Keywords: *'university market' 'value of human capital stock', 'Start-up', 'spin-off', "business ecosystem in the learning proces' and "Laboratories of busines".*

HYRJE

Gjithe perpjekjet e paleve te interesuara per te modernizuar "Tregun Universitar Shqiptar" fokusoheshin ne pershtatjen e dijeve me nevojat e tregut te punes gje qe solli ndryshime te rendesishme jo vetem te programeve mesimore por dhe te politikave te rekrutimit te studenteve. Pas lulezimit te universiteteve private u duk qarte se lidhja e shkolles me tregun e punes eshte e rendesishme, por e rendesishme eshte njekohesisht edhe lidhja e shkolles me sipermarrjen. Kjo per faktin se dhe ne "Tregun Universitar Boteror u pranua nga te gjithe qe tregu i punes dhe ne zhvillimet e tij me te mira eshte i limituar dhe gjithmone i dominuar nga nje papunesi e vullnetshme qe objektivisht percakton limitin e tij. Filloi keshtu nje politike e re universitare, ajo e stimulimit te figures se sipermarresit qe ne bankat e shkolles duke stimuluar nje treg qe nuk njeh limite, "Tregu i Sipermarrjes". Kjo beri te rianalizohen koncepte te studiuara me pare pa sukses si ai i kapitalizmit personal, shoqerive pa punetore, punesime me fature, etj., forma keto qe e ndertojne sipermarrjen mbi bazen e personit brenda sistemit.

Kapitalizmi personal baze e figures se sipermaresit.

Koncepti 'kapitalizem personal' i futur ne literaturen ekonomike te 50 vjecarit te fundit eshte nje togfjalesh qe shpreh ne vetvete nje unitet kontradiktor shume here te debatuar ne vizionin ekonomik te literatures klasike te kesaj shkence. Ne fakt nga dy konceptet qe ne vetvete shprehnin "kontradikten" midis kapitalit (parase) dhe personit (punes) kemi kaluar ne nje te vetem, ate te pageses se produktit te punes. Imagjinoni sa i ofenduar do te ndjehej nje shkrimtar sikur te paguhej per romanin e tij me nje vlere te barabarte me kohen e punes se nje daktilografisteje. Ai eshte me i ndergjegjshem se kushdo qe pagesa e tij do te jete ne funksion te suksesit ne treg te produktit dhe nuk do te perkoje me kohen e kryerjes se punes.

Sipermarrja, vecanarisht e biznesit te vogel, dalengadale dhe ne Shqiperi filloi te behet nje vlere shoqerore, nje burim zhvillimi e mireqenjeje dhe mbi te gjitha nje mjet integrimi dhe perkatesie sociale. Sipermaresi i vogel si punedhenes i vetvetes vuri ne dispozicion te aktivitetit te tij jo vetem punen, mundin,ankthin e ekzistences, por mbi te gjitha mori persiper riskun te shtoje ose te humbase ne cdo hap pasurine e tij duke krijuar dalengadale nje arkitekture te re jo vetem te tregut por dhe te ekonomise shqiptare.

Me te drejte lind pyetja: Çfare solli ne aspektin ekonomik dhe ne dinamiken e tregut kapitalizmi personal ne Shqiperi? Cilat jane tre dimensionet baze te tij ne aspektin social?

1. **Dimensioni i riskut**. Shperndarja e investimeve dhe e riskut ne nje pluralitet subjektesh qe investuan ne idete e tyre mbi bazen e mundesive intelektuale, njohese dhe ekzisteciale qe kishin. Keshtu risku zevendesoi dalengadale pasigurine, rriti veprimin dhe trasformoi menyren e jeteses se atyre qe "dashurine per punen e tyre" –sipermarrjen - e kthyen ne momente jo te rralla lumturie.
2. **Dimensioni i pavaresise (autonomise).** Levizshmeria e ideve, energjive dhe kapaciteteve intelektuale te njerezve, te cilet si sipermares u bene burimi kryesor i zhvillimit dhe i rritjes se pasurise, por te pavarur, ne nje sistem te lire. Shume prej tyre kuptuan se nuk duhet te paguheshin per kohen e punes por per produktin e prodhuar.
3. **Dimensioni i njohjes, i kompentencave, i dijes**. Krijimi i lidhjeve midis subjekteve ekonomike, qe te mbeshtetura mbi besimin nga njera ane dhe konkurencen nga ana tjeter, u munduan te pozicionoheshin ne segmente te vecante te tregut duke krijuar nje ekuiliber te pergjithshem ku secili mundohej te bente me te miren ne ate qe shiste dhe te blinte me lire ate qe i duhej. Por ky person shpejt kuptoi qe risku pa dijet ishte humbje dhe se zhvillimi i biznesit detyrimisht duhej te shoqerohej me rritjen e vazhdueshme te njohurive dhe se kjo do te kerkonte nje "edukim te vazhdueshem".

Ne kete menyre ne pak vjet edhe ne Shqiperi "Personi" u be "Sipermarrje" dhe pa dashur u trasformua ne SIPERMARRES, figure kjo pak e vleresuar dhe e nderuar ne tregun shqiptar. Eshte detyra e te gjitheve, e sipermarresve ne rradhe te pare, e pedagogeve ne rradhe te dyte dhe e te gjithe atyre qe mbrojne mendimin intelektual progresiv te ketij vendi t'i japim kesaj shtrese rendesine qe ka ne ndryshimin e nje vendi. Zhvillimi si procesi me i domosdoshem i rritjes ekonomike nuk u realizua vetem nga zgjerimi i investimeve (publike dhe private), nga zmadhimi i konsumit dhe rritja e punezenies, por u realizua ne radhe te pare sepse nje grup njerezish pranuan te riskojne ate qe kishin, pranuan te marin persiper detyren qe ti ofrojne te tjereve ate qe ata e kane nevoje, pranuan te behen sipermarres.

Edukimi dhe sipermarrja

Shume do te thone qe sipermarres lind dhe nuk behesh, por asnje nuk thote dot se sa nga foshnjat e nje materniteti te lindur vitin e kaluar do te behen sipermarres. Shume te tjere thone qe sipermarres nuk behesh nga shkolla, nuk ka universitet qe ta meson kete "zanat", por pothuajse te gjithe pranojne se lendet qe mesojme neper universitetettona jane te domosdoshme per biznesin. Ku qendron e verteta? Sa ndikojne universitetet ne krijimin e klases se re te sipermarresve? Sa mund te lidhet sipermarrja e bizneseve te reja me sistemin e "edukumit universitar"?

Nuk mund t'ju pergjigjemi me saktesi te gjitha pyetjeve te mesiperme por mund te perpiqemi te kuptojme si ndikon "edukimi universitar" ne krijimin e kesaj shtrese dhe si mund te ndihmoje ai ne rritjen ekonomike me ane te krijimit te bizneseve te reja. Le te ndalemi keshtu ne tre momente kryesore:

1. Si mund te kuptojme me mire oportunitetin (mundesite) e sipermarrjes?

Mundesia e sipermarrjes krijohet ne momentin qe nje produkt, sherbim, lende e pare teknollogji, metode organizative etj mund te shitet me shtrenjte se kostoja e saj. Pavaresisht se ky fakt mund te kushtezohet nga faktore te ndryshem, te gjithe jemi te bindur qe nje ndryshim (ne kuptimin evolutiv) gjeneron nje mundesi per te cilen na duhen informacione te caktuara, analiza sa me te hollesishme, metoda studimi shkencore, eksperimente etj. Cili organizem me mire se universiteti, qe vazhdimisht ka informacionet me te fundit, qe perdor metodat me te perparuara studimore, qe eshte gjithmone me afer eksprimentimit mund te perceptoje me mire faktin se **kur, si,** dhe **perse** lind nje (oportunitet) mundesie re per tu shfrytezuar.

2. Perse disa e shfrytezojme me shpejt dhe me mire nje mundesite re?

Pranohet nga te gjithe se nje nga faktoret kryesore te shfrytezimit te nje mundesie te re eshte marrja sa me e shpejte e nje informacioni. Ne nje kohe dixhitale si kjo e sotmja informacionet qarkullojne shpejt, vertetesia e tyre mesohet kollaj dhe perpunimi i tyre eshte masiv. Por informacionet si te dhena primare ne vetvete nuk mjaftojne per te shfrytezuar ne maksimun nje te dhene. Duhen aftesi deduktive dhe induktive per vleresimin dhe shfrytezimin e tyre. Duhen analiza, metoda studimi, eksperimentime. Cili organizem me mire se universiteti, do te na ofronte elementet e domosdoshem per te shfrytezuar, perpunuar dhe realizuar nje mundesi te re qe lind nga nje informacion i ri.

3. Nga se varet shfrytezimi i nje mundesie te re? I kemi potencialet per ta realizuar nje gje te tille?

Shfrytezimi i nje mundesie te re ekonomikisht varet nga nga fakti qe vlera e pritshme e fitimit duhet te jete me e madhe se kostoja e oportunitetit. Nuk

besoj se ka nje strukture me te mire se universiteti qe ofron specialiste dhe njohes te tregut, analiste dhe studiues te financimit, marketere dhe inxhinjere te produktit dmth aftesi intelektuale dhe shkencore te domosdoshme per te shfrytezuar nje oportunitet. Ekzistojne pra potencialisht ne universitet te gjitha kapacitetet e nevojshme per te bere kete gje, por shpesh here keto kapacitete nuk shfrytezohen ne menyre efektive. Ne autopsine e "edukimit universitar" shume studjues, dhe jo vetem shqiptare, pranojne se studentet nuk stimulohen sa duhet te zhvillojne frymen e sipermarrjes. Mungon tek ta mbi te gjitha edukimi i nevojshem psikologjik qe te marrin vendimin per tu bere subjekte te nje tregu dhe jo thjesht objekte te tij qe ofrojne punen ne kembim te pages. Nuk mohohet ne asnje rast domosdoshmeria e pershtatjes se nevojave te tregut te punes me edukimin universitar por krahas kesaj duhet ti jeper rendesi dhe krijimit te shpirtit te sipermarrjes.

Shume pak neper universitetet tona analizohet figura e sipermarresit, por, dhe procesi i sipermarrjes si nje rrugetim ekonomiko-psikologjik qe fillon nga perceptimi i riskut deri tek ndermarrja e veprimit konkret. Jo me kot edhe universitetet prej kohesh kane ndare konceptet e "intrapreneur" me "entrepreneur" si dhe format dhe metodat e stimulimit te tyre. Siç u theksua dhe më lart, sipërmarrësi mund të përkufizohet si një individ i cili arrin të identifikojë dhe të përdorë në favor të tij një mundësi apo oportunitet që i ofrohet.Ky përkufizim përkon me termin "entrepreneur" në anglisht. Ndërsa "intrapreneurship" është një proces nëpërmjet të cilit në një strukture ekzistuese, Universitet, Laborator Biznesi etj. mund të implementohen sisteme apo praktika novatore, nëpërmjet përdorimit më efektiv të atyre burimeve të cilat më parë nuk ishin përdorur.

Pra në ndryshim nga "entrepreneur", nje "intrapreneur" vepron tashmë i konsoliduar me protokolle te caktuara si ne tregun universitar edhe ne tregun institucional, duke u bere nje tendence e re per te gjithe subjektet e tregut.

Te shumta jane debatet per rolin e universiteteve ne zhvillimin ekonomik por i vetmi fakt i pa mohueshem eshte detyra qe cdo qeveri e re ne cdo vend te botes i ve vetes per reforminin e sistemit shkollor. Rritja e qendrueshme ekonomike fillon gjithmone nga shkolla, dhe jo rastesisht vendet e Evropes Juglindore qe po kalojne nje nga krizat me te renda te pasluftes kane si objektiv paresor dhe te domosdoshem riforminin e "edukimit universitar".Aktualisht dhe ne Shqiperi,sugjerohet ne mase, se politikat e ardhshme te "edukimit universitar" duhet te kapercejne rikualifikimin e vazhdueshem te burimeve njerezore ne pershtatje vetem me tregun e punes dhe duhet te perqendrohen ne nxitjen dhe hapjen e bizneseve te reja. Koha tregoi se kapitali (paraja) nuk eshte me kushti

kryesor i domosdoshem per te ndermare nje sipermarrje dhe se vlen me shume nje ide-biznesi se sa nje "thes me para".

Polikika e startup-ve dhe roli i universiteteve.

Po te shikojme analitikisht disa nga te dhenat e zhvillimit te Ekonomise Shqiptare ne 5 vjecarin e fundit mund te themi se rritja ekonomike u stimulua kryesisht, nga njera ane si pasoje e liberalizimit te vazhdueshem te pjeseve kryesore te tregut dhe nga ana tjeter, nga investime publike per zhvillimin e domosdoshem te infrastruktures. Kjo politike e shoqeruar me nje presion fiskal te ulet pati si rezultatin e saj me pozitiv rritme relativisht te larte te produktit te brendshem bruto, thithjen e investimeve te huaja dhe nje stabilitet real ne kembimet valutore. Por sic e dime te gjithe, ne ekonomi cdo e mire ka dhe nje te keqe e cila shpesh here eshte e kushtezuar dhe nga faktore te pa kontrolluar. Ne situata te caktuara te tregut nderkombetar evidentohen probleme te natyrave te ndryshme sidomos gjate periudheve te ndryshimit te pushteteve. Aktualisht gjendemi ne kete situate ekonomike:

- Deficit buxhetor dhe borxh publik qe nuk lejon investimeve te medha publike
- Rrenie e ritmeve te rritjes me presion ne tregun e punes sidomos te te rinjve
- Rritje te presionit fiskal dhe ulje e investimeve te huaja direkte dhe indirekte.
- Domosdoshmeri e riformatimit te politikave pensionale, shendetsore dhe arsimore me qellim uljen e shpenzimeve.
- Frenin i ritmeve te kreditimit me shtimin e kredive te pa paguara ose pjeserisht te pa shlyera.


Ne keto kushte ekonomia shqiptare do te kete veshtiresi te zhvillohet nga investimet publike (treguesit e nivelit te borxhit flasin qarte per kete), nuk mund te stimulohet nga rritja e konsumit, nuk mund te zhvillohet nga investimet e huaja, pra duhet te gjeje rruge te reja zhvillimi. Nder politikat e shumta, do te donim te ndaleshim ne stimulimin e startup-it universitar si nje mjet i sukseshem jo vetem ne riformatimin e ekonomise dhe nxitjes se punezenies por dhe ne transformimin e "edukimit universitar".

Pa u ndalur gjate ne konceptin ekonomik te startup-it duam te theksojme se pas viteve 2005 kjo politike u konsiderua si rruga me e suksesshme e hapjes se

bizneseve te reja, sidomos per grupmoshat 24-36 vjec. Ishte nje nga politikat me efikase ne uljen e papunesise ne shtresat e arsimuara te ketij brezi. E konceptuar ne bashkepunim me universitetet dhe pushtetin lokal politika e startup-it evidentoi shembuj te sukseshem zhvillimi si ai i bashkise se Amsterdamit dhe te Berlinit ne administrim lokal ose ai i Universitetit te Brightonit (Centre for Entrepreneurs – UK) ne edukimin universitar. Ne rastet e para hapja e bizneseve te reja ne dy kryeqytetet ishte 4 here me e madhe se mesatarja e vendit ndersa per universitetin per here te pare te ardhurat nga shitja e kuotave te pejsmarrjes ne startup dhe e patentave te certifikuara ishte me e madhe se te ardhurat nga pagesat universitare.

Po a mund te perdoren keto politika edhe ne universitetet shqiptare? Mund ato te rrisin efektivitetin e "edukimit universitar"? Pergjigjja jone do te ishte: PO. Ato kane strukturat, kane njerezit, kane te gjitha mjetet dhe eksperiencat nevojshme per te realizuar laboratore te vertete biznesi. Per te vertetuar kete do ti kthehemi stadeve te krijimit te nje biznesi dhe do te mundohemi te vertetojme se nuk ekziston nje strukture me e mire se universiteti per ti realizuar ato.

Ne konceptin klasik te krijimit te nje biznesi mund te analizojme 5 stade zhvillimi:



Po ti shikojme me kujdes 5 hapat klasike te ciklit te jetes se nje biznesi do te veme re qe 3 prej tyre mund te realizohen cilesisht shume mire nen kujdesin e universiteteve dhe dy shume mire nen keshillimin dhe mbikqyrjen reale te tyre.

Kush me mire se nje ekip universitar mund te realizoje keto 5 stade dhe me shume te testoje sipas procedurave me shkencore 10 hapat e propabilitetit

te suksesit te nje ideje biznesi. Kush me mire se nje ekip universitar mund te ndertoje nje biznesplan te plote per financim dhe cili universitet nuk posedon kapacitetet intelektuale per te organizuar dhe drejtuar nje start-up.

Cfare mugon atehere?

1. Dalja nga e ashtuquajtura "zone e konfortit" ose ne thjesht te bejme dicka me shume se shpjegimi, kontrolli dhe keshillimi studentor. Universitetet nga natyra e tyre kane mundesine me te mire te marrin informacionet rajonale te perparesive konkurenciale sepse kane studente nga te gjitha rrethet e vendit. Eshte e gabuar qe Startup-i te konsiderohet vetem biznes i teknologjive te reja sepse ka shembuj te shumte qe ai mbi te gjitha eshte shfrytezim i potencialeve qe nje vend ose krahine ofron. "Mrizi i zanave" eshte shembulli shqiptar me tipik i ketij zhvillimi.
2. Stimulimi i "laboratoreve te biznesit" eshte ndoshta mjeti me i perdorur nga shume universitete europiane per te stimuluar sipermarrjen dhe vecanarisht sipermarrjen e te rinjve. Ato ofrojne fasilitete te rendesishme sidomos ne fazen e pare te krijimit dhe me konkretisht:
    - Vendin ku mund te debatohen, testohen, diskutohen dhe parafabrikohen shume ide biznesi ne shume fusha qe nga aplikimet ne rrjet deri ne metodat e reja te shfrytezimit minerar. Ne nje universitet perqendrohen kapacitetet me te mira te nje vendi, ne moshen me pjellore te tyre duke sjelle me vete secili nje eksperience dhe nje enderr. Veshtire te gjesh nje vend tjeter me nje koncentrim te tille endrrash dhe idesh.
    - Nuk ka fushe te tregut dhe ekonomise qe nuk studijohet nga universitetet shqiptare. Aty mund te gjejme pergjigjen dhe ndihmesen e duhur ne fushen e kontabilitetit financiar, aplikimit per financim te nje projekti, automatizimit, informatikes, trajnimet profesionale dhe manaxhimit operativ.
    - Ne universitetet tona gjenden njerezit me te specializuar per koordinim te pejseve te vecanta te cdo projekti si studim individual ose ne grupduke krijuarpatenta dhe modele te cilat mund te certifikohen lehtesisht. Sot format ne te vlefshme te aplikimeve jane patentat e certifikuara dhe shume banka i pranojne ato si kolateral financimi. Jane njekohesisht shume shoqeri qe interesohen per blerjen dhe fianancimin e tyre.
    - Univesitetet per autoritetin qe kane mund te sherbejne si partnere te

besushem sidomos ne fazen e financimit te nje projekti start-up si ne raport me bankat e nivelit te dyte ashtu dhe ne raport me te ashtuquajturit "angel investitors" sepse te gjithe e dime se financim do te thote besim dhe ne opinionin shqiptar (sipas anketimeve) universitetet besohen me shume se sa institucionet politike dhe sistemi gjygjesor.

- Kush me mire se nje universitet mund ti ofroje shoqerive te medha produkte te reja, metoda drejtimi bashkohore duke u bere nje partner strategjik ne zhvillimin e tyre. Ristrukturimi dhe diversifikimi i cdo aktiviteti ne prag te krizes eshte me pak i dhimshem kur eshte mire i planifikuar.Sot ne bote pothuajse te gjitha parqet teknologjike jane ndertuar prane ose brenda nje universiteti dhe "edukimi universitar" eshte konsideruar nga te gjithe mjeti me i mire per ta transfomuar nje aktivitet lokal ne nje veprimtari globale.

Keto dhe shume elemente te tjere i bejne laboratoret e biznesit nje institucion te domosdoshem dhe pjese te pandare te universiteteve ne perpjekjen per te evoluar "edukimin universitar".

3. Perqendrimi ne kerkimin aplikativ eshte nje drejtim tjeter qe duhet stimuluar ne "edukimin universitar". Jemi nje vend me potencial numerik te limituar dhe kjo mund te veshtiresoje zhvillimin teorik te nje problemi por shume mire mund te ofroje zgjidhje aplikative te problemeve egzistuese. Rralle here institucionet publike shqiptare kane kerkuar nga universitetet adaptimin e sistemeve aplikative si per shembull: perdorimin e kartes se shendetit ne njesite e kujdesit shendetesor primar, ne nje kohe qe shteti financoi pafund konsulenca per ta realizuar ate nga subjekte te huaj. Eshte detyre e universiteteve nga ana tjeter t'i ofrojne politikes studime per financim me qellime aplikative, sepse ne shume raste i njohin problemet me mire se politika dhe mund te gjejne zgjidhje shume me ekonomike se ato te metodave te importuara nga konsulencat e huaja.

Se fundi koncepti i shume diskutuar i efektivitetit te "edukimit universitar" duhet pare brenda ekuilibrit te nje tregu universitar, ku pjesa private e tij vepron e shkeputur nga pjesa publike duke krijuar keshtu dy metra vleresimi dhe dy stacione ne rrugetim. Prandaj kur flasim per efektivitet te "investimit universitar"fatkeqesisht jo gjithmone llogarisim sakte shpenzimet shoqerore per te. Kjo na veshtireson dhe me shume perllogaritjen per vleresimin e stokut te"kapacitetit intelektual" te shqiptareve pranuar nga te gjithe si nje element i rendesishem i forces se zhvillimit te nje shoqerie.

"Tregu Universitar" dhe vleresimi i stokut te "kapitalit njerezor" ne Shqiperi.

Pasoje direkte e gjithe procesit te edukimit universitar eshte ndikimi i tij ne zhvillimin e qendrueshem ekonomik te nje vendi. Nder indikatoret me te rinj qe percaktojne potencialitetin e zhvillimit te nje ekonomie eshte dhe "vlera e stokut te kapitalit njerezor". Jane te shumta rekomandimet qe ky tregues dalengadale te konsiderohet si tregues i rendesishem i statistikes kombetare te nje vendi pikerisht per faktin se perllogarit nje tendece potenciale zhvillimi ne kohe.

Koncepti i kapitalit njerezor eshte i lashte ne teorine e mendimit ekonomik por vleresimi numerik i tij eshte futur ne njezet vjecarin e fundit. Mori rendesi sidomos pas viteve 2000 kur u klasifikua zyrtarisht si nje tregues jo vetem i zhvillimit ekonomik por dhe i mireqenies shoqerore. Ne teresine e perkufizimeve te ketij koncepti mund t'i permbahemi percaktimit te bere nga Organizata per Bashkepunimin dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) ne traktatin e vitit 2001, fq 18 qe e percakton keshtu:

"Kapitali njerezor konsiderohet teresia e dijeve, mundesive dhe kompetencave individuale te njeriut, qe ndikojne ne krijimin e mireqenies personale, shoqerore dhe ekonomike te tij."

Ne pamje te pare duket sikur kapitali njerezor eshte produkt i vetive individuale dhe genetike te njeriut por te gjitha analizat vertetojne se ne nje fare menyre ai nuk eshte vetem element gjenetik por njekohesisht dhe prodhim shoqeror qe si te gjitha format e kapitalit akumulohet dhe rritet nepermjet arsimimit dhe formimit profesional. Eshte pikerisht ky tipar qe e lidh kete koncept ne radhe te pare me edukimin ne pergjithesi dhe sidomos me "edukimin universitar" ne vecanti. Sot shume ekonomiste kur analizojne faktoret dhe mundesite e zhvillimit te nje vendi pervec elementeve te tjere qe analizojne, nje vend te rendesishem i dedikojne ketij koncepti, prandaj shume organizata nderkombetare kane percaktuar forma dhe protokolle te perllogaritjes se tij. Kjo beri qe Banka Boterore ne vitin 2006 per here te pare percaktoi kater metoda te perllogaritjes se vleres se kapitalit njerezor dhe me konkretisht:

- Perllogaritja mbeshtetur ne koston e arsimimit. (cost-based)
- Perllogaritja ne baze te aftesise per te krijuar te ardhura. (income-based)
- Perllogaritja ne baze te efektivitetit te procesit te edukimit (gjithe shkallet)
- Perllogaritja ne baze te kostos se rritjes, edukimit dhe shkollimit te femijeve nga 0- 26 vjec.

Pas vitit 2008 shume vende ndertuan edhe struktura te vecanta shteterore per te llogaritur vleren e kapitalit njerezor dhe te gjithe pranuan me ndryshime te vogla protokollin e ashtuquajtur Jorgenson-Fraumeni (njihet si metoda J-F) qe eshte nje perllogaritje me analitike e metodes se te ardhurave te krijuara nga njeriu per gjate gjithe viteve te punes ne vlere aktuale (full labor compensation). Per te kuptuar me mire kete metodike duhet te kemi parasysh keto elemente kyesore:

1. Ne perllogaritjen e ciklit jetesor te nje personi ne aspektin metodik te studimit duke marre parasysh qe mosha e pensionit percaktohet me ligj, popullsine si vlere te stokut te kapitalit njerezor e klasifikojme si me poshte
   - Grup mosha nga 0-4 vjec ku mungon shkolla dhe punesimi
   - Grup mosha nga 4-15 vjec ku ekziston vetem shkolla
   - Grup mosha nga 16-40 ku ekziston shkolla dhe puna
   - Grup mosha nga 40- 67 ku ekziston vetem puna
   - Grup mosha mbi 68 ku ekziston vetem pensioni
2. Grup moshat e mesiperme klasifikohen si mosha qe pershkojne kohen e jetes brenda tregut te punes, dhe kohen e jetes jashte tregut te punes. Meqenese grupi i pare dhe i dyte jane jashte tregut te punes dhe nuk krijojne te ardhura perllogaritja e vleres se stokut te kapitalit njerezor eshte e pamundur me metoden e te ardhurave. Prandaj pranohet se si perllogaritje direkte e vleres se stokut te kapitalit merret grup mosha 16-67 dhe mbi 67 si te ardhura nga pensionet.
3. Per te perafruar me shume perllogaritjet ne aspektin metodik te formulave te perdorura eshte e drejte te ndajme grup moshen 16-40 nga 40-67 sepse e para ka shkolle dhe pune dhe e dyta vetem pune. Kjo ben qe te kemi dy algoritma te ndryshme per keto grup mosha dhe dy rezultate te ndryshme ne aspektin e vleres.
4. Te gjitha algoritmet e perdorura ne vleresimin e stokut te kapitalit njerezor jane te sistemit zbrites nga niveli me i larte. Me konkretisht per nje person 75 vjecar (kehezgjatja e jetes mesatere) te ardhurat e vitit te 75-te te jetes ne vitin kalendarik 2012 jane A ndersa ato per vitin 2013 (viti i ardhshem) jane te barabarta me zero. Per nje 74 vecar te ardhurat e ardhshme per viti 2013 jane A ndersa te vitit 2012 jane B. Per nje 73 vjecar te ardhurat per dy vitet e ardhshme jane A+B ndersa per vitin 2012 C. Me kete sistem te gjitha grupet me nje nivel edukimi te njejte por me moshe te ndryshme kane nje vlere te individuale me te ardhurat reale te vitit present dhe nje vlere te ardhurash te ardhme te barabarte me njerezet me te medhenj te njejtit grup edukimit. Me konkretisht kjo paraqitet ne formulen qe vijon:

$$LIN_{age}^{edu} = EMR_{age}^{edu} * AIN_{age}^{edu} + SUR_{age+1} + LIN_{age+1}^{edu}\{(1+r)/(1+\delta)\}$$

LIN_{age}^{edu} - eshte vlera aktuale e te ardhuavenga puna, per individet me nivel arsimimi (edu), ne moshen (age) si shume e te ardhurave te pritshme te realizuara ne ciklin jetesor te punezenijes.

EMR_{age}^{edu} eshte niveli i punesimit te personave me nivel edukimi (edu) ne moshen (age)

AIN_{age}^{edu} eshte e adhura aktuale nga puna (si deklarate mbi te ardhurat) per individet me nivel arsimi (edu) ne moshen (age)

SUR_{age+1} eshte mundesia (propabiliteti) per te jetuar dhe nje vit me shume (age+1)

LIN_{age+1}^{edu} eshte vlera aktuale e te ardhuave nga puna, per nje individ me te njejtin nivel arsimimi por me moshe nje vit me shume.

r - eshte parashikimi i nivelit te rritjes vjetore te te ardhurave nga puna ne te ardhmen (ne terma reale), per nje person me keto karakteristika

δ eshte parashikimi i normes vjetore te inflacionit ne te ardhmen (ne terma reale).

Ne perllogaritjen e vleres se stokut te kapitalit njerezor ne aspektin e protokollit te matjes nuk vleresohen vetem te ardhurat qe krijohen nga koha e punes, por dhe te ardhurat qe krijohen nga shfrytezimi produktiv i kohes jashte pune (te ardhurat jashte tregut). Metodika ne kete rast eshte akoma me e nderlikuar dhe perllogaritet duke perdorur dy elemente te raportit page/te ardhura ne aktivitetet jashte tregut:

1. Metoda e kostove opportune (indirekt te matshe)
2. Metoda e kostove zevendesuse (krahasimisht te matshme)

Metoda e kostove oportune mbeshtetet ne parimin e vleresimit te shteses se rendimentit te kohes se punes (qe percakton te ardhura nga tregu) qe kushtezohet nga koha jo e punes (pushimi). Pranohet nga te gjithe p.sh.qe ushtrimet fizike (kohe jo pune) potencialisht ndikojne me nje shtese te rendimentit ne kohen e punes dhe ne vetete pavaresisht se per kete kohe pune nuk krijohen te ardhura direkte realizohen te ardhura shtese ne kohen e punes. Ne kete aspekt teorikisht mireqenia shendetesore (si vlere e kohes se pushimit) ne rastin me te keq eshte e barabarte ne vlere me shtesen e rendimentit te punes.

Metoda e kostove zevendesue mbeshtetet ne nje vleresim tjeter dhe konkretisht ne vleresimin e rezultatit te punes jashte tregut me koston e mundshme te realizimit te saj me nje subjekt te tregut qe ofron kete sherbim. Oret e punes qe nje person ben punet e shtepise mund te vleresohen me vleren e ores se punes te

nje ndihmese shtepiake ose vlera e kohes se punes qe nje njeri shpenzon per te bere rregullimin hidraulik ne nje defekti ne shtepi eshte e barabarte me koston e hidraulikut per kete defekt.

Te dy elementet e mesiperm kerkojne te dhena statistikore qe kane te bejne me perdorimin e kohes se lire gje kjo qe realizohet me anketime komplekse te mbeshtetura ne moshen, shkallen e studimit, seksin dhe karakteristika te tjera te popullsise. Pikerisht duke perdorur protokollet e mesiperme si dhe shume anketime e studime te profilizuara ne kete drejtim shume vende te zhvilluara kane percaktuar vleren e stokut te kapitalit njerezor ne nje periudhe te caktuar kohe.

Vlera e stokut te kapitalit njerezor ne Shqiperi

Vlera e stokut te kapitalit njerezor ne Shqiperi nuk eshte perllogaritur asnjehere sipas protokollit Jorgenson-Fraumeni dhe per zbatimin e matjes se ketij tregusi ka shume veshtiresi qe nuk lidhen vetem me algoritmat mates, por dhe me percaktimin e te dhenave qe duhen te perfshihen ne te. Ky fakt nuk lejon percaktimin e nje shifre te sakte si produkt i zbatimit te formules se vleresimit te te ardhurave te pritshme te nje shqiptari por nga te dhenat e vena ne dispozicion nga INSTAT-i mund te percaktojne me perafersi ecurine ne rritje te vleres se kapitalit njerezor ne vendin tone.

Elementet qe do te marrim parasysh ne perllogaritjet tona per te percaktuar vleren e stokut te kapitalit njerezor ne Shqiperi jane:

1. Niveli i shpenzimeve buxhetore per arsimin. Sic mund te shikohet ne tabelat ne vazhdim, shpenzimet buxhetore per arsimin zene rreth 3%. Ketu nuk jane pasqyruar shpenzimet e popullates per arsimin, qe fillojne nga kurset e gjuheve te huaja deri te universitetet private. Nese perfshijme edhe keto, shifra e percaktuar me lart eshte me e madhe. Vend te rendesishem gjithashtu ka dhe kualifikimi professional i popullates i realizuar nga individet ne momente te caktuara te ciklit te punes.
2. Niveli i sherbimit shendetesor dhe treguesit cilesor te jetes te popullates se nje vendi. Pavaresisht se treguesit cilesore te nivelit te jeteses jane te ndryshem ne aspektin pikesor ne thelb nje analize vlerore e tyre fotografon ne nje moment te caktuar edhe aspekte te vleres se kapitalit njerezor. Jo ralle reformat ne shendetesi synojne edhe ndertimin e treguesve statistikore te vleresimit te nivelit te ketij sherbimi.
3. Niveli i zhvillimit ekonomik dhe treguesit standart te vleresimit te tij.
4. Struktura e popullsise, mosha mesatare e saj dhe probabiliteti i zgjatjes se ciklit jetesor.

5. Politikat sociale dhe punesimit dhe krijimi i kushteve sa me lehtesuese ne lidhjen dhe konsolidimin e bizneseve te reja.

Duke mos qene ne gjendje te plotesojme te gjitha te dhenat e formules J-F per vleresimin e stokut te kapitalit njerezor jemi munduar qe te percaktojme nje vlere te tij ne Shqiperi ne menyre indirekte duke pranuar idene e konceptit se vlera percaktohet nga te ardhurat qe mund te prodhoje nje shqiptar gjate kohes se punes. Skema metodologjike e perdorur per arritjen e nje rezultati te perafert eshte ajo e *sistemeve te sigurimeve vullnetare* si skeme e vleres ne kohe te parase e korrigjuar me te dhenat e meposhtme:

1. Mosha mesatare e shqiptareve ne vitin 2011 eshte 35,25 vjec (INSTAT)
2. Mosha mesatare e pensionit 65 vjec
3. Kontributi vjetor si e ardhur mesatare vjetore per vitin 2011 eshte 437.784 leke dhe kjo shifer eshte mare me nje afat per 30 vjet.
4. Rritja mesatare vjetore e ekonomise shqiptare per 30 vitet e ardhshem 1,3%
5. Perqindja mesatare e inflacionit per 30 vitet e ardhshem 2,8%
6. Interesi i bonove te thesarit afatgjate per 30 vitet e ardhshem 6,3%
7. Numri i njerezve ne marredhenie pune ne Shqiperi ne vitin 2011 ishte 928.000 vete
8. Numri i personave ne Shqiperi ne vitin 2011 ne moshen nga 14-65 vjec 1.847.000 vete

Percaktimi i kesaj skeme eshte bere per faktin se ne Shqiperi eshte shume e vershtire te percaktohen treguesit sasior direkt dhe indirekt mbi te cilet mund te zbatohet protokolli Jorgenson-Fraumeni ne konceptin zbrites. Ne kete aspekt jemi te vetedijshem qe rezultatet e kesaj perpjekjeje mund te kene kufizime si ne aspektin e percaktimit sasior ashtu dhe ne ate te ekuivalences se metodologjise. Megjithate si nje perpjekje e pare mendojme se ky rezultat do te nxise debatin ekonomik mbi rendesine e ketij treguesi dhe do te shtynte analiste te tjere ne permiresimin e perllogaritjes se tij.

Kufizimet metodike te kesaj llogaritjeje mund te permblidhen si me poshte:

1. Perllogaritja zbritese e algoritmit J&F merr vlera reale per grupmosha reale te klasifikuar ne nivele homogjene te nivelit shkollor. Perllogaritja jone merr nivele reale te ardhurash por jo te homogjenizuara ne aspektin shkollor.
2. Algoritmit J&F eshte zbrites, ndersa ai i perdorur ne metodiken tone eshte rrites me vertetesine e furmulave te percaktuara per vleren ne kohe te parase. Ne kete kuptim vlera reale e nje 65 vjecari eshte nje vlere e perllogaritur ne kohe me vleren e nje 35 vjecari per 30 vjet mbi bazen e nje mesatarizimi jo homogjen.
3. Algoritmit J&F ve ne sistem vlera reale te te ardhurave qe gjenden lehtesisht ne vendet perendimore nga deklaratat e te ardhurave personale, ndersa

sistemi yne ve ne qender pagen dhe jo te ardhurat. Ketu eshte i rendesishem dhe fakti qe per shkak dhe te ekonomise jo formale te ardhurat nuk jane te barabarta me pagat ose me sakte me pagat e deklaruara.

4. Ne Shqiperi nuk mund te shkonim me sistemin zbrites per faktin e ndryshimeve qe kane ndodhur per 25 vitet e fundit keshtu qe e ardhura e nje pensionisti nuk mund te ekuilibrohej me pagen e tij para 30 vjeteve. Eshte e pamundur te ekuivalentojme vlera materiale ne kohe dhe sisteme te ndryshme.

PERMBLEDHJE


Pavaresisht ketyre kufizimeve mendojme qe si perpjekje e pare per te perllogaritur indirekt kete tregues, do te ndihmoje studiues te tjere te realizojne studime me te sakta dhe mbi te gjitha do te evidentoje rendesine e tij si element baze i zhvillimit ekonomik te vendit tone.

Duke qene te vetedijshem per keto kufizime dhe pasaktesi mund me perafersi sipas metodes se sigurimeve vullnetare,te perllogarisim se "Vlera e stokut te kapitalit njerezor" ne Shqiperi per moshen 14-65 vjec eshte rreth **15.171.000** leke ose me kursin mesatar per vitin 2011 eshte **147.300** USD.

Theksojme se kjo vlere nuk i takon askujt nga ne, nuk ka emer dhe mbiemer, por i takon shqiptareve ne pergjithesi, pa i ndare ne te pasur dhe te varfer, as ne te ditur dhe te shkolluar, por vetem ne te lumtur dhe te deshperuar.

Ne te ardhmen, ne vazhdim te ketij studimi, mund te behen prerpjekje per te velersuar me saktesisht kontributin e kapitalit njerezor sipas niveleve te edukimit ne krijimin e vleres ne ekonomine e vendit. Kjo do ishte e dobishme per te orientuar politikat e arsimit dhe punesimit, duke u mbeshtetur ne vleren kapitalit njerezor te vendit.

Tab. 1 – Shpenzimet per arsimin ne Shqiperi



Burimi: Ministria e arsimit dhe sporteve

Tab. 2 - Nxenes dhe studente ne vitin 2011

Studente te regjistruar ne shkollen e larte ne vitin 2011 (B,M.Dok)	158,163
Nxënës të regjistruar në shkollat e mesme 2011	150,134
Nxënës të regjistruar në arsimin 9-vjecar sipas cikleve 2011	420,684
Totali	**728,981**

– Burimi: ***INSTAT*** *Të dhëna Administrative*

Tab. 3 - Krahasime ndërkombëtare: Grupmoshat përfshirë në arsim

Shteti / Country	**Sipas Nivelit Arsimor - By Level of Education**				
		cikli i ulët	**cikli i lartë**		
	Pre primary - 0	Primary 1	Lower Secondary 2	Upper Secondary 3	Tertiary 5+6
Shqipëri - Albania	79	103	102	92	60
Bullgari - Bulgaria	85	101	84	101	60
Republika Çeke - Czech- Republic	103	102	103	91	65
Slloveni - Slovenia	91	98	96	100	85
Austri - Austria	101	100	102	95	71
Belgjikë - Belgium	119	104	119	101	69
Hollandë - Netherlands	90	108	134	123	76
Norvegji - Norway	99	99	100	126	73
Suedi - Sweden	95	101	97	97	74
Zvicër - Switzerland	100	103	110	86	54
Angli dhe Irlanda e Veriut	85	107	111	88	61
Shtatet e Bashkuara - United States of America	73	99	98	89	95

Treguesi është llogaritur për të regjistruar në vitin 2011 për Shqipërinë dhe në vitin 2010 për vendet e tjera

Burimi i të dhënave përveç Shqipërisë : Instituti i Statistikave të UNESCO-s

***Tab. 4* - PAGA MESATARE MUJORE PËR NJË TË PUNËSUAR (SEKTORI PRIVAT DHE SHTETËROR)**

(Lek/ ALL)

Aktiviteti ekonomik	**2006**	**2007**	**2008**	**2009**	**2010**	**2011**	**2012**
Industri	21,950	24,735	32,214	32,837	33,273	35,746	36,994
Ndërtim	19,184	32,085	42,424	42,706	37,652	35,458	35,820
Transport e komunikacion	31,360	36,518	38,106	47,709	52,263	55,476	54,382
Tregti	20,677	27,301	32,217	34,959	31,179	32,962	33,705
Shërbime	19,869	23,636	28,073	30,197	28,819	31,819	34,165
E ponderuar mesatare						**39,013**	
E rillogaritur me terma real						**46,816**	

– Burimi: INSTAT *Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve 2000- 2012*

– Source: INSTAT*Annual Business Structural Survey 2000- 2012*

***Tab. 5* - PAGA MESATARE MUJORE SIPAS GRUP-PROFESIONEVE NË SEKTORIN SHTETËROR**

(në lekë)

Emërtimi	**2006**	**2007**	**2008**	**2009**	**2010**	**2011**	**2012**
Paga mesatare për :							
Ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtues	50,975	59,160	60,500	71,529	73,450	76,514	81,738
Specialistë	33,359	39,118	42,487	50,309	55,285	58,899	59,754
Teknikë dhe ndihmës specialistë	25,891	31,339	33,588	40,733	43,000	45,255	46,349
Nëpunës të thjeshtë	24,245	27,765	29,585	33,988	36,196	37,926	40,024
Punëtorë	21,332	23,932	25,129	31,453	33,799	35,950	36,138
Paga mesatare e ponderuar						**56,565**	

– Burimi: ***INSTAT*** *Të dhëna Administrative*

Tab. 6 - Rritja reale e pagës në sektorin shtetëror ne (%), 2000-2013

	2006	**2007**	**2008**	**2009**	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**
Ndryshimi vjetor i pagës mujore në sektorin shtetëror	7.5	17.1	8.3	11.9	6.7	6.9	7.3	4.1
Ndryshimi mesatar vjetor i çmimeve të konsumit	2.4	2.9	2.2	3.5	3.6	3.4	1.9	2.1
Ndryshimi i pagës reale	4.9	13.8	6	8.1	3	3.4	5.2	2
Rritje mesatare 2006-2011						**6.53**		

– Burimi: ***INSTAT*** *Të dhëna Administrative*

Tab. 7 – PBB dhe shpenzimet ne Shqiperi

Vitet	PBB ne md/ leke	Shpenzimet publike ne md/lek	Shpenzimet publike ndaj PBB ne %	Deficiti buxhetor ne ml/lek	Deficiti buxhetor ne %
2008	1,089,293	351,602	32.28%	60,254	5.53%
2009	1,148,082	379,862	33.09%	80,005	6.97%
2010	1,222,462	362,752	29.67%	38,031	3.11%
2011	1,282,255	376,351	29.35%	45,877	3.58%
2012	1,284,092	386,239	30.08%	46,856	3.65%
2013	1,307,206	409,408	31.32%	68,897	5.27%

Burimi: F.M.N.,Ministrise se Financave per te dhenat e vitit 2013 (shpenzimet)

Tab. 8 – Tregues mbi punesimin ne Shqiperi

Vitet	2009	2010	2011	2012
Te afte per pune	1,041,000	1,060,000	1,070,000	1,075,000
Te punesuar	899,000	917,000	928,000	933,000
Te papune te regjistruar	142,000	143,000	142,000	143,000
Ne perqidje	13.64%	13.49%	13.27%	13.30%

Burimi: INSTAT Niveli i papunesise sipas viteve

Tab. 9 - Vlera e stokut te kapitalit njerezor per disa nga vendet me te zhvilluara.

Shtetet	Produkti i mbrendshme bruto ne mld $	Popullsia Totale	Te ardhurat per fryme popullsise	Popullsia nga 14-64 vjec	Vlera e kapitalit nje-rezor ne $
Anglia 2009	2,840	65,000,000	43,692	42,900,000	692,000
Gjermania 2009	3,624	82,000,000	44,195	55,760,000	564,300
Amerika 2009	14,200	305,500,000	47,195	210,795,000	995,305
Franca 2010	2,831	63,000,000	44,936	42,210,000	529,676
Italia 2009	2,307	60,000,000	38,450	39,418,732	342,000

BIBLIOGRAFIA

Il ValoreMonetarioDello Stock di CapitaleUmano In Italia.Anni1998-2008. *Istituto Nazionale di Statistica.*

Gibson, J and Oxley, L(2006). A Forward-Looking Measure of the Stock of Human Capital in New Zealand. *The Manchester School*, Vol.74, No.5, 593-609.

Jorgenson, D.W. and B.M. Fraumeni (1989). The Accumulation of Human and Non-HumanCapital1948-1984 in R.E. Lipsey and H.S. Tice (eds.). The Measurement ofSavings, Investment, andWealth.*The University of Chicago Press*, Chicago.

Jorgenson, D.W and B.M. Fraumeni (1992a). The Output of Education Sector in Z.Griliches (ed.)Output Measurement in the Service Sectors*. The University of Chicago Press*, Chicago.

Jorgenson, D.W and B.M. Fraumeni (1992b). Investment in Education and U.S. Economic Growth. *Scandinavian Journal of Economics*, 94, Supplement, 51-70.

Li, H. (2010) Human Capital in China.*China Center for Human Capital and Labor Market Research, Central University of Finance and Economics*, Beijing. China, October 2011.

Liu, G. Measuring the stock of Human capital for comparative analysis: An application of the lifetime income approach to selected countries. *OECD Statistics Directorate Working papers*, n.41 (SDT/DOC 2011/6) Paris: OECD.

Mira d'Ercole, M. (2012). l progetto dell'Ocse sulla misura monetaria dello stock di capitaleumano.

Mulligan, C.B., X. Sala-i-Martin (1997). A labor-income-based measure of the value of human capital: an application to the States of the United States, Japan and World Economy. *Elsevier*, vol. 9

Nosvelli, M. (2009). La misurazione del capitale umano: una rassegna della letteratura. *Working (Liu,G. 2011) paper Ceris*-Cnr n.2/2009, Torino: Ceris.

O'Mahony, M., P.A. Stevens (2004). International Comparisons of Performance in the Provision of Public Services: Outcome Based Measures for Education. *London: National Institute of Economic and Social Research.*

O'Neill, D. (1995) Education and Income Growth: Implications for Cross-Country Inequality. *Journal of Political Economy,* 103, 1289-1301.

Psacharopoulos, G., A.M. Arriagada (1986). The educational composition of the labor-force.

Schultz, T. W. (1961). Investment in Human Capital. *The American Economic Review*, 51(1), 1-17.

REFORMIMI I ARSIMIT TË LARTË DHE ZHVILLIMI EKONOMIK

Skender Demaliaj
Mediterranean University of Albania
skender.demaliaj@umsh.edu.al

ABSTRACT

The implementation of a new mentality of education and knowledge - key to the economical and integration development. A much more educated nation will be translated into: higher level of economical development, higher civic culture, increase of confidence, satisfaction, competence, support for the democratization of the country. Economical development is inextricably linked to the country's industrialization, urbanization and poverty reduction, which is the main obstacle to the democratic development. Challenges and needs of higher education in Albania.

Keywords: *higher education, democratization, economic development, poverty, challenges.*

HYRJE

Udhëheqja e lartë shtetërore e Japonisë analizoi shkaqet e humbjes së Luftës së Dytë Botërore dhe përcaktoi strategjinë për zhvillimin e shpejtë ekonomik të vendit për të qenë një fuqi e madhe ekonomike rajonale dhe botërore. Ata arritën në përfundimin se në radhë të parë kemi nevojë për dituri, për institucione arsimore dhe kërkimore shkencore, të cilat do të realizonin e ndërtonin projekte madhore. Për t'u dhënë jetë këtyre projekteve dhe ambicjeve ishte e domosdoshme reforma në sistemin arsimor, veçanërisht në arsimin e lartë.

Reforma nënkupton ristrukturimin e gjithë sistemit të arsimit: qëllimin, kuadrin ligjor, institucionet, programet dhe sistemin e përzgjedhjes, financimin,

administrimin, vlerësimin, arsimimin dhe edukimin e mëtejshëm të personelit mësimor.

Studimet në ditët e sotme modelin e ri ekonomik e shohin pazgjidhshmërisht të lidhur me arsimin e lartë e në shërbim të njëri-tjetrit. SHBA, Japonia, Gjermania, Kina, India, Brazili etj.- janë shembujt më domethënës të këtij bashkëpunimi dhe ndërveprimi. Sipas Toni Bler *potenciali njerëzor është pasuria më e çmuar e një kombi*, kurse për Viktor Hygoin: *e ardhmja u takon dy tipave njerëzish, njeriut të mendimit dhe njeriut të punës, të cilët që të dy përbëjnë një tërësi të vetme, sepse të mendosh do të thotë të punosh* (Gazeta Telegraf, 2014).

1. **Një popull shumë më i arsimuar do të përkthehet:**
- **nivel më i lartë i zhvillimit ekonomik,**
- **sjellje e kulturës qytetare, rritje e besimit, kënaqësi, kompetencë,**
- **mbështetje për demokratizim,**
- **klasë e mesme më e madhe.**

Reformimi i modelit ekonomik kërkon edhe reformimin e arsimit të lartë. Politika për zhvillimin e arsimit të lartë ka të bëjë me qëndrimet apo raportet që duhet të mbajë shteti, shoqëria dhe familja ndaj arsimit, vendi që duhet t'i jepet në raport me sektorët e tjerë nga njëra anë dhe ç'kërkojnë ata prej tij, nga ana tjetër. Në këndvështrimin e zhvillimit të mendimit ekonomik shkollimi, krijimi i mentalitetit dhe i ideve të reja, aplikimi i teknologjive të reja, duhet jo vetëm të vihen në provë, por duhet te jenë pjesë e nxitjes së mendimit për të përqafuar vizionin dhe modelin e ri ekonomik. Inplementimi i mentalitetit të ri të shkollimit dhe të dijeve të tyre - janë një faktor i rëndësishëm për strategjinë e re rikonstruktuese te ekonomisë sonë, janë çelësi i suksesit të zhvillimit dhe integrimit. Është provuar tashmë se praktikat e vjetra me shumë vështirësi u lëshojnë vendin metodave të reja edhe kur kushtet bazë të punës prej kohësh kanë ndryshuar, kurse ata që punojnë atje nuk duan ose nuk janë në gjendje ta kuptojnë. Kështu ndodh edhe me një pjesë të pedagogëve e drejtuesve të shkollave të larta, prandaj ka vështirësi në reformimin e arsimit të lartë.

Arsimi për vetë specifikën është më shumë proces futurologjik, sesa bashkëkohor dhe si i tillë përmban objektivisht elementë të projeksionit. Po të mos ishte kështu nuk do të kishim përparim. Nga ky lajtmotiv duhet të udhëhiqemi në reformën arsimore, veçanërisht kur është fjala për arsimin e lartë. Reforma arsimore është e lidhur me nevojën për një kontribut të efektshëm në zhvillimin ekonomik të vendit, në zhvillimin demokratik të tij, për një ndikim më të madh në integrimin e ardhshëm europian të tij. Kthesa cilësore e shekullit XX në arsim

lidhet me dy elementë të rëndësishëm:

a) Ekonomia në prirje të arsimit u zvendësua me arsimin në prirje të ekonomisë.
b) Parashikimi për zhvillimin perspektiv të shoqërisë u mbështet në arsim.

Aq më të fuqishëm jamë këta dy elementë tani në shekullin XXI. Siç thekson Prof. Dr. Ermelinda Meksi *ekonomia shqiptare është një ekonomi që nuk e ka mbështetur zhvillimin në novacione teknologjike, por në politikat e stabilitetit makroekonomik, nga dërgesat e emirgantëve apo nga ekonomia informale. Por tani kemi një situatë tjetër ekonomike: dërgesat e emigrantëve kanë rënë dukshëm nga viti në vit dhe do të bien akoma më shumë në të ardhmen. Ekonomia informale nuk do të vazhdojë kështu, të ardhurat nga doganat do të bien me hyrjen ne BE, borxhi i jashtëm është rritur shumë dhe duhet paguar. Kështu një ditë do të gjendemi para një krize te thellë dhe të rrezikshme ekonomike. Cilësia në arsimin e lartë, futja e teknologjisë së re moderne do të jetë shpëtimi. E për këtë duhet të mendojmë shumë të gjithë dhe të veprojmë të gjithë së bashku shpejt. Koha kërkon që Shqipëria të përgatitet me shpejtësi për të kaluar nga forma aktuale e zhvillimit në një formë tjetër zhvillimi, e mbështëtur në burime njerëzore cilësore. Kjo kërkon rritjen e cilësisë në universitetet tona, kreditim real të tyre dhe të gjithë elementët që përcaktojnë cilësinë e universitetit* (Meksi, E.2009)

Përcaktimi i prioriteteve për zhvillimin e arsimit të lartë është domosdoshmëri për të realizuar me sukses këtë. Ish-Presidenti Klinton në Konventën e Demokratëve tha se Presidenti Obama "*do të krijojë vende të reja pune dhe shumë pasuri për njerëzit me ide të reja*" (Angjeli, A.2013). Idetë e reja lindin prej elitave. Elitat përgatiten dhe formohen në universitete.

Globalizmi ka ndryshuar mënyrën se si njerëzit duhet të mësojnë për biznesin, historinë, shoqërinë, gjuhën, psikologjinë, artin, gjeografinë, politikën dhe shkencën. Arsimimi ka një rëndësi të veçantë, pasi ai është kthyer në një investim dhe jo në një proces eksplorimi për të bërë jetën e fëmijëve më të begatë. Barack Obama në ditën e parë të shkollës (Arlington, Virginia), më 8 shtator 2009 iu drejtua nxënësve me fjalët: " *Çka ju bëni me shkollimin tuaj, do të vendosë as më shumë e as më pak të ardhmen e këtij vendi. Çka ju mësoni në shkollë sot, do të vendosë nëse ne, si komb, do të mund të përballemi me sfidat e së ardhmes*" (Gazeta Mësuesi. 2009).

Bota ku jetojmë po shndërohet me shpejtësi në një shoqëri informacioni, në një ekonomi të dijes dhe të teknologjive moderne. Nuk janë të pakta shtetet që kanë vendosur si përparësi futjen dhe integrimin në shoqërinë e informacionit

dhe në ekonominë e dijes, duke ndërtuar projekte të veçanta. Është koha që edhe ne të bëhemi pjesë e këtyre projekteve. Investimi në arsim është krejt i veçantë, është investim unikal, sepse është një investim në dije, në teknologji, në shkencë, "***investim i trurit***", investim i së ardhmes. Me të drejtë duhet shqetësohemi për "***ikjen e trurit***", për moskthimin e atyre që studiojnë e shkollohen në Perëndim. Arsyeja e vërtetë: në Shqipëri ata nuk gjejnë realitetin përkues me sistemin, në të cilin ata u formuan dhe u rritën, u përgatitën dhe u bënë të aftë të vijojnë në kushtet konkrete profesionin dhe ekspertizën. "***Ikja e trurit***", moskthimi i trurit dëmton shumë krijimin e elitave të reja politike dhe shtetërore. E pa këto elita nuk ka zhvillim të ekonomisë, demokratizim të jetës së vendit, ndërtim dhe funksionim të shtetit ligjor, një administratë në shërbim të qytetarëve. Nuk ka realisht integrim të sistemit tonë arsimor në atë europian që është synimi kryesor i arsimit tonë. Aq më shumë që rinia studentore është dhe mbetet promotor i këtij procesi. Kthimi dhe punësimi i studentëve që shkollohen në Perëndim rrit konkurencën e ndershme në tregun e punës, nxit dhe stimulon universitetet brenda vendit për reforma të thella, rrit përgjegjësitë e studentëve dhe të pedagogëve, të drejuesve të tyre. Rrit investimet dhe presionin për të gjetur burime financiare joshtetërore. Rrit konkurencën e universiteteve shtetërore me ato private. Mbi të gjitha rrit presionin pozitiv të opinionit publik, të familjes ndaj sistemit të arsimit tonë të lartë. Ofron një model, por edhe modelon shkollën tonë të lartë. Në vendin e parë për arsimin (sipas revistës "News Week") është Finlanda, në vendin e dytë Koreja e Jugut, e cila në vitet `60 të shekullit të kaluar ishte në nivelet e Afganistanit. Në shkollat e Koresë së Jugut u zhvilluan shkencat ekzakte. Parimi ishte që të shkollohet e të civilizohet popullsia fshatare që të aftësohet për të përdorur teknologjinë moderne. Sot ky vend eksporton në SHBA dhe në Evropë falë teknologjisë.

Në SHBA, mjekët dhe juristët pranohen në këto degë pasi kanë fituar një diplomë universitare në një degë, si rregull të përafërt me të. Kërkesat për përgatitjen e kuadrove të lartë janë të larta.

Të mësuarit nuk është qëllim në vetvete. Njeriu mëson që të jetë i denjë për respektin e të tjerëve. Pa respektin dhe bashkëpunimin e ndërsjelltë, pa konsensusin dhe tolerancën nuk mund të demokratizohet një shoqëri.

Një popull i arsimuar dhe me standard të lartë jetese nuk lejon shkeljen e të drejtave të individit. *Nuk ka mirëqënie shoqërore, nuk ka prosperitet shoqëror pa respektimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Standardi i tyre mund të arrihet vetëm duke zgjeruar dhe përforcuar demokracinë dhe duke zhvilluar individë me pavarësi të plotë shpirtërore dhe morale* (Pula, L. 1996).

Reformimi me sukses i arsimit të lartë ndihmon edhe në demokratizimin e komunikimeve individ-shoqëri, individ-pushtet. Sipas studimeve psikologjike "*Komunikimi, shpirti krijues në të gjitha format dhe bashkëpunimi mund ta largojnë dhunën dhe vuajtjen*" (Dolto, F. 1994)

Komunikimet e frytshme e aftësojnë studentin të dialogojë e të bashkëpunojë – kërkesa këto të mprehta të atmosferës së sotme sociale. Komunikimet e dendura dhe të suksesshme zhvillojnë dhe mbajnë gjallë frymën e dialogut. Sipas Xhon Djuit: "*Dështimet e mëdha të shoqërisë sonë në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar, janë kryesisht, rrjedhim i mungesës së dialogut, i paaftësisë për të kuptuar nevojat dhe aspiratat tona të papajtueshme*" (Djui, Xh. 1995).

Zhvillimi me ritme të larta të ekonomisë kërkon edhe rritjen e kujdesit, të vëmendjes dhe të fondeve për studentët e talentuar. Nuk mjaftojnë vetëm bursat për studentët ekselentë, por edhe bashkëpunimi i shkollës së lartë me koorporatat dhe bizneset vendase dhe të huaja.

Në Gjermani funksionon shërbimi profesional pedagogjik dhe psikologjik, i cili punon intensivisht për identifikimin, diagnostifikimin, prognozimin e zhvillimit dhe të aftësimit të potencialeve intelektuale të nxënësve dhe studentëve të talentuar. Në Rusi, për të zgjuarit dhe të talentuarit organizohen shkolla të specializuara, të cilat punojnë me programe të kodencuara (Shkolla e Moskës, e Peterburgut, e Novosimbiskut). Në Izrael zhvillohet programi i Jeruzalemit për nxënësit e zgjuar dhe të talentuar, program afatgjatë dhe që përfshin disa gjenerata. Po kështu në SHBA, Japoni e vende të tjera të zhvilluara.

Arsimi i lartë është një formë e rëndësishme e investimit në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe konsiderohet me të drejtë si "***motori i zhvillimit në ekonominë e re botërore***", është përcaktues, jo vetëm i një zhvillimi më të shpejtë dhe më të lartë ekonomik, por edhe më cilësor (përmes zhvillimit teknologjik, inovacionit dhe të reja të tjera të shkencës), është ndikues për rritjen e të ardhurave, përmirëson sistemin shëndetësor të një vendi, kontribuon në rritjen e reduktuar të popullsisë, përmirëson teknologjinë dhe forcon mirëqeverisjen. Kontributi i arsimit të lartë në nxitjen e rritjes ekonomike është i rëndësishëm, aq më shumë në periudha krize, si kjo që po kalon vendi ynë. Arsimi i lartë ndihmon në idustrializimin e shpejtë të ekonomisë, duke ofruar fuqi punëtore me aftësi profesionale, teknike dhe menaxheriale, bën ndryshimet e mundshme të qëndrimeve të nevojshme për socializimin e individëve dhe transformimin e modernizimit të përgjithshëm të shoqërive, ndihmon nëpërmjet mësimdhësies dhe kërkimit shkencor në tërheqjen, krijimin dhe përhapjen e dijes. Arsimi i lartë gjithashtu ndihmon në formimin e një shteti të fortë dhe në të njëjtën kohë bërjen

pjesë në procesin e gobalizmit. Zhvillimi ekonomik promovon rritjen e klasës së mesme. Demokracia ka si kusht paraprak në një farë mase sundimin e shumicës dhe ajo e ka të vështirë të zhvillohet në kushtet e pabarazive të mëdha, si rezultat i të cilave një masë e madhe të varfërish përballet me një oligarki të vogël të pasurish. Klasa e mesme është produkt i industrializimit dhe i rritjes ekonomike. Klasa e mesme luan një rol të rëndësishëm në demokratizimin e jetës së një vendi. Duke raportuar për demonstratat e vitit 1987 kundër regjimit autoritar të Chun-it në Seul, The Economist bënte pyetjen: *Çfarë ndodh kur gazi lotsjellës takohet me klasën e mesme në Seul? Përgjigja është e thjeshtë: gazi lotsjellës zhduket* (Etzioni, E. 2009).

Zhvillimi ekonomik e bën demokracinë të mundur, lidershipi politik e bën atë reale. Nëse duam që demokracitë të vijnë në jetë, elitat e ardhshme politike duhet që minimalisht të besojnë se demokracia është forma më pak e keqe e qeverisjes për shoqëritë e tyre dhe për ato vetë. *Ato duhet të kenë gjithashtu aftësinë për ta drejtuar tranzicionin drejt demokracisë, duke iu kundërvënë si radikalëve, ashtu dhe konservatorëve, të cilët do të ekzistojnë në mënyrë të pashmangshme dhe do të përpiqen në mënyrë këmbëngulëse që të minojnë përpjekjet e tyre* (Etzioni, E. 2009). Elitat përgatiten në shkollën e lartë. Është apo nuk është e aftë elita politike për t'i dalë zot fateve të vendit, është edhe në varësi të përgatitjes së saj që në shkollën e lartë.

Një klasë e mesme e gjerë luan rol zbutës në konfliktet moderne duke inkurajuar partitë demokratike dhe të moderuara dhe duke ndëshkuar grupet ekstremiste. Të ardhurat kombëtare janë të lidhura si me vlerat demokratike, ashtu edhe me mënyrën e jetesës së klasave të varfëra. *Sa më i varfër të jetë një vend dhe sa më i ulët të jetë standadi i jetesës së klasave të varfëra, aq më e madhe është trysnia mbi shtresat e larta për t'i trajtuar më të varfërit në mënyrë inferiore, si një kastë më e ulët* (Etzioni, E. 2009). *Niveli i lartë i mirëqënies ekonomike, shpërndarja relativisht e barabartë e të ardhurave dhe e pasurisë, ekonomia e tregut, një klasë e mesme e fuqishme, nivele të larta edukimi dhe arsimi, zhvillimi ekonomik dhe modernizimi social, zhvillimi i konkurimit politik para zgjerimit të pjesëmarrjes politike, konsensusi mbi vlerat politike dhe shoqërore, dëshira e elitës për t'u matur me kombet demokratike, nivele të ulëta të dhunës civile – janë disa nga variablat kryesore që kontribuojnë për demokracinë dhe demokratizimin e një vendi* (Huntington. P, S. 2011).

Sa më e arsimuar të jetë popullsia, aq më shumë shanse ka për demokracinë dhe të dhënat e vërtetojnë këtë. Vendet më demokratike të Evropës janë thuajse tërësisht të shkolluara. Më i fundit në klasifikim ka një shkollim të përgjithshëm

të popullsisë në masën 96%. Në Amerikën Latine, ndryshimi shkon mes një mesatareje prej 74% (vendet më pak diktatoriale) në 46% (vendet më shumë diktatoriale). *Shkolla e zgjeron botkuptimin e nxënësve dhe studentëve dhe u krijon atyre mëndësinë e kuptimit të nevojës për norma tolerance, i pengon ata të aderojnë në grupe ekstremiste dhe doktrina moniste dhe iu rrit aftësinë për të bërë zgjidhje të arsyeshme elektorale* (Etzioni, E. 2009). Qëllimi kryesor i arsimit në demokraci është që t'u japë njerëzve sa më shumë që të jetë e mundur mundësi zgjedhjeje për veten, mundësi zgjedhjeje për profesionin, për arsimin e lartë, për pjesëmarrjen në politikë e në qeverisje etj.

Varfëria është pengesa kryesore për zhvillimin demokratik. E ardhmja e demokracisë varet nga e ardhmja e zhvillimit ekonomik. Ky është një postulat tashmë i vërtetuar.

Kriza ekonomike, polarizimi politik dhe shoqëror, shkelja e ligjit, përjashtimi nga pushteti politik i grupeve dhe i klasave të ulëta – janë shkaqet kryesore për rikthimin e sistemeve politike autoritariste... Paaftësia e vazhdueshme për të siguruar mirëqënien, prosperitetin, barazinë, drejtësinë, rendin e brendshëm apo sigurinë e jashtme, mund të minojë me kalimin e kohës edhe legjitimitetin e qeverive demokratike (Huntington. P, S. 2011).

Ndër premtimet e socialistëve para ardhjes në pushtet ka qenë: buxhet për arsimin 5% të GDP pa asnjë kompromis. Në buxhetet e këtyre dy viteve nuk është mbajtur ky premtim. Pa para nuk ka punë kërkimore shkencore në shkollën e lartë, nuk ka studentë të shkëlqyer, për të cilët duhet të investohet brenda dhe jashtë vendit.

Sfidat dhe nevojat e arsimit të lartë në Shqipëri.

E ardhmja e botës është një e ardhme e të nxënit, e përgatitjes për të përballuar ndryshimin. Puna po bëhet gjithnjë e më shumë më pak materiale dhe më tepër inteligjente, ku përparësi ka teknologjia dixhitale, kanë lëndët fizikë, kimi, biologji, informatikë. Këtu duhet filluar reforma në arsimin e lartë.

Shoqëria do të gjejë përgjigjen e saktë për çdo hap, vendim, ligj vetëm po qe se udhëhiqet nga deviza e W. Willsonit: *A është e mirë? A është e drejtë? A është në interes të njerëzimit*? Pra edhe tek ne shtrohet pyetja: A është reforma në arsimin e lartë në funksion të zhvillimit ekonomik, të demokratizimit të vendit dhe të rritjes së mirëqënies?

Sipas ekspertëve dhe studimeve të kohëve të fundit në këtë stad arsimi i lartë ka nevojë për më shumë:

- Rregulla më të qarta të funksionimit të sektorit të arsimit të lartë.
- Konkurencë të ndershme dhe të drejtë.
- Zbatimin korrekt të legjislacionit fiskal për arsimin.
- Shpenzimet për arsimin të jenë jo më pak se 5% e PBB-së.
- Zhvillim më i madh i arsimit profesional, për pajisjen e studentëve me dijet dhe shprehitë për rritjen e konkurrencës dhe të aftësive të nevojshme për të përballuar sfidat e shekullit të 21-të.
- Stimulimin e kërkimeve aplikative dhe inovacionit.
- Përdorim të stimujve për frenimin e largimit të trurit jashtë vendit dhe tërheqjen e porsadiplomuarve në universitetet e huaja.
- Ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme.
- Zhvillimin e një sistemi të teknologjive të informacionit në hap me kohën.
- Sigurimin me lehtësi të teknologjive dhe bibliotekave (fizike dhe elektronike).
- Politika të reja të qarta fiskale, mbështetëse të mjediseve universitare dhe ndihmëse të tyre.
- Përfshirjen e universiteteve shqiptare në projekte shkencore studimi dhe zhvillimi, pasi në këtë mënyrë do t'i jepej më shumë "***frymëmarrje***" zhvillimit të këtij sektori dhe të ardhmes së tij.
- *Lidhje më të mirë të arsimit të lartë me tregun kombëtar dhe rajonal të punës dhe përdorimin e politikave fiskale lehtësuese dhe mbështetëse për punësimin e të porsadiplomuarve* (Angjeli, A. 2013).

PËRFUNDIME

Ne duhet të mendojmë e të kërkojmë më shumë burimet tona të brendshme. Të hartojmë një politikë shkencore kombëtare për të frenuar emigrimin e "***trurit***" me një strategji afatmesme dhe afatgjatë, në bashkëpunim të ngushtë me politikën ekonomike. Arsimi ndryshon për t'i hapur udhë ndryshimit të gjithë shoqërisë.

Politika arsimore duhet të krijojë kushte që të mund të lindin sa më shumë tregje të kualifikimit të mëvetësishëm, veçanërisht pas përfundimit të shkollës së lartë. Për të realizuar me sukses këtë kërkohet:

- informim mbi afatet e kualifikimit,
- këshillim pjesëmarrësve dhe pjesëmarrësve potencialë,
- zhvillim i kurrikulave,
- kualifikim i personelit kualifikues,
- përkrahje e institucioneve kualifikuese në menaxhim dhe drejtim,

- propagandim i kualifikimit,
- nxitje dhe sigurim i cilësisë së kualifikimit.

Strategjia e zhvillimit të arsimit të lartë është e lidhur pazgjithshmërisht me strategjinë e zhvillimit të popullsisë, pasi kjo është pikënisje e të gjitha strategjive (mosha, gjinia, shpërndarja territoriale). Kërkohen më shumë studime në këtë drejtim.

"**Mrekullia europiane**" u arrit me punë e dije. Edhe "**Mrekullia shqiptare**" këtë rrugë duhet të ndjekë. Integrimi kërkon thellimin e reformave në të gjitha fushat, pra edhe në arsimin e lartë, konsolidimin e institucioneve, funksionimin e shtetit ligjor, zhvillimin ekonomik me hapa të shpejtë, luftë të pandërprerë e pakompromis kundër krimit, korrupsionit, trafiqeve të paligjshme etj. Dyert e Evropës hapen me rezultate konkrete të reformave.

Siç thekson Profesor Servet Pëllumbi *meriton mbështetje çdo nismë e çdo kontribut për lidhjen e nivelit të arsimit dhe të edukimit me nevojat dhe qëndrimin e kombit ndaj mjedisit rrethues, demokracisë dhe kulturës, për t'i bërë të gjithë qytetarët vërtet të lirë dhe të drejtat e njeriut përparësi të padiskutueshme të institucioneve të shtetit ligjor, të shoqërisë civile dhe të opinionit shoqëror* (Pëllumbi, S. 2013).

Në fazën e tanishme modeli arsimor dhe kulturor duhet të realizojë tre detyra themelore: asimilimin teknologjik modern, hapjen kulturore ndaj botës dhe tejkalimin e barierave ideologjike dhe politike (Fuga, A. 2002).

BIBLIOGRAFIA:

Angjeli, Anastas. 2013. Ditari i tranzicionit ekonomik. Tiranë: Toena & UMSH PREES, f. 1052, 1111-1112.

Dewey, John. 1995. Towrdige, f. 11.

Dolto, Fransuaze. 1994. Adoleshentët. Tiranë: Ilda, f. 103.

Etzioni, Eva. 2009. Klasat dhe elitat në demokraci dhe në demokratizim. Tiranë: Dudaj, f. 304-305, 309, 78, 69.

Fuga, Artan. 2002. Ndërmjet fshatit dhe qytetërimit. Tiranë: Jerusalem, f. 241.

Gazeta Mësuesi. 2009. Fjalimi i Barak Obamës. 30 shtator, f. 2.

Gazeta Telegraf. 2014. Thënie të të mëdhenjve. 15 korrik, f. 8.

Huntington, P. Samuel. 2011. Vala e tretë. Tiranë: Instituti i Studimeve Ndërkombëtare, f. 55, 316, 318.

Meksi, Ermelinda. 2009. Gazeta Shqip. Arsimi i lartë dhe ekonomia. 26 shtator, f. 8.

Pëllumbi, Servet. 2013. Etikokracia. Tiranë: Morava, f.252.

Pula, Luljeta. 1996. Shekulli i 21-të (Mendime dhe opinione). Nju Jork: Gjonlekaj, f. 225.

INVESTIMI NË KAPITALIN NJERËZOR DHE ROLI I EDUKIMIT

Sonila Nikolla
Mediterranean University of Albania
sonila.nikolla@umsh.edu.al

ABSTRACT

Social capital is a set of trusted institutions and mutual formal and informal relationships between individuals in a community and various other subjects. It is a key resource for creating high levels of collective welfare and is a powerful factor in human development, social and economic. This value system if properly shared, strengthens the ethics of responsibility and represents a part of the identity of a country, if adjusted for the long term. The link between human capital, economic development and social welfare is now widely supported in economic theory and demonstrated in practice. Equally shared is the link between human capital formation and education. Investing in education generates at least three categories of effects: immediate effects on individual performance, innovative and competitive effects for business, and the effect of growth and prosperity for the community. If education has such a strong impact on the economic and social development, the quantity and quality of schooling has a central importance in national public policies. This paper aims at elaborating these opportunities regarding human capital quality in Albania.

Keywords: *Welfare, human capital, economic growth, education returns*

HYRJE

Në analizën e zhvillimit ekonomik në nivel kombëtar është rritur vëmendja për çështjet që lidhen me cilësinë e burimeve njerëzore, duke theksuar çështje

të tilla si niveli i arsimimit të popullsisë dhe i të punësuarve, marrëdhëniet mes kompanive, karakteristikat e infrastrukturës dhe kapacitetit inovativ. Një linjë e veçantë e hulumtimit është thelluar në mënyrë të veçantë në rolin e kapitalit njerëzor, duke vënë në dukje se edhe në nivele makroekonomike investimi në kapitalin njerëzor jep një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik. Procesi i akumulimit të kapitalit njerëzor është analizuar në disa mënyra, tradicionalisht ka favorizuar rolin e arsimimit, duke ngritur hipotezën që një popullatë dhe një forcë punëtore më e arsimuar sigurojnë rritjen e produktivitetit. Ekonomia globale është e mbushur me ndryshime të thella, që natyrisht, ndikojnë në ekonomitë kombëtare. Procesi i globalizimit, aplikimi i teknologjive të reja të komunikimit në treg, rritja e jetëgjatësisë në vendet perëndimore janë sfidat kryesore që ekonomitë perëndimore janë përballur. Kapitali njerëzor është një çështje kyçe në këtë fushë të ndryshimeve të mëdha. Në shoqërinë bashkëkohore, kapitali njerëzor është i lidhur direkt me rritjen e produktivitetit të punëtorëve dhe, rrjedhimisht, me zhvillimin e vendit. Investimi në kapitalin njerëzor dhe rritja e njohurive janë linjat e veprimit që duhet të ndiqen, sidomos në këtë periudhë të rënies ekonomike. Modelet e rritjes që theksojnë rëndësinë e kapitalit njerëzor janë të shumta, dhe gjithnjë e më shumë studiues nga fusha janë të bindur që, për disa vende, është e nevojshme për të rifilluar nga investimet në kapitalin njerëzor për të pasur një produktivitet të qëndrueshem që do të sillte dhe ne një rritje ekonomike. Në Shqiperi, për fat të keq, ka shumë që dyshojnë në ekzistencën e kushteve të favorshme për këtë lloj investimi. Në të vërtetë, studimet tregojnë se në vendin tonë ekziston një mjedis veçanërisht miqësor për investimin në kapitalin njerëzor, me të gjitha pasojat që kjo sjell në ekonomi.

Teoria e Kapitalit njerëzor dhe rritja ekonomike

Teoria tradicionale e rritjes ekonomike ishte e bazuar në mekanizmin e akumulimit të kapitalit fizik te makinerive dhe infrastrukturës. Ndërsa teoria e re e rritjes ekonomike e vë theksin në rëndësinë e shqyrtimit të njohurive dhe aftësive të forcave e punës, duke zhvendosur fokusin në akumulimin e kapitalit njerëzor. Ideja e teorive të reja është se një forcë punëtore më kompetente dhe e arsimuar ndikon ne rritjen e produktivitetit të punës dhe rrit aftësinë e ekonomisë për të zhvilluar teknologjitë më të përparuara. Nga një pikëpamje teorike, mënyra më e lehtë për të futur kapitalin njerëzor është që ta shtojmë atë në mënyrë eksplicite si një input të ri në funksionin e prodhimit agregat, që bën që niveli i të ardhurave të varet nga sasia e kapitalit fizik të përdorur, nga sasia

e punës dhe nga produktiviteti total i faktorëve, i cili varet dhe nga shkalla e progresit teknik.

Rritja e kapitalit njerëzor është një input i rëndësishëm jo vetëm në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve, por gjithashtu dhe në aftesinë e një sistemi ekonomik për të krijuar dhe zhvilluar ide dhe teknologji të reja. Nga kjo nxjerrim dhe një justifikim të plotë për politikat e përqendruara në arsim si motori kryesor i rritjes ekonomike.

Kapitali njerëzor është produkt i një vendimi mbi investimin bazuar në faktin që duhet të hiqet dorë nga diçka sot për të marrë diçka me vlerë më të madhe nesër. Në terma të përgjithshme, mund ta përkufizojme kapitalin njerëzor si pasurinë e njohurive dhe aftësite teknike që zotërojnë individëd. Të gjithë, pra, kanë një bagazh njohurish, përvojash dhe aftësish të cilat përbëjnë kapitalin human. Ky kapital njerëzor jo vetëm që mund të përdoret në procesin e prodhimit, por gjithashtu ka një rol të rëndësishëm në përcaktimin e produktivitetit për punëtor. Në fakt, një stok në gjëndje më i madh i kapitalit njerëzor për individin, do të thotë më shumë aftësi dhe njohuri që sjellin më shumë mundësi për të kryer detyra të specializuara. Për më tepër, në qoftë se do të shihnim zhvillimin historik të kapitalit njerëzor, mund të dallojmë se ka pasur fillesa me stok relativisht të ulët, për detyra pak të specializuara, deri sa rritet gjithmonë e më shumë dhe për detyra më të specializuara.

Përveç kësaj, kapitali njerëzor përcakton jo vetëm rritje të rëndësishme në nivelin e produktivitetit të individit, por rezultate vijnë dhe nga produktiviteti global dhe nga rritja sociale që individët me stokun më të madh të kapitalit njerëzor sjellin për shoqërinë. Këto karakteristika të kapitalit njerëzor janë sigurisht më të rëndësishme, sepse ato kontribuojnë në rritjen e njohurive sociale, e cila është një lloj i dijes që kalon mes gjeneratave të ndryshme të shoqërisë dhe kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e saj. Në përgjithësi, aftësitë sociale janë të mira publike në dispozicion të komunitetit, dhe zbulimi i tyre varet nga kontributi i një individi apo i një grupi individësh, kryesisht nëpërmjet aktiviteteve të kërkimit dhe zhvillimit. Përveç kësaj, studimet e fundit kanë treguar se një stok më i madh i kapitalit njerëzor bën që individet të jenë më të vetëdijshëm dhe të kenë qëndrime dhe stil jetese më të shëndetshëm dhe gjithashtu kjo con drejt një tendence për të kryer më pak krime. Në përgjithësi, një stok më i madh i kapitalit njerezor ka ndikime të mëdha dhe në nivelin e besimit në komunitet. Ky aspekt, normalisht, ka pasoja të rëndësishme mbi produktivitetin, sepse mund të nxisë individët për të ndërmarrë strategji bashkëpunimi, duke maksimizuar përfitimet që të gjithë palët mund të nxjerrin nga kjo situatë.

Në nivel shtetëror, investimet në kapitalin njerëzor janë një variabël kyç, veçanërisht për të mbështetur rritjen afatgjatë. Disa vende ekonomikisht të zhvilluara e sigurojnë këtë rritje përmes avancimit të teknologjisë nëpërmjet aktivitetit të kerkimit dhe zhvillimit, duke investuar vazhdimisht në kapitalin njerëzor dhe, prandaj, kanë personel adekuat për të kryer punë me specializim të lartë dhe shumë të lartë. Kjo është arsyeja pse një vend, veçanërisht në qoftë se është ekonomikisht jo shumë i përparuar, kurrë nuk duhet të nënvlerësojnë investimet në kapitalin njerëzor. Pra, ideja se ishte e mjaftueshme për të kopjuar risitë teknologjike nga vendet e tjera për të rritur produktivitetin në afat të gjatë, gjeti limitin kur u mbyll hendekun mes vendit ndjekës vëndit dhe udhëheqës. Në fazën e parë të situatës së zhvillimit, investimet në kapitalin njerëzor nuk ishin të nevojshme, sepse mund të zbatoheshin në procesin e prodhimit teknologji te zbuluara në vende të tjera, por pasi mbyllej hendeku i teknologjisë, vendi duhej domosdoshmërisht të bëhej vetë një lider në kërkim dhe zhvillim. Vetem në këtë mënyrë vendi mund të vazhdojë rritjen e tij. Ky tranzicion na jep një preventiv të investimit adekuat në kapitalin njerëzor.

Investimi në kapitalin njerëzor është ende një zgjedhje e individit. Shteti ne fakt mund të inkurajojë këtë investim duke krijuar kushte të favorshme që të ndodhë. Megjithatë, vendimi për të investuar në kapitalin njerëzor mbetet gjithmonë një zgjedhje e individit, i cili adapton, në lidhje me zgjedhjen e lartpërmendur, të njëjtin lloj qëndrimi që ka ndaj çdo lloj investimi tjetër. Kjo është arsyeja pse ekonomistët kanë identifikuar një normë kthimi te investimit për të përcaktuar përparësitë dhe mangësitë e kësaj zgjedhje. Norma e kthimit, pra, lejon krahasimin e zgjedhjes së investimeve në kapitalin njerëzor me çdo zgjedhje tjetër në investimet alternative. Brenda kjo normë përfshin shumë variabla, të tilla si diferencat e pagave në mes atyre që bëjnë këtë investim dhe kush jo, kostot e drejtpërdrejta të periudhës së studimit, kostot oportune e periudhës së studimit më të zgjatur, mundësia e gjetjes së menjëherëshme të një pune. Kombinimi i këtyre variablave përcakton më me lehtësi këtë zgjedhje. Duke iu referuar Shqipërise, krahasuar me vëndet të tjera ekonomikisht më të zhvilluara, vëmë re se norma e kthimit të investimit në arsim është akoma i ulët.

"Teoria e kapitalit njerëzor pretendon se njohuritë dhe aftësitë e fituara përmes edukimit, rrisin aftësinë e individëve për të prodhuar të mira dhe shërbime, prandaj, kapitali njerëzor rrit produktivitetin e individëve dhe të komunitetit të cilit i takojnë." Kjo deklaratë është e rëndësishme sepse konfirmon se jo vetëm faktorët e kapitalit njerëzor dhe të punës janë vendimtare, por edhe cilësia dhe sasia e njohurive të secilit punëtor kane një ndikim te madh. Kjo është arsyeja

pse një vend duhet të mbështesë dhe të investojnë në përvetësimin e njohurive nga ana e individëve, për të përfituar në këtë mënyrë në produktivitet.

Në terma të përgjithshëm, atëherë, mund të përcaktojmë kapitalin njerëzor si pasurinë e njohurive dhe aftësive teknike që zotërojnë individët. Historikisht, kapitali njerëzor ndryshon sipas nevojave të tregut të punës dhe të procesit të prodhimit , duke kaluar nga forca fizike ne cilësitë intelektuale gjithnjë e më të specializuara, dhe së fundi në aftësitë më të përparuara kompjuterike.


Kapitali njerëzor i kërkuar për një punëtor në shekullin XXI është i ndarë kryesisht në tri dimensione. I pari ka të bëjë me posedimin e aftësive gjuhësore elementare, me aftësinë për të kryer analiza sasiore, dhe më përgjithësisht, me aftësinë për të përpunuar informacionin dhe përdorimin e tij në zgjidhjen e problemeve apo për të mësuar më shume. Dimension i dytë ka të bëjë me aftësinë për të përdorur teknologjitë specifike apo për të kryer proceset e veçanta të prodhimit, dhe dimensioni i tretë i referohet njohurive shkencore.

Të mësuarit individual është burim ekskluziv i përmirësimit të njohurive, në kuptimin se njohuritë e një personi përjashtojnë posedimin e njohurive të njëjta nga të tjeret, vetëm nëse mbajtësi i këtyre dijeve nuk dëshiron ti bëjë të ditura ato. Kjo bëhet për dy arsye. Nga njëra anë njohuritë janë të kufizuara në hapësirë dhe kohë, dhe kjo nënkupton ekskluzivitetin e tyre. Ekskluziviteti i një të mire do të thotë se ekzistojnë kushte ekonomike dhe jo ekonomike që dikush mund të përjashtohet nga përdorimi i saj. Nga ana tjeter, ekskluziviteti i njohurive individuale vjen edhe për shkak të faktit se ka kushte teknike, të tilla si specializimi i lartë, të cilat veprojnë si një pengesë në hyrje dhe parandalojnë qasjen nga të gjithë. Ne jemi në një situatë ku ne kemi një faktor fiks, individin dhe aftësitë e tij, dhe këtij faktori i shtojmë doza në rritje të faktorit variabël, që janë njohuritë. Përmirësimi që mund të arrihet nga rritja e njohurive individuale ulet nën një prag të caktuar, sepse fushat e zbatimit të dijes mund të jenë të kufizuara.

Njohuritë sociale ose shoqërore janë njohuri të akumuluara në shoqëri dhe, prandaj, shpëtojnë nga kontrolli i individeve që i zotërojne ato. Ato janë njohuritë që rrjedhin nga zbulimet shkencore, përkatësisht nga ato inovacione që vijnë nga sfera e individit që i ka shpikur për ti bërë një trashëgimi të përbashkët, me të cilat jemi në kontakt përmes procesit të socializimit, dhe pikerisht për këtë nuk janë ekskluzive. Ndërsa njohurite që ka një inxhinier, ato që shërbejnë për profesionin e tij, janë njohuri që rrjedhin nga puna e inxhinierit, dhe në këtë mënyrë përjashtojnë të gjithe jo-inxhinierët. Të njëjtat njohuri përdoren në mënyrë të njëjtë nga një ekonomist.

Literatura ekonomike aktuale ka shfrytëzuar këtë dallim midis njohurive individuale dhe njohurive sociale për të shpjeguar rritjen ekonomike. Më veçanërisht, është parashikuar se aftësitë e individëve, kapitali i tyre njerëzor, mund të përdoren si në hulumtim dhe në aktivitetet e prodhimit. E para, edhe pse nuk ka efekte të menjëhershme produktive, do të zhvendosë kufijtë e dijes dhe të teknologjisë, me pasoja në produktivitetin e përgjithshëm të ekonomisë. Pikërisht ky avancim teknologjik është motori i rritjes ekonomike.

Njohuritë individuale dhe shoqërore janë të lidhura fort. Në veçanti, njohuritë individuale që përdoren në aktivitete të tilla si hulumtimi dhe zhvillimi kontribuojnë në formimin e dijes së shoqërise. Në këtë kuptim, secili prej nesh kontribuon në njohuritë sociale kur përdor njohuritë për të kontribuar në këto lloj aktivitetesh. Ndërsa rritja e njohurive individuale ndikon në rritjen e produktivitetit të një vendi, rritja e njohurive shoqërore kontribuon në rritjen e afatgjatë. Në fakt, në afate të gjata, në qoftë se produktiviteti i një vendi ka arritur në pikën e tij optimale, e vetmja mënyrë për të siguruar që ekonomia të jetë ende në rritje është të krijojë kushte të reja të përshtatshme për rritjen e produktivitetit. Këto kushte të reja vijnë si pasojë e zhvillimit teknologjik, i cili nga ana e tij është pasojë e dijes shoqërore. Kjo është arsyeja pse aftësitë sociale janë motor i rritjes ekonomike.



Për sa i përket punëkërkuesve të papunë të regjistruar sipas nivelit arsimor shohim që numri i punëkërkuesve me arsim të lartë ka nje tendence në rritje në tre vitet e fundit edhe pse në numër të vogël, ndërsa numri i punëkërkuesve me arsim 8/9 vjecar dhe me arsim te mesem është në zbritje.

Kapitali njerëzor në rritjen e një vendi, aspekte mikroekonomike dhe makroekonomike

Niveli i kapitalit njerëzor për një vënd është shumë i rëndësishëm për rritjen ekonomike të tij. Ka dy mënyra që kapitali njerëzor kontribuon në rritjen ekonomike. Së pari ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në produktivitetin e individit dhe, së dyti ndikon në mënyrë indirekte ne produktivitetin afatgjatë. Në fakt, rritja e stokut të kapitalit njerëzor në një vënd sjell gjithashtu rritjen e aktiviteteve të kërkim - zhvillimit të cilat janë vendimtare për rritjen ekonomike afatgjatë.

Mund të dallojmë se si rëndësia e kapitalit njerëzor ndikon në rritjen ekonomike te një vendi. Sa më shumë ekonomia është afër pikës optimale të kufirit teknologjik, më shumë ajo ka nevojë për të investuar në kapitalin njerëzor për të lëvizur në nivelin e kufirit dhe për të ruajtur rritje të qëndrueshme për një afat të gjatë.

Hulumtimet në këtë fushë studiojnë lidhjen midis arsimit dhe produktivitetit përmes të dhënave mbi nivelet e pagave. Qasja standarde është për të shpjeguar dallimet në nivelet e pagave të individëve duke përfshirë nivelin e arsimit të arritur, moshën dhe shumë karakteristika të tjera të individëve. Është e padiskutueshme se nivelet e pagave janë të lidhura pozitivisht me vitet e arsimimit. Për më tepër, lidhja ndërmjet arsimimit dhe pagave individuale bëhet më e fortë në kohë të ndryshimeve të shpejta teknologjike, si në vitet e fundit. Ekuacionet e regresionit gjithashtu lejojnë vlerësimin e normës së kthimit të investimeve private në arsim. Kjo ndryshon në varësi të periudhës dhe të vendit. Kthimi vlerësuar nga investimi në kapitalin njerëzor për mesataren e BE-së është 6,5%. Tregu i punës, megjithatë, është larg nga të qenit një treg konkurrues i përkryer dhe struktura e pagave është e ngjeshur mes aftësive të ndryshme.

Një aspekt i rëndësishëm ka të bëjë me efektet sociale të gjeneruara nga investimi në kapitalin njerëzor individual. Në përgjithësi, një rritje në kapitalin njerëzor në total ka funksion nxites për investime individuale në kapitalin njerëzor, sjell një rënie të pabarazisë së të ardhurave, ul nivelin e krimit, përmirëson gjëndjen shëndetësore, rrit kohezionin social dhe gjithashtu rrit normën e demokratizimit, duke i bërë qytetarët më të vetëdijshëm dhe aktiv.

Këto eksternalitetet pozitive sjellin një ndryshim mes normës individuale të kthimit te investimit dhe normës shoqërore të kthimit të investimeve në kapitalin njerëzor. Norma shoqërore e kthimit duhet të marrë parasysh të gjitha kostot sociale, dhe jo vetëm ato individuale, dhe të gjitha përfitimet sociale, jo vetëm ato individuale, të investimit në kapitalin njerëzor. Për fat të keq, përfitimet sociale të mësipërme janë shumë të vështira për t'u matur, edhe pse është e arsyeshme të supozojmë se norma shoqerore e kthimit është më e lartë sesa ajo individuale. Në përfundim, studimet mikroekonomike tregojnë se norma e kthimit mbi kapitalin njerëzor duket mjaft e lartë në krahasim me investimet alternative, nga dy pikëpamje si nga ana individuale si nga ajo shoqerore.

Ndërsa të dhënat mikroekonomike për individët lejojnë të llogaritet norma e kthimit të investimeve në kapitalin njerëzor dhe gjithashtu lejojne analizen e lidhjes se kapitalit njerëzor me produktivitetin dhe pagat, analiza e të dhënave makroekonomike nxjerr në pah dhe përcakton rolin e kapitalit njerëzor në rritjen agregate ekonomike. Në vitet e fundit, në sajë të teorive të reja të rritjes, kalitali njerezor ka qenë një nga pikat qëndrore të analizës empirike. Ne mund të dallojmë dy tendenca: kontabilitetin e rritjes dhe regresionet e rritjes.

Kontabiliteti i rritjes ndan rritjen e të ardhurave në një pjesë që mund të shpjegohet me rritjen e inputeve dhe një pjese tjetër që lidhet me variacione në efikasitetin dhe progresin teknik. Duke shpjeguar rritjen e të ardhurave, ndryshimet tek faktorët zënë peshë sipas produktit të tyre marxhinal. Ky parim mund të shtrihet në çdo numër të inputeve, të cilet, kur të dhënat janë në dispozicion, mund të ndahen më tej (për shembull forca e punës mund të ndahet në kategori të ndryshme të punëtorëve për të matur ndikimin në rritjen e kategorive individuale).

Shumë më e gjerë dhe me ndikim është literatura e regresioneve te rritjes. Fillimisht puna është e lidhur ngushtë me emrin e ekonomistit të njohur Robert Barro i Universitetit të Harvardit, i cili arriti në përfundimin se: 1) rritja është pozitivisht e lidhur me nivelin fillestar të viteve të shkollimit nga shkolla e mesme ose më të lartë tek meshkujt, ndërsa shkolla fillore nuk ka efekt në rritje. Kjo sugjeron një rol të rëndësishëm në përhapjen e teknologjive të reja. 2) Rritja nuk është e lidhur me nivelin e arsimimit tek gratë. Kjo sugjeron përdorimin joefikas të kapacitetit të grave nga tregu i punës në shumë vende, nëpërmjet një pjesëmarrje të ulët të grave për të punuar. 3) Të dhënat për rezultatet e testeve të nxënësve, të standardizuara dhe ndërkombëtarisht të krahasueshme, janë përdorur për të matur cilësinë e arsimit në vende të ndryshme. Rezultatet në lëndët shkencore kanë një lidhje veçanërisht të fortë dhe pozitive me rritjen. Përveç kësaj, numri mesatar i

viteve të shkollimit (që mat sasinë e kapitalit njerëzor) mbetet i rëndësishëm dhe i lidhur pozitivisht me rritjen edhe kur rezultatet e testeve në lëndët shkencore (që masin cilësinë e kapitalit njerëzor) janë futur në regres.

Me pas vëmë re se, në qoftë se ka një lidhje midis kapitalit njerëzor dhe produktivitetit, ne duhet të presim edhe një lidhje pozitive mes normës së rritjes së të ardhurave për frymë dhe ndryshimit te arritur në nivelin mesatar të arsimimit. Nga sa më sipër duke pare se investimi në kapitalin njerëzor ka një normë kthimi të lartë, të krahasueshme me investimeve alternative në dispozicion të individëve, ne mund të konkludojmë se masat për të rritur sasinë dhe cilësinë e kapitalit njerëzor duhet të jenë një pjesë e rëndësishme e një politike të orientuar drejt rritjes.

Për vendet më pak të zhvilluara shpesh investimi në arsim është parë si zgjidhja për rritjen dhe për këtë arsye shpesh eshte ne bazën e masave të rekomanduara nga organizata të tilla si Banka Botërore. Asnjë vend nuk është bërë ndonjëherë i pasur me një popullsi krejtësisht analfabete ose pa aftesi teknike. Në të njëjtën kohë në shumë vende eshte përmirësuar në masë të madhe qasja në arsimin fillor, pa të cilin mendohet se nuk do te kishte rritje ekonomike, dhe nuk kane munguar stimujt e sakte për të shfrytëzuar kapitalin e njerëzor, në mënyrë që arsimi të kthehet në investim në të ardhmen e individëve. Për të bërë të mundur këtë, nevojiten politika të tjera plotësuese për arsimit.

Kapitali njerëzor në Shqiperi

Vlera e kapitalit njerëzor vihet ne dukje nga kushtet e kerkeses dhe të ofertës. Për këtë lind nevoja e nje analize te kushteve te kërkesës dhe te ofertës së kapitalit njerëzor në Shqiperi. Oferta e kapitalit njerëzor ka të bëjë me paketen me të cilen individët paraqiten në tregun e punës. Do te shohim se si paraqitet situata ne Shqiperi ne lidhje me stokun e kapitalit njerezor. Duke analizuar kërkesën për punë shohim se kërkesa për punë ndikon në masë të madhe furnizimin e punës dhe, për pasojë, kërkesa për kapitalin njerëzor ndikon fuqimisht ofertën. Kërkesa për punë është përcaktuar kryesisht nga sektori publik dhe sektorit privat, me bizneset e vogla. Në sektorin privat shohim se si struktura e prodhimit të biznesit të vogël nuk është e interesuar për aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit, si këto aktivitete kanë kosto të konsiderueshme dhe do të peshojnë shumë në pasqyrat financiare të këtë lloj të biznesit. Përveç kësaj, ky punëdhënës preferon punësimin e punëtorëve me kualifikim më të ulët, ose punëtorë pa pagesë të familjes, dhe gjithashtu kufizon mjaft trajnimin e tyre në vendin e punës. Kombinimi i këtyre dy elementëve do të thotë se, në përgjithësi, bizneset e vogla preferojnë të punësojnë

punëtorë më pak të aftë për detyra më pak të specializuara dhe më të përsëritura.

Në përfundim, situata e përshkruar mund të çojë në konsideratë se kemi te bejme me një rreth vicioz; një normë e ulët e kthimit të investimit në arsimi con në dekurajimin e investimit në kapitalin njerëzor dhe pengojnë arritjen e stokut të kapitalit njerëzor që gjëndet në vendet e përparuara; një mungesë e kapitalit njerëzor nuk është e favorshme për aftësinë e ekonomisë për të rinovuar dhe adoptuar teknologjitë që, në sajë të kontributit të kapitalit njerëzor, bëjnë të mundur rritjen e kërkesës dhe të produktivitetit. Në fakt, nga njëra anë, normat e ulta të kthimit në arsim, për shkak të diferencave të ulëta të pagave dhe kushteve të tjera në tregun e punës, veçanërisht për shkak të kërkesës për punë dhe kapitalit njerëzor, dekurajojnë individët për të investuar në kapitalin e tyre njerëzor. Si rrjedhim oferta e kapitalit njerëzor është e ulët. Nga ana tjetër, ky fakt nuk lejon zhvillimin e inovacionit teknologjik dhe për këtë arsye kemi dhe nje zhvlerësim te kapitalit njerëzor.


Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014, sipas Anketës së Forcave të Punës, numri i të punësuarve të moshës 15-64 vjeç është 1.039.336 persona. Numri i personave të papunë të moshës 15-64 vjeç është 227.407 persona.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2014 në Shqipëri, për popullsinë e moshës 15-64 vjeç shkalla e papunësisë është 18,0 %, qe do te thote qe krahasuar me tremujorin e katert te vitit 2013 numri i personave të papunë është rritur me 30.459. Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç shkalla e papunësisë është 33,9 %. Ndersa shkalla e punësimit për popullsinë e moshës 15-64 vjeç është 52,1 % dhe kjo krahasuar me tremujorin e katert te vitit 2013 është rritur me 82.629 persona. Nga keto te dhena shohim qe 63,6 % e popullsisë 15-64 vjeç është aktive në tregun e punës, pra e punësuar ose në kërkim aktiv të një pune, qe krahasuar me nje vit me pare numri i personave në moshë 15-64 vjeç jashtë tregut të punës ka rënë me 105.113. Shkalla e punësimit për meshkujt është 13,8 pikë përqindje më e lartë sesa për femrat dhe krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2013 për popullsinë 15-64 vjeç shkalla e papunësisë për femrat është rritur me 1,5 pikë përqindje, ndërsa për meshkujt ka rënë me 0,5 pikë përqindje.

Duke krahasuar te dhenat per tremujorin e katert te vitit 2014 me te dhenat e tremujorit te tretë të vitit 2014 për popullsinë 15-64 vjeç shohim qe numri i të punësuarve është ulur me 3.722, ndersa numri i personave të papunë është rritur me 7.821. Numri i personave në moshë 15-64 vjeç jashtë tregut të punës ka rënë me 3.903 dhe shkalla e papunësisë ka rënë me 0, 2 pikë përqindje për meshkujt dhe është rritur me 1,6 pikë përqindje për femrat.

Shkalla e pjesmarrjes në forcat e punës

Mosha	Tr.1.2013 Q1.2013	Tr.2.2013 Q2.2013	Tr.3.2013 Q3.2013	Tr.4.2013 Q4.2013	Tr.1.2014 Q1.2014	Tr.2.2014 Q2.2014	Tr.3.2014 Q3.2014	Tr.4.2014 Q4.2014	Age
15 vjeç e lart	**54.9**	**52.5**	**51.5**	**50.9**	**50.8**	**53.6**	**55.2**	**55.3**	**15 years and above**
15-64 vjeç	**62.0**	**59.7**	**58.6**	**58.1**	**57.9**	**61.3**	**63.4**	**63.6**	**15-64 years**
15-29 vjeç	**40.3**	**38.3**	**37.5**	**38.8**	**36.9**	**41.4**	**45.1**	**44.2**	***15-29 years***
30-64 vjeç	**73.8**	**71.7**	**70.2**	**68.9**	**69.9**	**72.1**	**73.2**	**74.0**	**30-64 years**



Per sa i perket shkalles se punësimit sipas statusit në punësim dhe nivelit arsimor shohim qe shkalla e punësimit per grup-moshen 15-64 vjeç është më e lartë për të punësuarit me arsim profesional (65,5 %), pasuar nga ata me arsim të lartë (64,9 %). Të dhënat tregojnë se përqindja e të punësuarve me pagë është më e lartë për personat me arsim të lartë dhe e kundërta vërehet tek të punësuarit me arsim 8/9 vjeçar ku mbizotërojnë punëtorët pa pagesë të familjes.


Po të analizojmë të punësuarit me arsim të mesëm, shkalla e punësimit është më e lartë për personat me arsim të mesëm profesional (65,5%) krahasuar me personat që kanë kryer shkollën e mesme të përgjithshme (45,5 %).


Një në pesë të punësuar të grup-moshës 15-64 vjeç me arsim 8/9 vjeçar janë të punësuar me pagë, afro gjysma janë punëtorë pa pagesë të familjes, dhe një e treta e tyre janë të vetë-punësuar. Pesha që zënë të punësuarit me pagë rritet me rritjen e nivelit arsimor. Nga të punësuarit me arsim të lartë 86,7 % janë

të punësuar me pagë dhe vetëm 3 % janë të punësuar si punëtorë pa pagesë të familjes. Tek të punësuarit me arsim të mesëm profesional dhe me arsim të mesëm të përgjithshëm përqindjet që zënë të punësuarit me pagë janë përkatësisht 48,2% dhe 49 %.

Tab. 1 Shkalla e punësimit sipas statusit në punësim dhe nivelit arsimor per tremujorin e katert 14

	8-9 vjecar	e mesme profesionale	e mesme e pergjithshme	arsim i larte	total
te punesuar me page	22	48.2	49	86.7	43.3
te vetepunesuar	32.8	31.7	25.9	10.3	26.9
punetor pa pagese i familjes	45.1	20.1	25.1	3	29.8





KONKLUZIONET

Nëse do të formulonim pyetjen e mëposhtme: "Në Shqiperi a duhet të investojmë në kapitalin njerëzor?", sipas materialit të analizuar në këtë tezë, përgjigja është pozitive. Në Shqiperi kushtet janë të favorshme për te investuar në kapitalin njerëzor, si në anën e kërkesës dhe të ofertës, edhe pse akoma kemi një përdorim të pamjaftueshëm të kërkesës dhe të ofertës. Pasi bëmë një analizë teorike të kapitalit njerëzor dhe investimit në kapitalin njerëzor dhe pasi specifikuam se çfarë është në bazë të llogaritjes së investimeve individuale, ne kemi parë, se sa i rëndësishëm është ky investim në të dy rastet si për individin ashtu si në nivel agregat, dhe gjithashtu rëndësinë e këtij lloj investimi për shtetin.

Studimet mikroekonomike tregojnë se norma e kthimit mbi kapitalin njerëzor duket mjaft e lartë në krahasim me investimet alternative, nga dy pikëpamje si nga ana individuale si nga ajo shoqerore. Duke parë se investimi në kapitalin njerëzor ka një normë kthimi të lartë, të krahasueshme me investimeve alternative në dispozicion të individëve, ne mund të konkludojmë se masat për të rritur sasinë dhe cilësinë e kapitalit njerëzor duhet të jenë një pjesë e rëndësishme e një politike të orientuar drejt rritjes, dhe nuk duhet te mungojne stimujt e sakte për të shfrytëzuar kapitalin e njerëzor, në mënyrë që arsimi të kthehet në investim në të ardhmen e individëve. Për të bërë të mundur këtë, nevojiten politika të tjera plotësuese për arsimit.

BIBLIOGRAFIA:

INSTAT - Rezultate të Anketës së Forcave të Punës, T4 - 2014

Blanchard, A., Giavazzi, O., & Amighini, F. (2011). Macroeconomia: una prospettiva europea. Il Mulino: Bologna.

Cipollone, P., & Sestito, P. (2010). Il capitale umano, Il Mulino: Bologna.

De La Fuente A., Ciccone A. (2003), Human Capital in a global and Knowledge based Economy, European Commission, Luxenbourg

De La Fuente A., Domenech R. (2006), Human Capital in Growth Regressions : how Much Difference does Data Quality Make?, in: Journal of the European Economic Association, n. 1

SHQIPËRIA DHE REFORMIMI NË EDUKIMIN E DJEMVE KUNDRA DHUNËS NË FAMILJE

Ela Tollkuçi
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
ela.tollkuci@umsh.edu.al

ABSTRACT

The Prevention of gender violence among young boys of the middle school and the high school in Albania is an important aspect for the projects of the organizations that handle with domestic violence. This article is based on the perspective according to which the educational programs to non-violence primarily should educate young people with the historic memory that elevates peaceful citizenship. Only in this way the programs will reach the consistency over time. In parallel with this ongoing objective the educational process should include cultural informative and treatment programs for situations of exposure to violence and abuse among youth in the family, the involvement of young people in communities and criminal activities,bullying phenomenon and sexual harassment in schools, as factors that warn about the future of intimate partner violence (IPV). In Albania there is a lack of standardized and accredited programs that are part of the ongoing outreach activities for young people in all developed countries of the EU. Sensitizing workshops against violence will be put in comparative plan with proper application of prevention programs for education among equals.

Keywords: domestic violence, Albania, reform

HYRJE

Mendimi filozofik kontemporan mbi dhunën ridimensionohet në analizën e Aldo Capitinit tek Catarci (2013). Kur mendojmë dhe arsyetojmë mbi dhunën jemi të prirur të orientohemi drejt konceptit të luftës në të gjitha format dhe

varietetin e shfaqjes së saj. Për pasojë, steriotipet e mizorive dhe vuajtjeve njerëzore si rrjedhojë e mungesës së burimeve ushqimore, vuajtja psikologjike e shfaqjes kolektive të panikut e deri tek format e ankthit dhe të depresionit, traumat nga humbja e personave të afërm apo edhe vështirësitë dhe pamundësitë për rekuperimin psiko-fiziologjik nga humbjae gjymtyrëve në rast aksidenti të luftës, përbëjnë skenat nga imagjinata e gjithësecilit qëngrihen si elementë ushqyes të frikës ndaj konceptit të luftës në kompleksitetin e saj. Në të vërtetë, dhuna duhet të shihet përtej situatave ekstreme dhe të vendoset, për fat të keq, deri tek e përditshmja jonë. Këtu i referohem jo vetëm dhunës sëlidhur me çështjet gjinore, raziale, etnike, dhunës ndaj fëmijëve në komunitet, shkolla apo dhe familje, por një dimensioni më latent që kërkon kapacitetin dhe vëmendjen e një studiuesi për t`u parashtruar dhe analizuar si problematikë. Është fjala për atëqë njihet si `dhuna nga sistemi`. Sistemi ekonomik, financiar, social, i parëjo vetëm nga këndvështrimi i një shteti por edhe në raportetmidis shteteve, ka çuar në një shkallë të tillë pabarazie sociale e cila ushqen ndjenja frustrimi të gërshetuara me urrejtje tek shtresat mëtë varfra të të rinjve. Ndjesia është e një përjetimi të barazvlefshëm me poshtërim, dhunëfizike dhe emocionale nga individë me mundësi më të mira ekonomike. E nëse do t`i referoheshim ndonjë shëmbulli konkret, eksperienca na ofron raste në të përditshmen e shembujve nga rajoni e deri tek nivelet e pabarazisë botërore. Natyrshëm lind pyetja: ç`duhet të mendoj një adoleshent i lindur dhe irritur nëpër fshatrat e Shqipërisë ku mungesa e përkujdesjes sociale arrin deri në pikën që nuk ka një urë lidhëse që t`i mundësojë banorëve komunikimit misdis botëve dhe realiteteve? Ç`mund t`i themi një fëmije të rritur në periferi, apo një lypësi të komunitetit Rom dhe Egjyptian të cilët jetojnë në varfërinë më të skajshme, teksa shohin nëpër lagjet in (bllok) të Kryeqytetit veshjet, profumet, çelikun e shkëlqyer, baret dhe ristorante `in vogue`, ndërtesat dhe makinat me xhama vezullues, që duket sikur të përfshijnë në një realitet krejt të papërputhshëm me atë tëvetëm disa kilometrave më tutje? Ç`mund të thuash për të rinjtë e lagjve `Favelas` në Rio de Janero teksa shohin shëtitoret e buzëdetit të Copagabanës dhe Ipanemës në gjithë shkëlqimin magjepës të tyre? Podisnivelet e theksuara të Afrikës Jugore si mund t`ja bashkangjisim interpretimit racional që qetëson kërshërinë emcionle? Si mundet t`i shpjegojmësot një të riu, me qetësinë dhe argumentimin e nevojshëm, se dypërqin e popullsisë botërore disponon më shumë se gjysmën e pasurisë dhe se pjesa më e varfër e njerëzimit duhet të mbijetojë me më pak se një përqin të të gjithë të mirave të kësaj bote (Naudé, 2009)? Konceptii mirëqënies psikologjike positiviste do të kërcënohej nga mos mbartja e elementeve social dhe ekonomik

tëkëtij sistemiholistik (Delle Fave, 2007). Një i tillë realitet bëhet fatkeqësisht potencial për formimin e fëmijëve të privuar nga gjithçka që shqisat e tyre prekin dhe ndejnë në të përditshmen derisa zemërimi për çdokënd që posedon të mira të shëndërohet në një mekanizëmtë fortëkompensues tëpersonalitetit të tyre.

Struktura Kryesore

Edukimi global (Catarci, 2013) i të rinjve, sidomos në nivel shkollash 9-vjeçare dhe të mesme, mbetet një domosdoshmëri për funksionimin e programeve afatgjata në edukimin kundra dhunës. Fatkeqësisht, kulturat e njerëzmit bazohet së shumëti tek dhuna dhe për këtë arsye kjo detyrë i mbetet edukimit nëpërmet kulifikimit të praktikës pedagogjike. Shkolla ka potencial të çoj deri në fund funksionin paqësor të saj nëpërmjet ristrukturimit të thellë të mendësive dominuese. Është fjala për të ekuilibruar në imagjinatën kolektive, idealet e heronjve që vënë drejtësi duke rrokur armët dhe me heroizma të përgjakshme, nëpërmjet përdorimit të përshkrimeve të paqta të cilat duhen përcjelle jo vetëm si një ndërprerje e normalitetit të armiqësisë së përhershme. Aq i pa mësuar është njerëzimi me jo- dhunën sa dhe përdorimi i një termi të përshtatshëm përshkrues për tëështë vështirë të gjendet në leksikun tonë. Jemi të mësuar me përshtatje të tipit: jo-dhuna, kundër dhunës, paqësisht, por asnjëherë një term i mirëfilltë që të tregojë aktin e vërtet të `jo-dhunshëm`. Procesi edukativ, në të gjithë shtrirjen e tij që tejkalon hapsirat e klasës së zhvillimit të orëve mësimore duke përfshirëmedian e informimit të masës, librat letrar dhe artistik, teatrin, kinemanë, duhet të bëhen ndërmjetës të delegjitimizimit të dhunës në të gjithë skenaret e trashëgimisë kulturore dhe sociale. Kërkesa për njëmision të tillë do të bazohet sërisht në burimet e traditës ku në çdo kulturë gjenden forca dhe potenciale të paqta për të sjellë ndryshimin. Është vetem në kuadrin e përgjithshëm të pikëpamjeve të tilla që do të mund tëmarrë formë një shoqëri e re pa memorien tragjike dhe triumfatore të dhunës. Dhuna nga Partneri Intim (Intimate Partner Violence IPV) konsiderohetsi një fenomen me efekte shkatërruese kundrejt grave, fëmijëve dhe burrave (L. S. Kimberg, 2008). Jo gjithmonëky fenomenështë parë i lidhur me të gjitha pjesët e shoqërisë. Ai konsiderohet si një problem social i shtrirë në të gjithë botën që prek dhe dëmton mirëqënien e grave në grupmosha të ndryshme. F. G. Kouyoumdjian., at. al. në 2013 e kondideron atë si një sjellje,brenda një lidhje intime, që shkaton dëme fizike, seksuale apo psikologjike, duke përfshirë këtu akte të agresionit fizik, detyrimit seksual, abuzimit psikologjik dhe sjellje kontrolluese. Kyështë një

përkufizim që sot anembanë i atashohet konceptit të dhunës nga parntneri intim origina e së cilësështë, sipas studimeve ndërkulturore të Organizatës Botërore të Shëndetit, dhuna brënda familjes. Gjithnjë sipas Organizatës Botërore të Shëndetit (WHO, 2008) shkalla botërore e përqindjes në shpërndarje të dhunës së eksperimentuar në familje kundrejt grave varion nga 15 % deri në 71%. Nëse këto përqindje do t`i referoheshin eksperincave të shkuara të dhunës atëhere këto shifra variojnë nga 4% derinë 54%. Akoma dhe më të larta priten të jenë vlerësimet nëse i referohemi dhunës psikologjike dhe kontrollit të sjelljes. Në këtë kuadër IPV është jo vetëm një fenomen me shtrirje botërore por edhe me konseguenca të konsiderueshme në dëmet fizike dhe psikologjike të viktimës duke u konsidruar kështu dhe si njëproblem i madh për shëndetësinë (J. Ntaganira., at. al, 2008). Leander. at. al. (2012), referon se sipas Bordit Nacional Suedez mbi Shëndetin dhe Mirëqënien në 2006, ndër shpenzimet vjetore të lidhura me çështjet e dhunës në familje, të cilat në Suedi kapnin një vlerë që shkonte deri në 3.3 billion SEK, 38 milion SEK lidhen vetëm me kostot mjekësore. Sipas këtyre të dhëna tëkohëve të fundit në Suedi ka një rritje të ndjeshme të denoncimeve në polici nga pjesa më e re e popullatës, të lidhura me rastet e përdhunimeve dhe dhunën në ambjentet e punës, sidomos kjo duke u krahasuar me tirdhjetë dhe dyzet viteve më parë. Gjithashtu statistikat spitalore në Suedi, tregojnë një rritje të numrit të asistencës së kërkuar për rrjedhojë të sulmeve me natyrë seksuale. Një problematikë tjetër e trajtuar në nivel anketimi dhe kërkimi shkencor është edhe keqtratimi igrave gjatë gjithë procesit të shtazanisë së tyre.M. A. Gainotti (2007) evidenton të dhënat e pasqyruara nga revista `Journal of Family Violence` (2004) dhe nga `Pan American Health Organization` (2005) siaps së cilave ky fenomen i ndjeshëm në Amerikë ka konseguenca të rënda jovetëm për nënën por mund të çojë në trauma fizike edhe tek një i porsalindur. Dhuna ndajgruas gjatë shtatzanisë lidhet me një probabilitet të lartë për traumatizim kronik të saj gjë që shoqërohet me një sintomatologji të çrregullimit nga stresi post-traumatik. Në formë ciklike kjo situatë e nëns përkeqëson aftesitë e saj për t`u kujdesur për fëmijën gjë që kompromenton shëndetin e tij, zhvillimin normal dhe marrëdhëniën e vazhdueshme me nënën. Prania e fëmijës gjatë episodeve të përsëritura të dhunës kundrejt njërit prej prindërve, është vërtetuar të jetë e asociuar me çrregullime psikologjke, varësi nga substancat narkotike dhe alkooli, sjellje kriminale dhe tentativa për vetëvrasje (A. Gainotti, 2007). Ndër çrregullimet e tjera tëshëndetit mendor që përfshijnë gratë e dhunura mund të përmendim idetë për vetëvrasjes, komorbilitetin e përbashkët mes stresit post traumatik dhe ideve për vetëvrasje si dhe çrregullime

gjinekologjike dhe obstetrike të lidhura me dhimbje kronike tëbarkut dhe lindje të parakoshme (Ntaganira, 2008). Njëtjetër problem i madh që vihet re është dhe lidhja e fortë që ekziston midis marrëdhënies me një partner të dhunshëm dhe probalilitetit për infeksione seksualisht të trasmetueshme STD dhe të virusit të imunodeficiencës njerëzore i njohur ndryshe si HIV. Nënjë studim të Decker, Silverman (2005) në identifikim e sjelljeve në rrezik për sëmundjet seksualisht të trasmetueshme dhe të HIV, lidhja midis infektimit nga këto sëmundje dhe kryerjes së një marrëdhënie seksuale të dhunshme, rezultoi në shifrën 51.6% tek adoleshentet e diagnostikuara për këto patologji. Studimi i Silverman. at. al.,(2008), evidenton faktin qëprobabiliteti për t`u infektuar nga HIV tek gratë e martuara në Indi, të cilat përjetojnë dhunë fizike dhe seksuale nga bashkëshortët e tyre është katër herë më i lartësesa tek ato gra të cilat nuk përjetojnë marrëdhënie të dhunshme. Kjo rrezikshmëri emërtohet si e dyfishtë për faktin se është e shoqëruar jo vetëm nga predispozicioni i lartë që kanë këta partnerë (meshkuj) të dhunshëm për sjellje seksuale të rrezikshme që rrisin probalilitetin e infektimit nga STD dhe HIV (marrëdhënie të pambrojtura me shumë partner) (Silverman, 2007; Decker. at.al., 2009), por edhe sepse vetë gratë e kanë të ulët nivelin e kontrollit të marrëdhënieve seksuale me parnerë të tillë. Indeksi i rrezikshmërisë për infektim nga HIV rezulton ndërkaq i pa ndikuar nga sjellja e rezikshme seksuale e vetë grave (marrëdhënie e pa mbrojtur dhe me shumë partnerë). Kyrezultat vjen si rrjedhojë e faktit se përqindja e grave indiane të cilat kanë më shumë se një partner seksual është shumë e ulët. Ky fakt është konseguencë e diferencimeve gjinore që në Indi prekin së shumëti sferën seksuale. Këto evidenca të kontekstit Indian përmbysen në rastin e grave afrikane ku, sipas të dhënave, 44 përqind e atyre grave që frekuentojnë konsutorët e paralindjeve, rezultojnë të kenë patur më shumë se një partner sekusual gjatë jetës. Për këto arsye, tek gratë indiane, mund të thuhet se infektimi me HIV i tyre është i lidhur me nivelin e marrëdhënieve të pa mbrojtura jashtëmartesoretë bashkëshortëve të tyre si dhe me marrëdhëniet seksuale të dhunshme me ato vetë. Një tjetër problem i tërthortë i dhunës në kontekstin familjar i referohet konseguencave të përhershme tek gjeneratat e reja. Dhuna e asistuar nga fëmijët, e cila është në vetvete një formë keqtrajtimi ndaj tyre, ka jo vetëm pasoja të shtrira në kohë por shihet dhe si një element trashëgimi të dhunës nga një gjeneratë në tjetrën(A. Gainotti, 2007). Ky aspekt trasmetues i dhunës bën që të kapërcehen kufijtë e kontekstit familjar dhe të shfaqet në format e dhunës karshi shokëve të shkollës, miqve dhe madje edhe ndaj mësuesve. Baldry (2003) thekson faktin se fëmijët që janë të ekspozuar ndaj dhunës në familje kanë gjasa të larta që,jo vetëm të shfaqin sjellje

bulizmi karshi moshatarëve të tyre në shkollë, por edhe të jenë vetë viktimë e ketyre sjelljeve nga të tjerët. Kjo e fundit shfaqet në 71% të rasteve tek fëmijët e prekur nga dhuna e asistuar dhe është e lidhur me nivelet e ulta të vetëvlerësimit, frikës dhe depresionin që i shoqëron nëkontekstin familjar. Sipas Naqin dhe Tremblay (2001) ekziaton një raport shumë i fort parashikues midis niveleve të larta të hiperaktivitetit dhe kundërvënies së fëmijëve nëpër kopshte së bashku me zhvillimit në proporcion me rritjen të niveleve të agresivitetit. Ky rezutlat dhe mbi të gjitha identifikimi i një marrëdhënie domethënëse midis trajekrores së agresivitetit të fëmijës dhe moshës së hershme (në adoleshencë) të prindërimit tek nënat me nivel të ulët arsimor, janë dy gjetje të rëndësishme në studimin me djemtë e grupmoshës 6-15 vjeç të kampionit Kanadez. Rezultateve të studimeve më lartëi bashkangjiten ato mbi sjellet e bulizmittë shfaqura nga djemtëdhe tërinjë nëpër shkolla të lidhura me nivelet e ulta të përshtatjes sociale dhe me probabilitetin e lartë për të qënë parashikues të një sjellje prej parneri intintim të dhunshëm gjatë moshës së rritur (Nansel. at. al., 2001; L. Falb. at. al., 2011). Ekziston një lidhje shakakësore midis ekspriencave të vështira gjatë rritjes dhe sjelljes së dhunshme ndaj parnerit (L. Falb. at. al., 2011). Këto eksperinca përfshijnëjo vetëm dhunën e asistuar midis prindërve, por edhe eksperienca të mirëfillta dhune dhe abuzimi seksual gjatë fëmijërisë, ekspozim ndaj komunitete të dhunshmë dhe pjesëmarrje në grupe delinkuente të të rinjve. Sjella e bulizmitnëpër shkolla përkufizohet si njëagresion i përsëritur fizik ose psikologjik ndaj një nxënësi tjetër, i cili përceptohet nga ana e agresorit si më i dobët dhe më pak i fuqishëm se ai vetë (Baldry, 2003). Sipas L. Falb. at. al., (2011), burrat të cilët tregonin për sjelljet e tyre tëbulimit në shkollë, gjatë fëmijërisë, kanë më shumë gjasa të jenë të dhunsëhm fizikisht dhe seksualisht me partneret e tyre aktuale. Ky rezultat shihet si një evidence e lidhjes së drejtpërdrejtë midis selljeve të shpeshta tëbulizmittek fëmijët dhe predispozicionit që kjo krijon për të ardhmen si një parner intim i dhunshëm. R. Nansel, at. al, (2001) raporton se sjellja e bulizmitështë më e përhapur tek meshkujt sesa tek femrat dhe më shumë tek të rinjtë e shkollave 9-vjeçare sesa tek ata të shkollës së mesme. Fenomeni i bulizmitështë një problem shumë serioz në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shfaqet në forma të ndryshme tek meshkujt dhe tek femrat. Tek meshkuj janë ndër më të zakonshmet format e bulizmitfizik dhe verbal, kurse tek femrat predominojnë provokimet, komentet negative seksuale dhe thashethemet mbi personin e piketuar. Në Shqipëri ka një ndërgjegjësim në lidhje me fenomenin e bulizmiti cili refletohet në aktivizimin e organeve drejtuese nëvend për hartimin e programeve edukativo-ndërgjrgjësuese, raporteve nga organizata të ndryshme

në mbrojtje të të drejtave të fëmijës dhe punës akademike në kuadrin e kërkimit dhe analizës lidhur me situatën në vend. Megjithaë vazhdojnë të mbeten të pakta inisiativat e ndërmarra nga këto institucione në kuadrin e reduktimit të këtij fenomeni nëpër shkollat e Shqipërisë. Ndër problematikat kryesore që studimet e pakta parashtrojnënë lidhje me këtë fenomen në Shqipëri përmendin: mungesën e informimi të duhur të mësuesve dhe drejtuese të instituoneve shkollore ecila çon në mos perceptimin e këtij fenomeni dhe për pasojënë indifenetizëm apo në të kundërt në qëndrime rastësore dhe ekstreme ndaj akteve të vënanë veprim (Hasekiu, 1997; Karaj, Kashahu, 2014), lidhjen e këtij fenomeni me nivelin socio-ekonomik, origjinën e prejardhjes së familjes si dhe paragjykimet/ perceptimet e preferencat seksuale të të riut viktimë të bulizmit (ALO 116, 2013; Karaj, Kashahu, 2014). Parandalimi i këtij fenomeni në kontekstin tonë shihet i lidhur me përgatitjen e aktiviteteve sensibilizuese tek nxënësit, të manualeve për identifikimin dhe trajtimin e bulizmit nga mësuesit si dhe pasurimi i kurrikualve të lëndëve edukative dhe sociale me njohuri të nivlit të ndryshëm në këtë kuadër (Karaj, Kashahu, 2014). Pavarësish dëshirës së mirë për të sensibilizuar dhe edukuar të rinjë e shkolla 9-vjeçre dhe gjimanazeve mbi çështje të lidhura me dhunën në tërësi, në Shqipëri mbetet akoma për t`u bërë një punë e jashtëzakonshme kryesisht për pjesën e fuqizimit dhe aktivizimin e të rinjve si promotorët kryesor kundër dhunës tek të gjithë moshatarët e tyre. Deri më taniështë bërë një punë e mirë në kuadrine promovimit dhe të ndërgjegjësimit të të rinjve për çështjet e dhunës në familje, dhunës në ambjentet e shkollë dhe dhunës me baza gjinore. Në këtë kuadër roli promovues i OJF-ve ka qënë thelbësor duke u shëndëruar në katalizatorët primar të cilat me ndihmën e ministrive, dejtorive të shkollave nëpër rrethe dhe vetë institucioneve të arsmit parauniversitar, kanë realizuar informinim dhe ndërgjegjësimin e nxënësve të shkollave mbi fenomenet e dhunës ndër vite. Duke patur parasysh të gjitha aspektet positive dhe negative që kanë karakterizuar realizimin e një procesi të tillë, të zgjatur ndër vite, si dhe sfidat që padiskutim mbeten akoma për t`u superuar, mund të themi se në përgjithësi jemi në një pikë të mirë informimi tek të rinjë mbi konceptin e dhunës në përgjithësi, dhunën ndaj të rinjve në kontekstin e familjes dhe të shkollës, dhunën me bazë gjinore, raciale, etnike dhe diçka më pak për dhunën me natyrë homofobike. Një pjesë e mirë e të rinjve në të gjithë territorin e Shqipërisë kanë informacion mbi karakteristikat e gjitha këtyre formave të dhunës dhe njohin institucionet shtëtërore dhe pivate ku mund të drejtohen për tëdenoncuar dhe për tëpërfituar ndihmë. Mbetet si një objektiv i ripër realitetin Shqiptar aktivizimi real dhe fuqizimi i këtyre të rinjve si promotorët më të rëndësishëm kundra këtij

fenomeni jovetëm me bashkëmoshatarët në kontekstin e tyre shkollor, por pse jo dhe më gjerë në familje, komunitet dhe shoqëri në tërësi. Kjo sfidë ka nevojë për një ndërhyrje multifaktoriale që përfshin përmirësimin e vetë kurrikulës shkollore, edukimin dhe trajnimin e drejtuesve, mësuesve dhe psikologeve të shkollave si dhe integrimin e programeve afatgjata për fuqizimin e të rinjve në të gjitha format e shfaqes së fenomenit dhunë. Në lidhje me këtë aspekt eksperienca që vjen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikëspërfshin studime, një pjesë e të cilave me *follow-up* disa vjeçar, që i referohen programeve të ndërhyrjes tek fëmijët e moshës parashkollore dhe shkollore (J. Reynolds, at. al., 2001; A. Mytton, at. al., 2002). Shqipëria numëron gjithashtu edhe një sërë inisiativash disa vjeçare për ndërgjegjësim dhe reduktimin e dhunës nga mësuesit e shkollave si dhe të parandalimit të dhunës me bazë gjinore tek djemtë e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme. I tillëështëPromovimi dhe përvetësimi i Mënyrave të Reja të Disiplinës (MRD), në kuadër të zbatimit të Programit Komunikim për Ndryshimin e Sjelljes (Grillo, Hima,2012) i cili riprodhon gjithashtu idenë e një edukimi të brendësuar dhe të vazhdueshëm kundra dhunës. Themelimi i `Jo-Dhunës` fillon me gjenerimin e një sistemi arsimor qëështë promotor i qëndrimeve dhe të vepruarit miqësor, positiv dhe paqësor të mësuesve, në programet që nxisin qytetarinë e të rinjve në kontekste familjare, komunitare dhe kulturore të distancuara prej dhunës dhe projektimeve të saj. Në këtë program me jetëgjatësi katër vjeçare forma e re edukative realizohet nëpërmjet katër aspekteve komunikuese (Ndalo, Pyet, Përfshij dhe Ndërmerr) të përfaqësuara nga akronimi PEET. Edukimi i nxënësve fillon në radhë të parë me disiplinimin në radhë të parë të mësuesve drejt proceseve të komunikimit që frenojnë dhe kontrollojnë sjelljet e dhunshme. Pausat përpara çdo veprimi impulsiv, të pyeturit dhe të biseduarit mbi rastet në gjykim, përbëjnë parakushtet e nevojshme për një sjellje sa më pak derogative, agresive dhe dhunuse. Pavarësisht shëmbullit të një inisitivave të suksesshme, akoma shumë mbetet për t`u bërë sidomos në aspektet që lidhen me dhunën e të rinjve ndërmejt tyre dhe specifikisht atë me baza gjinore. Puna efektive e realizuar deri më tani në këtë drejtim lidhet me aktivitetin sensibilizues të OJF-ve me djemtë e klasave të nënta dhe të shkollave të mesme të territorit të Shqiprisë. Këto aktivitete konsistojnë kryesisht nëËorkshope me njëkohëzgjatje pej disa orësh për realizimin e të cilave nuk ekziston detyrimi për të ndjekur manuale dhe startegji standarde me impakt të lartë veprimi.Në pjesën më të madhe të rasteve trajnuesja/si respektonkriteret e informimit mbi tipologjitë e ndryshme të dhunës me baza gjinore, konseguencat psiko-fizike të saj tek i dhunuari, roli i institucionetve në ndimë të viktimave të dhunës si dhe ndryshimet

në lesgjilacion dhe masat që ndërmeren për ndalimin e agresorëve. Ngelet në mirëbesimin ndaj kapaciteteve, informimit dhe eksperiencë së trajnueses/sit prespektiva për të përcjellë kompleksitetin në tërësi të çështjes me qëllim që aktiviteti të ketë një impakt afatgjatë tek të rinjtë. Një shembull konkret ëorkshopi me djemtë kundra dhunës me bazë gjinoreështë ai i zhvilluar në shkollën 9-vjeçare në komunën Domë të Tiranës[46]. Fazat e palanifikuara në qëllim të këtij funksioni u organizuan rreth përcjelljes tek të rinjtë të konceptit të empatisë ndaj tjetrit; në ilustrimini e dhunës fizike, psikologjike, emocionale dhe ekonomike; në konseguencat fizike dhe psikologjike afatgjata që lë ekspozimi ndaj dhunës; në institucionet përgjegjëse për denoncimin, parandalimin dhe integrimin e viktimave të dhunës; në legjislacionin në favor të viktimave të dhunës; në konceptin e `Dashurisë`, bazuar në modelin e trekëndëshit të dashurisë së kompletuar të Sternberg[47], si një dimension i rëndësishëm dhe kompleksiv i jetës njerëzore qëgaranton kontrollin e sjelljeve agresive ndaj parnerit intim. Të gjitha këto faza u shoqëruan nga ilustrimet e rasteve konkrete, diskutime të orientuara të nxënësve, teknikën e plotësimit të vendit bosh në fjali, me listim dhe ilustrim të termave, role play dhe stimuj simbolik për zhvillim e aktiviteteve krijuese (zhvillimi i një loje në fushën e futbollit).

Përmirësime të ndejshme do të kishte në zhvillimin e aktiviteteve kundra dhunës me bazë gjinore nëse organizatat dhe institucionet e arsimit do të bazoheshin në programe të mirëfillta të zhvilluara në kuadër të bashkëpunimit midis organizatave prezente në disa vende të botës. Një program i tillë është Promovimi i Sensibilizimit në Parandalimin e Dhunës Gjinore nëpërmjet Edukimit midis te Njëjtëve (Pana, Lesta, 2012)[48]. Karakteristikat që diferencojnë programet e tillë përfshijnë një shtrirje tëkonsiderueshme në kohë, seksione të ndara gjatë të cilave të zhvillohen në periudha të mirëpërcaktuaraaktivitete komplementare me njëra-tjetrën, trajnimi i të rinjve si ekspert të ardhshëm të

[46] Workshopi është në kuadër të projekteve të Linjës së Këshillimit për Gra dhe Vajza (2014) të organizuara dy herë në vit dhe gjatë të cilave parashikohen aktivitete me djemtë e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme me temë parandalimin e dhunës me bazë gjinore. Inisiativa të tilla aktiviteteve lidhet me predispozicionin e lartë të djemëve në këtë periudhë të zhillimit për t`u identifikuar me rolin e agresorit në marrëdhëniet e tyre me gjininë tjetër.

[47] Trekëndëshi i dashurisë së kompletuar të Sternberg, përfshin elementët e pasionit, intimitetit dhe impenjimit.

[48] Organizatat partnere që kanë marrë pjesë në përpilimin e këtij projekti janë: European Anti-Violence Netëork (EAVN), Grecia; Casa delle Donne per non Subire Violenza, Italia; Women's Issues Information Centre (WIIC), Lituania; Centre of Research in Theories and Practices that Overcome; Inequalities (CREA), Universitàdi Barcellona, Spagna

promovimit kundra dhunës me baza gjinore tek grupet e tëngjashmëve, njohje e thelluar dhe e detajuar e gjithë aspekteve që përbëjnë dhunën me bazë gjinore mes të rinjve si dhe fuqizimi i tyre duke u bërë agjentët primar të ndryshimit mes bashkëmoshatarëve dhe komunitetit në tërësi, përdorimi në bazë seksionesh i ushtrimeve të lidhura me vlerësimin e qëndrimeve dhe sjelljeve, të temave për diskutim, të ushtrimit mbi`të jetuarin në një kuti`, të skenareve të dhunësme bazë gjinor, tërole-play, barainstrom dhe aktivitete laboratorike si prezantim filmi, ekspozita me fotografi dhe postera, shkrime lirike dhe artikuj të ndryshëm, spektakle teatrale, diskutime dhe intervista të nxënësve të trajnuar në radio dhe televizione qëndrore dhe lokale.

PËRMBLEDHJE

Edukimi i të rinjve brënda strukturave arsimore po shihet gjithnjë e më shumë gjatë këtyre viteve të fundit si njëproces që implikon epistemologjitë reja udhërëfyese në sistemin edukativ në tërësi. Është nevoja ta konsiderojmë edukimin nga një qasje e re dhe me një frymë paqeruajtëse. Vlerësimi i trashgimive kulturore epike karshi pjesës më lirike, i heronjve të përgjakshëm dhe atyre shpirtëror, i politkave luftarave dhe atyre diplomatike duhet të barazpeshohet e madje të shkojë me kohën drejt një bilanci më pozitiv të ekperiencave dhe formave më të paqta.Rrëfimet e historisë nëpër shkollat duhet t`i mundësojë fitores shpirtërore dhe fitores së `Jo-dhunës` hapsirat e nevojshme për krijimin e njeriut të lirëtë së ardhmes. Modelet e heronjëve kundërshtar tëdhunës do të vjinë sërisht nga e shkuara historike e trashëgimisë kulturor të një kombi por do të lexohen me frymëm e re të një konteksti paqësor që e merr hovin nga filozofia e Gandit, Martin Luter King dhe e Nelson Mandelës. Ashtu siç thotë Aldo Capitini[49] "*historianët duhet të njohin që nga pikëpamja historike nuk është e saktë që paqësori humbet gjithmonë dhe se i dhunshmi fiton gjithnjë……Spartaku dhe njerëzit e tij nuk fituan aspak: kurse Gandi fitoi pa i prekur asnjëfije floku ushtarëve anglez dhe familjeve të tyre në Indi dhe Uilliam Pen ku u prezantua me miqtë e tij `Quakers` tek lëkurëkuqët, pa asnjë armatim, udhëheqësit e tyre i hodhën tutje armët, e lindi kështu një gjëndje paqeje që dallonte nga tëgjitha të tjerat e Amerikës së Veriut. Ekzistojnë fitore edhe pa dhunë"*. Natyrisht, rrugëtimi

[49] *Psicologia della nonviolenza. A cura di Filippo Trasatti.* http://www.ficemea.org/IMG/Pedagogie_de_la_nonviolence_40TEMA.pdf.

drejt një të ardhme të tillëmbetet akoma i gjatë dhe kërkon kohën e tij të duhur për të edukuar vetëdijen e jo-dhunës tek të rinjtë. Procesimi mbetet i ngadalshëm, por nëmomentin kur ai ndodh gjasat janë të jetë i qëndrueshmën dhe i përhershëm. Derisatë vendosen kurrikula të tilla që do ta kthejnë në prioritet çarmatosjen e mendimit, duhet të vazhdojë një punë e fortë sensibilizimi dhe fuqizimi kundra çdo akti të dhunshëm të shprehur në çfarëdollojë konteksti. Më konkretisht, në lidhje me edukim kundra dhunës me baza gjinore, tek djemtë e shollave 9-vjeçare dhe të mesme, eksperinca botërore i gjykon si mjaftë të efekshme programet afatgjata të trajnimit të kësaj grupmoshe. Një i tillëështë programi Promovimi i Sensibilizimit në Parandalimin e Dhunës Gjinore nëpërmjet Edukimit midis te Njëjtëve ` Youth 4 Youth`e Pana, Lesta (2012). Karakteristika më interesante e tij është ndarja në gjashtë seksione secila prej të cilave ka një obiektiv specifik formues. Nëseksionin e parë, nxënësit njihen me konceptin e roleve gjinore dhe me pritshmëritë që ndërtohen mbi këto role nga ana e familjes, komunitetit dhe mjeteve të komunikimit të masës. Ata mësojnë gjithashtu të shohin me një pikëpamje sa më kritike rolet gjinore të ngurta si dhe çështjet e pabarazisë që ato mbartin. Seksioni i dytë, trajton çështjen e dhunës gjinore në kontekstin e shkollës. Ky informacion jepet nëpërmjet kalimit nga një koncepti më i gjerë i dhunës me baza gjinore për tek bulizmi gjinor nëpër shkolla. Seksioni i tretë, trajton konceptin e dhunës gjinore brënda marrëdhënive intime. Objektivi i kësaj faze është t`i mësojë nxënësit të shmangin percetimet romantike mbi dhunën të lidhura kryesisht me elementet psikologjike të saj. Në seksionin e katërt fillon trajnimi për t`u bërë një edukator mes të ngjashmëve. Qëllimi është të përcillen të gjitha njohjet dhe kompetencat për t`u bërë operatorë të ardhshëm që do të veprojnë në ambjentet e tyre shkollore. Seksioni i gjashtë, lidhet me aplikimin e mirëfilltë të nxënësve të trajnuar si edukator mes të ngjashmëve. E rëndësishme në këtë fazëështë vendimarrja e lirë e studentëve-trajner mbi aktivetet dhe numrin e seksioneve që do tëzhvillojnë me bashkëmoshatarët e tyre. Faze e fundit, qëështë edhe ajo më argëtuesja, janë aktivitetet artistike dhe të*follow-up* gjatë të cilave student përgatisin pjesë artisitike, filmike dhe ekspozita me karakter të ndryshëm në funksion të komunikimit të gjithanshëm me të ngjashmit e tyre. Shtrirja e një programi të tillë zgjat për një kohë disa mujorëshe dhe ka një efekt prej `topi të dëborës` tek të rinjtë që do të angazhojë. Modeli i tij bazohet mbi mendësitë e reja të mësimdhënies sipas së cilave,*training* dhe praktika janë eksperiencat më efikasëse për përvetësimin e kompletuar të dijes. Jo më kotë nuk i thonë`eksperienca është mëma e dijes`.

BIBLIOGRAFI

A. C. Baldry., 2003. Bullying in schools and exposure to domestic violence. Child Abuse Negl. 27, (7), 713-732.

A. Delle Fave., 2007. La condivisione del benessere. Il contributo della psicologia positive. FrancoAngeli s.r.l., Milano, Italy.

A. J. Reynolds, J. A. Temple, S. Ou, D. L. Robertson, J. P. Mersky, J. W. Topitzes, M. D. Niles., 2007. *Effects of a School-Based, Early Childhood Intervention on Adult Health and Well-being*. Arch Pediatr Adolesc Med, vol. 161, 8, p 730-739.

A. Pana, S. Lesta., 2012. Youth4Youth. Promuovere la sensibilizzazione nella Prevenzione della Violenza di Genere tramite l'Educazione tra Pari. Istituto Mediterraneo sugli Studi di Genere, Nicosia, Cyprus.

D. Grillo, F. Hima., 2012. *Parandalimi i Dhunës si Mënyrë Edukimi në Shkolla*. Konferenca Shkencore:Dhuna kundër Fëmijëvenë Shqipëri. Si e parandalojnë dhunën kundër fëmijëve sistemi i mbrojtjessociale dhe shërbimet sociale në Shqipëri? PEGI, Lundër, Tiranë, Albania, p 96-102.

D. S. Nagin, R. E. Tremblay., 2001. *Parental and Early Childhood Predictors of Persistent Physical Aggression in Boys from Kindergarten to High School*. Archives of General Psychiatry, vol. 58, 4, p 389-394.

F. Hasekiu., 1997. Bullying: Incidence, Impact, and Intervention. Faculty of Education Sciences, Department of Psychology, "Aleksander Xhuvani" University, Elbasan, Albania.

F. G. Kouyoumdjian, L. M.a. Calzavara, S. J.a. Bondy, P. O'Campo, D. Serwadda, F. Nalugoda, J. Kagaayi, G. Kigozi, M. Wawer, R. Gray, Rond., (2013). *Intimate partner violence is associated with incident HIV infection in women in Uganda*. AIDS, Volume 27, 8, p 1331–1338.

J. G. Silverman, M. R. Decker, N. A. Kapur, J. Gupta, A. Raj., (2007). *Violence against wives, sexual risk and sexually transmitted infection among Bangladeshi men*. Sexually Transmitted Infections, vol 83, 3, p 211-215.

J. G. Silverman, M. R. Decker, N. Saggurti, D. Balaiah, A. Raj., (2008). *Intimate Partner Violence and HIV Infection Among Married Indian Women*. JAMA, vol. 300, 6, p 703-710.

J. Ntaganira, A. S. Muula, F. Masaisa, F. Dusabeyezu, S. Siziya, E. Rudatsikira., (2008) E. *Intimate partner violence among pregnant women in Rwanda*. BMC Womens Health, 8, 17.

J. A. Mytton, C. DiGuiseppi, D. A. Gough, R. S. Taylor, S. Logan., 2002. *School-Based Violence Prevention Programs. Systematic Review of Secondary Prevention Trials*. Arch Pediatr Adolesc Med, vol. 156, 8, p 752-762.

K. L. Falb, L. McCauley, M. R. Decker, J. Gupta, A. Raj, J. G. Silverman., (2011). *School Bullying Perpetration and Other Childhood Risk Factors as Predictors of Adult Intimate Partner Violence Perpetration*. Archives Pediatrics Adolescent Medicine, vol. 165, 10, p 890-894.

K. Leander, M. Berlin, A. Eriksson, K. Gillandergadin, G. Hensing, G. Krantz, K. Swahnberg, M. Danielsson., (2012). *Violence. Health in Sweden: The National Public Health Report 2012. Chapter 12*. Scandinavian Journal of Public Health, 40, 9, 229–254.

L. Kashahu, Th. Karaj., 2014. *Perceptimet dhe Qëndrimet e Mësuesve dhe Drejtuesve të Shkollave 9-Vjeçare mbi Fenomenin e Bullizmit*. BJES, vol. 6, 1, p 35-48.

L. S. Kimberg., (2008). *Addressing Intimate Partner Violence with Male Patients: A Review and Introduction of Pilot Guidelines.*Journal of General Internal Medicine, vol. 23, 12, p 2071-2078.

M. A. Gainotti., (2007). *La violenza domenstica*. Comunicazione presentata alla Giornata di Studio“ I Centri Antiviolenza a Roma e in Italia: prassi e ricerca”. Facoltà di Scienze della Formazione – Università di Roma Tre.

M. Catarci (2013), Il pensiero disarmato: La pedagogia della nonviolenza di Aldo Capitini. EGA, Torino, Italy.

M. R. Decker, G. R. Seage, D. Hemenway, A. Raj, N. Saggurti, D. Balaiah, J. G. Silverman., (2006). *Intimate Partner Violence Functions as both a Risk Marker and Risk Factor for Women's HIV Infection: Findings from Indian Husband-Wife Dyads.*J Acquir Immune Defic Syndr, vol. 51, 5, p 593-600.

M. R. Decker, J. G. Silverman, A. Raj., (2005). *Dating violence and sexually transmitted disease/HIV testing and diagnosis among adolescent females.*Pediatrics, vol. 116, 2, p 272-276.

W. Naudé., (2009), «The financial crisis of 2008 and developing countries». Discussion paper no. 2009/01, United Nations University, Unu-Wider, Helsinki.

World Health Organization.,(2008). World health statistics 2008, WHO Press, Geneva, Switzerland.

ALO., 2013. Raport Analitik i ALO 116. www.alo116.al/sites/default/files/uploade/Bulizmi.pdf

Psicologia della nonviolenza. A cura di Filippo Trasatti. http://www.ficemea.org/IMG/Pedagogie_de_la_nonviolence_40TEMA.pdf